

**"PROBLEMI GJERMAN GJATË ACARIMIT TË  
MARRËDHËNIEVE LINDJE-PERËNDIM  
1945 – 1968"**

Alban Malia

Dorëzuar  
Universitetit European të Tiranës  
Shkollës Doktorale

Në përbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në  
Marrëdhënie Ndërkombëtare, për marrjen e gradës shkencore "Doktor"

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr. Roland Lami

Numri i fjalëve: 82.814

Tiranë, Dhjetor 2019

## **DEKLARATA E AUTORËSISË**

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky studim është punuar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër shkencor apo arsimor për vlerësim. Deklaroj gjithashtu që, sipas rregullave akademike dhe etike, kam cituar dhe referuar materialet që nuk janë punë origjinale e imja.

## **ABSTRAKTI**

Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore dhe fillimi i Luftës së Ftohtë pasi në qendër të tyre negociatat dhe problemet që dolën ndërmjet fuqive fituese të luftës për problemin e Gjermanisë. Siç e tregoi koha, ky problem ishte mjaft kompleks dhe i vështirë. Problemi i ndarjes apo i bashkimit të Gjermanisë ishte çështja më thelbësore që do të përcaktonte stabilitetin politik të globit në gjysmën e dytë të shekullit XX. Çështja gjermane ishte një faktor me rëndësi përcaktuese në epokën e Luftës së Ftohtë dhe veçanërisht në fillimet e saj. Punimi i mëposhtëm tregon sesi u nda Gjermania nga fituesit e Luftës II Botërore, si u përcaktua e ardhmja e saj dhe sesi ndarja e saj nuk ndihmoi në qetësimin e raporteve ndërmjet Lindjes komuniste dhe Perëndimit kapitalist. Punimi që po ju paraqesim është historik-analitik ku përfshihen elementë politikë dhe diplomatikë thelbësorë për të njojur marrëdhëni ndërkombëtare të periudhës së filimit të Luftës së Ftohtë.

**Fjalët çelës:** Gjermani, SHBA, BS, politikë, diplomaci, marrëdhënie ndërkombëtare, Luftë e Ftohtë.

## **ABSTRACT**

The period between the end of the Second World War and the beginning of the Cold War is the core of the problems and negotiations that have emerged between the victorious powers of the war over Germany's problem. Time has told us that this problem was quite complex and difficult. The problem of the separation or unification of Germany was the most fundamental issue that would determine the political stability of the world in the second half of the 20th century. The German issue was a determining factor in the Cold War era and especially in its beginnings. The following paper shows how Germany was separated by the winners of World War II, how its future was defined, and how its division did not help to tranquilize relations between the Communist East and the capitalist West. The work presented is a historical-analytical one that includes essential political and diplomatic elements to understand the international relations of the Cold War era.

**Key words:** Germany, US, SU, politics, diplomacy, international relations, Cold War.

## **DEDIKIMI**

Dedikimi shkon për babain tim, i cili me dijen, përvojën dhe aftësitë që ka akumuluar gjatë jetës së tij, nuk është kursyer asnjëherë që të më mbështetesë në çdo kohë e çdo rrethanë, dhe duke më ndihmuar gjithmonë që të bëj zgjedhjet më të mira për arritjen e objektivave.

## PËRMBAJTJA E LËNDËS

### Kapitulli I – Hyrje - Muajt e konferencave të mëdha, shkurt - tetor 1945

1.1. Hyrje	7
1.2. Përgatitjet për ndarjen e botës gjatë dhe pas mbarimit të luftës	8
1.3. Konferenca e Jaltës dhe mosmarreveshjet e para mes fituesve të ardhshëm	14
1.4. Konferenca e Potsdamit	18
1.5. Konferenca e Londrës e viti 1945	22

### Kapitulli II: Modeli Analistik i Temës + Skeleti Teorik

2.1. Metodologjia dhe analiza politike e kuadrit teorik	25
---	----

### Kapitulli III - Lindja vs Perëndimit 1946-1948

3.1. Acarimi i mëtejshëm i mosmarrëveshjeve	37
3.2. Ndarja e Evropës në dy pjesë ideologjike	39
3.3. Dilemat për bashkimin e Gjermanisë	41
3.4. SHBA-ja, Britania e Madhe dhe Franca bashkojnë zonat e tyre të pushtimit	45
3.5. Bashkimi Sovjetik dhe epoka atomike	55
3.6. Problemi gjerman	61

### Kapitulli IV - Gjermania e ndarë mes dilemave 1947 – 1949

4.1. Dilemat sovjetike dhe perëndimore	64
4.2. Bllokada e Berlinit	67
4.3. Reformë financiare në zonën perëndimore gjermane	71
4.4. Ura ajrore	73
4.5. Stalini i jep fund bllokadës së Berlinit	79
4.6. Përpjekjet për krijimin e një shteti të ri gjerman	81
4.7. Konrad Adenauer, kancelari i parë i RFGJ-së	84
4.8. Valter Ulbrihti themelon Republikën Demokratike Gjermane	88

### Kapitulli V - Pasiguritë ndërkombëtare në krijimin aleancave 1950 – 1957

<b>5.1. Ndarja e Gjermanisë</b>	<b>90</b>
<b>5.2. Arsyet e krijimit të një aleance perëndimore ndaj rrezikut ushtarak sovjetik</b>	<b>93</b>
<b>5.3. Krijimi i Evropës perëndimore nga Moneja, Shumani dhe Adenaueri</b>	<b>99</b>
<b>5.4. Lufta e Koresë</b>	<b>103</b>
<b>5.5. Ndërtimi i ushtrisë gjermane (Bundeswehr)</b>	<b>109</b>
<b>5.6. Hapi i fundit i Stalinit</b>	<b>113</b>
<b>5.7. Kryengritja e Berlinit dhe eleminimi i Berias</b>	<b>118</b>
<b>5.8. Gjermania perëndimore hyn në NATO dhe ndarja e Evropës</b>	<b>123</b>
<b>5.9. Heqja e ligjit të luftës ndërmjet Gjermanisë dhe Shqipërisë</b>	<b>128</b>
<b>5.10. Parimi apo interes? - Revolucioni hungarez dhe Kriza e Suezit</b>	<b>134</b>
<b>5.11. Pikëpyetja evropiane</b>	<b>148</b>
<b>5.12. Reagimi britanik në epokën bërthamore</b>	<b>152</b>
<b>5.13. Reagimi gjerman në epokën bërthamore</b>	<b>157</b>
<b>5.13. Reagimi francez në epokën bërthamore</b>	<b>162</b>
<b>5.14. Roli i Shteteve të Bashkuara në strategjinë e NATO-s</b>	<b>165</b>

## **Kapitulli VI - Krizat e mëdha ndërkombëtare 1958 – 1968**

<b>6.1. Ultimatumi i Hrushovit për Berlinin</b>	<b>169</b>
<b>6.2. Përpjekja e Ajzenhauerit</b>	<b>176</b>
<b>6.3. Acarim marrëdhënie sh RDGJ-Shqipëri</b>	<b>180</b>
<b>6.4. Muri i Berlinit</b>	<b>185</b>
<b>6.5. Beteja për Berlinin perëndimor</b>	<b>197</b>
<b>6.6. Dueli Kenedi vs. Hrushov</b>	<b>193</b>
<b>6.7. Adenaueri, dë Goli &amp; Kenedi</b>	<b>212</b>
<b>6.8. Evropa ndahet dy herë</b>	<b>216</b>
<b>6.9. Enigmatiku dhe kontroversi dë Gol</b>	<b>220</b>
<b>6.10. Vrasja e Kenedit-komplot apo rast banal?</b>	<b>229</b>
<b>6.11. Nga Atlantiku në Urale</b>	<b>234</b>
<b>6.12. Gjermanët përballetë problemi gjerman</b>	<b>241</b>
<b>6.13. Enigma diplomatike</b>	<b>238</b>
<b>6.13. Rënia e Erhardtit dhe tranzicioni i Kiesingerit</b>	<b>248</b>
<b>Përfundime</b>	<b>257</b>
<b>Bibliografia</b>	<b>260</b>

## **Kapitulli I – Hyrje - Muajt e konferencave të mëdha, shkurt - tetor 1945**

### **1.1. Hyrje**

Epoka e katastrofës la në kujtesën e njerëzve një tragjedi të pashlyeshme. Të gjithë ata që i mbijetuan kësaj tragjedie të pashembullt në historinë e njerëzimit e patën të vështirë të ambientoheshin me një periudhë të re në jetën e tyre. Mizoria diktoriale naziste dhe 70 milion viktimat që shkaktoi, solli në vëmendje të udhëheqësve fitues të luftës një koncept të ri përsa i përket shmangies së katastofave të këtij lloji; gjithëpërfshirjen. Në fakt, ishte shumë e vështirë të imagjinoje sesi do të mund të bashkëjetonin në një rend të përbashkët botëror dy sisteme totalisht të kundërt nga njëri tjetri; kapitalizmi dhe komunizmi. Problemi i përbashkët me emrin "nazizëm" kishte bërë të mundur aleancën e çuditshme ndërmjet këtyre dy sistemeve gjatë Luftës II Botërore. Pas konfliktit më gjakatar që kishte njojur ndonjëherë historia njerëzore, lindte nevoja për një rend të ri të besueshëm ndërkombëtar i cili do të shhangte të gjitha luftërat dhe konfliktet. Rendi i Versajës i ndërtuar më 1919 për të ndëshkuar Gjermaninë, solli ndëshkimin e gjithë botës. Këtej e tutje paqja duhet të ishte e drejtë dhe askush nuk duhej të ndihej i kërcënuar.

Historia politike e gjysmës së parë të shekullit XX, solli tmerre të mëdha për popujt dhe vendet e botës. Pas përfundimit të Luftës II Botërore, popujt dhe shtetet shpresonin se tashmë problemet ishin mbyllur dhe se paqja do të mbizotëronte. Paqja, në fakt mbizotëroi vetëm në kontinentin evropian pasi në pjesë të tjera të botës, konfliktet vijuan të ekzistonin me intensitet të lartë. Përfundimi i luftës në Evropë më 7 maj 1945, vuri përballë njëri tjetrit dy superfuqi; Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Sovjetik. Kjo përballje krijoi një sistem të ri në marrëdhëni ndërkombëtare që në histori njihet me emrin "Lufta e

Ftohtë". Interesant është fakti, se të dy superfuqitë gjatë 45 viteve të ekzistencës së këtij sistemi, asnjëherë nuk do të ndesheshin ballë për ballë ushtarakisht njëri me tjetrin. Vende të dyta e të treta anembanë botës do të shërbenin si mish për top në garën për supremaci botërore ndërmjet dy superfuqive. Lufta e Dytë Botërore shërbeu si thirrje ndaj ndërgjegjes së humanizmit. Lufta e Ftohtë shërbeu për t'i kujtuar njerëzimit sesa afër ishte vetëshkatërrimi. Teknologjia ushtarake veçanërisht ajo bërthamore, do të qëndronte mbi kryet e njerëzimit si shpata e Demokleut. Evropa do të ishte përsëri në qendër të vëmendjes, por kësaj here jo me armë, por me diplomaci dhe luftë të pamëshirshme spiunazhi nga të dyja anët e perdes së hekurt. Bashkimi Sovjetik do të mbizotëronte gjysmën e Evropës, nga deti Ballistik deri në detin Adriatik duke përfshirë në orbitën e tij të gjitha shtetet që bënin pjesë në këtë zonë. Perëndimi i udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës qëndronte në anën tjetër të perdes i armatosur deri në dhëmbë për të përballuar çdo agresion të mundshëm sovjetik. Frika e shkatërrimit të plotë si pasojë e avancimit të paimagjinueshëm teknologjik solli vetëpërmbajtje dhe paqe në Evropë.

Teknologjia, informacioni, armët, njerëzimi kishin hyrë në një tjetër nivel marrëdhënieš. Në Evropë dhe në botë po lindte një brez i ri i cili sidomos në hemisferën perëndimore nuk kishte aspak dijeni për luftën dhe sakrificën e prindërve të tyre. Ndërsa pjesa tjetër e perdes së hekurt vijonte "sakrificën" e pakuptimtë. Njerëzimi po hynte në një fazë të re testimi. Shumë gjëra do të ndryshonin, por përsëri paqja do të jetonte me frikën e kërcënimit të luftës. Në këtë periudhë (1945-1968) bota iu afrua më shumë se asnjëherë tjetër apokalipsis të plotë. Po të ndodhë kjo, atëherë filozofi gjerman Imanuel Kant i shekullit të XVIII do të kishte patur të drejtë përsa i përket 'paqes së përjetshme'.

## **1.2. Përgatitjet për ndarjen e botës gjatë dhe pas mbarimit të luftës**

Në shekullin XX, asnë shtet përveç Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk pati një impakt kaq të gjerë në jetën e njerëzve. Gjermania pa dashjen e saj, ndihmoi supremacinë amerikane në gjysmën e Evropës dhe në botë. Gjatë gjysmës së parë të shekullit XX, Gjermania ra viktimë e idesë së saj për madhështi të paarritshme. Dhuna që krijoj ideologjia e "kombit të zgjedhur" dhe e "racës superiore" krijoj një tragedji të paharrueshme në ndërgjegjen njerëzore. Nga viti 1945 deri më 1990, Gjermania ndihmoi që bota të ishte më e drejtë. Ajo doli e shkatërruar plotësisht nga Lufta e Dytë Botërore dhe u gjend në qendër të vorbullës të Luftës së Ftohtë. Nuk kishte rëndësi se ku do të përplaseshin kundërshtarët ideologjikë gjatë Luftës së Ftohtë, në mendje ekzistonte gjithnjë Gjermania, pasi edhe vetë Lufta e Ftohtë filloi për hir të saj.

Ishte e pashmangshme që Gjermania të mos gabonte rëndë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ajo u krijuua më 18 janar 1871 në Sallën e Pasqyrave në Versajë nga Oto fon Bismark i mbiqaujtur kancelari i hekurt. Që të krijohej si shtet, Gjermanisë iu desh të bënte tri luftëra me tre shtete; me Danimarkën, me Austrinë dhe me Francën. Në përpjekje për të vendosur hegemoni botërore, Gjermania përfshiu globin në dy luftëra të tmerrshme botërore në gjysmën e parë të shekullit XX. Në të dyja dështoi.

Adolf Hitleri nuk ishte Bismarku. Shumë studjues mendojnë se Hitleri ishte "pjellë" e mendësisë bismarkiane që karakterizoi Gjermaninë nga fundi i shekullit XIX deri në vitin 1945. Gjermania po kalonte nga një fatkeqësi në tjetrën dhe në këto fatkeqësi të saj po përfshinte edhe Evropën dhe një pjesë të mirë të botës. Fundi i vitit 1944 tregoi se Gjermania ishte në prag të kolapsit të plotë. Lideri i saj Adolf Hitleri i cili kishte parashikuar se Rajhu gjerman i ndërtuar prej tij do të ekzistonte një mijë vjet, po shihte fundin e tij. Tërheqjet e përgjithshme gjermane në Bashkimin Sovjetik, Afrikë të Veriut

dhe Evropë ishin preludi i një katastrofe të pashmangshme për vendin. Por, Hitleri vazhdonte luftën si një lojtar shahu i nivelistë të tretë i cili nuk e pranon humbjen derisa të kapet mat (Smyser, 1999:5).

Marrëveshja e fund tatorit 1944 ndërmjet Çërçillit dhe Stalinit mbi ndarjen në Evropën Lindore e kishte bindur udhëheqësin britanik se tashmë me Stalinin duhej përdorur tjetër gjuhë. Ashtu si në fundin e epokës së Napoleon Bonapartit, Anglia u bë promotori për të vendosur një sistem të ri në marrëdhëniet ndërkombëtare i cili do të garantonte paqen pas luftës. Udhëheqësit e aleancës së madhe të cilët ishin takuar edhe në vitin 1943 në Teheran, kësaj radhe ranë dakord që të takoheshin përsëri për të vendosur mbi fatin e Gjermanisë dhe të aleatëve të saj. Në fillim të vitit 1945, aleatët perëndimorë (SHBA dhe Britania e Madhe) nuk kishin asgjë të përbashkët me Bashkimin Sovjetik përvèç dëshirës për të mundur fuqitë e Boshtit. Secila nga këto tre fuqi kishte interesat e veta. Ruzvelti ishte më tepër një idealist edhe pse karriera e tij politike kishte qenë e shkëlqyer si pasojë e pragmatizmit të treguar (Smyser, 1999:6). Njëlloj si shumica e amerikanëve ai besonte se bota nuk duhej të ndahej më në zona ndikimi. Ai nuk ndante të njëjtin mendim me sekretarin e tij të shtetit Kordell Hall (Hull) që problemet globale mund të zgjidheshin duke përmirësuar Lidhjen e Kombeve (Smyser, 1999:6).

Një mbledhje e re ndërmjet tre aleatëve të mëdhenj po dukej në horizont. Askush nga të tre nuk kishte më dyshim për fitoren përfundimtare. Takimi ishte i nevojshëm pasi do të vendosej për fatin e botës. Ruzvelti ishte i vetëdijshëm qysh në verën e vitit 1944 se do të takohej përsëri me Çërçillin dhe Stalinin (Brands, 2008:792). Në politikën e jashtme, presidenti Ruzvelt ishte bërë më i kujdesshëm që pas sulmit japonez në Përl Harbor më 7 dhjetor 1941. Ai më shumë u besonte ushtarakëve sesa diplomatëve të tij. Shefit i Shtabit të

përgjithshëm të ushtrisë, gjenerali Marshall, ishte personi të cilit Ruzvelti ia dëgjonte më shumë fjalën. Gjenerali Marshall e ka cilësuar Ruzveltin me fjalët:

“*Nën stres të madh, Ruzvelti ishte një njeri i forte*” (Persico, 2001:362).

Ai kishte rënë dakord me mendimin e gjeneralit të tij se kërkesat politike të pasluftës duhet të ishin të njësuara me nevojat e fitores (Murphy, 1964:211). Në mendjen e tij vijonte të ekzistonte mendimi se ishte e kotë të merreshe me pasluftën ndërsa lufta vazhdonte (Smyser, 1999:6). Po të ndodhët kështu, Stalini do të fitonte edhe ushtarakisht edhe politikisht. Për fatin e mirë të perëndimit, Ruzvelti nuk do të ishte vetëm kur të takohej me Stalinin për të vendosur sesi do të ishte bota e pasluftës.

Uinston Çërçill, ishte njeriu që kishte menduar njëlloj si Stalin se çfarë do të bëhej kur të përfundonte lufta. E gjithë karriera e tij politike ishte një ndërthurje ndërmjet idealizmit dhe pragmatizmit. Kryeministri britanik ishte një orator i shkëlqyer përvçe një shkrimitar i talentuar. Oratoria e tij ndihmoi në bashkimin e popullit britanik në ditën e tij më të errët të kërcënimit hitlerian. Po ashtu si presidenti amerikan, kryeministri britanik dëshironte që Bashkimi Sovjetik të ishte pjesë e aleancës së madhe deri në përfundim të luftës. Çërcilli ishte i bindur se Stalin nuk kishte asnë nga parimet demokratike të Ruzvelltit, por ç'rëndësi kishte kjo. Bashkimi Sovjetik duhej mbajtur patjetër në luftë deri në fitoren përfundimtare. Për Gjermaninë të tre liderët binin dakord. Kapitullimi duhej të ishte pa kushte. Britania e Madhe dhe Bashkimi Sovjetik kërkonin garanci në të ardhmen që vendet e tyre të mos kërcënoheshin më nga sulmet gjermane (Smyser, 1999:7).

Për të shpëtuar Evropën nga kërcënimimi gjerman, qysh në konferencën e Teheranit më 1943, Ruzvelti kishte propozuar ndarjen e Gjermanisë në pesë pjesë: 1. Prusia në verilindje; 2. Hanoveri dhe pjesa e ulët e Gjermanisë në veriperëndim; 3. Saksonia dhe zona e Lajpcigut

në lindje; 4. Hesse-Darmstad dhe Hesse Kassel në perëndim; 5. Bavaria, Badeni dhe Vyrtembergu në jug (Smyser, 1999:7). Fillimisht, Çerçilli nga ana e tij ra dakord me planin e presidentit Ruzvelt, por shtoi se çështja më e rëndësishme ishte të trajtohej me ashpërsi Prusia (Smyser, 1999:7). Nga ana e tij Stalini tha se i pëlqente ideja e ndarjes së Gjermanisë, por përpara se të jepte aprovimin e tij kishte nevojë ta studjonte më thellë problemin (Smyser, 1999:7). Nga ana e tyre, Ruzvelti dhe Çerçilli dëshironin të shmangnin gabimin e bërë nga paraardhësit e tyre në Versajë më 1919. Sipas tyre, kishte qenë pikërisht ky gabim i madh që kishte ndihmuar ardhjen në pushtet të Adolf Hitlerit dhe të nazistëve. "Mësimet e Versajës" vendosnin disa papajtueshmëri ndërmjet aleatëve të mëdhenj në takimin e tyre të radhës. Nga njëra anë Gjermania dhe Hitleri me nazistët të cilët veçanërisht duhej të ndëshkoheshin për luftën dhe pasojat e saj. Po të ndodhët kjo, do të vendoseshin në një tavë Gjermania dhe nazistët dhe përsëri kjo gjë nuk do të shërbente për të patur një paqe afatgjatë dhe përsëri gjermanët do të ktheheshin në problem për botën si pasojë e rizhytjes së tyre në ekstremizëm politik.

Megjithë dyshimet politike që karakterizonin shtetet aleate, një tjetër dyshim që i ndoqi ishte se ku do të takoheshin tre të mëdhenjtë. Udhëheqësi sovjetik Jozef Stalini, duke parë se situata në frontin lindor kishte marrë për mirë në favor të Bashkimit Sovjetik refuzonte të largohej nga Rusia (Brands, 2008:792). Presidenti amerikan Ruzvelt nga ana e tij, ishte ngurrues të shkonte në një vend komunist përpara zgjedhjeve presidenciale. Me të fituar, ai dhe këshilltari i tij më i afërt Herri Hopkins u takuan me ambasadorin sovjetik Andrej Gromiko për t'i thënë se ishin të gatshëm të takoheshin në tokën sovjetike ku të dëshironte Stalini. Hopkinsi ishte dakord që liderët të takoheshin në Krime. Stalini ishte dakord (Brands, 2008:792). Në kujtimet e tij Hopkins ka shkruar:

*"Të gjihë këshilltarët më të afërt të presidentit ishin kundër vajtjes së tij në Krime. Shumica e tyre nuk kishin besim te rusët dhe nuk e kuptonin pse Presidenti i Shteteve të Bashkuara duhej të kalonte gjysmën e botës për të takuar Stalinin" (Brands, 2008:792 vepër e përmedur).*

Po ashtu edhe Çërçilli nuk ishte dakord. Shumë shpejt amerikanët e kuptuan pse Çërçilli nuk donte të shkonte në Jaltë. Sipas kryeministrat britanik pallati Livadia ku ishte vendosur paraprakisht se do të mbahej mbledhja, kishte kaluar disa herë gjatë luftës në dorë të gjermanëve dhe rusëve. Në tërheqje e sipër, gjermanët e kishin fshirë vendin dhe hedhur në erë pallatin e vjetër të ndërtuar nga Nikolla II (cari i fundit rus). Pallati i ri i ndërtuar nga sovjetikët gëlonte nga çimkat (përgjuesit) dhe Çërçillit nuk ia kishte ëndë të përgjohej. Ruzvelti e kishte pranuar këtë vend pasi ishte shumë i përshtatshëm për sëmundjen e poliomelitit nga e cila vuante. Ruzvelti kaloi një "kalvar" të vërtetë gjatë rrugës për të mbërritur në Jaltë. Atij iu desh të udhëtonte me avion, anije dhe me makinë. Vendndalimi i tij i parë ishte në Maltë ku ushtarakët amerikanë dhe britanikë kishin marrë të gjitha masat për të mirëpritur presidentin (Brands, 2008:393). Në Maltë mbërriti edhe Çërçilli dhe të dy burrat qëndruan në ishull aq kohë sa të hanin drekë e darkë dhe të koordinohen, por jo aq shumë sa të bënин Stalinin të dyshonte për ndalesën e tyre (Brands, 2008:393). Ruzvelti mbërriti në Jaltë i pari në mbrëmje më 3 shkurt 1945. Stalini mbërriti të nesërmen në mëngjes (Brands, 2008:393).

Më 4 shkurt 1945, Stalini ftoi me solemnitet presidentin Ruzvelt të hapte konferencën në sallën e mrekullueshme të ballove në pallatin Livadia. Çërçilli dhe enturazhi i tij ishin dakord me këtë propozim të Stalinit. Presidenti Ruzvelt falenderoi udhëheqësin sovjetik për dashamirësinë e tij dhe shtoi se:

*"...ka shumë vend për të diskutuar, të gjithë hartën e Evropës" (Brands, 2008:794 vepër e përmedur).*

Me një marrëveshje xhentëllmenësh, dita e parë e konferencës u përqendrua vetëm në luftën kundër Gjermanisë. Stalini ftoi gjeneralin Aleksej Antonov për të prezantuar një raport lidhur me ecurinë e luftës në frontin lindor (Brands, 2008:795). Për anën amerikane dhe britanike pas prezantimit të gjen. Antonov, fjalën e mori gjen. Marshall. Kapërcimi i pengesës së Ardeneve i kishte afruar ushtritë anglo-amerikane në dyert e Gjermanisë (Brands, 2008:795). Dukej qartë se fati i saj ishte i vulosur.

### **1.3. Konferenca e Jaltës dhe mosmarreveshjet e para mes fituesve të ardhshëm**

Secila nga të tre fuqitë kishte sjellë në Jaltë prioritetet e veta. Britanikët donin të mbanin perandorinë e tyre, sovjetikët të forconin dhe vulosnin pushtimet e tyre në Evropë dhe të shkonin sa më larg në Lindjen e Largme dhe amerikanët të futnin Rusinë në luftën e Paqësorit (Persico, 2001:390). Ky qëllim i fundit i presidentit Ruzvelt ishte një gabim i madh politik. Megjithë kundërshtimet e Çërçillit, Ruzvelti pranoi që Rusia të merrte të gjithë territorin që kishte humbur në luftën e vitit 1904-1905 kundër Japonisë. Gjithashtu, BS-ja merrte ishujt Kurile dhe gjysmën jugore të ishullit Sakhalin. Me t'u lejuar kjo, asgjë s'mund ta mbante lidhur Bashkimin Sovjetik nëse do të kishte luftë në Azi me t'u mundur Gjermania (Persico, 2001:390). Rusët ishin shumë të gëzuar nga ky lëshim pasi kërkonin shpagim ndaj Japonisë për poshtërimin e pësuar prej saj vite më parë. Në këtë atmosferë, kaloi edhe dita e parë e punimeve të konferencës. Në darkën që u shtrua në një stil tipik rus, asnjeri prej tre të mëdhenjve nuk bëri biseda politike dhe ishin në humor shumë të mirë (Brands, 2008:795).

Ditën e dytë të konferencës, realiteti u shpalos me të gjithë zymtësinë e tij. Ushtria e Kuqe kishte pushtuar pothuajse të gjithë Evropën lindore. Çërçilli dhe Ruzvelti e kuptuan se

kishin shumë pak mundësi të aplikonin stilin perëndimor të demokracisë në Poloni dhe në fqinjët e saj, por gjithsesi duhej ta provonin. Ruzvelti kërkonte me ngulm që Bashkimi Sovjetik t'i bashkohej luftës në Paqësor menjëherë apo Gjermania të kapitullonte. Stalini nga ana e tij ishte i paduruar për t'i shkëputur Ruzveltit firmën që trupat amerikane të mos qëndronin në Evropë më shumë se dy vjet pas përfundimit të luftës (Smyser, 1999:14). Nëse do të ndodhët një gjë e tillë, Britania e Madhe dhe Franca (kjo e fundit nuk ishte ftuar në Jaltë) do të ishin të ekspozuara drejtpërsëdrejti ndaj rrezikut sovjetik.

Fati i Evropës zuri pothuajse të gjithë ditën e dytë të diskutimeve. Ushtarakët e të tre vendeve paraqisin harta sesi duhej të ishin ndarë zonat e ndikimit dhe sesi transformoheshin shtetet veçanërisht Gjermania. Çerçilli shqetësohet përfatim e vendeve të vogla dhe duke parë moskokëçarjen e Stalinit lidhur me këtë çështje tha:

*"Shqiponja duhet t'i lejojë zogjtë e vegjël të këndojnë dhe të mos shqetësohet se për kë këndojnë ata" (Brands, 2008:796).*

Më këtë frazë, Çerçilli dinte të thoshte se vendet duhet të ishin të lirë të zgjidhnin atë model qeverisjeje që dëshironin dhe jo t'u imponohej nga jashtë. Padyshim, Stalini as që e çonte nëpërmend t'i linte "zogjtë e vegjël" të zgjidhnin vetë fatin e tyre. Fillimisht, që të tre udhëheqësit ishin dakord që Gjermania të copëtohej. Por Stalini ndërhyri duke thënë:

*"Çfarë lloj copëtimi? A duhet çdo pjesë të ketë qeverinë e vet" (Brands, 2008:796) ?*

Çerçilli ndaj kësaj pyetje të Stalinit bëri ndërhyrjen e tij duke thënë se:

*"Mendoj se të gjithë jemi dakord përfatim, por metoda aktuale e heqjes së vijave është tepër e komplikuar përfundosur përpesë apo gjashë dite. Kërkohen njohuri më të thella përgjegjësive historinë dhe çështjet ekonomike. Nëse dikush do të më pyeste sot sesi do ta ndani Gjermaninë, unë nuk do të dija e çfarë përgjigje t'i jepja" (Brands, 2008:796).*

Stalini e kuptoi lojën e Çerçillit. Kryeministri britanik dinte të fitonte kohë. Një gjë e tillë do të ishte tepër e dëmshme përliderin sovjetik. Përliderin, katastrofa që po mbërrhente Gjermaninë kërkonte një zgjidhje të shpejtë. Lidhur me këtë çështje a duhesin lajmëruar

gjermanët sesi vendi i tyre do të copëtohej? Një tjetër çështje që u shtrua në konferencën e Jaltës ishte a do t'i jepej Francës në Gjermani një zonë pushtimi? Franca nuk ishte ftuar në konferencë. Edhe pse gjenerali dë Gol kishte bërë disa vizita në Londër dhe Uashington përpëra konferencës, ai nuk ishte pritur as nga Çërçilli as nga Ruzvelti (Smyser, 1999:13).

Për herë të parë në historinë e saj të lavdishme politike, Franca nuk ishte ftuar të ishte pjesëmarrëse në një konferencë ku po vendosej fati i botës. Ky do të ishte edhe momenti i kthesës që do të ndërmerrte gjenerali dë Gol gjatë epokës së Luftës së Ftohtë.

Në Jaltë u ra dakord që të ndahej Gjermania, por nuk u ra dakord se kush do të paguante reparacionet e luftës. Gjithashtu, nuk u ra dakord se cila do të ishte forma e qeverisjes për Gjermaninë e pasluftës. Mos ndoshta fuqitë fituese dëshironin të qëndronin përjetë në territorin gjerman? Çërçilli dhe Ruzvelti nuk dëshironin ta ndihmonin në pafundësi Moskën. Vetëm gjatë katër viteve luftë ata i kishin akorduar Bashkimit Sovjetik 6 miliard \$ ndihma në ushqime dhe armatime (Herring, 1973). Stalini nga ky refuzim i aleatëve u tërbua. Ai u kujtoi udhëheqëve perëndimore se Bashkimi Sovjetik kishte vuajtur më shumë se kushdo tjetër gjatë luftës. Në këtë pikë, Ruzvelti ishte gati t'i bënte lëshime Stalinit, por hasi në kundërshtimin e Çërçillit. Me shumë zor, Ruzvelti pranoi të shtronte përpëra kongresit shumën prej 20 miliard \$ ndihmë për Bashkimin Sovjetik, por Çërçilli këmbënguli që asnjë shifër të mos prezantohej në deklaratën përfundimtare të konferencës (Baker, 1978:179).

Konfereca e Jaltës pati probleme përsa i përket reparacioneve. Ky fakt tronditi aleancën. Stalini u ndie u frustruar pasi e pa që nuk po fitonte dot në një kohë kur pozicioni ushtarak i Bashkimit Sovjetik ishte më i mirë se në çdo epokë. Ai e kuptoi se nuk mund të bënte gjë tjetër. Pjesën më të madhe të reparacioneve ai duhej ta merrte nga zona e Ruhrit që ishte

edhe zemra e industrisë gjermane, por që në fakt kishte rënë në zonën britanike të pushtimit. Ndërsa aleatët kishin kohë të shtynin disa prej vendimeve për Gjermaninë, ata nuk kishin fare kohë të mos merrnin vendime për Poloninë që ishte edhe tema kryesore e bisedimeve. Mbi Poloninë rëndonin dy çështje; e para kufijtë perëndimorë në të cilët prekej direkt Gjermania dhe së dyti, qeveria e ardhshme e Polonisë në të cilën nuk prekej Gjermania, por që ishte direkt i interesuar Bashkimi Sovjetik. Qëndrimi Sovjetik mbi Evropën Lindore e shtangu Çërçillin. Ai e kuptoi se kjo pjesë e Evropës do të binte nën ndikimin sovjetik. Edhe pse në tetor 1944, kishin rënë dakord me Stalinin sesi do të ishin zonat e ndikimit në Evropën Lindore, atij iu desh t'i dorëzohej vullnetit të liderit sovjetik. Tashmë, zogjtë e vegjël do të këndonin sipas oreksit të shqiponjës së madhe. Të dy liderët u ballafaquan ashpër për Poloninë. Stalini përkrahte qeverinë e themeluar në Ljublin ndërsa Çërçilli qeverinë polake në mërgim në Londër. Për fat të keq, Çërçilli nuk mund të bënte gjë në këtë drejtim, pasi Ushtria e Kuqe e kishte pushtuar *de facto* Poloninë.

Kur Konferca e Jaltës u mbyll më 12 shkurt 1945, të tre të mëdhenjtë kishin humbur dhe fituar. Ruzvelti kishte fituar në arenën ndërkombëtare duke i marrë premtimin Stalinit se do të votonte formulën amerikane për Kombet e Bashkuara dhe hyrjen në luftë kundër Japonisë. Stalini kishte korru sukses të madh duke vendosur të gjithë Evropën Lindore nën hegemoninë sovjetike. Çërçilli ia doli mbanë të mbante të paprekur Evropën Perëndimore dhe të rifuste Francën në këshillin e të mëdhenjve për të balancuar fuqinë sovjetike në rast të largimit të trupave amerikane nga Evropa (Smyser, 1999:17). Për herë të parë Ruzvelti kuptoi (Çërçilli e kishte kuptuar me kohë) se Stalini nuk do të bënte asnjë hap prapa nga territoret që kishte pushtuar (Smyser, 1999:17).

Konferenca e Jaltës ndau Evropën dhe Gjermaninë në zona ndikimi. Bota që u "vizatua" në Jaltë të Kimesë do të merrte poza të çuditshme. Zonat e ndikimit do të merrnin formë pak e nga pak. Pas kthimit nga Jalta, presidenti amerikan Frenklin Delano Ruzvelt do të shprehej:

*"Ishte më e mira që mund të bëja"* (Brands, 2008:805).

Për fat të keq koha nuk i dha të drejtë presidentit amerikan. Nga kjo marrëveshje përfitoi vetëm Amerika. Ekonomikisht SHBA-të dolën më të fituara (Stone, 2012:115). Investimet që ato do të kryenin në Evropën Perëndimore do të ishin të mëdha dhe po kështu edhe fitimet. Fatkeqësisht, gjërat nuk u mbyllën me konferencën e Jaltës. Njëloj si në të kaluarën, nevojitej një tjetër mbledhje e nivelit të lartë që të mund të vendoste pikat mbi "i". Ndërsa Gjermania po rrëshqiste drejt një fundi të frikshëm, tre të mëdhenjtë u shpërndanë në vendet e tyre për të rishikuar edhe një herë planet të cilat u kishin dalë "shpuar" në Jaltë.

#### **1.4. Konferenca e Potsdamit**

Pas mbledhjes së Jaltës, ngjarjet në përfundim të Luftës II Botërore rrohën me shpejtësi të madhe. Ushtritë aleate çanë mbrojtjen gjermane dhe filluan të përparonin me shpejtësi përmes Gjermanisë. Përpara se të vetëvritej më 30 prill 1945, Hitleri emëroi në postin e kancelarit gjerman admiralin Karl Dënic (Smyser, 1999:17). Duke parë e duke ditur se situata ishte e pashpresë, admirali Dënic urdhëroi forcat gjermane të kapitullonin. Dorëzimi zyrtar i Gjermanisë bë më 7 maj 1945 në Reims. Me këmbënguljen sovjetike, një ditë më pas u nënshkrua edhe në Berlin (Smyser, 1999:17).

Në aktin e kapitullimit flitej për dorëzimin e forcave ushtarake gjermane dhe jo për dorëzimin e qeverisë. Në paragrafin e parë të aktit të kapitullimit shkruhej:

"Ne, të poshtënënshkruarit, duke vepruar sipas autoritetit të Komandës së Lartë, dorëzohemi pa kushte tek Forcat e Komandës Supreme të Aleatëve dhe njëkohësisht tek Komanda e Lartë e Ushtrisë së Kuqe, me të gjitha forcat tokësore, detare dhe ajrore që janë akoma nën zotërimin gjerman" (Smyser, 1999:17).

Qeveria e admiralit Dënic vijoi të funksiononte jashtë kryeqytetit gjerman në Flensburg edhe për tre javë të tjera. Pas tre javësh, ajo pushoi së ekzistuari kur pa shumë ceremoni forcat aleate arrestuan të gjithë anëtarët e qeverisë. Meqë ishte një hap i njëanshëm, zyrtarisht asnje kryetar qeverie i Gjermanisë nuk firmosi dorëzimin zyrtar. Po ashtu, asnje zyrtar gjerman nuk hoqi dorë nga autoriteti dhe sovraniteti i vendit. Shumë juristë u shprehën kundër këtij akti të njëanshëm, pasi tashmë Gjermania nuk kishte më një qeveri që do të duhej ta përfaqësonë në institucionet qëndrore (Snowden, 1975:75). Më 5 qershori 1945, aleatët fitues të Luftës II Botërore morën në duart e tyre të drejtën e sovranitetit mbi Gjermaninë. Ky akt ka hyrën në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare si Deklarata e Berlinit (Smyser, 1999:18).

Edhe pse e kishin pushtuar Gjermaninë, përsëri aleatët nuk po gjenin qetësi për të vënë në jetë ato kushte që ishin vendosur në Jaltë mbi ndarjen dhe reparacionet që duhej të paguante vendi. Stalini vijonte të insistonte që aleatët të takohen në herë në zonën sovjetike të pushtimit në qytetin historik të Potsdamit pranë Berlinit. Ky qytet nuk ishte shkatërruar aq shumë sa qytetet e tjera gjermane gjatë bombardimeve. Aleatët perëndimorë ranë dakord dhe për tre javë nga 17 korriku deri më 1 gusht 1945 ata vendosën edhe një herë për fatin e Gjermanisë në rezidencën Sans Souci të Frederikut të Madh (Smyser, 1999:18).

Në këtë mbledhje, Çërçillit po i rrëshqiste toka nën këmbë. Bashkëpunimi që aleatët kishin patur gjatë luftës, po i venitej para syve. Me trishtim të madh po shihte sesi ushtritë sovjetike po i imponoheshin Evropës Lindore dhe Qendrore. Akoma më shumë e trishtonte

largimi i forcave amerikane nga Evropa për në Azi ose në atdhe. Kryeministri britanik u përpoq me mish e me shpirt të bënte për vete presidentin e ri amerikan Herri Truman të cilin kur kishte qenë zëvendës i Ruzveltit nuk e kishte përfillur asnjëherë. Kryeministri britanik po kthehej në një figurë të braktisur në Potsdam. Oratoria e tij nuk pinte më ujë përballë fuqisë së Trumanit dhe Stalinit. Çërçilli u përpoq të bindte Trumanin që të vononte tërheqjen e trupave amerikane nga zonat e pushtimit të paktën deri në në momentin që do të shkëpuste ndonjë lëshim Stalinit. Trumani refuzoi. Si për të vijuar më tej poshtërimin, Çërçilli dhe ministri i jashtëm Iden u detyruan të braktisin Konferencën e Potsdamit pasi Partia Konservatore humbi zgjedhjet parlamentare në Britani (Jenkins, 2002:798).

Pasuesi i Çërçillit në postin e kryeministrat në Britaninë e Madhe ishte Klement Etlli. Gjatë luftës, kishte qenë zëvendës kryeministër dhe kishte marrë pjesë në Konferencën e Potsdamit që nga fillimi i punimeve. Ai vijoi në rrugën e Çërçillit duke ndjekur me besnikëri politikën e jashtme të hartuar nga paraardhësi i tij, por nuk pati asnje lloj impakti në konferencë. Edhe ministri i jashtëm Ernest Bevin, tregoi karakter dhe vullnet, por pa mundur të ndryshonte asgjë. Njeriu më i rëndësishëm i konferencës ishte presidenti amerikan Herri Truman. Presidenti në fillim nuk kishte dashur të merrte pjesë në Potsdam. Ai mendonte se e prisnin punë më të rëndësishme në Uashington sesa në Gjermani. Atij nuk i pëlqente shumë të diskutonte, por të jepte urdhra të cilët do të zbatoheshin. Trumani nuk ta jepte përshtypjen se ishte një njohës i mirë i karaktereve, por karakterin e Stalinit e kishte njohur mirë. Ai e dinte se me forcën luftarake që kishin në dispozicion SHBA-ja nuk e ndalte dot Stalinin enigmatik. Deri ku kishte menduar të zgjerohej BS-ja? Këtë askush nuk e dinte. Udhëheqësi sovjetik në një bisedë me gjeneralin amerikan Bedell Smith në mars 1945 i cili do të ishte edhe drejtori i parë i CIA-s, i ishte shprehur se:

"Rusia i njeh armiqtë e saj" (Weiner, 2007:16).

Megjithë mosmarrëveshjet, të tre të mëdhenjtë u treguan të aftë të formësonin të ardhmen e Evropës dhe të merrnin gjashtë vendime të mëdha (Bymes, 1947:21-45).

Së pari, ata vendosën të formonin Këshillin e Ministrave të Jashtëm i cili do të mblidhej rregullisht për të përgatitur traktatet e paqes për Gjermaninë dhe aleatët e saj. Fillimisht, do të hartoheshin traktate të paqes për Italinë, Bullgarinë, Finlandën, Hungarinë, dhe Rumaninë dhe më pas një traktat më vete për Gjermaninë (Bymes, 1947:21-45). Së dyti, të tre të mëdhenjtë binin dakord që ta trajtonin Gjermaninë si një njësi të vetme ekonomike me shpërndarje të barabartë të të mirave të saj ekonomike (Bymes, 1947:21-45). Së treti, të tre të mëdhenjtë braktisin planin Morgento që dëshironte që Gjermania të mos humbiste asetet e saj ekonomike. Duke u gjendur përballë faktit të kryer, sekretari i thesarit (Morgento) u detyrua të firmosë (Bymes, 1947:21-45). Së katërti, të tre të mëdhenjtë ranë dakord që të mos kishte ndarje të përjetshme të Gjermanisë (Bymes, 1947:21-45). Së pesti, të tre të mëdhenjtë ranë dakord që të deportonin në Gjermani nga Çekoslovakia, Hungaria dhe Polonia gjermanët e mbetur në këto vende. Me këtë veprim ata "pastruan" vendet e lartpërmendura nga gjermanët etnikë (Bymes, 1947:21-45). Së gjashti, të tre të mëdhenjtë ranë dakord që asnjë qeveri e ardhshme gjermane të mos kundërshtonte traktatin e paqes (Smyser, 1999:23).

Në Potsdam lufta kundër Gjermanisë u shndërrua në luftë për Gjermaninë. Megjithëse të tre të mëdhenjtë nuk folën për copëtimin e vendit, me veprimet e tyre bënë të mundur pikërisht atë çka synonin të mos bënin. Pa një politikë të përbashkët, çdo fuqi pushtuese bëri ç'deshi në zonën e vet të pushtimit. Potsdami ishte mbledhja e fundit e tre të mëdhenjve e cila projektoi një Gjermani të bashkuar, por që përfundoi e ndarë. Potsdami

nuk solli zgjidhjen e çështjes gjermane vetëm sa e la pezull dhe si një kërcënim permanent konfrontimi.

### **1.5. Konferenca e Londrës e vitit 1945**

Kontinenti evropian pas përfundimit të Luftës II Botërore ishte totalisht i shkatërruar. Një shkatërrim të përmasave të tillë nuk e kishte bërë as Lufta 30 Vjeçare treqind vjet më parë dhe as luftërat napoloniane në shekullin XIX. Tashmë, fitimtarët duhet të përgatisnin traktatet. Kjo nuk doli një detyrë e thjeshtë. Për herë të parë këshilli i ministrave të jashtëm të vendeve fitimtare u mblodh në Londër nga 11 shtatori deri më 2 tetor 1945 (Smyser, 1999:27). Problemi i parë me të cilin u ballafaqua ky këshill ishte kundërshtimi i ministrit të jashtëm sovjetik Vjaçesllav Molotov për të pranuar si palë aleate Francën dhe Kinën (Bullock, 1983:9). Franca ishte e pakënaqur me këtë lëvizje sovjetike dhe e ndjeu përsëri veten të përjashtuar nga vendimet e mëdha. Presidenti amerikan Herri Truman apeloi direkt tek Stalini, por ky i fundit nuk iu përgjigj. Aleatët perëndimorë u treguan të vendosur. Ata nuk do të lejonin asnjë aleat të tyre të përjashtohej nga dëshirat sovjetike.

Ky akt, ishte edhe mosmarrëveshja e parë ndërmjet ministrave të jashtëm perëndimorë dhe ministrit të jashtëm sovjetik. Mosmarrëveshjet ndërmjet perëndimit dhe Bashkimit Sovjetik u panë edhe në pikëpamjet e kundërtta përsa i përket të ardhmes së Mesdheut dhe Evropës lindore, të cilët Bevini si përfaqësues i Britanisë së Madhe i konsideronte zona strategjike për vendin e tij. Po ashtu, edhe Molotovi i konsideronte zona të një rëndësie të veçantë strategjike për Bashkimin Sovjetik. Kur u fillua të bisedohej për Italinë, Molotovi kërkoi që Bashkimit Sovjetik t'i jepej në mirëbesim Libia, por ndeshi në refuzimin e prerë të Bevinit (Smyser, 1999:28). Molotovi kërkoi që Jugosllavisë t'i jepej porti i Triestes i cili ishte i

pushtuar nga anglo-amerikanët. Si Bevini ashtu dhe Bërnsi (sekretari amerikan i shtetit) nuk pranuan (Smyser, 1999:28).

Bevini e kuptoi lojën e Stalinit për Mesdheun. Ai kërkonte sa më shumë porte të sigurtë në këtë hapësirë për të luajtur një rol kyç në Lindjen e Mesme dhe në Mesdhe. Britania e Madhe nuk mund të lejonte kaq lehtë që të zëvendësohej në një zonë strategjike për të cilën kishte investuar dy shekuj. Por, politika është e pamëshirshme. Gjithmonë fuqitë e mëdha kanë zëvendësuar njëra tjetrën. Interesat britanike u ndjenë të kërcënuara nga Kanali i Suezit e deri tek fushat naftëmbajtëse të Arabisë. Ndërsa Britania e Madhe kërkonte të vijonte të ishte violinë e parë në Lindjen e Mesme, Bashkimi Sovjetik kërkonte të gjithë Evropën lindore. Për këtë arsyе Molotovi hodhi poshtë të gjitha argumentet perëndimore që të lejohej një proces i lirë për të zgjedhur formën e qeverisjes në këtë zonë të Evropës. Edhe pse në disa vende të Evropës lindore ishin formuar qeveri koalicioni, komunistët dhe pro sovjetikët pjesëtarë të këtyre qeverive ishin pushteti i vërtetë.

Edhe për Gjermaninë nuk u arrit asnjë marrëveshje domethënëse. Molotovi përsëriti edhe një herë kërkësen e Stalinit që zona e Ruhrit të ndahej mes katër fuqive pushtuese (Smyser, 1999:28). Aleatët perëndimore e kundërshtuan këtë kërkësë dhe nga ana tij Molotivi hodhi poshtë kërkësen e tyre për akses të lirë në zonën sovjetike të pushtimit (Smyser, 1999:28). Francezët e përdorën këshillin e ministrave të jashtëm për të kërkuar që zona e Rinelandit të shkëputej nga Gjermania dhe së bashku me Saarën të bëheshin pjesë e sistemit ekonomik francez dhe Ruhri të ndërkombëtarizohej. As me këtë propozim francez nuk u ra dakord. Duke qenë se nuk po bihej dakord për çështje thelbësore, sekretari amerikan i shtetit Bërns (Byrnes) i kërkoi Molotovit një takim të tre të mëdhenjve në Moskë në muajin dhjetor. Molotovi ra dakord me gjithë kundërshtimet e Bevinit (Smyser, 1999:28). Edhe në takimin

e dhjetorit, të tre ministrat e jashtëm nuk gjetën gjuhë të përbashkët. Mosmarrëveshjet ndërmjet tyre do të kulmonin në Konferencën e Paqes në Paris më 1946.

Presidentit Truman nuk po i pëlqente puna e sekretarit të shtetit. Ai u ankua se Bërnsi nuk kishte protestuar aq sa duhet për të ndalur sovjetizimin e Evropës lindore, për qëndrimin e trupave sovjetike në Iran dhe për refuzimin e Stalinit për të nënshkruar lundrimin e lirë në ujërat ndërkombëtare. Në zemërim e sipër presidenti i shkruan Bërnsit:

"*U lodha duke llastuar sovjetikët*" (Wheeler-Bennett, 1974:419).

Sekretari i Shtetit e mori mesazhin dhe në vijim të takimeve do të mbante një qëndrim më të ashpër. Konferenca e Paqes që u mbajt në Paris në datat 15 prill-16 maj dhe 15 qershor-12 korrik 1946 (Smyser, 1999:29), prodhoi një sërë marrëveshjesh paqeje. Kjo konferencë "lejoi" trupat sovjetike të qëndronin në Bullgari, Hungari dhe Rumani duke i njohur Moskës një rol dominant në këtë pjesë të Evropës. Për Gjermaninë u diskтуa në datat 29 prill, 15-16 maj dhe 9-12 korrik 1946 (Smyser, 1999:29). Me vështirësi u ra dakord përgjëra thelbësore pasi për pazare e lëshime as që bëhej fjalë (Bymes, 1947:159). Bërnsi u përpoq të arrinte një marrëveshje që do ta mbante Gjermaninë të çarmatosur për njëzet e pesë vjet dhe në vijimësi nën garancinë e katër fuqive. Bevini dhe ministri i jashtëm francez Zhorzh Bido (Bidault) e mbështetën propozimin e homologut të tyre. Por, ministri i jashtëm sovjetik e hodhi poshtë duke thënë se Gjermania tashmë ishte e çmilitarizuar (Bymes, 1947:160). Duke parë kokëfortësinë refuzuese të ministrit Molotov, Bërnsi u bind se ministri i jashtëm sovjetik do të refuzonte çdo propozim perëndimor. Ai dyshoi se Stalini thjesht po priste se kur do të largoheshin amerikanët nga Evropa për të marrë nën kontroll edhe pjesën tjeter të kontinentit.

## **KAPITULLI II: Modeli Analistik i Temës dhe Skeleti Teorik**

### **2.1 Metodologja dhe analiza politike e kuadrit teorik**

Tema e disertacionit “Problemi gjerman gjatë acarimit të marrëdhënieve lindje-perëndim 1945-1968” e ndarë në gjashtë kapituj të mëdhenj me nënkapitujt përkatës, trajton fillimin e evoluimin e problemit të Republikës Federale Gjermane (më tej: RFGJ), duke u thelluar në politikat e sukseshme të tij: përmirësimin e imazhit, aleancen e ngushtë me bllokun perëndimor dhe integrimin në sistemin ekonomik dhe politik të prëndimit. Gjithashtu, në këtë disertacion peshë të konsidrueshme zë integrimi i Republikës Demokratike Gjermane (më tej: RDGJ) në sitemin politik, ekonomik dhe ushtarak të krijuar nga Bashkimi Sovjetik pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Integrimi i RFGJ pas krijimit të saj, ishte pjesë e perspektivës evropianizuese të vendeve të aleatëve fitues perëndimorë të Luftës II Botërore që është edhe fokusi thelbësor i temës; ndërsa përcaktimi, analizimi dhe vlerësimi i sfidave të RFGJ-së gjatë procesit të anëtarësimit në të gjitha strukturat Euro-Atlantike dhe marrëdhëniet e tij me vendet jo vetëm të perëndimit përbën dhe tezën kryesore të këtij punimi. Në këtë punim doktorate, një vend të rëndësishëm zënë edhe marrëdhëniet e RDGJ-së me Bashkinin Sovjetik dhe gjithashtu i janë kushtuar dy nën kapituj marrëdhënieve të RDGJ-së me Republikën Popullore të Shqipërisë në vitet 1955 dhe 1961.

Metodologja e këtij punimi është gjithëpërfshirëse, duke shfrytëzuar burime të shumta për të mbuluar sa më mirë fushat e prekura në marrëdhëneit ndërkombëtare të kësaj epoke. Për zhvillimin e temës janë aplikuar tre metoda kërkimi: përshkruese, analizë teksti, krahasuese; të tria metodat gjenden të ndërthurura në përmbajtjen e punimit. Përshkrimi, evidentimi, analizimi, vlerësimi, krahasimi kërkimi arkivor, kanë rezultuar si mjete të domosdoshme për mbështetjen e tezës kryesore të këtij punimi që është të trajtojë, të

analizojë dhe inkuadrojë në kontekstin e marrëdhënieve ndërkombëtare, problemin gjerman gjatë fillimit të Luftës së Ftohtë dhe ecurinë e tij deri në vitin 1968. Studimi i qasjes së përgjithshme të kërkimit për “problemin gjerman” mbetet elementi thelbësor në metodologjinë e këtij punimi doktorate. Shfrytëzimi i burimeve të shumta ka patur si synim për të mbuluar sa më mirë fushat e prekura të kësaj teme mjaft të diskutuar në arenën ndërkombëtare, por fare pak ose aspak në Shqipëri. Analiza e tekstitës sështë një nga metodat e aplikuara, kur përfshihen dokumente, raporte, studime, materiale arkivore etj. Përbajtja e burimeve të përdorura për të analizuar këtë temë doktorate ka përfshirë kryesisht histori, analiza, komente, politikë, lajme zyrtare dhe dokumente shtetërore për të dhënë një panoramë sa më të pranueshme të rastit studimor problemi gjerman i periudhës 1945-1968.

Objektivat kryesorë që janë trajtuar në këtë temë kanë të bëjnë me analizën e rendit të ri botëror pas përfundimit të Luftës II Botërore; Gjermania si epiqedër e përplasjes së intereave të superfuqive në kontinentin evropian dhe të shikuarit e RFGJ-së si vend model për suksesin ekonomiko-politik për vendet e shkatërruar nga lufta. Pjesa kërkimore, është një nga më të rëndësishmet e përfshirë në këtë punim bazuar në pyetje specifike sesi ndikuani krizat në shtete të ndryshme të Evropës për RFGJ-në, dhe sa ndikoi epoka e acarimit mes dy kampeve kundërshtarë në rritjen e pavarësisë së dy shteteve gjermane në politikën e tyre të jashtme individuale. Burimet arkivore (për marrëdhëniet me Shqipërinë), librat, revistat, studimet e organizatave të ndryshme - që kanë qenë synim i studimit, burimet kryesore që kanë mbështetur strukturën dhe hipotezën bazë të këtij disertacioni mbi suksesin më të madh politik de ekonomik të RFGJ-së ndaj RDGJ-së që ishte një rezultat i parashikueshëm, duke ditur se cilët ishin modelet politikë të fuqive të mëdha fituese të Luftës II Botërore që ndanë Gjermaninë.

Nënhipotezat e trajtuarë në këtë temë disertacioni, është edhe teoria se nëse nuk do të kishte patur acarim të marrëdhënieve lindje-perëndim, ka mundësi që dinamikat në politikën e jashtme të dy Gjermanive do të qëndronin të pandryshuara. Gjithashtu, përballja indirekt me forcën dhe veprimet ushtarake të kundërshtarit, shkaktoi vetëpërmbajtje dhe negocime, duke shmangur përdorimin e forcës.

Konkretisht, në kapitullin e parë aplikohet metoda përshkruese, përmes një qasjeje historike - e nevojshme me qëllim që të kuptohet konteksti kohor i evoluimit të politikës ndërkombëtare në fund të Luftës II Botërore dhe në muajt e parë pas përfundimit të saj. Përmes botimeve serioze mbi ndarjen e Gjermanisë dhe evoluimit të politikës gjermane kam shfrytëzuar autorë të tillë Henri Kissinger, W.R Smyser, Alexei Filitov, Philip Windsor etj. të cilët jepin sqarime të jashtëzakonshme lidhur me procesin e ndarjes së Gjermanisë dhe procesin e riangazhimit të saj në familjen evropiane.

Në kapitullin e dytë e të tretë analizohen qëndrimet, hapat dhe sfidat e dhe përplasjet e të dy kampeve kundërshtarë jo vetëm ideologjikë përsa i përket politikës së tij së ndarjes së Gjermanisë. Procedura e zgjerimit, valët e njëpasnjëshme të tij janë hulumtuar duke iu referuar botimeve të ekspertëve më të mirë të kësaj epoke, Cate Curtis, Lucius Clay, Clay Clemens etj., dhe marrëveshje të para ndërmjet vendeve fituese të aleancës perëndimore. Përmes një hulumtimi në thëllësi, argumentohet përfshirja e shteteve fituese të aleancës perëndimore në përballje me politikën e Bashkimit Evropian siç ishte nga fazat e para të krijimit të bashkimit Evropian deri tek mentaliteti i epokës atomike, kanë shërbyer si një bazë solide për ndërtimin e këtij kapitulli.

Analizat përshkruese dhe hulumtuese janë metodat e ndërthurura në kapitullin e katërt dhe të pestë dhe të gjashtë, ku paraqiten hapat, përpjekjet dhe sfidat e Bashkimti Sovjetik për

t'iu kundërvënë bashkimit të Gjermanisë. Pas Luftës II Botërore, Bashkimi Sovjetik nuk i kishte kapacitetet për të patur bombën atomike. Këtë mungesë thelbësore liderët komunistë u përpoqën ta kompensojnë duke manipular opinionin publik brenda vendit të tyre me kombinimin e taktikave politike në mënyrë që t'i përshtateshin dogmës zyrtarë sovjetike. Stalini u përpq ta bindte popullin sovjetik se arma atomike ishte mbiçmuar. Nga ana tjetër, në fshehtësinë më të madhe kishte dërguar agjentë në SHBA që të mund të merrnin sekretin e ndërtimit të kësaj arme që do ta bënte të barabartë me Amerikën. Për t'i hedhur hi syve perëndimit, udhëheqësi suprem sovjetik nuk la konferencë paqeje pa marrë pjesë, notë diplomatike pa dërguar ku nxiste paqen në mënyrë që të paralizonte çdo mekanizëm perëndimor të drejtar kundër tij derisa të kishte në dorë bombën atomike. Që nga viti 1945 e deri në vitin 1949 kur më në fund edhe Bashkimi Sovjetik do të kishte armën atomike, Stalini ishte "ëngjelli" i paqes.

Ndoshta me vullnet të lirë, Stalini zgjodhi sigurinë në vend të ndikimit. Vendimi për të zgjeruar sa më shumë në perëndim Poloninë si në rastin e Ballkanit, reflektonte hendekun e thellë në strategjitet gjepolitike të liderit sovjetik. Për këtë arsy, duke u ndjerë më shumë se ç'duhet i sigurtë, ai i kërkoi Ulbrihit se kur do të ishte gati të bashkonte zonën e tij me perëndimorët dhe të merrte kontrollin e vendit. Me këtë vendim, Stalini mori përsipër një rrezik të madh. Ai ia kishte frikën një aleance të fortë mes Evropës perëndimore dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Nëse ndodhët kjo, Gjermania do të rimëkëmbej dhe për të nuk kishte më as më të voglën shpresë të matej me këtë aleancë ku do të bënte pjesë edhe Evropa e rimëkëmbur. Por, me diplomacinë e tyre të dobët, Stalini dhe Molotovi bënë të mundur pikërisht atë që ata i trembeshin më shumë.

Gjatë këtij procesi udhëheqësit e kanë për detyrë të bindin pasuesit e tyre për vërtetësinë e qëllimeve që ata u ofrojnë, në mënyrë që këta të fundit të ndërgjegjësohen se veprimi më i mënçur për tu bërë është kompromisi mes palëve. Kompromisi çon në ngriten e parimeve etike për drejtësi ndërmjet bashkëpunëtorëve të mbështetura tek toleranca dhe tek respekti për individualitetet njerëzore.

Që këto elementë të jënë funksionalë udhëheqësit duhet që t'i prijnë proceseve. Kjo do të thotë që ata të mos presin pasuesit që ti paraqesin kërkesat e tyre. Udhëheqësit duhet ti dijnë kërkesat e pasueseve përpara se këto të paraqiten dhe të kenë plotësuar disa prej tyre përpara se të fillojë kompromisi. Kjo gjë e bën shumë herë më të lehtë arritjen e kompromisit dhe lehtëson bashkëpunimin ndërmjet udhëheqësve dhe pasuesve. Ky element i bind gjithashtu pasuesit se kompromisi është i mundshëm dhe i frytshëm për të dyja palët. Procesi për krijimin e një traktati për të përfshirë vendet e Atlantikut të Veriut filloi të zgjerohej akoma më shumë. Bisedimet për një aleancë të tillë filluan në vitin 1948 me pjesëmarrjen e Britanisë, Francës, SHBA-së, Kanadasë dhe vendeve të Beneluksit. Në takimin e 9 shtatorit 1948, ata ranë dakord se ishte e domosdoshme krijimi i një aleance ushtarake për të rivendosur besimin evropian. Për të patur një shtrirje sa më të gjerë, në bisedime u ftuan edhe përfaqësuesit e Italisë, Danimarkës, Islandës, Norvegjisë dhe Portugalisë. Të gjitha këto shtete më 4 prill 1949, nënshkruan në Uashington traktatin për themelin e Aleancës së Atlantikut të Veriut (NATO).

Është e nevojshme të kuptohet mirë se udhëheqësit janë vendim-marrës dhe vendosin objektivat që duhen realizuar. Koha për realizimin e synimeve për çdo udheheqës dhe për çdo lidërsipër është e kufizuar. Organizimi i saktë i kohës duhet të jetë një nga vlerat parësore të çdo lidërsipi. Liderat nuk janë vetëm për të udhëhequr, por edhe edukatorë.

Ata duhet të jepin shembullin e mirë dhe të reflektojnë mirësi tek qytetarët e shtetit që përfaqësojnë. Vlerat njerëzore duhen të reflektohen tek çdo lidërship dhe prej andej të përhapen tek qytetarët. Nga eksperiencia e çdo lidërshipi të suksesshëm mund të thuhet se synimi i madh i çdo lidërshipi është të ndihmojë në krijimin dhe në mbajtjen e hapësirave të gjëra shoqërore gjatë ushtrimit të një ndikimi pozitiv.

Duke marrë në konsideratë këtë të fundit, del se përfshirja morale e çdo lidërshipi është edukata që rrezaton në jetën private dhe mbi të gjitha në jetën publike. Shoqëritë e vendeve demokratike janë jashtëzakonisht të emancipuara dhe si të tilla janë po kaq të ndjeshme ndaj lidërshipit. Për këtë arsy, çdo lidërship me mendje të shëndoshë reflekton mirë përpala se të marrë përgjegjësinë e madhe e të prezantuarit përballë opinionit publik të shtetit përkatës. Lidërshipi si natyrë nuk duhet të jetë hakmarrës. Kush mendon ndryshe, nuk e ka jetën e gjatë në politikë. Çdo lidërship ka brenda vetes gjithnjë dy komponentë, moralin dhe parimet. Shkrirja në një e këtyre dy elementëve sjell përmirësimin e vlerave qytetare në brendësi të lidërshipit. Asnjë udhëheqës nuk duhet të bëjë gabimin e largimit nga vetja të këtyre vlerave parësore dhe të vlefshme për jetën e tij politike. Prej këtej vijojnë karakteristikat e ndikimit praktik të lidërshipit në jetën politike të një vendi.

RFGJ-ja nuk e njihte RDGJ-në pasi sipas saj ajo nuk shprehte aspiratat e popullit gjerman. RFGJ-ja aplikonte doktrinën Hallshtajn (mori këtë emër sipas sekretarit të shtetit në zyrën e jashtme të Gjermanisë, Valter Hallshtajn (Hallstein). Sipas kësaj doktrine, Gjermania Federale e shikonte si akt jo miqësor ndaj saj nëse shtetet e tjera njihnin zyrtarisht RDGJ-në. Adenaueri mund të injoronte RDGJ-në, por s'mund të injoronte Bashkimin Sovjetik. Shumë të burgosur lufte gjermanë gjendeshin ende në BS. Moska e kishte ndalur riatdhesimin e tyre më 1950. Asnjë kancelar gjerman që dëshironë të kishte një politikë të

jashtme të pavarur nuk mund të kishte marrëdhënie me Moskën nëpërmjet palëve të treta.

As Bashkimi Sovjetik nuk mund ta shpërfillte RFGJ-në sepse që nga mesi i viteve '50 ishte kthyer në një yll të shndritshëm evropian, ndërsa RDGJ-ja akoma po lëpinte plagët e kryengritjes së 1953-it.

Gjatë gjithë epokës së Luftës së Ftohtë, eksperiencia e konflikteve ideologjike ndërmjet udhëheqësve të të dy kampeve kundërshtare solli jo pak herë ngritjen e hipotezave se si mund të kuptohej më mirë natyra e lidërshipeve përkatëse. Megjithëse bota po kalonte realitetë të vështira politike, përsëri ndjenjat për të qenë superior ndaj filozofisë së kundërt politike e çuan jo pak herë botën në kriza të forta.

Në marrëdhëni ndërkombëtare dhe në diplomaci, një nga mënyrat më të mira për të kuptuar natyrën e një ldiërshipi dhe mbi të gjitha për të mësuar enigmat e tij, janë takimet.

Lufta e Ftohtë ishte lufta ku asnjëherë nuk u ndeshën ballë për ballë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik. Vende të dyta dhe të treta do të shërbën si mish për top për realitet politike e të dyja superfuqive. Është e nevojshme të theksohet se qysh nga epoka e Stalinit të gjithë udhëheqësit e Bashkimit Sovjetik kishin mësuar t'i fshihnin synimet dhe ambicjet e tyre. Gabimi që bënë të gjithë udhëheqësit sovjetikë pas Stalinit ishte se askush (ndoshta me përjashtim të Gorbaçovit) nuk e kishte kuptuar epokën ku po jetonte dhe vazhdonte e jetonte me mësimet e të parit.

Stalini ishte mjeshtri i epokës së vet. Trashëgimia që ai i la pasardhësve ishte një vend superfuqi që duhej azhornuar çdo ditë me të rejt që kalonte bota. Vitet '30 për BS-në nuk ishin njësoj si vitet '50. Po ashtu vitet '60 nuk ishin njësoj si vitet '70 dhe krejt ndryshe ishin vitet '80. Nga të gjitha këto krahasime, mund të themi se çdo udhëheqës në vende totalitare ose jo, e ka tepër të domosdoshme t'i përshtatet realiteteve kohore dhe të dijë

mirë natyrën e kundërshtarit direkt. Për një udhëheqës të arsyeshëm çdo problem kombëtar apo personal i kundërshtarit të tij duhet të jetë në krye të axhendës personale, në mënryë që të dijë të nxjerrë përfitimet e duhura nga përllogaritje të sakta politike.

Është e folur dhe shkruar shumë lidhur me teoritë rreth marrëdhënieve ndërkombëtare, por për praktikat ndërkombëtare është shkruar fare pak. Mosmarrëveshjet që lindin rreth aktiviteteve politike janë edhe si pasojë e natyrës akademike që përfshin politikën. Dikur si një mjet akademik politika shikohej si një armë e filozofisë, historisë apo drejtësisë. Qëllimi i saj qendoror ishte të zbulonte parimet ku duhet të mbështetet shoqëria njerëzore. Qysh nga shekulli XIX dhe në vijim kanë qenë të pandërprera përpjekjet për ta kthyer politikën në një disiplinë shkencore. Pikun kjo përpjekje e arriti në vitet '50 dhe '60 të shekullit XX. Qysh atëherë, entuziazmi për një shkencë politike strikte ka ardhur duke u zbehur. Ditët e sotme kemi të bëjmë me një shkencë e cila është më e larmishme sepse kemi ndërthurje të plotë të ideve teorike dhe varieteve të shkollave të ndryshme të analizës. Origjinat e analizës politike datojnë në Greqinë e Lashtë dhe në mënyrë tradicionale asaj periudhe i referohemi si epoka e filozofisë politike. Aty përshkuhen normat etike dhe çështjet normative të fjalorit politik ku fjala “është zëvendësohet me fjalët “duhet” dhe “mundet”. Platonit dhe Aristoteli zakonisht identifikohen si baballarët themelues të kësaj tradite. Idetë e tyre rishfaqen në shkrimet mesjetare të Toma Akuinit dhe Shën Agustinit. Ideja themelore e Platonit ishte përshkrimi i natyrës ideale të shoqërisë në të cilën një diktator duhej zëvendësuar nga mbretërit e filozofisë.

Qasja empirike e analizës politike karakterizohet nga përpjekja pë të ofruar një shpjegim të paanshëm të realitetit politik. Përpjekja është “përshkruese” e cila kërkon kërkim dhe shpjegim në mënyrë që të japë edhe rekomandime. Analiza politike deskriptive

(përshkruese) kërkon qasje filozofike nga doktrinat empirike të lindura në shekullin e XVII nga teoricienë si Xhon Loku dhe Dejvid Hjum. Doktrina empirike e avancon besimin se eksperienca është baza e vetme e dijes dhe se të gjitha hipotezat dhe teoritë duhen të testohen nga një proces vëzhgimi. Qysh nga shekulli XIX idetë të tilla u quajtën pozitiviste. Pozitivizmi ishte një lëvizje intelektuale e udhëhequr nga August Komtë. Kjo doktrinë shpalte se shkencat shoqërore me të gjitha metodat shkencore duhet t'i binden shkencës njerëzore. Sipas tij shkenca ishte e vëtmja gjë që ishte pranë së vërtetës. Meqë ishte kështu, atëherë është e pamundur t'i shpëtosh zhvillimit të një shkence politike.

Kuadri teorik në të cilin jam bazuar në punimin e këtij dizertacioni është gjithnjë teoria realiste. Do të vlerësoja librat dhe analizat e Henry Kissinger si përfaqësuesin e kësaj shkolle që më kanë ndihmuar më shumë për të interpretuar teorikisht fenomenet në këtë periudhë. Avantazhet e kësaj teorie janë se i shpjegon marrëdhëniet ndërkombëtare nga pikëpamja e fuqisë dhe përdorimi i saj si mjet për të ndikuar mbi rezultatet që do të arrihen. Formimi i aleancave për të rritur fuqinë vepruese në krahasim me një shtet ose aleancë tjetër. Kufizimet e teorisë në fjalë janë nisur nga karakterizimi i sistemit ndërkombëtar si anarkik, kufizohen veprimet e vendimmarrësve dhe ndikohet në shpërndarjen e kompetencave ndërmjet aktorëve të ndryshëm.

Mos të harrojmë se çdo shtet i madh apo i vogël në çdo vend të botës, me gjithë dëshirën e madhe për të bërë sa më shumë, madje më shumë nga sa i ka mundësitë, duhet të bashkëpunojë me shtetet e tjera. Sigurisht që është më tepër e lehtë për t'u thënë sesa për tu bërë. Dhe kjo për një arsy shumë të thjeshtë. Çdo komb, çdo popull dhe çdo shtet ka mentalitetin e vet dhe qëllimet e veta. Shumë herë ndodhin raste kur dy njerëz nuk merren vesh njëri me tjetrin, mund të imagjinojmë se ç'mund të bëjnë dy shtete me miliona banorë.

Sigurisht që një marrëdhënie kërkon aktorë që ta mbajnë gjallë lidhjen dhe aktorët e marrëdhënieve ndërkombe të janë qeveritë e shteteve të botës. Është organizmi i tyre që mban marrëdhënien gjallë. Po si mbahet marrëdhënia gjallë? Nëpërmjet interesave.

Një sistem politik është në fakt një nënsistem i gjerë social. Në këtë sistem ka ndërmarrëdhënie të ndryshme dhe komplekse në gjithësi. Regjimet politike karakterizohen edhe nga organizimi jetës ekonomike. Një regjim është një “sistem rregullash” që nuk ndryshon edhe me ndryshimin e qeverive. Qeveritë ndryshohen nga zgjedhjet por, nuk mohohet ekzistenza e ndryshimit edhe nga “grushte shteti” ose e revolucioneve dhe përbësjeve të brendshme.

Interesi i klasifikimit të sistemeve politike rrjedh nga dy burime. Klasifikimi i parë është një ndihmesë thelbësore për të kuptuar politikën dhe qeverisjen. Si në shumicën e shkencave shoqërore, kuptimi i politikës kërkohet në një shkallë të gjerë procesi krahasimesh veçanërisht si metodë eksperimentale por që përgjithësisht është e paaplikueshme. Psh., nuk mund të bëhen eksperimente lidhur me ndarjen e pushtetive. Si pasojë ne mund të krahasojmë atë çka studiojmë. Edhe nëse kemi një mori faktesh për të krahasuar, ne duhet të jemi të aftë dallojmë atë çka është e kuptueshme dhe çfarë jo. Në fjalët magjike të Aleksis dë Tokvil “*pa krahasim, mendja nuk e di sesi të vijoje*”. Përpjekja për t’i klasifikuar sistemet e qeverisjes është thjesht një këshillë për ta bërë procesin e krahasimit më metodik dhe sistematik.

Të gjitha sistemet për tu klasifikuar paraqesin pengesa. Si të gjitha devizat analitike ekziston rreziku i thjeshtëzimit. Klasifikimi i regjimeve me të njëjtin petk tërheq vëmendjen e përafërsive që kanë vënë në rrezik dallimet e vërteta që mund të kenë apo akoma më keq, mund t’i injorojnë. Klasifikimi i regjimeve mund të ketë kuptime të

ndryshme në kontekste të ndryshme. Psh., në Japoni dhe në të gjithë Azinë Lindore “shteti” mund të jetë i ndryshëm në lloj dhe në kuptim nga “shteti” perëndimor. Analizat krahasuese vihen gjithnjë në rrezik nga etnocentrizmi. Së dyti, rrymat me vlera tentojnë të hyjnë në procesin e klasifikimit. Kjo mund të shihet si tendencë për të klasifikuar regjimet komuniste dhe fashiste si totalitare duke lënë të kuptohet se demokracitë perëndimore ishin duke luftuar kundër të njëjtë armik në Luftën e Ftohtë njëlloj si në Luftën e Dytë Botërore. Teoria realiste, ku më së shumti qëndron kjo temë ka parashtruar disa pikë të cilave mendojmë se u është dhënë përgjigje:

- Kush ishte nr. 1 dhe kush po e fitonte këtë pozicion?
- Pikënisja për të kuptuar politikat botërore është e gjithë historia që na demonstron se të gjithë kombet aktivë në politikat ndërkombëtare përgatiten vazhdimesht për një përfshirje aktive në luftë apo për të rimarrë veten nga një dhunë e organizuar në formën e luftës.
- Lufta e Ftohtë - fillimet e saj 1945-1968:
- Liderët që parashikojnë të ardhmen dhe e shohin atë si tragjike janë shpeshherë të pushtuar nga një marrëzi e cila i shtyn ata që t'i kryejnë me të vërtetë ato veprime që i bënin ata të sigurtë për atë gjë të cilës i druheshin se do të ndodhë.
- SHBA pas 1945-ës morën drejtimin e botës në dorë, por me çmimin e armiqësisë të BS.
- Ideologjia konfliktuale mes Lindjes dhe Perëndimit.
- Realizmi dhe politikat e paepura të fuqisë.
- Liderët si lëvizës të historisë.

Ndërthurja e metodave hulumtuese dhe kahasuese është aplikuar gjatë ndërtimit të konkluzioneve. Analizimi dhe krahasimi i qëndrimeve dhe i opinioneve të liderëve zyrtarë të kohës të marrë në shqyrtim, ndërthurur me mendimet e ekspertëve dhe politologëve, si dhe përfundimet e mia personale, kanë formësuar kapitullin e konkluzioneve. Fituesit perëndimorë të Luftës II Botërore kishin nxjerrë mësimet e duhura nga eksperiencat e së kaluarës. Një Gjermani e cila brenda 25 vjetësh kishte humbur dy luftëra botërore, do të ishte e tepërt të shkaktonte një të tretë. Gjermania u nda në dy shtete me sisteme të ndryshme politike dhe ekonomike.

Çmimi për fajin e luftës ishte tepër i rëndë për një popull që kishte vuajtur dhe kishte shkaktuar vuajtje të panumërtë. Gjermanët e përballuan me dinjitet këtë tragjedi të re që i rau vendit të tyre. Ata u ringritën shumë shpejt për t'i treguar botës se ishin një komb që e meritonte vendin e respektuar në marrëdhëni ndërkombëtare. Politikanët e Gjermanisë Perëndimore ditën të përballonin presionin e madh të opinionit publik kur refuzuan ftesën e Jozef Stalinit për bashkim, me kushtin që të largoheshin nga të gjitha aleancat ndërkombëtare. Ishte një zgjedhje e vështirë që kërkonte shumë forcë për t'u refuzuar. Kancelari i madh Konrad Adenauer e pranoi këtë çmim të rëndë mbi shpatulla. Ai ishte i vetëdijshëm se brenda një shteti të bashkuar nuk mund të jetonin dy sisteme të ndryshme politike dhe ekonomike. Sfida që lëshoi ishte e fortë; cilido nga shtetet gjermane do të ishte fitimtar në Luftën e Ftohtë ai do të kishte të drejtën që të përfshinte politikisht dhe ekonomikisht shtetin tjetër. Me pak fjalë nëse Lufta e Ftohtë do të përfundonte me fitoren e Bashkimit Sovjetik dhe të aleatëve të tij, e gjithë Gjermania do të bashkohej nën siglën e komunizmit.

## **Kapitulli III - Lindja vs Perëndimit 1946 - 1948**

### **3.1. Acarimi i mëtejshëm i mosmarrëveshjeve**

Bërnsi dhe Bevini hodhën poshtë propozimet e Molotovit për një ndarje mes katër fuqive të Ruhrit pasi nuk donin që asnjë pjesë e Gjermanisë të kishte karakter të ndarë ekonomik. Bevini i frikësohej një kontrolli sovjetik të Ruhrit pasi nëse lejohej, Stalini do të fuste duart në të gjithë zonën dhe do të kontrollonte ekonomikisht Gjermaninë dhe pjesën tjetër të Evropës. Për t'i bërë ballë presionit sovjetik, Bërnsi dhe Bevini ranë dakord që t'i bashkonin zonat e tyre ekonomike gjermane në përputhje me marrëveshjen e Potsdamit. Molotovi edhe pse në parim ishte për një bashkim të Gjermanisë, e hodhi poshtë këtë propozim. Po ashtu edhe Bidoja e hodhi poshte propozimin anglo-amerikan (Wheeler-Bennett and Nicholls, 1974:420). Për më tepër, Franca ishte kundër çdo lloj bashkimi të Gjermanisë pasi brenda 80 vjetësh ishte sulmuar katër herë. Britania e Madhe dhe SHBA-të kërkonin nga Bashkimi Sovjetik që të dërgonte ushqime në zonën e vet të pushtimi çka nuk e kishte bërë deri më tani. Po ashtu, ata akuzuan Molotovin se BS-ja kishte marrë reparacione nga Silezia dhe Kënigsbergu. Mosmarrëveshje për reparacionet vijonin që nga mbledhja e Jaltës. Molotovi fliste sikur Stalini nuk donte një paqe afatgjatë me Gjermaninë (Smyser, 1999:29). Në mbledhjen e 10 korrikut 1946, Molotovi u shpreh se Bashkimi Sovjetik nuk do të mund të firmoste një traktat paqje me Gjermaninë derisa kjo e fundit të paguante edhe qindarkën e mbetur për vite me radhë. Bërnsi kundërshtoi duke thënë se një ultimatum i tillë do të bënte të mundur që paqja asnjëherë të mos arrihej me Gjermaninë dhe se qëndrimi sovjetik do të conte në rishikimin e planeve amerikane për t'u larguar nga Evropa (Byrnes, 1947:176).

Në takimet e katër ministrave të jashtëm që u mbajtën pas mbylljes së konferencës së paqes, u vunë edhe një herë në dukje papajtueshmëritë politike ndërmjet Bashkimit Sovjetik dhe aleatëve perëndimorë. Ministri i jashtëm britanik Bevin e dinte se me fjalë nuk do të arrihej asnjë rezultat. Ai kërkonte të arriheshin marrëveshje. Ai kishte liri të plotë veprimi nga kryeministri Etlli, por fuqia britanike nuk ishte më ajo e shekullit XIX. Bevini ishte një anti komunist. Ai e përbuzte Molotovin dhe me qesëndi e quante "Mowlotov-Mullartov" (mow=mullar (anglisht) (Smyser, 1999:30). Nga këto qëndrime fyeze, Stalini shprehej se Bevini nuk ishte fisnik. Ministri i jashtëm britanik ishte i bindur se Bashkimi Sovjetik në takimet e Londrës dhe Moskës thjesht kishte fituar kohë për të konsoliduar pushtimet e veta në Evropën lindore. Bevini gjithashtu i frikësohej faktit se Bashkimi Sovjetik do ta firmoste traktatin e paqes me Gjermaninë vetëm kur ta ndjente veten të fortë aq sa të zotëronte të gjithë kontinentin. Edhe pse në parim ishte dakord me qëndrimin e Bidosë për ndarjen e Gjermanisë, ai kërkonte që aleatët perëndimorë të bashkonin në një zonat ekonomike jashtë ndikimit sovjetik. Këtë zgjidhje ai e pa si të vetmen rrugë për të mbajtur të angazhuara forcat amerikane në kontinent. Bevini u përpoq të bindte Bërsin që të gjenin një alternativë për bashkimin e Gjermanisë pa marrëveshje me Stalinin (Deighton, 1993:81). Përpjekjet sovjetike për të nxjerrë nëpërmjet spiunazhit sekretin e bombës atomike, përforcuan akoma më shumë dyshimet e Bevinit. U pa qartë se me Bashkimin Sovjetik, bashkëpunimi nuk do të ishte më në axhendë. Bota ishte ndarë de facto në dy kampe.

### **3.2. Ndarja e Evropës në dy pjesë ideologjike**

Kishte qenë si gjithnjë Uinston Çërçilli i pari që kishte denoncuar ndarjen e botës dhe veçanërisht të Evropës në dy kampe me ideologji të kundërta. Fjalimi i tij i famshëm në Fulton të Misurit në SHBA, në fillim të marsit 1946, ishte i ashper dhe tepër fatal për të ardhmen e botës. Në këtë fjalim ai [Çërçilli] u shpreh:

*"Nga Stetini në Ballistik e deri në Trieste në Adriatik, një perde e hekurt ka zbritur në kontinent. Qeveritë policore do marrin pushtetin në një numër të madh vendesh. Partitetë komuniste apo kolonat e pestat do të përbëjnë një sfidë në rritje për civilizimin e krishterë. Unë nuk besoj se Rusia Sovjetike kërkon luftë. Atë që dëshiron janë frytet e luftës dhe ekspansion të pafund të fuqisë dhe doktrinës së saj" (Stone, 2012:191).*

Stalini u nxeh jashtë mase dhe e akuzoi Çërçillin si "luftënxitës" i cili predikonte "teorinë raciale" më të cilën vetëm popujt anglisht folës kishin të drejtë të vendosnin për fatin e botës (Stone, 2012:191). Në fakt, ishte Bashkimi Sovjetik që kundërshtonte çdo formë kolonializmi dhe tashmë kërkonte të vendoste hegemoninë e vet ideologjike me forcën e bajonetës. Ky fjalim i ashper i Çërçillit nuk u mirëprit nga shumë senatorë amerikanë. Ata madje shkuan deri aty sa e akuzuan ish kryeministrin britanik si një ndihmës të nazizmit, pasi me politikat e tij dhe të Partisë Konservatore kishte ndihmuar në forcimin e regjimit hitlerian (Stone & Kuznick, 2012:192). Tashmë zaret ishin hedhur dhe bota gjendej përsëri në një rrugë pa krye. Frika e një përplasjeje të re po ndihej kudo në Evropë. A do të kishte përsëri luftë?

Përpjekja për të vendosur bashkarisht për të ardhmen e Gjermanisë po bëhej përherë e më e vështirë. Zgjedhjet politike po errësonin opzionet diplomatike. Në hartë, Gjermania nuk ekzistonte më. Aparati politik dhe ushtarët nazist ishte fshirë. Shoqëria gjermane ishte shpërbërë. Për këtë ndihmuan aleatët fitues. Të tre të mëdhenjtë nuk e kishin ndarë në mënyrë të barabartë vendin. Zonat amerikane dhe sovjetike kishin një sipërfaqe prej 66.340 km<sup>2</sup> me 17 milion gjermanë secila duke përfshirë dhe miliona refugjatë (Smyser, 1999:31).

Zona britanike e pushtimit kapte një sipërfaqe prej 97.000 km<sup>2</sup>, por zotëronë të gjithë krahinën e Ruhrit që ishte edhe zemra ekonomike e Gjermanisë me një popullsi prej 22 milion banorësh (Smyser, 1999:31). Zona franceze e pushtimit kapte një sipërfaqe prej 40.000 km<sup>2</sup> me 5 milion banorë dhe shumë pak refugjatë (Smyser, 1999:31).

Thembra e vërtetë e Akilit për Gjermaninë ndodhej në zonën sovjetike të pushtimit. Kjo përfaktin se Stalini dhe bashkëpunëtorët e tij gjermanë kishin filluar menjëherë revolucionarizimin e zonës dhe kthimin gradual të saj në sistemin komunist, model që do të shërbente përfshirë gjithë Gjermaninë. Udhëheqësi sovjetik e dinte se një ditë do t'i duhej të merrej me një Gjermani të ringjallur dhe duhej patjetër të ishte i sigurtë që vendi të kishte një sistem shoqëror, ekonomik dhe politik të përafërt me Bashkimin Sovjetik. Stalini nuk e shikonte Gjermaninë me syrin që e kishin parë Çërcilli dhe Ruzvelti apo Etlli me Trumanin. Njësoj si Bashkimi Sovjetik, edhe Gjermania bënte pjesë në kontinentin evropian. Polonia mund të shërbente si ndarje mes dy shteteve, por historia kishte treguar sesa lehtë mund ta kalonin këtë ndarje të dy vendet në dëm të njëri tjetrit.

Stalini e donte madje e kërkonte një Gjermani të bashkuar (Smyser, 1999:32). Me ndarjen e Gjermanisë atij do t'i mbetej pjesa më e padëshirueshme e vendit. Zona sovjetike e pushtimit kishte shumë pak asete. Gjeostrategjikisht, lidhej vetëm më Poloninë dhe një pjesë të vogël të Detit Ballistik. Liderit sovjetik nuk ishte nevoja t'i thuhej se pjesa e tij nuk ushtronë asnjë lloj ndikimi në pjesën tjeter të Gjermanisë. Kjo sillte natyrshëm edhe mungesën e ndikimit sovjetik në Evropën perëndimore. Shpresa e Stalinit ishte që të arrihej bashkimi gjerman nën autoritetin e Partisë Komuniste Gjermane. Plani i tij ishte i thjeshtë, por nëse do të realizohej do të ishte një arritje e madhe. Fillimisht, Gjermania duhej bërë shtet madje edhe shtet borgjez siç ishte në epokën e Republikës së Vajmarit. Partitetë

socialiste dhe komuniste do të ushtronin ndikimin e tyre derisa i tërë vendi të bëhej ekstremist i majtë. Ai filloi të instruktonte politikanët komunistë që të bashkëpunonin ngushtë me socialistët dhe të kishin durim se me kohë Gjermania do të bëhej marksiste (Gaddis, 1997:29).

### **3.3. Dilemat për bashkimin e Gjermanisë**

Stalini e shikonte bashkimin e Gjermanisë si një domosdoshmëri strategjike për Bashkimin Sovjetik. Madje, edhe një Gjermani borgjeze do të ishte shumë mirë për të pasi do t'i hapte rrugën Stalinit për ndikim në të gjithë Evropën. Në një mbledhje të Byrosë Politike mbajtur në fund të majit 1945, Stalini ishte shprehur se:

*"Do të ishte një utopi po të shpresonim fshatarizimin e shoqërisë gjermane"* (Smyser, 1999:32).

Ai donte që Gjermania të kishte marrëdhënie të mira me Bashkimin Sovjetik. Për këtë arsyе ai dërgoi në Gjermani, Anastas Mikojanin, njeriun e tij më besnik të çështjeve ekonomike për të bërrë një saktësim të situatës në Gjermaninë e pas luftës dhe për të rekomanduar se cilën rrugë ekonomike duhej të ndiqte Gjermania për të ndihmuar Bashkimin Sovjetik (Smyser, 1999:33). Me çështjen e bashkimit që qëndronte varur, zona sovjetike e pushtimit duhej të shërbente si bazë për përhapjen e ndikimit sovjetik nga gjermanët komunistë. Qysh në verën e vitit 1943, Stalini kishte themeluar Komitetin Kombëtar për Gjermaninë e Lirë i cili menjëherë pas lufte u kthye në zëdhënësin politik të Moskës në vend (Childs, 1983:1). Kryetar i këtij gruji ishte Valter Ulbrihti. Më 30 prill 1945, dy muaj e gjysëm përpëra konferencës së Potsdamit, ky komitet kishte hyrë në Gjermani. Ulbrihti ishte direkt njeriu i Stalinit për Gjermaninë. (Childs, 1983:3). Me udhëzim të Ministrisë së Jashtme Sovjetike, Ulbrihti filloi të bënte një studim lidhur me

Gjermaninë e pas luftës. Disa grupe të tjera të komunistëve gjermanë u shpërndanë në zona të tjera të vendit të administritimit sovjetik. Siç e kishin planifikuar, ata iu vunë menjëherë punës për të shtypur një gazetë, themeluar një radio dhe shtëpi botimi (Childs, 1983:14). Me autorizimin e autoriteteve sovjetike, ata u shndërruan në sindikatë dhe filluan menjëherë nga puna si administratorë të vendit ditën tjetër (Childs, 1983:14).

Sovjetikët dhe Ulbrihti u kujdesën që i gjithë personeli i kësaj sindiktate të përbëhej nga gjermanë që kishin jetuar në Bashkimin Sovjetik apo ishin simpatizantë të tij. Kontaktet që Ulbrihti kishte në Gjermani e ndihmuan shumë që të zgjidhët njerëzit dhe të demaskonte bashkëpunëtorët e nazizmit. Deviza e Ulbrihitit ishte:

*"Gjithçka duhet të duket demokratike, derisa t'i kemi gjërat fort në dorë"* (Smyser, 1999:33).

Më datë 14 korrik 1945, nën urdhrat e gjeneralit Georgij Zhukov, anëtarët e kësaj sindikate filluan të ushtrojnë ndikim të fortë për të bashkuar të gjithë popullin gjerman rreth tyre (Smyser, 1999:33). Në të zgjedhurin e Valter Ulbrihitit si njeriun e tij për të drejtuar Gjermaninë, Stalini kishte zgjedhur një njeri si vet (Smyser, 1999:33). Ulbrihitit i mungonte përkrahja popullore, por dinte sesi të merrte pushtetin. Ai nuk ishte një orator i spikatur, por dinte si ta organizonte punën. Politika gjermane nuk ishte e panjohur për të. Gjatë viteve të Republikës së Vajmarit, ai kishte qenë anëtar i parlamentit si anëtar i Partisë Komuniste. Kur Stalini ishte përpjekur t'i jepte formë sipas idesë së tij Partisë Komuniste Gjermane në vitet '20, ai ishte mbështetur tek besnikëria e Ulbrihitit (Fischer 2, 1991:142).

Ulbrihi ishte larguar nga Gjermania kur kishte ardhur në pushtet Hitleri. Fillimisht, kishte shkuar në Francë dhe më pas kishte marrë pjesë shkurtimisht në Luftën Civile Spanjolle. Aparatçikët sovjetikë e kishin identifikuar si një udhëheqës potencial për komunizmin gjerman (Fischer 2, 1991:142). Shërbimi sekret sovjetik e solli në Bashkimin Sovjetik ku ai

kaloi të gjithë periudhën e Luftës II Botërore. Atje ai u bë anëtar i Komintern-it. Askush nuk e njihte Partinë Komuniste Gjermane më mirë sesa Ulbrihti. Ai ishte njeriu i duhur i Stalinit.

Stalini dhe Ulbrihti filluan menjëherë nga puna apo u dorëzua Gjermania. Ata filluan një plan të gjerë shtetëzimi të industrisë në zonën sovjetike të pushtimit me pretendimin se ishte marrë çdo gjë që i përkiste nazistëve. Në mesin e vitit 1946, prona private nuk ekzistonte më në zonën sovjetike të pushtimit (Smyser, 1999:35). Nga zona e tij, Stalini mori ç'mundi për ta çuar në Bashkimin Sovjetik. Më shumë se një mijë fabrika u çmontuan dhe e gjithë teknologjia gjermane u dërgua në Bashkimin Sovjetik (Smyser, 1999:35). Aftësia teknologjike e zonës gjemane nën pushtimin sovjetik kishte pushuar së ekzistuari. Ulbrihti pati shpresuar se gjermanët do ta mbështhesnin këtë reformë, por ndodhi krejtësisht e kundërta. Tek interesi askush nuk të fal. Duke parë egërsinë me të cilën po silleshin sovjetikët (përdhunimet në masë dhe shpronësimet), mijëra gjermanë të zonës sovjetike po emigronin në zonat e administruara nga aleatët perëndimorë. Ulbrihitit nën presionin e Stalinit iu desh të merrte masa energjike për të ndalur emigrimin.

Megjithë ndihmën e madhe, Ulbrihti e kuptoi se komunizmi nuk mund të triumfone në Gjermani. Edhe në Austri e Hungari komunistët kishin performancë të dobët. Stalinit nuk po i pëlqente situata. Shumë social-demokratë e refuzuan shkrirjen me Partinë Komuniste. Lideri i respektuar social-demokrat Kurt Shumaker doli hapur kundër. Por, nën trysninë e Stalinit, lideri social-demokrat i zonës sovjetike të pushtimit Oto Grotevohl nuk rezistoi. Megjithë kundërshtimet e kryetarit Shumaker, Grotevohli shpalli shkrirjen e forcave social-demokrate me Partinë Komuniste në zonën sovjetike të pushtimit (Smyser, 1999:36). Sipas

komentatorit gjerman Wolfgang Leonhard i cili ishte vetë një komunist, kjo shkrirje kishte tendenca diktoriale (Smyser, 1999:37).

Për social-demokratët e zonave perëndimore të pushtimit aleat, ishte e thjeshtë të identifikohej Grotevohli si tradhtar. Ata nuk e merrnin fare parasysh se në çfarë presioni të tmerrshëm ndodhej lideri social-demokrat i zonës. Në datat 20-24 shtator 1947, u thirri kongresi i dytë i bashkimit (i pari ishte mbledhur në prill 1946) ku nga njëzet e dy folësit, vetëm dy i përkisnin Partisë Social-Demokrate. Zyrtarisht SPD-ja në zonën sovjetike të pushtimit nuk ekzistonte më (Smyser, 1999:37).

Për sovjetikët dhe komunistët gjermanë ishte e pamundur të fitonin simpatinë e popullit. Ushtria sovjetike kishte hyrë në Gjermani nga Prusia lindore dhe Silezia. Fushata e terrorit kishte qenë e tmerrshme. Ushtarët sovjetikë frymëzoheshin nga fjalët e marshallit Zhukov:

*"Ne do të hakmerremi në mënyrë të tmerrshme për gjithçka"* (Gaddis 10, 1996:141).

Përdhunimi u bë krimi më i përhapur i ushtarëve sovjetikë në zonën e tyre të pushtimit. Edhe pse pati oficerë sovjetikë që u përpoqën të ndalonin këtë gjëmë, madje edhe duke pushkatuar ushtarë, ata u dorëzuan pasi nuk mund të ndalej urrejtja që kishin sovjetikët ndaj gjermanëve në tërsi. Duke parë rëndësinë e situatës, gazeta Pravda rikujtoi një shkrim të Stalinit të 23 shkurtit 1942:

*"Do të ishte qesharake të identifikonim popullin gjerman me Hitlerin. Eksperienca historike kanë treguar se Hitlerët shkojnë e vijnë, populli gjerman dhe shteti gjerman mbesin"* (Smyser, 1999:38).

Marshalli Zhukov dhe urdhër të prerë që të ruhej disiplina, por tashmë dëmi ishte bërë. Sipas statistikave të viteve në vijim, më shumë se dy milion gra gjermane të çdo moshe u përdhunuan nga ushtarët sovjetikë (Smyser, 1999:38). Megjithë këto probleme në rritje, Stalini dhe Ulbrihti filluan të mos binin dakord lidhur me çështjet politike. Stalini dëshironë të ushtronte frikë në popullsinë gjermane dhe mund t'ja hiqte autoritetin

Ulbrihit me një të kërcitur të gishtave, por çuditërisht ai asnjëherë nuk e shkarkoi të besuarin e tij. Edhe Ulbrihti e kishte mësuar shumë mirë artin e mashtimit deri në atë shkallë sa mund t'ja hidhte edhe Stalinit, por përsëri lideri sovjetik nuk e shkarkoi atë. Aftësia e Ulbrihit për të ndjekur politika disi të pavarura nga shefi i tij mbetet një nga misteret më të mëdha të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të historisë gjermane të pas luftës (Smyser, 1999:39).

### **3.4. SHBA-ja, Britania e Madhe dhe Franca bashkojnë zonat e tyre të pushtimit**

Forcat aleate të pushtimit nuk e kishin situatën më të lehtë sesa sovjetikët në të tyren. Vendi ishte tërësisht i copëtuar, ekonomia e shembur dhe populli i rraskapitur. Edhe aleatët duket sikur ishin dakord me qëllimin e Stalinit. Asnjë ushtri gjermane nuk duhej ngritur më që të sulmonte fqinjët. Synimi i tyre ishte që të reformonin shoqërinë dhe politikën gjermane. Një tjetër problem që shtrohej përballë aleatëve ishte se sesi duhesin ndarë gjermanët nazistë nga gjermanët e ndershëm. Njëloj si sovjetikët, edhe aleatët perëndimore ndesheshin me problemin e emigracionit i cili ishte edhe më i mprehtë, pasi ata gjermanë që ishin strehuar fillimisht në zonën sovjetike kishin ikur prej andej dhe kishin ardhur në zonat perëndimore nën kontrollin aleat. Në këtë situatë kaotike, vlen të përmendet një fakt i thjeshtë. Aleatët perëndimore nuk ishin të përgatitur aq mirë sa sovjetikët (Smyser, 1999:42). Shumë udhëheqës perëndimore veçanërisht ata amerikanë, as që i afroheshin vizionit historik të Stalinit për të bërë një ndarje logjike ndërmjet popullit gjerman dhe Hitlerit. Ata as që e kishin idenë se çfarë i priste dhe aq më pak se çdo të bënin sapo të fillonte pushtimi. Çdo pushtues perëndimor solli të veçantat e veta në zonën e vet të pushtimit. Problemet me të cilat ata u përballën në zonat e tyre të pushtimit ishin të shumta

dhe të ndryshme. Dëshpërimi ishte pa dyshim "sëmundja" e parë që duhej eliminuar.

Popullit gjerman i duhej kthyer shpresa.

Që t'i kthehej shpresa popullit gjerman, në fillim duhej identifikuar sëmundja. Më 25 shkurt 1947, përfaqësuesit e autoriteteve aleate pushtuese, nënshkruan në Berlin ligjin që shfuqizonte shtetin e Prusisë (Clark, 2006:12). Prusia nga ky moment i përkiste të shkuarës historike. Në vendimin që u bë publik shkruhej:

*"Shteti prusian i cili në të kaluarën kishte qenë bartës i militarizmit dhe i reakzionit në Gjermani, de facto ka pushuar së ekzistuari. Të udhëhequr nga interesat për ruajtjen e paqes dhe sigurisë së popujve, dhe me dëshirën për të siguruar ndërtimin e mëtejshëm të jetës politike në Gjermani mbi baza demokratike, Këshilli i Kontrollit dekreton si vijon:*

*Neni I*

*Shteti Prusian së bashku me qeverinë e tij qendrore dhe të gjitha agjesitë e tij pushon së ekzistuari" (Clark, 2006:12).*

Duke hequr Prusinë nga harta e Evropës, aleatët treguan se ai territor nuk kishte më barazi me Badenin, Bavarinë apo Saksoninë. Ai territor kishte qenë sëmundja që kishte pikëlluar një Evropë të tërë. Në një fjalim në parlamentin britanik, më 21 shtator 1943, Çërcilli ishte shprehur:

*"Bërrthama e Gjermanisë është Prusia. Ajo është burim periodik kolere" (Clark, 2006:12).*

Shuarja e Prusisë nga harta politike e Evropës ishte një simbolikë e domosdoshme. Sipas fjalëve të një historiani të famshëm të quajtur Ludvig Dehio se, *'Nazizmi nuk ishte aksident, por një simptomë akute e sëmundjes prusiane dhe se austriaku Adolf Hitler ishte një "prusian i zgjedhur" në mentalitetin e tij'* (Clark, 2006:13).

Çdo zonë nën pushtimin e aleatëve perëndimorë u bë një entitet më vete gjatë vitit të parë të pushtimit (Black, 1992:171). Amerikanët që kishin qenë edhe forca që kishte ndërhyrë më shpejt në Gjermani, thuajse u demobilizua menjëherë dhe pritej që ushtarët amerikanë të ktheheshin në atdhe brenda dy vjetësh. Si fillim, ata aplikuan një doktrinë ndëshkimi bazuar në planin Morgento. Kjo doktrinë ka hyrë në histori me emrin JCS 1067 dhe është

aprovar në prill 1945 e mbështetur në katër D-të; demilitarizim, dekartelizim, denazifikim dhe demokratizim. Aty specifikohej qartësisht se Gjermania nuk duhej trajtuar si një vend i çliruar, por si një vend i mundur (Black, 1992:171). Ishte e ndaluar të kryeje çdo lloj miqësie me civilët gjermanë dhe ishte dekretuar që autoritetet pushtuese nuk do të ndërmerrnin asnjë hap për të forcuar ekonominë gjermane. Qëndrimi amerikan u bë akoma edhe më i ashpër kur u panë botërisht krimet e tmerrshme të kryera nga nazistët në kampet e përqendrimit dhe masakrimi i miliona hebrenjve, ciganëve, homoseksualëve, invalidëve dhe të tjerëve.

Gjenerali Lusjus Klei (Clay) i cili ishte zëvendësi i gjeneralit Duajt Ajzenhauer (Eisenhower), u emërua zv./shef i zonës amerikane. Ai u përqëndrua në çështjet gjermane dhe në mekanizmat e katër fuqive pushtuese. Gjeneralët Ajzenhauer dhe MekNerni (McNarny) ishin kryetarët. Klei ishte i njohur për gjermanët dhe për aleatët edhe gjatë luftës dhe deri në emërimin e tij si guvernator i përgjithshëm ushtarak më 1947, ai punoi për rimëkëmbjen e vendit (Black, 1992:175).

Një nga synimet e gjeneralit Klei ishte që të përgatiste sa më shpejt një administratë civile të gatshme të drejtonte zonën pas largimit të forcave amerikane. Ai drejtoi një program shumë të gjerë denazifikimi në çdo nivel të shoqërisë dhe nuk u përpoq të përbyste vendin siç bëri Ulbrihti në zonën sovjetike (Black, 1992:175). Ai u vu në kërkim të gjermanëve të "mirë" të cilët do ta ndihmonin të drejtonte pushtimin. Ai gjeti pak njerëz shumica e të cilëve kishin qenë drejtues gjatë kohës së Republikës së Vajmarit të cilët pas ardhjes së Hitlerit në fuqi ose ishin pushuar nga puna ose ishin burgosur. Një prej tyre ishte ekonomisti i famshëm Ludvig Erhard të cilit iu dha detyra të administronte ekonominë gjermane në zonën amerikane të pushtimit. Klei kishte projektuar që me kalimin e kohës,

futitë aleate perëndimore të ndihmonin Gjermaninë të demokratizohej. Që në vitin 1945, ai filloi kontaktet politike me gjermanët. Edhe pse ishte i detyruar të aplikonte rezolutën JCS 1067, ai u tregua i shkathët në interpretimin e saj dhe sa më shumë kohë kalonte, aq më shumë fitonte besimin e gjermanëve për të ndërtuar një rend demokratik. Ai donte t'u jepte gjermanëve një shans. Shumë bashkëkombas të tij që punonin me të filluan ta akuzonin për "lokalizëm" dhe afri të tepruar e gjermanët, por ai vijonte në rrugën e tij. (Smith, 1990:424). Klei kishte në dorë të gjithë pushtetin e mundshëm, por filloi të lejonte edhe një lloj vetqeverisjeje lokale. Në fillim të tetorit 1945, ai kishte filluar të vendoste administratën civile të ndarë në lande nën vëzhgimin e autoriteteve ushtarake amerikane. Duke qenë se e kishte studiuar mirë historinë gjermane, Klei mendonte se po ndërtonte një sistem i cili do të ishte i përputhshëm me traditat gjermane si dhe me modelin federalist amerikan. Klei kishte mësuar sesi ishin sjellë ushtarët sovjetikë në zonën e tyre të pushtimit dhe kërkonte maksimumin e korrektësisë nga ushtarët e tij. Në zonën amerikane nuk pati përdhunime masive, por ushtarët amerikanë u përfshinë në tregtinë e tregut të zi çka i shkaktoi jo pak probleme Kleit (Smyser, 1999:44). Ky element bëri që ushtria amerikane të humbte në shkallë të gjerë disiplinën e saj. Incidentet u shtuan dhe popullsia gjermane u mërzit. Por, Klei nuk e la situatën t'i shpëtonte nga dora. Ai vendosi rregulla të rrepta që ndihmuani në disiplinimin e ushtrisë dhe në fitimin e respektit të popullsisë gjermane (Smith, 1990:396). Klei besonte se edhe sekretari i shtetit Bërns mbështeste politikat e tij. Gjatë verës së vitit 1946, kur sovjetikët hodhën tezën e bashkimit të Gjermanisë, Klei shprehu shqetësimin se komunistët do të fitonin besimin e opinionit publik gjerman (Smith, 1990:397).

Molotovi kishte dhënë të kuptoje se vetëm Bashkimi Sovjetik e mbështeste bashkimin e Gjermanisë. Gjermanët e dinin se ata duhej ta kishin mirë me Ushtrinë e Kuqe pasi

amerikanët të largoheshin nga vendi. Klei donte t'u jepte gjermanëve një alternativë. Ai i kërkoi Bërsnit i cili kishte besim të verbër tek ai edhe për shkak të njojjeve të vjetra (ishin nga e njëjtë zonë në SHBA), që të vinte në Shtutgart dhe të kundërshtonte tezën e Molotovit. Dhe Bërsni nuk vonoi ta bënte. Gjatë fjalimit të tij në Shtutgart, ai mbajti një qëndrim të vendosur, por miqësor të SHBA-ve për dhënien e ndihmës në krijimin e një Gjermanie demokratike. Fjalimin ia kishte përgatitur Klei me dorën e tij. Ndër të tjera Bërsni u shpreh:

*"Ne nuk do t'i shmangemi detyrës tonë. Ne nuk do të têrhiqemi. Ne do të qëndrojmë këtu dhe do të furnizojmë me proporcionalitet forcat tona të sigurisë". (Byrnes, 1947:190).*

Bërsni u bë amerikani i parë i cili u tha gjermanëve që Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të vazhdonin të ishin të angazhuara në Evropë dhe do t'i mbështesnin ata. Me një fjalim të vetëm ai përbysi planin Morgento dhe têrheqjen amerikane në vitin 1947. Gjermanët u entuziazmuai aq shumë nga ky fjalim saqë edhe në stacionin e trenit kur Bërsni po largohej, i kërkonin me ngulm autografe. Bërsni nuk luajti me ndjenjat e popullit gjerman dhe gjermanët e mirëpritën atë (Smith, 1990:397).

Bërsni u largua nga detyra më 1947 dhe u zëvendësua nga Xhorxh Marshall. Ndihmësit e sekretarit të ri amerikan të shtetit mendonin se me sovjetikët nuk do të arrihej mirëkuptimi për Gjermaninë. Ekspertë si Çarls Bohlen dhe Xhorxh Kinan i cili më vonë do të botonte pa emër "teorinë e përbajtjes" i përbaheshin idësë se Gjermania duhej të mbahej e ndarë pasi Stalini do ta jepte zonën tij vetëm nëse i gjithë vendi do të ishte komunist (Snyser, 1999:45).

Klei i kërkonte me ngulm Marshallit që të bëhej ç'ishte e mundur të bindeshin sovjetikët për bashkimin e Gjermanisë dhe se populli gjerman duhet ta zgjidhte vetë formën e qeverisjes. Klei mendonte se Gjermania mund të bashkohej dhe të qëndronte mënjanë

mosmarrëveshjeve lindje-perëndim. Ai nuk dëshironte që Berlini apo pjesa sovjetike e pushtimit të qëndronin shumë gjatë nën diktatin komunist.

Debatet më të ashpra Klei i kishte me Xhon Foster Dallasin, asokohe këshilltar i Marshallit. Dallasi mendonte t'i ofronte Molotovit ndarjen e Ruhrit nga pjesa tjetër e Gjermanisë dhe të vendosej nën kontrollin ndërkombëtar. Klei mendonte se Ruhri duhej të kishte një status të veçantë, por jo të ishte një entitet gjerman më vete. Nëse Ruhri shkëputej nga Gjermania, populli gjerman do të fillonte të urrente perëndimorët siç urrente sovjetikët. Ai protestoi energjikisht, por pa sukses. Fati doli të ishte me Klein pasi Molotivi vetë nuk e pranoi këtë propozim sepse ishte ndjerë i fyer nga fjalimi i ashpër i Bërsnit (Smith, 1990:414).

Ndryshe nga amerikanët, anglezët kishin probleme të tjera. Ernest Bevini njëloj si Çerçilli mendonte se Britania e Madhe ishte dobësuar shumë dhe nuk ishte në gjendje ta përballonte e vetme Bashkimin Sovjetik. Fillimi, Bevini nuk dinte se kujt t'i drejtohej. Amerikanët kishin deklaruar se do të tërhiqeshin brenda dy vjetësh. Franca ishte thuajse e tëra jashtë loje edhe sepse dë Goli donte të shkëpuste edhe Ruhrin edhe Rinelandin nga zona britanike e pushtimit. Ndërkohë, britanikët kishin lëvizur shumë më ngadalë sesa amerikanët për të vendosur autoritetin lokal nën mbikqyrjen e tyre. Kur vendosën të bënин këtë, ata e bënë sipas stilit britanik dhe jo sipas stilit federal amerikan. Ata e centralizuan administratën në zonën e tyre të pushtimit. Edhe pse lejuan një lloj autonomie, përsëri ata ishin larg lirisë që kishte dhënë Klei. Bevini nuk aplikoi stilin e Erhardtit të ekonomisë së lirë, por stilin britanik të ekonomisë të drejtuar. Qeveria e re britanike ishte laburise dhe e përkushtuar ndaj socializmit. Ajo shtetëzoi më shumë se 50% të firmave gjermane. Anglezët vendosën parimin e bashkëpërcaktimit në të cilin punëtorët gjermanë do të kishin

zë të organizoheshin në bazë të vendimeve të ndërmarrjeve të tyre. Ky sistem u quajt më vonë në të gjithë Gjermaninë si *Mitbestimmung* (pjesëmarrje) (Smyser, 1999:46).

Për Anglinë, zona e saj e pushtimit në Gjermani ishte sfidë më vete. Gjermania kishte shumë pak prioritet krahasuar me perandorinë britanike dhe stërlinën angleze. Gjermanët në zonën britanike duhet t'ja dilnin mbanë vetë. Zona britanike kishte popullsinë dhe pjesën më të pasur të Gjermanisë. Gabimet administrative britanike sollën vështirësi në furnizmin e kësaj pjese me ushqime. Duke parë situatën që sa vinte e rëndohej, Etlli dhe Bevini u detyruan t'i dërgojnë ushqime ish armiqve të tyre. Për të shpëtuar nga një katastrofë e mundshme, Bevini propozoi planin që i vuri emrin e tij. "Plani Bevin" përfshinte të gjitha zonat nën administrimin britanik që të ushtronin ekonomi të lirë dhe nëse do të kishin sufiçite t'i dërgonin në vendet me vështirësi. Ai ishte i bindur se do t'ia dilte mbanë duke dërguar hekur dhe çelik në këmbim të ushqimit. Kleit i pëlqeu ky plan dhe filloi ta diskutonte me komandantin britanik përgjegjës të zonës, gjeneralin Brajan Robertson. Stalini dhe Ulbrihti ishin kundër. (Smyser, 1999:46).

Në fillim të vitit 1946, kryetari i bashkisë së Bremenit mendoi se kishte ardhur koha për një rigjallërim të ekonomisë gjermane që do të conte në bashkimin ekonomik. Ai ftoi të gjithë kryetarët e landeve në një konferencë me këtë synim. Zyrtarët francezë dhe ata sovjetikë nuk i lejuan zyrtarët gjermanë të shkonin në Bremen, ndërsa Klei dhe Robertsoni po. Kleit i duhej bashkëpunimi me britanikët pasi akoma shpresonte se edhe me Sokolovskin do të binin dakord për një zonë treshe bashkëpunimi. Molotovi i cili nga ana e tij ngrinte në qill bashkimin gjerman, kundërshtonte çdo përpjekje bashkëpunimi ndërmjet katër zonave të pushtimit. Në maj 1946, duke parë kokëfortësinë franko-ruse, Klei vendosi të mos dërgonte më ndihma në zonat e tyre të pushtimit. Me këtë veprim, ai synonte të detyronte francezët

dhe sovjetikët të hapnin dyert e bashkëpunimit, por nuk ia doli mbanë. Në këtë pikë, ideja e bashkimit të zonave anglo-amerikane të pushtimit ishte e pashmangshme.

Gjatë të gjithë verës së vitit 1946, diskutimet anglo-amerikane vijonin pareshtur mbi këtë çështje. Në shtator, Londra dhe Uashingtoni ranë dakord për shkrirjen në një të zonave të tyre. Më 1 janar 1947, ata krijuan Bizonia, një entitet i vetëm ekonomik me hapësirë nga Deti i Veriut dhe Hamburgu deri në zemrën industriale të Gjermanisë duke përfshirë edhe alpet deri në Austri. Frankurti u bë kryeqyteti i Bizonias (Smyser, 1999:47). Shumë zyrtarë britanikë duke përfshirë edhe Bevinin dëshironin ndarjen e Gjermanisë. Këtë veprim ata e cilësuan si hapin e parë. Në fjalimin e tij në parlament se "Rusia sovjetike përbën kërcënim më të madh sesa Gjermania e ringjallur" (Deighton, 1993:62), rriti angazhimin e përbashkët anglo-amerikan. Me këtë veprim, Franca mbeti vetëm përballë Bashkimit Sovjetik.

Franca ishte vendi që gati një shekulli kishte vuajtur më së shumti ekspansionin gjerman. Dë Goli si kryetar i Francës, nuk kishte më ndërmend ta lejonte një gjë të tillë. Ai drejtoi personalisht pushtimin francez në Gjermani. Njëlloj si Stalini, edhe lideri francez nuk kishte një kanal me ujë që ta mbronte nga Gjermania. Ai duhej patjetër të gjente një zgjidhje për sigurinë e Francës. Dë Goli mund të kishte një natyrë romantike për kombin, por kishte logjikë të fortë për pushtetin (De Porte, 1968:250). Ai kishte marrë pjesë trimërisht në betejën për mbrojtjen e Francës më 1940. Nga Londra, ai kishte drejtuar rezistencën franceze. Pas çlirimtës së Francës, ai kishte drejtuar politikën e vendit të tij për vetëm 8 muaj derisa u detyrua të dorëhiqej. Gjatë kësaj kohe të shkurtër, ai formuloi parimet bazë të cilat do të kishin një efekt të gjatë mbi Gjermaninë. Dë Goli nuk dëshironë që vendi i tij të kërcënohej më nga Gjermania. Ai ndoqi me konsekuençë politikat e Luigjit

XIV, Napolonit dhe Klemansosë në Versajë të cilët dëshironin që Rinelandi të ishte i shkëputur nga Gjermania dhe t'i bashkohej Francës apo Belgikës ose Holandës. Ai nuk do ta aneksonte këtë territor, por as nuk donte trupa gjermane atje. Dë Goli gjithashtu, kërkonte që edhe zona e Ruhrit të shkëputej ekonomikisht dhe politikisht nga Gjermania (De Porte, 1968:250). Ky territor, sipas tij do të vendosej nën kontrollin e vendeve që përdornin qymyr për industri si Franca, Italia, Zvicra, Holanda, Belgjika dhe Luksemburgu. Kushti do të ishte që këto vende të mos e aneksonin këtë territor. Nëse aleatët e tij perëndimoë të Luftës II Botërore nuk dëshironin ta ndanin Gjermaninë, atëherë ai ofronte opzionin e mbajtjes së pushtuar të këtij territori. Lideri francez nuk ishte në gjendje të thoshte sesa do të zgjaste pushtimi. Në mars të vitit 1946, Franca vuri veton për ndalimin e krijimit të partive politike gjermane (De Porte, 1968:250).

Dë Goli kërkonte të ristrukturonte strukturat evropiane të cilat do të bënин të mundur të përmbanin Gjermaninë. Dë Goli kërkonte të restauronte një botë që nuk ekzistonte më. Fillimisht, me gjithë irritimin që treguan kundër Francës dhe atij personalisht, tre fuqitë e tjera pushtuese duket sikur i mbështetën qëllimet e udhëheqësit francez. Kjo në fakt ishte e përkohshme. Shumë shpejt, gjenerali dë Gol do ta shikonte veten të izoluar nga aleatët e tij të natyrshëm. Duke parë se nuk do të mund t'ja dilte mbanë projektit të tij për të shkëputur zonën e Ruhrit nga Gjermania, ai iu rikthyte një projekti të vjetër francez.

Zona e Saarës kishte qenë objekt sherresh franko-gjermane që nga koha e Luigjit XIV. Që nga fillimi i pushtimit, dë Goli ia vuri syrin ta shkëpuste këtë zonë të pasur me qymyr nga Gjermania. Më 30 gusht 1945, ai e vendosi Saarën nën urdhrat e një komisioni të posaçëm francez të ndarë nga zona franceze e pushtimit (De Porte, 1968:254). Në dhjetor 1945, çdo prodhim qomyri të Saarës ai e niste për në Francë. Në nëntor 1947, krahina e Saarës ishte

inkorporuar në sistemin ekonomik francez (De Porte, 1968:254). Dë Goli mund të kishte triumfuar në planin afatshkurtër për ta mbajtur të ndarë në katër zona pushtimin e Gjermaninë, por Franca nuk i kishte mundësitetë për të aplikuar një politikë të pavarur në çështjen e gjermane. Qysh përpara se të jepte dorëheqjen, dë Goli filloi të shqetësohej më shumë për kërcënimin sovjetik sesa për ringjalljen gjermane. Qeveritë franceze po aplikonin gjithnjë e më shumë politika që i afroheshin Bizonias sesa interesit francez. Në fakt, interesi francez e kërkonte me ngulm bashkimin e zonës franceze me zonën anglo-amerikane. Më 21 korrik 1947, duke parë izolimin gjithnjë në rritje të Francës në çështjen gjermane, ambasadori francez në Uashington, informoi sekretarin e shtetit Marshall se kishte marrë udhëzim nga Parisi për ta informuar se Franca ishte dakord të bashkonte zonën e saj të pushtimit me Bizonian (De Porte, 1968:259). Franca kishte ndihmuar në copëtimin e Gjermanisë duke filluar që nga viti 1635 kur Risheljëja e angazhoi në Luftën 30 Vjeçare, dhe tani pas 300 vjet përplasjesh të pamëshirshme franko-gjermane, po ndihmonte në integrimin e armikut shekullor. Është fakt i njohur që interesi kombëtar nuk duhet të të shpjerë në ekstremizëm. Realpolitika është e pamëshirshme. Fuqitë perëndimore e kishin filluar pushtimin e Gjermanisë duke aplikuar politika të ndryshme. Në fund të vitit 1947, ata filluan të shkrijnë politikat e tyre dhe zonat e pushtimit në një. Këtë ata nuk e bënë për hatër të gjermanëve. Ata donin të shkurtonin shpenzimet dhe të gjenin një mënyrë sesi të integrohej vendi dhe ata të dilnin të kënaqur. Një tjetër arsyse përse ata vepruan në këtë mënyrë ishte edhe rritja e pandalshme e rrezikut sovjetik. Bota e tërë i kishte sytë nga Gjermania, por viti 1948 solli një tjetër ngjarje me rëndësi botërore e cila nuk do të shmangej nga interesi dhe vëmendja ndërkombëtare gjatë të gjithë kohës.

### **3.5. Bashkimi Sovjetik dhe epoka atomike**

Edhe pse gjatë viteve '40 dukej i pamundur, përfundimi i Luftës II Botërore i vuri perëndimit një sfidë të frikshme; Bashkimin Sovjetik. Dukej sikur ushtritë e Stalinit pas triumfit mbi nazizmin do të bënин realitet profecinë e Leninit për shembjen e kapitalizmit. Një armë e re ishte shpikur nga njerëzimi e cila do t'i bënte të pavlefshme të gjitha strategjitë ushtarake; bomba atomike. Amerikanët kishin qenë të parët që e kishin përdorur më 6 dhe 9 gusht 1945 në Hiroshima dhe Nagasaki. Shumë ekspertë dhe studiues mendojnë se goditja e dy qyteteve japoneze me armën më të tmerrshme që kishte shpikur ndonjëherë mendja njerëzore nuk ishte bërë për të detyruar Japoninë të dorëzohej, por për t'i dërguar një mesazh të qartë Stalinit. Mos vallë kjo ishte arma e fundit që do të bënte pluhur e hi shtetin sovjetik (Kissinger, 1957:362)?

Stalini dhe enturazhi i tij bolshevik do të kenë ndjerë një frikë të madhe në zemër kur shikonin se në çastin e lavdisë më të madhe të Rusisë sovjetike, ekzistanca e saj vihej në rrezik permanent. Nëse kapitalizmi me shpikjen e kësaj arme ia dilte mbanë t'i kapërcente të gjitha problemet e veta, atëherë doktrina sovjetike vihej në pikëpyetje. Nëse leninizmi dështonte në një mënyrë kaq tragjike, atëherë e tërë dogma marksiste duhej vënë në pikëpyetje. Por, përsëri lidershipi sovjetik i zhgënjeu të gjithë. Njëloj si në vitin 1939, kur nënshkroi aktin e mosslumit me kundërshtarin total Gjermaninë naziste, edhe kësaj here me një disiplinë të hekurt, udhëheqësi sovjetik refuzoi të deklaronte se nuk ka mospërputhshmëri ndërmjet teorisë së Leninit dhe realitetit. Madje Stalini shkoi deri aty sa të deklaronte se bomba atomike do të pëershpejtonte fundin e kapitalizmit (Kissinger, 1957:362). Këtë përshtatje të re me kohën, lideri i Kremlinit e aplikoi si tezën më të fundit të dokrinës marksiste dhe si një qëllim për mbijetesën e tij në pushtet. Stalini e dinte mirë

se ana e dukshme e gjërave duhej mbajtur me një perde mashtrimi ku duhej të kombinoheshin faktorët politikë, ekonomikë, psikologjikë dhe ushtarakë (Kissinger, 1957:362). Ai e dinte mirë se përjashtimi i njërit prej faktorëve të sipërpermendur do të sillte humbjen e tij. Stalini ishte i bindur se superioriteti i kundërshtarit në një fushë duhej kompensuar nga manipulimi i fushave të tjera.

Pas Luftës II Botërore, Bashkimi Sovjetik nuk i kishte kapacitetet për të patur bombën atomike. Këtë mungesë thelbësore liderët komunistë u përpoqën ta kompensojnë duke manipular opinionin publik brenda vendit të tyre me kombinimin e taktikave politike në mënyrë që t'i përshtateshin dogmës zyrtarë sovjetike. Stalini u përpq ta bindte popullin sovjetik se arma atomike ishte mbiçmuar. Nga ana tjetër, në fshehtësinë më të madhe kishte dërguar agjentë në SHBA që të mund të merrnin sekretin e ndërtimit të kësaj arme që do ta bënte të barabartë me Amerikën. Për t'i hedhur hi syve perëndimit, udhëheqësi suprem sovjetik nuk la konferencë paqeje pa marrë pjesë, notë diplomatike pa dërguar ku nxiste paqen në mënyrë që të paralizonte çdo mekanizëm perëndimor të drejtuar kundër tij derisa të kishte në dorë bombën atomike. Që nga viti 1945 e deri në vitin 1949 kur më në fund edhe Bashkimi Sovjetik do të kishte armën atomike, Stalini ishte "ëngjelli" i paqes.

Përpjekja e Stalinit për të minimizuar efektin e bombës atomike ishte aq konsistente saqë edhe në konferencën e Potsdamit kur presidenti amerikan Truman e kishte vënë shkarazi në dijeni, ai kishte bërë indiferentin. Në kujtimet e tij Trumani shkruan për këtë ngjarje:

*"Kryetari rus nuk tregoi ndonjë interes të veçantë. Gjithçka që ai tha ishte se u kënaq tek e dëgjoi një lajm të tillë dhe shpresoi se kjo armë do të përdorej kundër japonezëve" (Truman II, 1955:416).*

Ka të ngjarë që Stalini të ishte më parë i informuar sesa Trumani lidhur me ekzistencën e Programit Atomik në SHBA. Trumani u njoftua për këtë progam vetëm kur u bë president në prill 1945 (Kissinger, 1957:365). Sjellja e Stalinit në Potsdam reflektonte një qëndrim

për të minimizuar rëndësinë e bombës atomike në mënyrë që të tregonte se Kremlini ishte aq i fortë saqë nuk trembej nga ekzistanca e saj. Me një qëndrim të tillë të patundur, e tërë propaganda dhe diplomacia sovjetike u hodhën në mbështetje të tij. Bombardimi i Hiroshimës iu tregua popullit sovjetik vetëm në një cep të shtypit zyrtar dhe pa asnjë lloj komenti. Stalini ia atribuoi kapitullimin e Japonisë jo bombës atomike, por ndërhyrjes së Ushtrisë së Kuqe në Lindjen e Largme. Kur bomba e dytë atomike u lëshua mbi Nagasaki, populli sovjetik as u informua për këtë. Pas këtij akti të SHBA-ve, propaganda sovjetike u lëshua nga të katër anët e botës për të ndaluar prodhimin dhe përdorimin e kësaj arme. Strategët sovjetikë deklaronin se përdorimi i bombës atomike nuk kishte qenë vendimtar për kapitullimin e Japonisë. Kapitullimi ndodhi sepse kasta militariste japoneze kishte falimentuar. Bashkimi Sovjetik deklaratonte se:

*"Eksperiencia e Luftës së Dytë Botërore dhe fitoret madhështore të Ushtrisë së Kuqe kanë treguar qartësisht se suksesi në luftë nuk arrihet nga zhvillimi i njëanshëm i një arme, por nga perfekcionimi i të gjitha armëve dhe koordinimi i tyre" (Rubinstein, 1945:14).*

Sipas kësaj logjike, nëse bomba atomike nuk kishte qenë vendimtare kundër Japonisë, kurrsesi nuk mund të ishte frikësuese për Bashkinin Sovjetik. Që në këtë vit, propaganda sovjetike filloi të sulmojë garën imperialiste të SHBA-ve për dominim botëror me anë të kërcënimit të bombës bërthamore. Madje, shtypi sovjetik nuk hezitoi të bënte edhe krahasime me epokën e Hitlerit duke thënë se fitoret e para të tij i atriboheshin armëve moderne, por që nuk e ndihmuan në fitoren përfundimtare. E njëjtë gjë do të ndodhë me SHBA-në (Rubinstein, 1945:15). Agresiviteti amerikan sipas shtypit sovjetik pengonte të gjitha forcat përparimtare të bashkoheshin kundër përdorimit të saj (Rubinstein, 1945:18).

Më 25 shtator 1946, gazeta Pravda botoi një deklaratë të Stalinit në të cilën thuhej:

*"Unë nuk mendoj se bomba atomike është aq e fortë sa duan ta paragasin grupe të ndryshme politike. Bombat atomike kanë si qëllim të frikësojnë popujt dhe të*

*dobësojnë nervat e tyre, por ato nuk mund të vendosin për fatin e një lufte pasi për të [luftin] janë totalisht të pamjaftueshme". (Kissinger, 1957:367).*

Me ta thënë Stalini, të gjithë komunistët e botës e morën të mirëqenë një deklaratë të tillë dhe shpërfillën kërcënimin e luftës bërthamore. Madje, komunisët shkuan deri aty sa thanë se nëse bomba do të lëshohej kundër territoreve të Bashkimit Sovjetik dhe Kinës do të ishte pa asnje lloj efekti (Chao, 1950:24). Bashkimi Sovjetik po i qëndronte me besnikëri doktrinës së "pastërtisë ideologjike". Bomba atomike konsiderohej si propagandë perëndimore dhe të vetmet deklarata kundër bombës kishin thjesht efekt të dobët psikologjik (Traktenberg 3, 1948:94). Përpjekja për të minimizuar teknologjinë bërthamore shoqërohej me një terr të plotë informativ për t'i treguar popullit sovjetik përparimet perëndimore.

Ishte pikërisht ky hap përpara i perëndimit që detyroi Stalinin të vetëpërmblahej. Megjithatë, ka dy opsione lidhur me bombardimin atomik të Japonisë prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Për breza të tërë, amerikanët dhe bota kanë ditur se bombat u hodhën me ngurrim kundër Japonisë në fund të Luftës II Botërore për të shpëtuar mijëra jetë amerikane dhe aleate (Stone, 2012:131). Opzioni i dytë i bombardimit atomik të Japonisë dhe avancimit amerikan të teknologjisë bërthamore është edhe më problematik. Ironik është fakti se një shkrimitar amerikan i quajtur H.G. Uells (Wells) në librin e tij "Bota u çlirua" botuar më 1914, profetizoi trishtueshëm se '*lufta atomike ndërmjet Gjermanisë dhe Austrisë nga njëra anë dhe Anglisë Francës dhe SHBA-ve nga ana tjetër do të shkaktonte një tragjedi me 200 qytete të shkatërruara*' (Stone, 2012:133). Kur bomba atomike u bë realitet dhe bombardimi i Japonisë u bë fakt i kryer ai klithi me të madhe:

*"Mallkuar qofsha që juash hashë këtë". (Stone, 2012:133).*

Në vitin 1938, dy fizikantë gjermanë (njëri prej të cilëve Albert Ajnshtajn) emigruan në SHBA për t'i shpëtuar terrorit nazist. Një vit më pas, Ajnshtajni i shkroi presidentit Ruzvelt

që të lejonte eksperimentin e ndërtimit të bombës atomike. Vite më vonë Ajnshtajni u pendua që nxiti presidentin (Stone, 2012:133). Në dhjetor të vitit 1942, zyrtarisht në SHBA fillon programi 'Manhattan' nën vëzhgimin ushtarak të gjeneralit Lezli Gruvs (Groves) dhe fizikantit Robert J. Openhajmer (Oppenheimer). Prova e parë atomike do të bëhej në shkretëtirën e Nju Meksikos në sekret të plotë (Stone, 2012:136).

Sipas të dhënave të fundit të botuara, në Projektin Manhattan pati edhe mosmarrëveshje të forta. Fizikanti me orgjinë polake Jozef Rotblat, e braktisi programin kur u muar vesh se Gjermania kishte braktisur provat bërthamore në fund të vitit 1942 (Stone, 2012:144).

Ndërkohë që Gjermania u dorëzua më 7 maj 1945, kishte disa gjeneralë japonezë që bënин thirrje se do të vdisnin 100 milione japonezë me nder (Stone, 2012:144). Ky lajm sipas disa studjuesve do të shërbente edhe si alibia më e mirë për presidentin Herri Truman që të bombardonte me atom dy qytete të Japonisë. Leo Shilard (Szilard) anëtar i Komitetit për Implikime Shoqërore dhe Politike dhe i Fondacionit të Shkencës në Amerikë, kur mori vesh së SHBA-ja kishte në dorë armën më të fuqishme, iu drejtua zyrtarisht me një letër presidentit Truman ku i thoshte:

*"Bomba atomike në dorën tonë përfaqëson vetëm njërin hap në këtë drejtim dhe ju them se nuk ka kufizim të forcës shkatërrimtare që do të sjellë zhvillimi i saj në të ardhmen. Nëse një komb mban përgjegjësinë e përdorimit të kësaj force me qëllim shkatërrimin e kombeve të tjera, do të jetë fajtor që hapi derën e shkatërrimit në një shkallë të pakrahasueshme" (Smith, 1965:560).*

Më shumë se 155 shkencëtarë amerikanë iu drejtuani me peticione presidentit Truman lidhur me eliminimin e botës nga rreziku bërthamor. Por, kryetarët e projektit Mahnatan Gruvs dhe Openhajmer, u munduan me çdo mënyrë që ta pengonin lëvizjen e shkencëtarëve amerikanë që të ndikonte në vendimin e presidentit derisa përdorimi i bombës të bëhej i pandalshëm (Smith, 1965:561). Përpara përdorimit të bombës, Trumani dhe disa zyrtarë të tjerë menduan t'i çojnë një ultimatum të fundit japonezëve me

kërcënimin se '*po nuk u dorëzuat do të përdorim një armë të një fuqie të tillë saqë nuk e keni parë ndonjëherë*' (Dullas, 1966:255). Me këtë armë të jashtëzakonshme në dorë, Trumani mbërriti në Potsdam me një vetëbesim të jashtëzakonshëm. Në Gjermani presidentit i vjen lajmi se japonezët kërkonin të dorëzoheshin me kusht (Dullas, 1966:256). Kjo ishte e papranueshme. Në përgjigje të kërkesës japoneze, Trumani dërgoi telegramin:

*"Dorëzimi pa kushte është i vetmi opzion për paqen"* (Stone, 2012:162).

Arroganca amerikane ishte shumë e dukshme në konferencën e Potsdamit. Edhe vetë Çërçilli e kishte të vështirë ta shpjegonte se nga vinte kjo vetësiguri e Trumanit dhe Stalini u përpoq të afrohej me kryeministrin britanik. Stalini filloi të dyshonte se përsë Trumani nuk po e kërkonte më me ngulm hyrjen në luftë në paqësor të Bashkimit Sovjetik (Stone, 2012:165). Ndërkaq, kërkesat e japonezëve për paqe sa vinin e shtoheshin. Telegrami i datës 2 gusht 1945 nuk lë dyshim për këtë (Stone, 2012:166). Edhe presidenti Truman kërkonte paqen, por më parë ai donte ta përdorte bombën atomike. Dhe kështu u bë. Më datë 6 gusht 1945, në orën 8:15 të mëngjesit, Hiroshima pësoi një tragjedi të përmasave apokaliptike. Ajo thuaqse u zhduk nga faqja e dheut. Aq e tmerrshme ishte pamja e shpërthimit sa piloti ndihmës Robert Ljuis shkroi në ditarin e fluturimit:

*"O Zot! Çfarë bëmë"* (Stone, 2012:167)?

Sikur të mos mjaftonte kjo, tre ditë më vonë në Nagasaki u lëshua bomba e dytë e cila shkaktoi 140.000 viktima (Stone, 2012:174). Përdorimi i një arme të tillë shkaktoi tmerr në mbarë qyteterimin. Tashmë, ndërhyrja sovjetike në luftën kundër Japonisë nuk vlente më. Edhe pse në vitet që do të pasonin do të deklarohej me të madhe se ndërhyrja sovjetike i dha fund luftës me Japoninë dhe zyrtarisht Luftës II Botërore, faktet flasin për të kundërtën. Gjashtë nga shtatë gjeneralët amerikanë me pesë yje të cilët ishin MekArturi, Lihi, King, Nimic, Ajzenhaueri dhe Arnoldi, në vitet e mëpasme u përpoqën të bëjnë një larje

ndërgjegjeje. Por, fakte që të kenë kundërshtuar presidentin Truman nuk ka. Tashmë, Stalini në fillimin e Luftës së Ftohtë ishte paralajmëruar. Bashkimi Sovjetik do të fillonte një vetëpërmbytje të hidhur lidhur me Gjermaninë dhe Evropën. Stalini po shikonte me trishtim prapambetjen e tij teknologjike e cila e bënte nul supremacinë e tij në ushtarë. Një epokë e re kishte lindur në marrëdhëniet ndërkombëtare, ajo atomike. Vlera e njerëzimit kishte rënë përsëri shumë poshtë, kësaj radhe shumë pranë Ditës së Gjykimit.

### **3.6. Problemi gjerman**

Në këtë epokë të zyrtë atomike, çështja gjermane ishte në qendër të marrëdhënieve ndërkombëtare. Vendimet e Konferencës së Jaltës filluan të duken më qartësish në fund të vitit 1947. Gjermanët po fillonin të mësoheshin me idenë e të jetuarit të ndarë brenda vendit të tyre. Askush nuk mund të kalonte nga zonat perëndimore në zonat sovjetike. Gjermania ishte ndarë përsëri, ashtu siç kishte qenë me shekuj. Problemi gjerman është i hershëm në kontinentin evropian. Gjeopolitikisht, Gjermania është në qendër të Evropës. Aty kryqëzohen të gjitha rrugët tregtare të kontinentit. Duke qenë në një pozitë të tillë kaq strategjike, kombi gjerman kishte qenë gjithnjë shumë i fortë për Evropën. Në momentin që ky komb ishte dobësuar, kontinenti gjendej i kërcënuar. Atëherë, ç'duhej bërë me Gjermaninë? Duhej mbajtur e fortë, apo e copëtuar? Dilema e fuqive perëndimore ishte e madhe. Shteti që kërkonte më me ngulm që Gjermania të ishte e ndarë, ishte Franca. Anglia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin në mëdyshje. E ndarë dhe e copëtuar, Gjermania nuk përbënte kërcënim më për askënd, por e bashkuar dhe e rimëkëmbur ajo i vinte flakën botës. Një "Hitler" i dytë do të ishte një katastrofë ndërkombëtare.

Në epokën që kemi marrë në shqyrtim, çdo opzion lidhur me Gjermaninë shumëzohej me zero. Një Gjermani e bashkuar në dorë të Stalinit apo të perëndimit do të thoshte fitore e plotë e njërsë palë dhe humbje absolute e palës tjetër. Askush nga fituesit e luftës nuk e dëshironte një gjë të tillë. Edhe nën gërmadha, përsëri Gjermania ishte e rëndësishme. Për t'u marrë me të, fituesit zgjodhën rrugën më të sigurtë. Udhëheqësi sovjetik, Stalini, kishte ambicjet më kontradiktore lidhur me problemin gjerman. Nga dokumentet e botuara së fundmi, si dhe nga memuaret e zyrtarëve sovjetikë, shihet qartë se Stalini nuk e dëshironte një ndarje të Gjermanisë (Smyser, 1999:68). Plani tij ishte që të kishte në dorë një vend të bashkuar nën një qeveri në mos komuniste, të paktën miqësore (që ishte e njëjta gjë). Aleatët perëndimorë as që e çonin nëpërmend t'i jepnin dorë të lirë Stalinit në të gjithë Gjermaninë. Një Gjermani komuniste do të kishte qenë katastrofë për Evropën. Në pengimin e Stalinit për të vendosur hegemoninë e tij në Gjermani, pikësëpari ndikuan gabimet e këtij të fundit. Vendimi i tij i parë për të vendosur një pjesë të mirë të territorit gjerman nën administrimin polak ishte më i rëndi (Smyser, 1999:68). Nëse Prusia lindore dhe Silezia do të binin nën ndikimin sovjetik, atëherë do të ishte çështje kohe që e tërë Gjermania të ishte zonë e Stalinit. Kur udhëheqësi sovjetik t'ja jepte këto territore Polonisë, atëherë ai do të ishte në një pozitë shumë më të favorshme për të negociuar të ardhmen e Gjermanisë. Ai nuk kishte ndërmend që në Gjermani të vendosej një qeveri me vullnet të lirë. Atëherë, përse aleatët perëndimorë duhej me domosdo t'ja jepnin këtë triumf Stalinit? Stalini si pa kuptuar po paguante çmimin e humbjes së pjesës më të madhe të Gjermanisë për të siguruar Poloninë dhe rrjedhimisht BS-në nga agresionet e mundshme të ardhshme gjermane.

Ndoshta me vullnet të lirë, Stalini zgjodhi sigurinë në vend të ndikimit. Vendimi për të zgjeruar sa më shumë në perëndim Poloninë si në rastin e Ballkanit, reflektonte hendekun e thellë në strategjitet gjepolitike të liderit sovjetik. Për këtë arsy, duke u ndjerë më shumë se ç'duhet i sigurtë, ai i kërkoi Ulbrihit se kur do të ishte gati të bashkonte zonën e tij me perëndimorët dhe të merrte kontrollin e vendit. Me këtë vendim, Stalini mori përsipër një rrezik të madh. Ai ia kishte frikën një aleance të fortë mes Evropës perëndimore dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Nëse ndodhët kjo, Gjermania do të rimëkëmbej dhe për të nuk kishte më as më të voglën shpresë të matej me këtë aleancë ku do të bënte pjesë edhe Evropa e rimëkëmbur. Por, me diplomacinë e tyre të dobët, Stalini dhe Molotovi bënë të mundur pikërisht atë që ata i trembeshin më shumë (Smyser, 1999:68).

Ministri i jashtëm sovjetik Molotov, bëri më shumë gafa nga sa mund t'ia mbante xhepi. Ai hodhi në erë një sërë mundësish për të shtrirë ndikimin sovjetik në mbarë Gjermaninë. Gafa më e rëndë e tij ishte kur hodhi poshtë propozimin e Bërnshit dhe Marshallit për një marrëveshje të katër fuqive pushtuese për të ndaluar çdo lloj riarmatimi të Gjermanisë. Ai vetëm skërmiste dhëmbët ndaj çdo lloj propozimi amerikan dhe kjo ishte një mënyrë për t'i bërë qejfin Stalinit, por jo për të arritur një marrëveshje fitimprurëse. Stalini dhe Molotovi kërkonin garanci më shumë se çdo ministër i jashtëm perëndimor mund t'u ofronte. Kur Molotovi i tha Bërnshit se 'Gjermania duhet të kishte një qeveri antifashiste' dhe shtoi se nuk do të firmoste asnje marëveshje derisa kjo gjë të bëhej realitet. Me qeveri antifashiste, Molotovi kishte ndërmend një qeveri komuniste. Në momentin kur Bërnsi po largohej nga këshilli i ministrave të jashtëm për t'ja lënë vendin Marshallit, jo pa trishtim i tha Molotovit se ndjente keqardhje që s'kishin arritur asnje marrëveshje dhe se për këtë faji ishte i ministrit të jashtëm sovjetik (Smyser, 1999:69).

## **Kapitulli IV - Bota e ndarë mes dilemave 1947 - 1949**

### **4.1. Dilemat sovjetike dhe perëndimore**

Kur Molotivi u largua si ministër i jashtëm pas vdekjes së Stalinit, është shprehur se kishte qenë qëllimi i tij për të shtrirë sa më shumë që të ishte e mundur kufijtë sovjetikë drejt perëndimit. Nëse vërtet këtë gjë e kishte ndëmend ministri i jashtëm sovjetik, ishte krejtësisht e pamundur që ai ta arrinte. Edhe gjeneralët e Stalinit të stacionuar në Gjermani, ndihmuani në ndarjen e Gjermanisë. Ata hidhnin poshtë çdo propozim të Kleit për shkrirjen e një apo dy zonave. Sipas Sokolovskit, nëse do të lejohej kjo, pozita e Ulbrihit si shef i ardhshëm i vendit do të rrezikohej (Smyser, 1999:69). Ndoshta gabimi më i madh i Stalinit ishte kur zgjodhi Valter Ulbrihtin si njeriun e tij për të drejtuar Gjermaninë. Ulbrihti nuk mund të arrinte as gjysmën e atyre që kërkonte Stalini. Ai mund të kontrollonte vetëm zonën sovjetike, por Stalini mund ta bënte këtë edhe pa të pasi kishte atje Zhukovin dhe Sokolovskin. Stalini kishte nevojë për një njeri që të shtrinte ndikimin e tij jashtë zonës sovjetike të pushtimit. Ulbrihti as që i afrohej synimit të Stalinit madje me veprimet e tij i shtoi armiqjtë e Bashkimit Sovjetik. Por, ajo që nuk dinte Stalini ishte se Ulbrihti e kërkonte me ngulm ndarjen e Gjermanisë. Ai veproi në mënyrë të atillë saqë Stalini nuk e pengonte dot (Starobin, 1969:684). Filozofia e Ulbrihitit ishte: "*Më mirë një zog në dorë sesa dy zog në shkurre*" (Starobin, 1969:684). Politika e Stalinit në Gjermani ndikoi në të ardhmen e Evropës për 45 vjet. Në fund të vitit 1947, dy vjet e gjysëm pas fitores së madhe mbi nazizmin, Stalini nuk fitoi më shumë. Njëloj si cari Aleksandër I më 1814, Stalini kishte këmbyer një fitore të madhe ushtarake me një diplomaci inkompétente. Molotovi ka pjesën e tij të fajt, por ishte Stalini ai që vendoste.

Nga të gjithë liderët perëndimorë, Sharl dë Goli ishte i vetmi që kërkonte me konsistencë që Gjermania të ndahej. Ai dhe Bidoja nuk mund ta ndanin Ruhrin dhe Saarën nga trungu gjerman siç dëshironin, por edhe kështu siç ishte, Gjermania i shkonte për shtat Francës. Me një diplomaci të shkathët, dë Goli bëri të mundur që për çdo vendim për Gjermaninë dhe të Gjermanisë, Franca të të kishte veto absolute. Edhe pse nuk ishte dakord me politikat anglo-amerikane në Gjermani, përsëri atij iu desh të bindej se në këtë mënyrë Gjermania do të mbahej e dobësuar. Më i aftë se dë Goli u tregua Zhorzh Bido. Ai e kishte kuptuar ndryshe nga shefi i tij, se duke bashkuar zonën franceze të pushtimit me zonën anglo-amerikane, Gjermania do të mbetej e ndarë. Në këtë mënyrë Bidoja kishte ndryshuar qëndrimin francez pa ndryshuar strategjinë e Francës. Qysh më 1946-ën, ai e kishte kuptuar se Çërçilli nuk mund ta realizonte marrëveshjen e madhe me Stalinin për Evropën duke përjashtuar Francën. Si të vetmen mënyrë për të ndaluar ndikimin sovjetik në perëndim, do të ishte formalizimi i ndarjes së Gjermanisë ndërmjet perëndimit dhe lindjes dhe mbajtjes me çdo kusht të pranisë amerikane në këtë zonë të Evropës (Zubkov, 1996:37).

Nga ana e tyre, britanikët kishin hartuar një plan për t'i mbajtur me çdo kusht amerikanët në kontinent shumë kohë përpara se amerikanët ta bënin këtë gjë (Zubkov, 1996:37). Njëloj si dë Goli i cili kërkonte një Gjermani të ndarë pasi kishte frikë gjermanët, Bevini donte një Gjermani të ndarë pasi kishte frikë sovjetikët. Sistemi politik që do të ndërtohej në Evropën perëndimore do të ishte rrëth Francës dhe Anglisë me praninë amerikane në një Gjermani të ndarë (Zubkov, 1996:38). Presidenti amerikan Herri Truman nuk kishte një politikë për Gjermaninë kur ai mori pushtetin. Por, Trumani kishte aftësinë të dëgjonte këshilltarët e tij. Njëloj si Bevini ai iu bind realpolitik-ës për të pranuar dhe kërkuar një Gjermani të ndarë që ishte zgjidhja më e sigurtë për të përballuar Stalinin. Përplasjet e Bërsnit me Molotovin

në vitet 1946 dhe 1947, e bindën përfundimisht Trumanin se me Stalinin nuk mund të arrihej një marrëveshje. Në rrethana të tilla, tërheqja e trupave amerikane nga Evropa do të ishte e pamundur (Zubkov, 1996:40).

Sapo Trumani vendosi të lidhej kokë e këmbë me Londrën dhe të mbante trupat amerikane në Evropë, ai pati më në fund një ide të qartë sesi do të ishte politika për Gjermaninë. Atij iu desh ta braktiste planin Morgento dhe të ndërtonte zonën perëndimore të Gjermanisë. Molotovi vlerësoi kësaj here me të drejtë, se Trumani e kishte braktisur politikën e Ruzveltit. Trumani nga ana tij ia ktheu se lufta kishte përfunduar dhe se Stalini nuk mund të priste që qëndrimet në kohë lufte të ishin edhe në kohë paqeje. Të katër fuqitë pushtuese kishin hartuar pas lufte politika mbi vlerësimë të gabuara. Ata kishin vlerësuar se interesat e tyre do të mbeteshin të njëjta edhe pasi të ishte mposhtur Hitleri. Koha provoi të kundërtën. Ata shpresonin se gjermanët do të mbeteshin pasivë gjatë kohës që ata mbanin të pushtuar vendin e tyre. Përkundrazi, gjermanët filluan të dalin hapur për t'u lidhur me perëndimin. Duke parë vendosmërinë gjermane, Stalini u detyrua t'u kërkojë fuqive perëndimore garanci se një Gjermani e bashkuar nuk do të përbënte më problem për Bashkimin Sovjetik. Edhe pse e kishin zhdukur *de facto* nga harta, Gjermania nuk do të mund të zhdukej *de jure*. Lufta e Ftohtë filloi për shkak të problemit gjerman dhe avancimit sovjetik në vitet 1944-1945 dhe në bisedimet e pafrytshme lindje-perëndim më 1946 (Smyser, 1999:71).

Ndarja e Gjermanisë nuk ekzistonte si pjesë e ndonjë plani të mëparshëm të aleatëve dhe as nuk ishte hartuar një i tillë as në Moskë, Uashington, Londër apo Paris. Ky plan lindi si pasojë e mosmarrëveshjeve mes fituesve të Luftës II Botërore. Përveç dë Golit i cili ishte konsistent në vendimin e tij për të ndarë Gjermaninë, të tre aleatët e tjerë mbi të gjithë

Stalini as që e kishin ndërmend një plan të tillë. Bevini e zgjodhi si të tillë për të mbrojtur Evropën perëndimore dhe për të mbajtur të angazhuar në kontinent amerikanët. Trumani e pranoi për të parandaluar dominimin sovjetik në Gjermani dhe në mbarë Evropën. Stalini e zgjodhi sepse Molotovi nuk ishte i aftë të negacione një marrëvëshje e cila do t'i jepte atij ndikim real në Gjermani dhe ndoshta në të gjithë Evropën. Të katërta fuqitë fituese nuk ranë dakord sesi duhej mbajtur e bashkuar Gjermania, por as për mënyrën sesi duhej ndarë ajo. Ata morën vendime të vecanta për ndarjen dhe bënë atë që bënë. E vërteta e madhe është se askush nuk i pyeti gjermanët lidhur me fatin e tyre. Ushtritë që kishin hyrë në Gjermani për të fituar, mbetën si forca pushtuese. Ata mbetën aty edhe për të kundërshtuar njëra tjetrën, kësaj radhe jo për faj të Gjermanisë.

#### **4.2. Bllokada e Berlinit**

Mosmarrëveshjet e perëndimit me Moskën e nxitën ministrin e jashtëm britanik Ernest Bevin të ftonte zyrtarët perëndimorë (ministrat e jashtëm) në shkurt të vitit 1948 për një takim në Londër (Deighton, 1989:32). Për të qenë i sigurtë se shtetet e tjera evropiane do ta pranonin ripërtëritjen ekonomike të Gjermanisë, Bevini ftoi ambasadorët e Belgjikës, Luksemburgut, Holandës, Francës dhe Shteteve të Bashkuara. Ai i nxiti që të punonin për të themeluar një shtet gjermano perëndimor të inkorporuar brenda sistemit euro-amerikan të aleancës. Meqenëse trauma e pushtimeve gjermane ishte ende e fortë tek katër vendet evropiane, Bevini e ndau konferencën në dy sesione të mbajtura në datat 23 shkurt - 6 mars dhe 20 prill - 7 qershor 1948 (Deighton, 1989:33). Ambasadorët perëndimorë kishin një qëllim të përbashkët, por shtronin shumë pyetje. Në fund, të gjithë ishin dakord se ripërtëritja ekonomike gjermane do t'i shërbente ripërtëritjes ekonomike të Evropës.

Ministri francez Zhorzh Bido, tha se në parim ishte dakord me propozimin britanik, por Franca sipas tij kishte ende nevojë për mbrojtje kundër Gjermanisë (Deighton, 1989:35). Fjala e ministrit francez u mbështet edhe nga zyrtarët e vendeve të Beneluksit. Përveç të tjera, Bidoja shtoi se nuk do të lejonte që zona e Ruhrit të përfshihej në shtetin e ri gjerman. Madje Gjermania nuk duhej lejuar që të përfshihej në planin Marshall (ndihma ekonomike amerikane për vendet e Evropës perëndimore) si dhe Londra, Parisi dhe Uashingtoni duhej të kishin nën kontroll situatën ekonomike në Saarland. Londra dhe Uashingtoni i pranuan propozimet franceze. Pas shqyrtimeve më të kujdeshme, ata ranë dakord që plani Marshall të përfshinte zonat e perëndimore të Gjermanisë (Deighton, 1989:37).

Diskutimi më i flaktë në këtë takim ishte sesi do të ndërtohej qeveria e ardhshme gjermane (Smyser, 1999:73). Francezët vijonin të këmbëngulnin tek e drejta e Francës për të asociuar zonat që ishin nën pushtimin francez me ekonominë e vendit të tyre. Me kalimin e orëve të gjata në diskutime, ata panë se nuk do t'ja dilnin dot. Pas diskutimeve të shumta, vendet perëndimore ranë dakord të pranonin krijimin e një qeverie perëndimore gjermane me institucione të pavarura (Smyser, 1999:74). Kur konferenca e Londrës mbaroi sesionin e parë, Stalini duke qenë se nuk merrte pjesë, vendosi të provokonte perëndimin në pjesën e tij më vulnerabël në Gjermani, në Berlin. Ai urdhëroi marshallin Sokolovski dhe këshilltarin e tij politik Vladimir Semjonov (Semyonov) që të ashpësonin kontrollet në rrugët e Berlinit. Stalini kishte kohë që e kishte ndërmend një veprim të tillë dhe takimi i Londrës ia qartësoi akoma më shumë veprimin. Nga ana e tij Molotovi kërkoi që të mblidheshin ministrat e jashtëm të vendeve të Evropës Lindore për të kërkuar një takim të

Këshillit të Ministrave të Jashtëm të vendeve fituese të Luftës II Botërore. Stalini ishte dakord (Narinsky, 1994:6).

Udhëheqësi sovjetik, urdhëroi Sokolovskin të denonconte takimin e Londrës për Gjermaninë. Sokolovski e denoncoi duke deklaruar se fuqitë perëndimore kishin marrë vendime të njëanshme pa u konsultuar me Bashkimin Sovjetik. Situata u acarua akoma më shumë kur Valter Ulbrihti deklaroi në shtyp se "nuk ishte e largët dita kur forcat perëndimore do të largoheshin nga Berlini perëndimor me forcë" (Narinsky, 1994:7).

Më 31 mars 1948, Sokolovski bllokoi të gjithë trenat ushtarake që udhëtonin nga zonat perëndimore në Berlin derisa të lejoheshin inspektorët sovjetikë të kontrollonin vagonat një për një. Në ditë më vonë, më 1 prill 1948 ai urdhëroi që asnjë tren të mos lëvizte nga Berlini pa urdhrin eksplisit të Komandaturës Sovjetike (Narinsky, 1994:7).

Gjenerali amerikan Lusjus Klei e pa veten në një pozicion paradoksal. Ai për vete nuk i kishte miratuar vendimet e takimit të Londrës sepse ai preferonte një Gjermani të bashkuar dhe jo të ndarë. Por, ai nuk do të pranonte asnjë kufizim të autoritetit amerikan në Berlin apo kudo tjetër në Gjermani. Ai hodhi poshtë kërkësën sovjetike për inspektim të trenave. Klei pranoi t'i jepte sovjetikëve listën e plotë të pasagjerëve, por Sokolovski nuk pranoi. Asnjë tren aleat nuk do të lëvizte më në Berlin (Smyser, 1999:74).

Gjenerali Klei po përballej jo vetëm me presionin sovjetik, por edhe me heshtjen e superiorëve të tij që në fjalë të tjera përkthehet hezitim. Sekretari i Shtetit Xhorxh Marshall nuk dëshironte që të kishte krizë në Berlin. Ai kishte rënë dakord me propozimet e Bevinit për të ndarë Gjermaninë, por nuk ishte gati të pranonte pasojet e këtij veprimi. Edhe ushtria amerikane ishte hezituese. Ministri i Luftës Keneth Rojall (Royall) vuri në pikëpyetje vendimin e Kleit për të hedhur poshtë kërkësën e Sokolovskit. Ai kërkoi kompromis.

Madje ai propozi që të evakuoheshin të gjithë amerikanët nga Berlini. Klei e kundërshtoi me forcë dhe i tha se nuk do të lejonte as edhe një familje amerikane të largohej (Smyser, 1999:74). Madje gjenerali trim amerikan shtoi se po të largoheshin amerikanët të gjithë berlinezët do të ishin me moral shumë poshtë dhe Berlini do të binte i téri në duart e sovjetikëve. Me të rënë Berlini, do të ishte çështje kohe që e gjithë Gjermania të bëhej sovjetike (Smyser, 1999:75).

Klei vendosi të sfidonte qëllimet sovjetike duke dërguar një tren për në zonën sovjetike të Berlinit. Sovjetikët e ndaluan trenin. Klei u bind se me sovjetikët kishte punë për të bërë. Një garnizon amerikan kishte mbetur i bllokuar pasi për ta furnizuar duhej kaluar nëpër zonën sovjetike në Berlin. Klei vendosi t'i furnizonte ushtarët e tij nga ajri. Sokolovski nuk do të ishte aq i marrë sa të qëllonte avionët amerikanë. "Gërricjet" amerikano - sovjetike apo kishin filluar. Stalini kishte urdhëruar një mini bllokadë dhe e konsideronte si sukses për të shtuar presionin e tij. Ai besonte se kishte prekur pikën më të dobët të perëndimit. Valter Ulbrihti e nxiti Stalinin të vijonte më fort me këtë taktkë për të larguar përgjithmonë perëndimorët nga Berlini. Më 26 mars 1948, Gjermania do të ishte më pranë Bashkimit Sovjetik nëse perëndimorët largohejin nga Berlini. Stalini ra dakord dhe Sokolovski u udhëzua që të fillonte punën për ta përfshirë të gjithë Berlinin në zonën sovjetike (Zubkov, 1996:52). Aleatët perëndimorë u vunë në alarm pasi sovjetikët mund të bllokoin Berlinit. Informacionet për një mundësi të tillë ishin mbledhur qysh në janar 1948 kur dy oficerë të dehur sovjetikë në piye e sipër kishin deklaruar se nuk ishte e largët dita kur Berlini do të bllokohej (Zubkov, 1996:52). Klei dhe vartësit e tij nuk kishin pse të mos i besonin pasi në shkurt 1948 kishte ndodhur grushti i shtetit në Çekoslovaki duke e kthyer këtë vend në satelit të Bashkimit Sovjetik (Collier, 1978:7).

Gjatë të gjithë pranverës të vitit 1948, tensionet ndërmjet perëndimorëve dhe sovjetikëve erdhën duke u rritur. Sovjetikët shkuan deri aty sa filluan të konfiskonin mallrat nga vagonat e trenave. Situata u bë e padurueshme. Më 7 qershor 1948, konferenca e gjashtë vendeve të mbledhura në Londër hartoi planin përkatës për Gjermaninë me pikat e mëposhtme:

1. *Zonat perëndimore të pushtimit në Gjermani do të përfshiheshin plotësisht në planin Marshall.*
2. *Një autoritet ndërkombëtar kontrolli do të bënte të mundur që edhe zona e Ruhrit të përfshihej në planin Marshall.*
3. *Veprime të menjëherëshme do të ndërmerrreshin për të koordinuar politikat ekonomike në të tri zonat perëndimore.*
4. *Qeveria gjermane do të kishte formë federale qeverisjeje në të tre zonat perëndimore.*
5. *Franca, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do t'i tërhiqnin plotësisht trupat e tyre nga Evropa derisa paqja të mos kërcenohej më (Smyser, 1999:76).*

#### **4.3. Reformë financiare në zonën perëndimore gjermane**

Deklarata e Londrës e tronditi Stalinin. Kjo do të thoshte se aleatët perëndimorë do të mbeteshin në Gjermani. Më 10 qershor 1948, sovjetikët u përpoqën të shkëpusin lokomotivat amerikane nga vagonët e trenave. Më 11 qershor 1948 ata e e ndaluan trafikun mes zonave perëndimore dhe Berlinit për dy ditë. Më 12 qershor ata ndaluan qarkullimin tek ura e madhe për arsy "rregullimi" të objektit. Me këtë mënyrë ata donin të ndanin ekonominë e Berlinit nga ajo e zonave perëndimore (Clay, 1950:361). Stalini dhe perëndimi duket se po përgatiteshin për një përplasje të fortë. Lideri sovjetik sapo kishte injoruar të drejtat e perëndimit në Berlin. Në Londër, perëndimorët kishin injoruar të drejtat e Stalinit në zonat e tyre. Tani ai do të sfidonte të drejtat e tyre në pjesën e tij. Të gjithë kishin shkelur të drejtat e njëri tjetrit.

Më 18 qershor 1948, autoritetet perëndimore të pushtimit bënë një lëvizje të mençur për të rigjallëruar ekonominë gjermane. Ata shpallën reformën monetare, por nuk e shtrinë atë në

Berlin. Reforma bazohej tek monedha e re gjermane Dojçmark (Deutsche Mark) dhe nuk ishte e kufizuar ndaj Rajhmarkës së vjetër. Kursi i këmbimit do të ishte një me dhjetë. Fuqitë perëndimore mendonin se monedha e re do t'i jepte fund inflacionit dhe tregut të zi (Clay, 1950:362). Në të njëtjën kohë, autoritetet civile në zonat perëndimore të Gjermanisë, nën drejtimin e Ludvig Erhardit hodhën tej shumë restriksione ekonomike të vendosura qysh nga koha e nazizmit. Edhe pse fillimi i Kleit nuk i përkrahu reformat e Erhardit, më në fund i dha të drejtë. Zonat perëndimore do të kishin ekonominë e tyre të pavarur.

Reforma monetare i dha Sokolovskit shansin që priste, bllokadën. Më 23 qershor 1948, Sokolovski dhe autoritetet sovjetike të pushtimit bënë reformën e tyre monetare duke e aplikuar jo vetëm në zonën e tyre, por në të gjithë Berlinin. Autoritetet perëndimore nuk e ndaluan me kushtin që ata të kishin zërin e tyre të kontrollit. Në mënyrë alternative ata futën D-markën nën kontrollin e katershës. Perëndimorët lejuan që në Berlin të ishin në garë dy monedha. Më 24 qershor 1948, sovjetikët ndërprenë rrugët e komunikimit ndërmjet Berlinit perëndimor dhe zonave perëndimore (Smyser, 1999:77). Ata ia vunë fajin vështirësive teknike. Nga ana e tyre perëndimorët ndërprenë energjinë elektrike nga perëndimi me të cilën furnizohej lindja. Gjithashtu, nga deti bllokada perëndimore u bë efektive (Smyser, 1999:78).

Duke parë vendosmërinë perëndimore, sovjetikët nën drejtimin e Molotovit thirrën një konferecë të jashtëzakonshme në Varshavë të vendeve të Evropës lindore si kundërpeshë ndaj takimit të Londrës. Kërkesat që u parashtruan ishin:

- 1 *Vijimi i bashkëpunimit të katër fuqive për demilitarizimin e Gjermanisë.*
- 2 *Kontroll i të katër fuqive mbi krahanët dhe industrinë e rëndë të Ruhrit.*
- 3 *Një marrëveshje mes katër fuqive për një qeveri të përkohshme demokratike dhe paqësore për të gjithë Gjermaninë, të përbërë nga*

*përfaqësues të organizatave demokratike si dhe nga partitë politike gjermane.*

- 4 *Një traktat paqeje me Gjermaninë në përputhje me vendimet e konferencës së Potsdamit ku të gjitha forcat pushtuese duhet të tërhiqeshin nga Gjermania pas një viti të nënshkrimit të traktatit.*
- 5 *Përbushja e reparacioneve* (Smyser, 1999:78).

Deklarata e Varshavës shprehë vullnetin e Stalinit për të këruar sa më shumë. Toni kategorik i kërkeseve jepte përshtypjen se Stalini dhe Ulbrihti gjendeshin në pozita të forta.

Ata mund ta shtrydhnnin Berlinin perëndimor duke i bërë presion opinionit publik në Gjermani se ishin fuqitë perëndimore ato që dëshironin ndarjen e vendit.

#### **4.4. Ura ajrore**

Berlini perëndimor gjendej përsëri në një udhëkryq të rrezikshëm. Për të qetësuar banorët, gjenerali Klei lëshoi direktivën se asnjë ushtar amerikan nuk do të lëvizte nga qyteti. Apeli i tij për të marrë urdhra nga superiorët gjeti vetëm heshtje. Amerikanët vërtet ndodheshin në qytet, por ata ishin të izoluar. Kudo gjendeshin trupa sovjetike të mirë armatosura të gatshëm për të hyrë në veprim ndaj ish aleatëve të tyre. Nuk ishin të paktë edhe zyrtarët perëndimorë që thonin se qyteti ishte i humbur. Duke parë pavendosmërinë e aleatëve, sovjetikët besonin se brenda një kohe të shkurtër të gjitha forcat perëndimore do të largoheshin nga Berlini (Smyser, 1999:78).

Autoritetet në Berlin dhe vetë qytetarët e Berlinit, në këto momente delikate zgjodhën të ngrinin zërin. Kryetari i bashkisë në detyrë Ernst Rojter (Reuter) thirri një miting të madh në stadiumin Olimpik ku përpala një turme prej 80 mijë vetash shprehu vullnetin e qytetarëve për të qëndruar në anën perëndimore dhe ftoi aleatët të mos largoheshin nga qyteti (Smyser, 1999:78). Rojteri as që donte t'ja dinte për të bërë ndonjë kompromis me sovjetikët. Kur Klei e thirri në zyrë dhe i tha të ishte më i matur ai u shpreh vrullshëm se

berlinezët pranonin të jetonin pa bukë, ujë dhe rrymë elektrike sesa të humbnin edhe një herë tjetër lirinë. Kur Klei e pyeti se a do ta mbështesnin berlinezët një përpjekje nga ajri për të furnizuar qytetin, kryetari i tha "po" pa asnë hezitim (Loth, 1994:31).

Rojteri pa te Klei një aleat dhe dëgjues të vëmendshëm. Gjenerali amerikan kishte deklaruar se amerikanët nuk do ta linin pa ndërgjegje Berlinin. Edhe pse më parë kishte shpresuar që të tërhiqte trupat nga Gjermania në vitin 1947, pas konferencës së Londrës ai e kishte kuptuar se ky vend do të ndahej. Në këtë rast, ai kurrsesi nuk do të donte t'ja linte qytetin dhe vendin Ulbrihitit. Ai vendosi të furnizonte qytetin me ndihma nga ajri. Ai u koordinua me guvernatorin ushtarak britanik gjeneralin Robertson, i cili nga ana e tij e mbështeti plotësisht urën ajrore dhe urdhëroi forcat ajrore britanike t'u bashkoheshin atyre amerikane.

Nga ana e tij, Klei thirri gjeneralin Kërtis LiMej (LeMay), komandantin e forcave ajrore amerikane në Evropë nëse mund të dërgonte me avionë ushqime, qymyr, ilaçe dhe furnizime të tjera. Përgjigja e gjeneralit LiMej ishte e thjeshtë: "*Do çojmë gjithçka*" (Smyser, 1999:79). Nga ana e tij, Klei do të kishte preferuar që furnizimet për popullsinë t'i bënte me rrugë hekurudhore, por sovjetikët e kishin bërë të pamundur këtë. Ai u angazhua personalisht në inspektimin e mallrave dhe në ngarkimin e avionëve për të çuar furnizimet. Për një periudhë kohe, Klei e pa veten mes dy "zjarresh". Nga njëra anë zyrtarët amerikane kishin frikë se mos Stalini jepte urdhër që të goditeshin avionët amerikanë dhe nga ana tjetër, ekzistonte frika se mos sovjetikët ndërhynin në qytet. Klei vendosi t'i sfidonte të dyja palët (Naimark, 1995:56). Në SHBA as Departamenti i Shtetit as Pentagoni, s'e mbështetën urën ajrore. Qysh ditën e parë të bllokadës, ata e urdhëruan Klein të kishte kujdes me futjen e monedhës së re dhe e nxitën të fillonte evakuimin e nëpunësve amerikanë gjë të cilën

Klei refuzoi ta bënte. Ajo që e ndihmoi Klein ishte se ishte i plotfuqishëm në Gjermani dhe askush në SHBA nuk i jepte dot urdhra përveç presidentit. Megjithë përpjekjet e Kleit dhe Robertsonit, ura ajrore filloi të funksionojë shumë ngadalë. Në ditën e parë u dërguan vetëm 80 ton ushqime nga 2500 ton minimum i kërkuar (Naimark, 1995:57). Ditën e dytë forcat ajrore britanike lëshuan 44 ton furnizime.

Qeveria e parë që mbështeti urën ajrore për Berlinin ishte ajo britanike. Bevini deklaroi hapur se qeveria mbretërore do të qëndronte në Berlin dhe s'kishte bllokadë që ta largonte prej andej (Smyser, 1999:80). Për t'i treguar Stalinit se Perëndimi do t'i mbronte interesat e veta në Berlin, Bevini kërkoi dy skuadronë bombardues B-29 të njëjtë me ata që kishin hedhur bombat atomike në Japoni të dërgoheshin në Britani dhe prej andej të mbronin dërgesat ajrore. Ndërsa Klei, Robertsoni dhe Rojteri tregonin vendosmëri, në Uashington dyshimet vijonin. Gjatë një takimi që u mbajt në Pentagon më 27 qershor 1948, ndër të tjera u fol edhe për tërheqjen e trupave amerikane (Naimark, 1995:80). Askush nga zyrtarët e Pentagonit nuk besonte se ura ajrore do të përmbushte kërkuesat e qytetarëve në Berlin për furnizime. Megjithatë, SHBA-të pranuan të dërgonin "fortesat" ajrore për t'i treguar Stalinit se interesat amerikane do të mbroheshin në Berlin. Me këtë veprim, Evropa për herë të parë u gjend nën mbrojtjen direkte ajrore të SHBA-ve.

Presidenti Truman as që e çonte nëpërmend një tërheqje nga Berlini. Rojalli protestoi, por presidenti i tha se SHBA-të gjendeshin në Berlin në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare (Davison, 1958:110). Ministri i jashtëm britanik Bevin u gëzua tej mase kur mori vesh për vendimin e Trumanit. Në fjalën e tij në Dhomën e Komuneve ai tha:

*"Ne jemi të ndërgjegjshëm se si rezultat i këtyre vendimeve, një situatë e rëndë mund të ndodhë. Në ndodhë, ne duhet t'i kërkojnë Dhomës ta përballojë atë. Qeveria e Madhërisë së Tij dhe aleatët tanë perëndimorë nuk shohin alternativë tjetër përveç kapitullimit dhe askush prej nesh nuk e pranon atë" (Davison, 1958:116).*

Ulbrihti dhe Stalini e rritën presionin e tyre. Përfaqësuesit sovjetikë në Berlin, më 1 korrik 1948, njoftuan se Bashkimi Sovjetik nuk do të merrte pjesë më në aktivitetet e përbashkëta pasi qeveria e katër fuqive në Gjermani nuk ekzistonte më. Sokolovski u tërroq nga komanda ushtarake e përbashkët dhe flamuri sovjetik u hoq nga Komandatura e katër fuqive pushtuese (Davison, 1958:116). Ulbrihti filloi hartimin e një plani që do të përfshinte të gjitha territoret sovjetike përfshirë Berlinin në një sistem të përbashkët ekonomik. Në vijim të vendimeve të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik të datës 27 qershor 1948, ai tha se përfaqësonte luftën e klasave kundër atyre që donin të sabotonin zhvillimin e Gjermanisë (Davison, 1958:120).

Megjithë vendimin e Trumanit, Departamenti i Shtetit dhe Pentagoni vijonin të kishin dyshimet e tyre për Berlinin. Disa prej këshilltarëve të Xhorxh Marshallit ku më të spikaturit ishin Xhorxh Kinan dhe Carls Bohlen vijonin të këmbëngulnin në braktisjen e qytetit (Smyser, 1999:81). Kinani propozonte që të negociohej me Moskën tërheqja e të gjitha trupave të huaja dhe të arrihej marrëveshja për neutralizimin e Gjermanisë. Marshalli nga ana tij u përpoq të largonte Klein nga Berlini, por ish sekretari i shtetit Bërns e mbrojti gjeneralin pa i treguar për dëshirën e Marshallit. Deklaratat e Marshallit për Berlinin nuk e tutën Trumanin dhe Bevinin nga qëndrimet e tyre për ish kryeqytetin gjerman (Kimball Smith, 1965:519). Franca nga ana e saj vijonte të hezitonte pasi kishte dyshime nëse aleatët perëndimore do të vijonin të qëndronin në Berlin (Kimball Smith, 1965:520).

Në gusht të vitit 1948, Marshalli vendosi të përpinqej për të gjetur një zgjidhje diplomatike për krizën e Berlinit. Të tre fuqitë perëndimore i këshilluan ambasadorët e tyre në Moskë që të takonin Stalinin për të kuptuar lëvizjet e tij. Ata njoftuan pas takimit me të se lideri sovjetik ishte i gatshëm t'i jepte fund krizës. Ai këmbëngulte në kërkesën e tij për një

qeveri për të gjithë gjermanët dhe të nënshkruhej traktati i paqes. Mesa dukej ai dëshironte që ta përdorte krizën e Berlinit për të patur kushte më të mira politike dhe ekonomike për Bashkimin Sovjetik (Narnisky, 1994:2). Udhëheqësi sovjetik u përpoq t'u shpjegonte ambasadorëve perëndimorë lidhur me "vështirësitë teknike" që pengonin arritjen e vendimeve të mëdha për problemin gjerman. Stalini këmbëngulte se Bashkimi Sovjetik kishte qenë i detyruar të përdorte një njësi të vetën monetare në zonën sovjetike të Berlinit dhe kjo për faj të aleatëve perëndimorë (Narnisky, 1994:2). Me një zë karakteristik të qetë, Stalini në fund të takimit u tha ambasadorëve se ishte gati të pranonte një marrëveshje për një monedhë të përbashkët gjermane si në zonën sovjetike ashtu dhe në atë perëndimore (Smyser, 1999:82).

Duke marrë për bazë fjalët e Stalinit, zyrtarët perëndimorë u përpoqën të arrinin një marrëveshje me sovjetikët lidhur me monedhën e përbashkët. Edhe pse thuajse gjatë të gjithë muajit shtator u takuan me Sokolovskin, gjenerali sovjetik asnjeherë nuk e përsëriti premtimin e Stalinit (Smyser, 1999:82). Edhe pse Stalini kishte dhënë fjalën, në këtë kohë atij dhe Ulbrihit iu duk vetja aq të fortë sa të vendosnin vullnetin e tyre në Berlin. Ndihmat perëndimore vijonin me intensitet deri në 3100 ton ushqime në javë, por Stalini dhe i besuari i tij në Gjermani besonin se ardhja e dimrit dhe mjegulla do t'i pengonin aletat të dërgonin ndihma. Kësisoj, qyteti do të dorëzohej. Stalini e mori për dobësi të perëndimit bisedën me ambasadorët në Moskë. Ai mendoi se tashmë perëndimi do të dorëzohej dhe çështja gjermane do të zgjidhej në favor të tij. Në më të mirin vakt, ai mund të arrinte bashkimin e Gjermanisë sipas kushteve të tij. Në më të keqin, ai mund të merrte vetëm të gjithë Berlinin (Narinsky, 1994:24).

Më 30 nëntor 1948, Ulbrihti dhe sovjetikët e ndanë *de facto* qytetin e Berlinit duke emëruar një kryetar bashkie në zonën lindore. Më 5 dhjetor u bënë zgjedhjet e para lokale. Berlini lindor do të kishte një administrator dhe kryetar bashkie të veçantë deri në vitin 1990 (Smyser, 1999:82). Edhe perëndimi nuk ndenji duarkryq. Ernst Rojter u bë kryetari i parë i bashkisë në Berlinin perëndimor. Krenar për origjinën e tij berlineze, ai besonte më shumë se pushtuesit perëndimorë se qyteti nuk kishte pse të turpërohej për të kaluarën e tij. Ai ishte njësoj si të gjithë bashkëqytetarët e tij, i pavarur (Smyser, 1999:83). Njëlloj si gjenerali amerikan Klei, ai i besonte logistikës. Ai e njihte sistemin e qarkullimit në Berlin në mënyrë të përkryer pasi dikur kishte punuar dhe ndihmuar në ndërtimin e tij. Pavarësia e tij ishte e njojur për perëndimorët pasi më datë 9 shtator 1948, kur ata ende po negacionin me Stalinin për të ardhmen e qytetit, në një miting të madh ku morën pjesë berlinezë nga të dyja anët e qytetit ai u shpreh:

*"Ne nuk jemi për t'u shkëmbyer, ne nuk jemi për t'u negociuar dhe ne nuk jemi për t'u shitur. Kushdo që mund ta dorëzojë këtë qytet do të dorëzojë edhe qytetarët e Berlinit, edhe veten" (Smyser, 1999:83).*

Duke parë guximin e berlinezëve për t'u mos u nënshtruar presioneve të Ulbrihitit dhe Stalinit, ndihmat ajrore u intensifikuan. Trumani sfidoi dyshimet e Departamentit të Shtetit dhe Pentagonit dhe urdhëroi rritjen e tonazhit të ndihmave. Çdo ditë numri i avionëve që fluturonin mbi Berlin ishte në rritje. Në një takim në Uashington me shefat e shtabit të përgjithshëm dhe në prani të gjeneralit Klei, duke shpërfilluar kërkesat për vetëpërmembajtje, Trumani iu drejtua Kleit:

*"Gjeneral, ju do t'i keni avionët tuaj" (Smyser, 1999:84).*

Çdo javë avionë të rinj amerikanë vinin në Gjermani. Ndihmat u shtuan. Flota ajrore britanike gjithashtu dërgoi forca të reja. Klei dhe Rojteri e kuptuan se tashmë forcat në tavolinë kishin ndryshuar. Perëndimi do ta fitonte betejën e parë me Bashkimin Sovjetik

për Gjermaninë në Luftën e Ftohtë. Sokolovski u përpq të bënte ç'mundte pér tē ndaluar urën ajore. Ai i lajmëroi forcat perëndimore se avionët sovjetikë do tē bënин manovra në qiellin e Berlinit dhe mund tē kishte ndonjë aksident ajror. Avionët sovjetikë i shkonin shumë pranë avionëve me mallra, por nuk u angazhuan kundër tyre dhe as aksidente nuk pati (Smyser, 1999:84). Në dhjetor 1948, tonazhi i ndihmave arrii në 4500 ton në ditë. Zona perëndimore e Berlinit po inkadrohej me shpejtësi në strukturat perëndimore megjithë bllokadën. Numri i refugjatëve nga Berlini lindor po rritej me shpejtësi. Efikasiteti i ndihmave ishte mbresëlënës. Kulmi i suksesit ishin Pashkët e vitit 1949 kur në datën 17 prill (e diel) tonazhi arrii në 12941ton (Smyser, 1999:85). Më shumë sesa dërgimi i ushqimeve dhe qomyrit, ura ajrore perëndimore ishte një mesazh se Berlini nuk do tē braktisej. Zona sovjetike po ndjente barrën e kundër bllokadës. Uzinat dhe fabrikat në lindje po pakësosheshin gjithnjë e më shumë nga forcat punëtore. Sovjetikët po kishin gjithnjë e më shumë mungesa tē qomyrit dhe makinerive tē tjera kaq tē domosdoshme pér tē patur një industri efektive në zonën e tyre. Në pranverën e viti 1949, bllokada sovjetike solli probleme pér vetë Bashkimin Sovjetik pasi nuk kishte më se ç'të çmontonte në zonën e vet tē pushtuar.

#### **4.5. Stalini i jep fund bllokadës së Berlinit**

Më 31 janar 1949, në një intervistë dhënë Nju Jork Tajmsit, Ernst Rojteri u shpreh:

*"Mori fund. Rusët tani e kuptuan se nuk mund ta marrin Berlinin me bllokadë. Shumë shpejt ata do tē jenë tē detyruar tē gjejnë një rrugë tē re". (Clay 1950:392).*

Dy javë më vonë, Stalini gjatë një interviste listoi kushtet e tij pér tē hequr bllokadën e Berlinit. Në to nuk përfshihej kërkesa që kishte parashtruar pér eliminimin e monedhës perëndimore (Smyser, 1999:86). Shtetet e Bashkuara tē Amerikës nëpërmjet përfaqësuesit

të tyre i kërkuan përfaqësuesit sovjetik Jakob Malik nëse fjalët e Stalinit ishin të vërteta. Maliku u shpreh se nuk kishte marrë ende një përgjigje (Smyser, 1999:86). Gati një muaj më vonë, më 15 mars 1949, Maliku u shpreh se heshtja për fjalët e Stalinit nuk ishte e paqëllimshme. Ai kishte marrë udhëzime që të hiqej bllokada nëse edhe kundër bllokada perëndimore hiqej në mënyrë të menjëherëshme. Pas gjashtë javë bisedimesh, u deklarua më 5 maj 1949 se bllokada dhe kundër bllokada merrnin fund më 12 maj 1949. Duke parë braktisjen nga ana e Stalinit, Ulbrihti edhe pse kishte informacione nga Sokolovski, mendoi ta paraqiste veten si një gjerman i mirë duke u shprehur se "Berlini nuk ishte kryeqyteti i zonës sovjetike të pushtimit, por kryeqyteti i Gjermanisë" (Davison, 1958:256).

Edhe pse zyrtarisht bllokada mori fund më 12 maj 1949, ura ajrore vijoi të funksiononte deri më 30 shtator 1949. Deri në atë datë, mbi Berlin ishin kryer 276.926 fluturime zyrtare (Collier, 1978:161). Suksesi i urës ajrore forcoi bazat e aleatëve perëndimorë në Berlin dhe në mbarë Gjermaninë. Më 20 mars 1949, dojçmarka u bë monedha e vetme zyrtare në Berlinin perëndimor dhe në zonat perëndimore. Ekonomia gjermane në këto zona u bë një e vetme. Monedha lindore nuk pranohej për transaksione financiare. Ajo mund të përdorej lirisht vetëm në zonën lindore.

Në total, ura ajrore kishte dërguar më shumë se 2.3 milion ton furnizime ku një e treta ishin ushqime. Dy të tretat e fluturimeve përmbanin qymyr. Në këtë operacion një vjeçar morën pjesë 441 avionë amerikanë, 248 britanikë të cilët kishin bërë mijëra kilometra vajtje ardhje. Shtatëdhjetë e tetë pilotë vdiqën si pasojë e disa aksidenteve që nuk u shkaktuan nga Bashkimi Sovjetik (Collier, 1978:161). Në fund të vitit 1949, ekonomia e Berlinit filloj të gjallërohej. Bllokada e mbajti gjallë qytetin. Berlinezët kanë meritën e tyre për t'i mbajtur të angazhuar aleatët në qytetin e tyre. Preferanca e tyre për perëndimin ishte e

kuptueshme. Me shekuj gjermanët kishin qenë pjesë e ambicjeve dhe e kulturës perëndimore edhe pse shtetin e kishin krijuar shumë vonë. Berlinezët treguan se e donin demokracinë dhe ishin gati të vdisnin për të (Collier, 1978:155).

Meritën për shpëtimin e Berlinit e kishin katër burra: Ernst Rojter, Ernest Bevin, Herri Truman dhe Lusius Klei. Ata sfiduan dyshimet e gjithë të tjerëve dhe me vendosmëri e shpëtuan qytetin nga katastrofa komuniste. Rojteri me shumë burrëri sfidoi autoritetin e Ulbrihit dhe e rreshtoi qytetin në krah të perëndimit. Bevini mbështeti Berlinin kur thua jse të gjithë britanikët i urrenin gjermanët. Trumani sfidoi këshillat e stafit të tij. Klei menaxhoi situatën politike dhe ushtarake të qytetit. Kur misoni u krye, nyja që ata kishin lidhur mes Berlinit dhe perëndimit ishte e pazgjidhshme.

Nga ana tjetër Stalini, Ulbrihti dhe Sokolovski gjykuau gabim bllokadën. Ajo nuk u dha atyre frytet që kërkonin. Stalini u përpoq ta ndreqte gabimin duke kërkuar një mbledhje të ministrave të jashtëm të katër fuqive pushtuese, por suksesi i urës ajrore i shoi shpresat për një një zgjidhje politike në favor të tij. Bllokada rrezikoi perspektivat sovjetike përmarrëdhëniet të mira me një Gjermani të bashkuar. Stalini kishte shpallur luftë të hapur ndaj perëndimit dhe betejën e parë në Gjermani sapo e kishte humbur. Tani atij do t'i duhej të merrej me perspektivën e një Gjermanie të ndarë dhe të përshtaste rolin e Bashkimit Sovjetik në të.

#### **4.6. Përpjekjet për krijimin e një shteti të ri gjerman**

Bllokada e Berlinit ishte eksperiencia e parë negative që përfunduan gjermanët pas përfundimit të Luftës II Botërore. Ajo që ndodhi i bindi ata se ishte e detyrueshme të

themelonin një shtet. Ministrat e jashtëm perëndimorë ranë dakord. Ata kishin bashkuar zonat e tyre të pushtimit dhe tani u hodhën hapat e fundit për të themeluar një shtet në Gjermaninë perëndimore. Nëse do të ndodhët, kjo pjesë e Gjermanisë do të gëzonte siguri dhe prosperitet (Clay, 1950:393). Aleatët iu vunë pa vonesë punës për të krijuar shtetin gjerman në perëndim. Që në fillim, pati mosmarrëveshje lidhur me mënyrën sesi do të ekzistonte ky shtet dhe çfarë autoriteti duhej të kishte. Duke parë se nuk po binin në një mendje, forcat perëndimore menduan të pyesnin gjermanët sesi e dëshironin ata shtetin e tyre. Më 1 shtator 1948, u mblohdh asembleja e parë kushtetuese gjermane për të vendosur formën e qeverisjes (Clay, 1950:393). Aleatët kishin të drejtën e vetos, por menduan t'u jepnin gjermanëve një mundësi për të paraqitur idetë e tyre dhe për të bërë propozime konkrete. Aleatët ranë dakord që të ndërtohej një statut ku do të deklaroheshin të gjitha fuqitë dhe detyrimet për të ndërtuar një kushtetutë të re gjermane.

Kur bllokada e Berlinit ishte bërë serioze, më 1 korrik 1948, tre fuqitë perëndimore nëpërmjet guvernatorëve të tyre, u takuan në Frankfurt me kryetarët e landeve dhe u parashtruan tre dokumente. Këto letra u quajtën "Dokumentet e Frankfurtit" dhe lejonin kryetarët e landeve të nxitonin për të të krijuar shtetin e Gjermanisë perëndimore (Clay, 1950:394). Data 1 shtator 1948 do të ishte edhe afati kur kryetarët e landeve do të paraqisin projekt propozimin i cili do të hidhej në referendum popullor. Në dokumentet e Frankfurtit qartësoheshin të drejtat e se cilës palë si dhe forma e re e organizimit të shtetit gjerman (Pulzer, 1995:45).

Fillimisht, kryetarëve gjermanë të landeve projekti perëndimor iu duk i vakët për faktin e thjeshtë se Gjermania do të ishte e ndarë. Konrad Adenaueri i cili ishte një figurë kyçë politike në zonën britanike të pushtimit, u ankua se aleatët kërkonin të mbanin për një kohë

të gjatë dominimin e tyre mbi popullin gjerman duke ndarë vendin. Nuk ishin të pakta spekulimet e tij lidhur me këto dokumenta dhe ata që ngritën zërin më fort se ai ishin social-demokratët (Pulzer, 1995:46). Por, pragmatistët gjermanë ishin ata që e kuptuan më mirë situatën dhe rrjedhimisht fituan. Ata e kuptionin se lypësit nuk mund të zgjidhnin. Një vend që kishte nisur një luftë dhe e kishte humbur atë duhet të pranonte edhe një mundësi jo perfekte për të jetuar. Pas përpjekjesh të gjata, kryetarët e landeve jo pa keqardhje, pranuan ofertën e fuqive pushtuese perëndimore. Si kusht ata vendosën që shteti i ri të mos kishte një kushtetutë të përhershme, por vetëm një dokument të përkohshëm sipas të cilit shteti do të funksiononte sovran derisa të kryhej bashkimi.

Gjermanët kanë debatuar gjatë dhe ashpër për këtë lloj dokumenti. Duke hequr fjalën "kushtetutë" sepse do të thoshte përjetësi e këtij shteti, ata i hapën rrugë legjitimitetit që në një kohë të përshtatshme të bashkoheshin edhe me pjesën në zonën sovjetike. Ata ranë dakord që dokumenti që do të zëvendësonte kushtetutën të quhej *Grundgesetz* (Ligi bazik) (Pulzer, 1995:47). Në një notë dërguar fuqive perëndimore pushtuese, Karlo Shmidt, kryetari i social-demokratëve u përpoq t'u shpjegonte sesa keq ndiheshin gjermanët që tashmë u duhej të flisnin vetëm për gjysmën e kombit të tyre. Ai gjithashtu u përpoq t'u shpjegonte aleatëve se kryetarët e landeve e kishin të pamundur të firmosnin me dorën e tyre ndarjen e vendit. Gjenerali Klei iu përgjigji ashpër letrës së Shmidit duke i thënë se gjermanët kishin harruar se kush ishin miqtë e tyre të vërtetë. Ai vuri veton duke thënë se aleatët nuk do të pranonin ndryshime në gjuhën e përdorur në tekstu se kjo ofertë ishte e pandryshueshme (Smyser, 1999:90). Klei nuk mund ta pranonte që gjermanët t'ja hidhnin fajin aleatëve për ndarjen e vendit. Gjenerali francez Zhozef-Pier Kënig u shpreh se ndoshta ishte gabim që gjermanëve t'u jepej kaq shumë sovranitet (Smyser, 1999:91).

Gjenerali britanik Robertson ndërhyri duke i thënë Kleit dhe Kënigut që t'i linin ngjarjet në rrjedhën e tyre. Ata ranë dakord dhe nxitën kryetarët e landeve që të pranonin projektin perëndimor. Klei gjithashtu u shpreh se ura ajoore ishte një tjeter shembull që tregonte se perëndimorët donin të ndihmonin jo të dëmtonin popullin gjerman. Kryetarët e landeve sipas Kleit me qëndrimet e tyre po e dëmtonin të ardhmen e vendit dhe se dotë ishte shumë e gabuar që të refuzohej ky projekt të cilit i ishte dashur të kapërcente shumë pengesa politike që të mund të sillej përpala tyre. Ernst Rojteri përkrahu idenë e Kleit dhe nxiti kryetarët ta pranonin ofertën për shtetin e ri. Duke marrë shkak nga pozicioni i fuqishëm i Ulbrihit në zonën lindore, Rojteri u shpreh:

*"Ndarja e Gjermanisë nuk u vendos këtu, ajo ishte bërë fakt i kryer"* (Smyser, 1999:91).

#### **4.7. Konrad Adenauer, kancelari i parë i RFGJ-së**

Gjermania po paguante për fajet e saj, jo për dëshirën e perëndimorëve. Madje, shumë studjues janë shprehur se perëndimorët u treguan të përmbajtur me një komb i cili ishte përgjegjës për luftën më të madhe dhe më shkatërrimtare në historinë e njerëzimit. Vetëpërmbajtja e dhimbshme e perëndimorëve tregonte sesa të avancuar ishin ata në krahasim me gjermanët. Më 1 shtator 1948, gjermanët iu vunë punës për të ndërtuar shtetin e ri. Në mbledhjen e Bonit këshilli parlamentar reflektoi mbi fuqinë e partive gjermane. Dy grupet më të forta Partia Social Demokrate dhe Partia Kristian Demokrate (CDU) kishin nga 27 vota secili. Këtyre forcave iu shtua edhe një parti e re, Bashkimi Social Kristian (CSU). Shumë prej anëtarëve të këtyre partive kishin qenë kundërshtarë të vendosur të nazizmit (Smyser, 1999:92). Karlo Shmidi harto tekstin përfundimtar të ligjit bazik i cili u mirëprit nga të gjithë të pranishmit. Duke qenë se kryetari i social-demokratëve u zgjodh

për të hartuar draftin, CDU&CSU-ja u zgjodhën për të drejtuar konventën. Kryetar u zgjodh Konrad Adenauer.

Konrad Adenauer kishte qenë një figurë e rëndësishme politike në Republikën e Vajmarit dhe kryetar i bashkisë së Këlnit nga 1917 deri më 1933. Ai e kishte modernizuar qytetin dhe administratën duke e bërë qytet lider në të gjithë Gjermaninë dhe në botën katolike. Hitleri e kishte shkarkuar nga detyra sepse Adenaueri kishte urdhëruar heqjen e të gjitha simboleve naziste nga bashkia dhe nga vendet publike. Ai u burgos dy herë nga nazistët dhe ky fakt ia kishte rritur prestigjin pas luftës. Duke qenë një lider konsevator i qendrës së djathtë, autoriteti i Adenauerit u rrit shpejt. Ai e ktheu koalicionin CDU-CSU në një forcë kombëtare (Smyser, 1999:92).

Fillimisht, aleatëve Adenaueri nuk iu duk i gjindshëm. Autoritetet britanike të pushtimit nuk e pëlqenin atë pasi kishte qenë prej shumë kohësh kundërshtar i social-demokratëve. Madje, ata e kishin hequr edhe nga kryetar i përkohshëm i Këlnit pas lufte pasi kishte refuzuar të priste pemët e qytetit që të përdoreshin për zjarr (Smyser, 1999:92). Ekstremizmat nuk u pëlqenin aleatëve. Një ekstremizëm i ri në Gjermani do ta conte përsëri botën në katastrofë. Megjithatë ata vendosën ta vinin në provë. Ligji bazik ishte shumë i fortë dhe i drejtpërdrejtë. Së pari ai argumentonte se partitë politike të cilët nuk e kalonin pragun e 5% të votave nuk hynin në parlament. Në këtë mënyrë iu tha stop politikanëve abuzues që të krijonin parti të vogla pér të promovuar idetë e tyre të paarritshme. Së dyti, kërkohet një votë konstruktive pér mosbesimin që të mund të mos rrëzohej lehtë qeveria. Me këtë akt, parlamenti nuk mund të shkarkonte një qeveri pa zgjedhur një tjetër në vend të saj. Kjo masë i bënte partitë më të ndërgjegjshme pér veprimet e tyre dhe mbi të gjitha nuk e linte vandin pa një qeveri të përgjegjshme. Kjo

masë krijonte një qeveri të qëndrueshme pa krijuar diktaturë. Së treti, pushtetet e kryetarit të shtetit u kufizuan. Kryetari i shtetit nuk mund të vendoste për krijimin e një qeverie pa miratimin e parlamentit. Ishte e padëshirueshme që një grup sklerotik konspiratorësh dhe një feldmarshall i plakur të merreshin vesh për të vendosur qeverinë si në rastin e fon Papenit me fon Hindenburgun të cilët emëruan Hitlerin kancelar më 1933. Duke dashur të shmagrin gabimet e Republikës së Vajmarit, gjermanët me ligjin bazik bënë të mundur që askush të mos e shihe kolktukun e pushtetit si të përjetshëm.

Duke qenë një popull me traditë shoqërore, gjermanët donin t'u kujtonin aleatëve perëndimorë se ligji bazik nuk fillonte më 1948. Gjermanët kishin kushtetutën e tyre të shkruar qysh më 1849 (100 vjet më parë) prej social-demokratëve dhe liberalëve. Ata donin t'u tregonin perëndimorëve se tradita shoqërore gjermane kishte rrënje të thella në histori dhe se asgjë nuk mund të kryhej jashtë saj (FRG, 1985:17). Tradita gjermane me këtë akt hodhi poshtë modelin centrist Bismark/Vajmar/Hitler. Edhe pasi këshilli parlamentar e aprovoi draftin përfundimtar më 10 shkurt 1949, aleatët përsëri patën rezerva veçanërisht për zërin e taksave dhe të buxhetit (FRG, 1985:19).

Në këtë pikë, hyn në skenë një njëri personaliteti i të cilit do të ndikonte të gjithë kontinentin evropian. Robert Shumani u tregua se ishte lloji i aleatit që Ernest Bevini po kërkonte për Gjermaninë. Shumani ishte rritur në Alsasë-Lorenë një zonë që kishte shkaktuar aq shumë grindje ndërmjet francezëve dhe gjermanëve. Ai kishte shërbyer në ushtrinë gjermane gjatë Luftës I Botërore dhe fliste rrjedhshëm gjermanisht. Ai me Adenauerin flisnin gjermanisht me njëri tjetrin në mënyrë që të kuptoheshin më mirë, ndërsa zyrtarët e tjerë francezë ishin të detyruar të prisnin përkthimin (Smyser, 1999:94).

Kur Shumani vizitoi Londrën më 1949, ai dhe Bevini sheshuan shumë mosmarrëveshje për

Gjermaninë. Ata ranë dakord që qytetarët gjermanë të qeverisnin Gjermaninë perëndimore pa cënuar interesat dhe të drejtat e fuqive aleate. Ata ranë dakord që Ruhri të mund të pëmbushte interesat ekonomike franceze, por jo në dëm të të tjerëve. Bevini dhe Shumanitë ranë dakord edhe për strukturat federale gjermane. Në marrëveshje me sekretarin e ri të shtetit Din Acheson (Dean Acheson) ata ranë dakord të hiqnin disa restriksione mbi prodhimin industrial gjerman dhe t'i thonin 'stop' çmontimit të industrisë gjermane. Shumanitë kërkonte që marrëdhëniet franko-gjermane të hynin në një fazë të re dhe fuqitë aleate në Gjermani të fitonin gradualisht statusin e vëzhguesit (Bullock, 1983:695).

Duke qenë se Franca po jepte shenjat e saj të pajtimit me Gjermaninë, aleatët dhe gjermanët e kishin më të thjeshtë të largonin mosmarrëveshjet mes tyre. Ajo çka është më e rëndësishme që të përmendet është se, aleatët ranë dakord t'i jepnin më shumë autoritet Gjermanisë perëndimore që të fitohej siguria e duhur për të dalë përpara popullit. Kjo do të thoshte se gjermanët duhet të vetëqeveriseshin. Tashmë, gjermanët përkohësisht do të kishin mbi kokë jo më autoritetin ushtarak të pushtimit, por komisionerë të lartë.

Gjatë muajit prill 1949, tre ministrat e jashtëm të fuqive pushtuese perëndimore firmosën "marrëveshjen e mrekullueshme" sipas draftit të Achesonit. Në këtë marrëveshje Ruhri i bashkohej shtetit të ri gjerman në krijim e sipër. Bevini insistonte se tashmë Stalini nuk duhej lejuar që të fuste më hundët në çështjen gjermane dhe evropiane (Bullock, 1983:667). Edhe pse Klei donte të vijohej me minimizimin e autoritetit ushtarak, përsëri aleatët kishin në dorë shumë gjëra në Gjermani. Ata mund të pengonin çdo legjislacion gjerman që mund të binte në kundërshtim me politikat e pushtimit. Ata mund të merrnin çdo pushtet në rast emergjencë. Këto masa e kënaqnin Shumanin pasi mund të deklaronte qetësisht në

Asamblenë Kombëtare (parlamentin) se Gjermania nuk përbënte më kërcënëm për Francën (Smyser, 1999:95).

Më 8 maj 1949, këshilli parlamentar miratoi ligjin bazik me një shumicë të madhe prej 53 votash pro dhe 12 kundër. Në 12 ditët në vijim, dhjetë landet ratifikuan tekstin (vetëm Bavaria refuzoi pasi donte më shumë autonomi). Po kështu edhe tre guvernatorët të fuqive perëndimore e miratuan. Më 23 maj 1949, Ligji Bazik hyri në fuqi dhe u krijua Republika Federale Gjermane (Bundesrepublik Deutschland). Më 14 gusht 1949, u zhvilluan zgjedhjet e para parlamentare. Më 15 shtator 1949, me diferençën e një vote të vetme Budestagu (Parlamenti) zgjodhi Konrad Adenauerin si kancelarin e parë të shtetit të ri, post të cilin ai e mbajti për 14 vjet. Më 21 shtator RFGJ-ja filloi funksionimin si shtet i pavarur me sovranitet të kufizuar (Smyser, 1999:95). Katër vjet pas rënies së Rajhut të Tretë, gjermanët filluan një jetë të re politike. Ata filluan të vendosnin vetë përfatim e tyre, por për këtë ata paguan një çmim të shtrenjtë; ndarjen kombëtare.

#### **4.8. Valter Ulbrihti themelon Republikën Demokratike Gjermane**

Gjatë dhe pas bllokadës së Berlinit, Valter Ulbrihti dhe Vasili Sokolovski nuk e ndërprenë asnjëherë punën për të ndryshuar strukturën e pushtetit në zonën sovjetike të pushtimit. Këto ndryshime e përforcuan akoma më shumë pushtetin e Ulbrihit. Që nga viti 1947, pëshpëritez kudo në zonën sovjetike se komunisti Ulbriht do të ishte "zoti" i padiskutueshëm i vendit (Smyser, 1999:96). Komunistët në zonën sovjetike fillimisht u treguan të kujdeshshëm që të mbanin marrëdhënie të mira me sovjetikët sepse fundja ata i kishin sjellë në pushtet. Në fillimet e pushtetit të tij, Valter Ulbrihti i quante të papjekura kushtet për një pushtet të plotë në vend. Rreth SED-it (Partia e Bashkuar Socialiste e

Gjermanisë) kishin filluar dyshimet e para sovjetike për paaftësi për të përbushur plotësisht programin e saj të miratuar nga Moska. Në pamje të parë dukej se Ulbrihti po ndërmerrte një politikë të pavarur nga Bashkimi Sovjetik. Madje, lideri gjermano-lindor kishte folur jo ashpërsisht, por me rezerva ndaj grushtit të shtetit në Çekosllovaki (Smyser, 1999:97). Për të zbutur klimën me BS-në, Ulbrihti më 4 korrik 1948 u shpreh se SED-i nuk ishte më një parti e Karl Marksit dhe Fridrih Engelsit, por parti e Vladimir Iliç Leninit. Ai e nxori jashtë loje fraksionin social demokrat brenda partisë dhe akuzoi publikisht udhëheqësin jugosllav Josip Broz-Tito për braktisje të komunizmit. Për Ulbrihtin, Moska përfaqësonte të vetmen rrugë të drejtë për çdo parti socialiste (Smyser, 1999:97).

Moska dhe Ulbrihti do të ishin zërat e vetëm që do të dëgjoheshin në zonën sovjetike. Anton Akerman një nga ideologët më në zë të SED-it, iu desh të distancohej nga një artikull i shkruar pak kohë më parë nga ai, ku kishte deklaruar se ruga për të gjithë gjermanët do të ishte një dhe e vetme (Smyser, 1999:97). Ai shkoi deri aty sa të vetëdenonconte artikullin e tij të shkruar më 1946. Tashmë, modeli sovjetik i luftës së klasave do të kishte përparësi mbi gjithçka. Për të kompletuar plotësisht modelin sovjetik, në shtator të vitit 1948, u themeluan komisione të posaçme për të kontrolluar çdo sferë të jetës në zonën sovjetike. Disa kuadro me pikëpamje social demokrate u arrestuan me urdhër të Sokolovskit. Ata që shpëtuan, ia mbathën në Gjermaninë perëndimore.

Nën urdhrat e Ulbrihitit dhe Sokolovskit komisioni i planifikimit ekonomik në zonën sovjetike kishte një staf prej 5000 anëtarësh të cilët përfshinin çdo aspekt të qeverisë. Me politikat e tyre, Ulbrihti dhe SED-i ia thjeshtuan punën aleatëve perëndimore për të mirëkontrolluar pjesën e tyre. Sovjetizimi i SED-it dhe krijimi i zonës sovjetike të administrimit të dominuar nga partia komuniste ia minuan Stalinit dëshirën për të marrë

edhe zonën perëndimore. Shtimi i numrit të refugjatëve nga zona sovjetike ia përforconin akoma më shumë bindjen zyrtarëve perëndimorë për të mos patur asnjë lidhje me SED-in. Edhe një herë tjetër, përpjekja e Ulbrihitit për të patur sa më shumë pushtet në zonën sovjetike dëmtoi çfarëdolloj përpjekje të Stalinit për të shtrirë ndikimin komunist në zonat e tjera. Ulbrihti u bë i gjithëpushtetshëm. Me urdhër të tij, u organizuan tre kongrese në emër të "popullit gjerman" me të cilët mburrej se kishte ndikuar në të gjithë opinionin publik në Gjermani. Disa anëtarë komunistë të mbetur në zonat perëndimore u larguan për në lindje duke i bërë një favor të paçmuar aleatëve. Me veprimet e tyre, Sokolovski dhe Ulbrihti dëmtuan çështjen sovjetike në Gjermani dhe në mbarë Evropën perëndimore. Dy prej anëtarëve të CDU-së që ishin në Berlinin lindor Jakob Kajzer dhe Ernst Lemer pasi u detyruan të merrnin pjesë me dhunë në kongreset e organizuara nga Ulbrihti, u arratisën në perëndim. Me deklaratat e tyre ata i shumëzuan me zero thirrjet e Ulbrihitit se impakti i kongreseve kishte ndikuar në të gjithë Gjermaninë (Smyser, 1999:98).

## **Kapitulli V - Pasiguritë ndërkombëtare në krijimin aleancave 1950 - 1957**

### **5.1. Ndarja e Gjermanisë**

Fitorja e CDU-së në perëndim i shkonte shumë për shtat politikës së Ulbrihitit. Pragmatizmi i saj për një të ardhme të sigurtë kishte mbështetur ndarjen e Gjermanisë sesa nacionalizmi pa shkak i SPD-së (Partia Social Demokrate Gjermane). Për shkak të bindjes së tij se bllokada e Berlinit do të largonte të gjithë aleatët perëndimorë nga Berlini, Ulbrihti në mesin e vitit 1948 filloi të hartonte një plan i cili do të përfshinte të gjithë ish kryeqytetin gjerman. Ai iu vu punës për një qeveri të veçantë në zonën sovjetike. Ky plan i ishte

paraqitur Sokolovksit qysh në vitin 1946, por Stalini kur e kishte parë e kishte hedhur poshtë. Në vitin 1948, me ndihmën e Sokolovskit, Ulbrihti më në fund mund ta bënte realitet planin e tij (Naimark, 1995:56). Me një mendje për të kriuar një shtet në zonën sovjetike të pushtimit, Ulbrihti dhe Sokolovski iu vunë punës për të themeluar një ushtri të re gjermane. Më 3 korrik 1948, Sokolovski lëshoi urdhrin për themelimin e një force të re policie e cila në fakt ishte një organizatë paraushtarake e quajtur Kasernierte Volkspolizei (Policia Popullore në Kazermë). Pas themelimit të RDGJ-së, Ulbrihti e shndërroi këtë forcë në ushtri të vërtetë me një numër prej 50 mijë vetësh (Naimark, 1995:57).

Stalini e kuptoi në vitin 1948 se Ulbrihti kishte shkuar më tej dhe më shpejt nga sa dëshironte ai. Gjithashtu, udhëheqësi sovjetik e kuptoi se ura ajrore do të conte në shkëputjen e mëtejshme të territoreve perëndimore nga lindja dhe se mundësia për të negociuar për një shtet gjerman të bashkuar sa vinte dhe bëhej më e zbehtë. Lëvizjet e Ulbrihit për të themeluar me çdo kusht një shtet në zonën sovjetike, minonin përpjekjet e Stalinit për negociatë. Duke mos gjetur rrugëdalje, Stalini e thirri në Moskë Ulbrihtin duke i kërkuar të hidhte poshtë politikën e ndjekur deri në atë kohë. Ai iu shpreh liderit gjerman se situata nuk ishte e njëjtë si në vendet e tjera të Evropës lindore pasi nuk kishte më një shtet të bashkuar gjerman. Tani e tutje duhej të punohej vetëm për bashkimin dhe paqen (Naimark, 1995:59). Stalini shkoi deri aty sa e talli Ulbrihtin duke i thënë se po luftonte si stërgjyshërit e tij teutonë me trimëri, por me budallallëk (Naimark, 1995:59). Ai i tha Ulbrihit se nuk donte të dëgjonte më për ndarjet lindje-perëndim. Stalini shkoi deri aty sa shkarkoi Sokolovskin pasi kishte mbështetur politikat e Ulbrihit për themelimin e një shteti lindor gjerman. Por, atij i duhej Ulbrihti pasi ishte formuar në Moskë nga Kominformi dhe njeri tjetër me kë ta zëvendësonë nuk kishte.

Përpjekja e Stalinit për një shtet të bashkuar gjerman erdhi shumë vonë. Ngjarjet në Gjermani u rrokullisën aq shpejt sa i dolën nga dora atij dhe Ulbrihit. Në perëndim, SED-i i Ulbrihit urrehej më shumë sesa sovjetikët. Duke mos gjetur rrugëdalje, Ulbrihti në maj të vitit 1949 organizoi zgjedhjet për një kongresin e partisë me votë popullore. Rezultati ishte zhgënyes. 35% e votuesve i thanë "jo" listës të propozuar nga ai dhe 7% e votuesve i nxorën fletat e votimit të pavlefshme (Smyser, 1999:100). Ky fakt ishte një paralajmërim i fortë se SED-i dhe sovjetikët nuk do ta kishin të lehtë të bënin për vete gjermanët në zonën e tyre. Kur u themelua RFGJ-ja, Stalini e kishte shumë të vështirë ta gjelltiste realitetin. Komunistët në RFGJ kishin fituar 5.7% të votave dhe mezi kishin hyrë në parlament. Me humbjen e tyre Stalini nuk mund të shpresonte për një zë të fortë e të bashkuar komunist në të gjithë Gjermaninë. Duke mos patur asnjë alternativë, me shumë dëshpërim Stalini lejoi Ulbrihtin të organizonte themelimin e një shteti gjerman në zonën sovjetike. Shteti i ri do të quhej Republika Demokratike Gjermane (DDR) një term që vetë Ulbrihti e kishte hedhur poshtë me përbuzje më 1946. RDGJ-ja u themelua zyrtarisht më 7 tetor 1949 (Smyser, 1999:100). Urimet e vakëta të Stalinit i vunë vulën e dështimit të dytë sovjetik në Gjermani.

Duke mos dashur t'i faturonte vetes një tjetër dështim, Kongresin e tretë të partisë Ulbrihti e ktheu në parlament (Volkskammer) me 330 vende, 210 nga të cilët ishin zënë nga anëtarë të SED-it (Childs, 1983:23). Duke ndjekur shembullin perëndimor, administrata ushtarake sovjetike u shpërbë më 10 tetor 1949 dhe u zëvendësua nga Komisioni Sovjetik i Kontrollit (Naimark, 1995:58). Ndër organet më të famshme dhe njëkohësisht më famëkeqi që u formua ishte Ministria e Sigurisë Shtetërore e cila i jepte llogari vetëm Byrosë Politike.

Qysh në fillim, Ulbrihti dhe Grotovohli e kishin në dorë këtë strukturë të frikshme që në të gjithë Gjermaninë dhe në mbarë botën u njoh me emrin Stasi (Naimark, 1995: 59).

## **5.2. Arsyet e krijimit të një aleance perëndimore ndaj rrezikut ushtarak sovjetik**

Veprimet e Stalinit në Evropën lindore kishin ndjellë frikë dhe pasiguri në perëndim. Frika e një sulmi sovjetik në pjesën e lirë të kontinentit nga Ushtria e Kuqe vijonte të ishte makthi kryesor për Evropën e pas luftës. Grushti i shtetit në Çekosllovaki kishte të njëtin efekt si ndërhyrja ushtarake e Stalinit në Poloni. Stalini kishte urdhëruar të ndërhyhej kundër një vendi i cili gëzonte simpati të madhe ndërkombëtare për rezistencën ndaj Hitlerit në fund të viteve '30. Kushdo që të ketë qenë qëllimi i Stalinit, ai ishte tërësisht i pajustifikueshëm. Evropiano-perëndimorët patën frikë të madhe. Nëse komunistët nuk e kishin fare të vështirë të organizonin një grusht shteti në Pragë, çfarë do t'i ndalonte ata të bënin një gjë të tillë në Romë apo Paris? Dhe nëse do të përpinqeshin të bënin diçka të tillë, kush do t'i ndalonte?

Ministri i jashtëm britanik Ernest Bevin pati idenë e madhe për të themeluar një aleancë të re ushtarake e cila do të lidhte fort Evropën Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Edhe ministri francez Bido ra dakord duke thënë me gjysëm shakeje se nuk dëshironë më të ishte në krye të një rezistence të fshehtë në rast pushtimi të vendit të tij nga një agresor. Franca dhe Britania ranë dakord që të themelohej një aleancë e re ushtarake me qëllim për të qetësuar opinionin publik evropian dhe për të treguar se komunizmi nuk mund të marshonte siç i donte qejfi në këtë pjesë të kontinentit. Duke qenë se nuk bënin dot pa Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Uashingtoni u ftua të merrte pjesë (Smyser, 1999:101).

Ministri i jashtëm britanik Bevin, argumentonte se mbijetesa e perëndimit varej nga aleanca e fortë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës me Britaninë e Madhe dhe dominionet britanike (Smyser, 1999:101). Me të ndodhur grushti i shtetit në Pragë, ai i kishte thënë Marshallit që të mos humbej më kohë, por të krijohej një aleancë mes SHBA-së dhe Evropës perëndimore. Duke parë ngurrimin e Marshallit, Bevini ftoi në vitin 1948 ministrat e jashtëm të Beneluksit dhe Francës t'i bashkoheshin një pakti ushtarak evropiano-perëndimor. Duke parë avancimin sovjetik në Evropën qendrore, Senati amerikan votoi Rezolutën Vanderberg e cila e nxiste presidentin Truman të ndiqte në mënyrë progresive zhvillimin rajonal për vetëmbrojtje (Smyser, 1999:102).

Procesi për krijimin e një traktati për të përfshirë vendet e Atlantikut të Veriut filloi të zgjerohej akoma më shumë. Bisedimet për një aleancë të tillë filluan në vitin 1948 me pjesëmarjen e Britanisë, Francës, SHBA-së, Kanadasë dhe vendeve të Beneluksit. Në takimin e 9 shtatorit 1948, ata ranë dakord se ishte e domosdoshme krijimi i një aleance ushtarake për të rivendosur besimin evropian (Narinsky, 1994:2). Për të patur një shtrirje sa më të gjerë, në bisedime u ftuan edhe përfaqësuesit e Italisë, Danimarkës, Islandës, Norvegjisë dhe Portugalisë. Të gjitha këto shtete më 4 prill 1949, nënshkruan në Uashington traktatin për themelimin e Aleancës së Atlantikut të Veriut (NATO) (Smyser, 1999:102).

Si çdo aleancë, edhe NATO-ja pati problemet e veta qysh në fillim. Franca këmbëngulte që me po aq vendosmëri aleanca të vepronë edhe ndaj Gjermanisë njëloj si kundër Bashkimit Sovjetik nëse do të rrezikonte paqen dhe stabilitetin. Por, shumë shpejt u kuptua se pa Gjermaninë nuk mund të ecej. Franca dhe Italia ishin të paralizuara nga forca e partive komuniste përkatëse. Mbrojtja e Gjermanisë hyri në orbitën e interesave gjeostrategjike të

kohës. Edhe pse sekretari amerikan i shtetit Din Acheson këmbëngulte për demilitarizimin e plotë të Gjermanisë, vetë pozita gjeografike e atij vendi e bënte të detyrueshëm përfshirjen e tij në të ardhmen e afërt në strukturat euro-atlantike.

Prova më e vështirë e sistemit të mbrojtjes së Aleancës së Atlantikut të Veriut ishte vetë NATO-ja. Kjo aleancë është një bashkim vlerash të një historie të përbashkët dhe kulture të njëjtë. Nga të gjitha aleancat që ka njojur historia kjo është aleanca më e fuqishme. Evropa perëndimore përbante gati gjysmën e investimeve amerikane në botë. Në një kuptim të gjerë të fjalës, aftësia e aleatëve perëndimore tregohet në përballimin me sukses të një agresioni të mundshëm. Ja përsë pikërisht në këtë pikë janë bërë edhe gabimet më të mëdha që kanë çuar jo në pak raste në kriza të thella brenda NATO-s. Në vitet e Luftës së Ftohtë thuhej se amerikanët duhet ta mbanin mirë me Evropën perëndimore se aty gjendeshin bazat më të madhe të SHBA-ve dhe ishte e nevojshme që ato të gjendeshin atje. Në fakt është krejt e kundërta. Ishte Evropa ajo që duhej ta mbante mirë me Amerikën se në sajë të investimeve amerikane në çdo fushë të jetës bëhej e mundur mbrojtja dhe funksionimi i gjysmës së kontinentit si demokraci. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kishin dhe kanë një interes strategjik në Evropë që lidhet me mundësinë e përhapjes së interesave amerikane në Euro-Azi. Me ndryshimin e realiteteve gjeostrategjike mbijetesa e sigurisë nuk ndodhet më në Evropë, por është zhvendosur në Azi ku e gjithë përpjekja e Aleancës Perëndimore është e përqendruar në ndryshimet e pushtetit dhe mbi të gjitha që një tirani të mos zëvendësohet me një tjetër.

Nëse Euro-Azia do të qeverisej nga një forcë armiqësore apo nga një grup ekstremistësh, kërcënimi për paqen dhe sigurinë në botë do të ishte konstant. Çelësi për të kontrolluar Euro-Azinë është padiskutim Evropa perëndimore në kontakt të ngushtë me SHBA-në.

Nëse aleanca ndërmjet SHBA-së dhe Evropës do të çuhej, kjo gjë do të sillte një rrënim të fortë të vlerave euro-atlantike dhe do të conte në humbjen e Lindjes së Mesme dhe mbi të gjitha në përbysje të dhunshme në Afrikë. Nëse do të ndodhë kjo, shtetet që do të nxirrin më shumë përfitime do të ishin Bashkimi Sovjetik dhe Kina. Parë nga një pikëpamje ushtarake, kjo gjë kishte pak gjasa që të ndodhë. Nuk duhet harruar se dikur në vitin 1941, Gjermania për pak sa nuk e fundosi Rusinë Sovjetike dhe më 1954-ën një aleancë gjermano-amerikane e bëri të pamundur një agresion nga ana e Rúsise edhe atëherë kur kjo e fundit quhej Bashkim Sovjetik. Burimet industriale që zotërojnë vendet e hemisferës perëndimore janë të fuqishme. Bashkimi Sovjetik atëherë kishte shumë nevojë për paratë e Evropës, por pa t'i shpëtonte nga duart mundësia për ta patur kontinentin pronë të vetën. Kjo përfaktin se trupat amerikane nuk u larguan nga Evropa. Mbarimi i Luftës II Botërore nuk solli tërheqjen amerikane nga kontinenti i vjetër, përkundrazi solli rritjen e investimeve të gjithanshme amerikane në Evropën perëndimore.

Themelimi i NATO-s solli edhe vështirësitë e para në marrëdhëniet amerikano-evropiane. Kjo përfaktin se evropianët me në krye francezët u gjendën përballoë dilemës që ofronte doktrina strategjike amerikane. Pa një koncept të qartë lidhur me natyrën e luftës së ardhshme dhe si duhej të përballohej ajo, edhe një aleancë e formuar në bazë të parimeve më të ndershme do të humbte në gjetjen e një kuptimi se përsë duhet të ekzistonte. Në mungesë të një strategjie të kuptueshme për të gjithë partnerët, shpallja e aleancës në mënyrë formale nuk gjeti mbështetje. Edhe pas krijimit të saj, NATO-ja e kishte të vështirë të shpjegonte natyrën e mbrojtjes që do t'u ofronte aleatëve të saj. Gjithmonë kur ndodh një luftë, një shtet vendos fillimisht gjithnjë të rezistojë pasi shkalla e shkatërrimit që do të

gjejë në rast se dorëzohet do të jetë shumë e madhe. Në epokën atomike shkalla e shkatërrimit është e një niveli të paimagjinueshëm sa fare mirë do të quhej katastrofë.

Qysh në krijimin e saj prej SHBA-ve, NATO-ja pati shumë probleme. Problemi parësor erdhi pasi amerikanët fillimisht refuzuan të ndanin me aleatët e tyre evropianë sekretin e bombës bërthamore. Nga ana tjetër, edhe aleatët evropianë nuk u treguan të gatshëm për të bërë sakrificat ekonomike të nevojshme që ishin të domosdoshme për të patur një mbrojtje kuptimplotë. Madje disa prej tyre shkuan deri aty sa preferuan t'i shkëputen realitetit duke mohuar ekzistencën e rrezikut (Kissinger, 1957: 271).

Përsa kohë që doktrina e Shteteve të Bashkuara e identifikoi mbrojtjen e Evropës me luftën e përgjithshme, kontributi i aleatëve duhej të ishte gjithëpërfshirës. Por, shtetet e evropiane të perëndimit nuk i kishin burimet për të bërë një luftë totale dhe afërsia e tyre territoriale me Bashkimin Sovjetik i bënte këto shtete akoma më vulnerabël. Kështu, ndihmesa e tyre për Shtetet e Bashkuara zëre se nuk ekzistonte. Vendi që e kuptonte më mirë se kushdo tjetër pozitën strategjike dhe udhëheqëse të SHBA-ve ishte padashim Britania e Madhe. Ajo kishte dalë nga Lufta II Botërore shumë e dobët dhe megjithëse kishte përfituar nga furnizimi i saj me bombën bërthamore prej Amerikës përsëri nuk mund t'i bënte ballë e vetme një agresioni të mundshëm sovjetik ndaj Evropës perëndimore. Ja përse ndihma e Amerikës për mbrojtjen e Evropës gjatë Luftës së Ftohtë ishte e domosdoshme. Por, nëse Shtetet e Bashkuara kanë qenë përgjegjëse për shumë mospërputhje në politikat e NATO-s me përjashtim të Britanisë, vendet e tjera evropiane nuk ndihmuan në kapërcimin e këtyre vështirësive pasi ishin shumë të etura për të rimarrë veten nga plagët e luftës dhe këtë e përdornin si justifikim për të shmangur përgjegjësitë.

Megjithatë NATO-ja ishte dhe mbetej çelësi i efikasitetit të një aleance efektive në fillimet dhe gjatë epokës bërthamore. Nëse do të ishte e mundur të sajohej një koncept i gjithëkuptueshëm për mbrojtjen për të gjithë partnerët, atëherë bota do t'ia kishte kursyer vetes të gjitha tmerret teknologjike. Nëse NATO-ja insistonte në mbajtjen e një doktrine me dallime strategjike ndërmjet partnerëve atëherë do të kthehej në një aleancë pa vlerë dhe të gjitha përpjekjet e saj për stabilitet botëror do të shkonin dëm. Si një organizatë politike, ajo mund të kishte vlefshmëri, por si grupim ushtarak do të quhej e paefektshme. Në çdo krizë që mund të ndodhë, rreziku i një shpërthimi me armë të shkatërrimit në masë sidomos në Azi nuk do ta shpëtonte Evropën nga “ndotja”. Me kalimin e kohës, përshtypja e pafuqishmërisë tek aleatët evropianë do të conte në neutralitet në vend të veprimit. Në mënyrë që të jepet një vlerësim për NATO-n në fillimet e Luftës së Ftohtë, do të ishte më e udhës të analizoheshin politikat e mbrojtjes të shteteve anëtare dhe mbi të gjitha të partnerëve më të fuqishëm të Amerikës, Britanisë së Madhe, Gjermanisë Perëndimore dhe Francës. Çdo kush prej këtyre vendeve kishte një dilemë personale përsa i përket epokës bërthamore. Britania e Madhe mendonte të aplikonte një politikë vetëpërbajtjeje bazuar tek raprezaljet që ishin të ngjashme me idenë amerikane. Gjermania mendonte të përqendrohej vetëm tek kompleksiteti i një mbrojtjeje lokale. Franca mendonte të hiqte një vijë ndarëse ndërmjet teknologjisë bërthamore dhe asaj konvencionale. Në kohën kur shtetet evropiane ishin të ndarë me këto dilema, komunizmi i hodhi perëndimit sfidën e radhës, në Azi.

### **5.3. Krijimi i Evropës perëndimore nga Moneja, Shumani dhe Adenaueri**

Perspektiva e një riarmatimi gjerman sigurisht që nuk do të shihej me sy të mirë në Francë. Qytetarët francezë kishin vuajtur së tepërmë nga Gjermania e armatosur që nga viti 1870. Opinioni publik francez nuk do ta pranonte faktin se do të kishin të bënин përsëri me një shtet të aftë për të ndërhyrë ushtarakisht në Francë për herë të katërt brenda 80 vitesh. Në fillim të viteve 1950, në Francë nuk ekzistonte një politikë e qartë sesi duhej të sillej vendi me Gjermaninë. Dë Goli ishte i vetmi politikan francez që kishte hartuar dy koncepte lidhur me marrëdhëniet franko-gjermane. Koncepti i parë kishte të bënte me copëtimin final të Gjermanisë dhe i dyti, me bashkëpunimin franko-gjerman brenda Evropës (Smyser, 1999:10). Ministri i jashtëm Bido kishte dashur që në fillim ndarjen e Gjermanisë, por ishte tërhequr duke parë rrezikun sovjetik në rritje. Franca ishte anëtarësuar në NATO me bindjen se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe do ta mbronin nga Gjermania dhe Bashkimi Sovjetik. Megjithë këto masa, Francës i duhej patjetër një mënyrë për të bashkëjetuar me Gjermaninë. Përgjigjen më të saktë për të gjitha dilemat franceze e dha Zhan Mone.

Moneja kishte jetuar katër vjet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës si një ekonomist ndërkombëtar. Atje, ai kishte formësuar idenë e tij sesi duhet të ishin Franca dhe Evropa. Që në fillim të vitit 1944, ai ishte shprehur për revistën 'Fortune' se SHBA-të duhej të mbështesnin Evropën e bashkuar. Në idenë e tij, Franca, Britania e Madhe dhe Gjermania ishin çelësi i këtij bashkimi (Duchene, 1994:181). Në këtë ide, Moneja gjeti "shpirtin binjak" tek Robert Shumani i cili e shikonte bashkëjetesën franko-gjermane si domosdoshmëri për të përballuar fuqinë anglo-saksone. Në prill të vitit 1949, Moneja i tha Shumanit idenë e tij për bashkimin e industrisë franko-gjermane të qymyrit dhe çelikut

(Duchene, 1994:182). Ky bashkim do ta bënte luftën ndërmjet dy vendeve praktikisht të pamundur. Ky akt do të përshpejtonte edhe integrimin evropian. Shumani, duke kuptuar misionin e Monesë, bindi kabinetin qeveritar francez ta pranonte këtë propozim pa shumë debate. Më 9 maj 1950, propozimi u bë publik (Duchene, 1994:182). Kancelari Adenauer kishte dy muaj që kishte shprehur idenë e bashkimit të Francës me RFGJ-në, por dëshironte t'ja linte fqinjtit perëndimor kënaqësinë e të bërurit publik të idesë.

Që nga ky moment, Moneja hartoi planin për krijimin e Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut (ECSC). Nga ky moment, Moneja dhe Adenaueri u bënë miq të përjetshëm. Komisioneri i lartë amerikan MekKloi e mbështeti fuqishëm këtë projekt edhe pse iu desh të përdorte pak forcën për të bindur baronët e Ruhrit ta pranonin këtë projekt. Britania e Madhe nëpërmjet ministrit Bevin e mbështeti këtë projekt, por nuk mori pjesë në të (Smyser, 1999:110). Për Britaninë, marrëdhëniet me SHBA-në përbënин qëllimin kryesor.

Më në fund, Franca e kishte gjetur politikën e saj gjermane. Traktati u nënshkrua më 18 prill 1951 dhe marrëdhëniet armiqësore franko gjermane morën fund. Në vend të politikës së dobësimit të Gjermanisë që ekzistonte që nga viti 1631 (doktrina e Rishëljesë "Raison d'Etat"-shih vol. I 1600-1899, Gj.B.), Franca zgjodhi rrugën e duhur, atë të bashkëpunimit. Betejat tashmë i përkisnin historisë dhe një e ardhme e ndritur i priste të dyja vendet. Pengesat nuk mund të kaloheshin vetëm me një shtrëngim duarsh dhe me firmosjen e një traktati. Për shumicën e francezëve, gjermanët paraqisnin një rrezik permanent. Ata kundërshtonin krijimin e ushtrisë gjermane dhe bashkimin e dy Gjermanive. Kryeministri francez i kohës Rëne Pleven, ishte i ndërgjegjshëm se e vetme Franca nuk mund t'i bënte ballë riarmatimit gjerman. Vetëm nëpërmjet bashkëpunimit me ushtrinë gjermane, ata mund t'i bënin ballë suksesshëm një sulmi eventual nga Bashkimi Sovjetik. Njëloj si

Shuman, Plevni mendonte se ishte më mirë të bashkoheshin me Gjermaninë sesa të luanin lojëra të vjetra për të parandaluar të pashmangshmen (Smyser, 1999:111).

Plevni që më 24 tetor 1950, kishte hartuar planin për përfshirjen e ushtrisë së re gjermane brenda kuadrit të sistemit evropian të mbrojtjes (Smyser, 1999:111). Plani i tij ishte të krijonte EDC-në (European Defence Community) në të cilin gjermanët do të kishin oficerët dhe trupat e tyre, por asnjë rol komandues. Gjermania perëndimore nuk do të kishte ushtrinë e saj jashtë NATO-s (McGeehan, 1971:passim). Plani i Plevnit gjeti mbështetjen edhe të ushtarakeve të lartë francezë. Të ndërgjegjshëm për dobësitë e tyre, ata e dinin se me një ushtri të pakontrolluar gjermane nuk kishin asnjë mundësi të fitonin. Më të ashpër në kundërshtimin e krijimit të ushtrisë së re gjermane, ishin vetë gjermanët. Vuajtjet e tyre gjatë Luftës II Botërore e justifikonin plotësisht refuzimin. Parrulla më e famshme atëkohë tek gjermanët që refuzonin krijimin e ushtrisë ishte 'Ohne Mich' (pa mua) (Smyser, 1999:111).

Kancelari Adenauer u përpoq t'i bindte bashkëkombosit e tij duke u thënë se armatimi ishte i nevojshëm pasi vetëm gjermanët mund ta mbronin vendin në kufirin e Rinit (Smyser, 1999:111). Ai gjithashtu bëri thirrje se vetëm rimatimi gjerman mund të rikthente sovranitetin e vendit. Kancelari ia bëri të qartë gjermanëve dhe aleatëve perëndimorë se Gjermania nuk do të merrte pjesë në EDC si një vend i pushtuar. Franca i kishte marrë siguritë e veta. Britanikët i mbështetën argumentet e Adenauerit. Fillimisht, amerikanët hezituan, por në fund pranuan. Gjermania po i rikthehej në kohë rekord familjeve të kombeve të qytetëruar.

Një vit pas nënshkrimit të traktatit të çelikut dhe qymyrit, RFGJ-ja firmosi për të hyrë në EDC. Traktati u nënshkrua në Bon më 25 maj 1952 dhe në historinë e marrëdhënieve

ndërkombëtare njihet me emrin 'Deutschlandvertrag (Traktati Gjerman) sepse ishte njohja e parë ndërkombëtare e vendit pas përfundimit të Luftës II Botërore (Smyser, 1999:112). Në këmbim të rikthimit gjerman, aleatët i kërkuar Adenauerit besnikëri. SHBA-ja dhe Britania e Madhe u shprehën qartësisht se dëshironin një RFGJ të bashkuar qartësisht me perëndimin. Neutraliteti i RFGJ-së do të ishte i papranueshëm (Schwartz, 1991:247). RFGJ-ja nuk mund të aplikonte më politikën bismarkiane "lindja kundër perëndimit' apo të firmoste një traktat si ai Rapallo më 1922 që i bënte marrëdhëniet gjermano-sovjetike të veçanta (Schwartz, 1991:247).

Adenaueri kishte vepruar me hapin e kohës. Që nga vitit 1952, aleatët perëndimorë do ta shikonin RFGJ-në si një aleat të pazëvendësueshëm ekonomik, politik dhe ushtarak. Integrimi i RFGJ-së në Evropën perëndimore u bë i plotë. Gjysma tjetër e vendit nuk mundi të ecte me këtë hap duke mbetur shumë prapa. Ironia e momentit ishte se duke dashur të ndryshonte hartën e Koresë, Kim Il-sungu kishte ndryshuar për mirë hartën e Evropës. Lideri gjermano lindor Valter Ulbriht e kuptoi rëndësinë e situatës. Duke ndjerë rrezikun e boshatisjes së vendit, ai urdhëroi ndërtimin e një vije të mirë vëzhguar përgjatë të gjithë kufirit me RFGJ-në. Askush nuk mund ta kalonte atë, as nëpërmjet vdekjes. Kullat e ndëtuara nga policia i shërbënë pikërisht izolimit gjermano lindor (Schwartz, 1991:247). Gjermano perëndimorët po fillonin të shijonin frytet e para të lirisë dhe rrjedhimisht të prosperitetit ekonomik. Evropiano-Lindorët do të zhyteshin edhe më thellë në varfëri.

#### **5.4. Lufta e Koresë**

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik nuk do të ndesheshin asnjëherë ballë për ballë ushtarakisht kundër njëri tjetrit. Vende të dyta dhe të treta në mbarë rruzullin tokësor do të shërbën si "mish për top" në garën ndërmjet dy superfuqive për supremaci. E tillë do të ishte situata edhe në gadishullin korean. Trupat amerikane do ta gjenin veten e tyre të ngërthyer në një konflikt shumë larg territorit amerikan. Situata gjeopolitike në lindjen e largët nuk ishte pozitive për Amerikën. Themelimi i Republikës Popullore të Kinës nga Mao Ce Duni më 1 tetor 1949, ndryshoi kryekëput strategjinë amerikane në Azi. Bashkimi Sovjetik do të kishte një aleat të ri dhe shumë të fuqishëm në garën për dominimin botëror. Kryetari i ri kinez nuk humbi kohë për t'u lidhur me Bashkimin Sovjetik. Më 16 dhjetor 1949, Mao Ce Duni bëri vizitën e tij të parë zyrtare në Moskë (Kissinger, 2011:113).

Që në takimin e parë me Stalinin, lideri kinez u shpreh se 'Kina kishte nevojë për një paqe nga 3 deri në 5 vjet që të mund të rikthente ekonominë e vendit në gjendjen e para luftës' (Kissinger, 2011:113). Udhëheqësi kinez nuk e mbajti fjalën. Pas shtatë muajsh, trupat ushtarake kineze do të gjendeshin në krahun e ushtarëve të Koresë së Veriut kundër amerikanëve. Asokohe udhëheqësi i Koresë së Veriut ishte Kim Il-sung, një komunist i bindur në drejtësinë e "stalinizmit". Lideri e korean e ndjente se me kthimin e Kinës në komuniste padyshim që presitigji, autoriteti dhe forca e tij do të rritheshin dhe si rrjedhim komunizmi në Azi do të triumfonte. Por, shpikësi i stalinizmit, Stalini, nuk e mendonte në të njëjtën mënyrë. Udhëheqësi sovjetik si një pragmatist i regjur në çështje ndërkombëtare, lindjen e Kinës komuniste e shikonte më shumë si kërcënim strategjik sesa si aleancë jetëgjatë. Pas acarimit me liderin jugosllav Josip Broz-Tito, Stalinit nuk i duhej edhe një

tjetër acarim brenda kampit sovjetik. Në Azi, për momentin Stalini nuk do të lejonte një çarje të kampit. Ai e kuptonte fare mirë domethënien e një Kine komuniste. Qëllimi i tij kryesor ishte që të manipulonte pasojat që mund të kishte ky vend në politikat e Bashkimit Sovjetik dhe të përfiton nga impakti i Kinës së re në Azi.

Me Mao Ce Dunin, Stalini nuk do ta kishte të lehtë. Lideri kinez ia kishte dalë mbanë që t'i mbijetonte luftës civile duke refuzuar ndihmën sovjetike. Ishte e qartë se bashkëpunimi ndërmjet dy liderëve diktatorialë nuk do të ishte i lehtë. Maoja kishte informacion mbi kërkesat e Stalinit se gjatë Konferencës së Jaltës në shkurt të 1945-ës u kishte kujtuar aleatëve perëndimorë të drejtat e Rusisë në bazën detare të Lushunit (ish Port Arturi i vjetër), në Mançuri dhe në gjirin e Dalianit. Madje lideri sovjetik kishte shkuar aq larg sa këto "kujtesa" i kishte kthyer në kushte për të hyrë në luftë kundër Japonisë (Kissinger, 2011:115). Padyshim, Stalini dhe Maoja ishin dy makiavelistë të rangut më të lartë. Stalini kishte më shumë eksperiencë se Maoja në çështjet ndërkombëtare dhe për pak kohë ishte më i fuqishëm se ai. Maoja kishte më shumë fuqi se Stalini në kuptimin gjeopolitik çka i jepte një vetëbesim të lartë. Duke qenë se ishin dy strategë të mëdhenj, ishin krejtësisht të vetëdijshtëm se herët a vonë vendet e tyre do të përfundonin në përplasje.

Pas disa pazaresh jo të lehta për Maon për t'u kapërdirë, Stalini lëshoi pe dhe ra dakord për një traktat aleance me të. Megjithatë, ai insistoi që bazat e Lushunit dhe Dalianit të mbeteshin baza sovjetike derisa të nënshkruhej paqja e plotë me Japoninë. Më 14 shkurt 1950, Bashkimi Sovjetik dhe Kina nënshkruan traktatin e miqësisë, aleancës dhe ndihmës së ndërsjellë (Kissinger, 2011:117). Në rast të një luftë me një fuqi të tretë, secila palë ishte e detyruar të ndihmonte palën tjetër. Me këtë traktat, Stalini mendoi se e futi në kurth Maon, por në fakt ishte udhëheqësi kinez ai që përfitoi më shumë nga aleanca. Kjo për një

fakt të thjeshtë; kufijtë e Kinës do të ishin të sigurtë. Fillimisht, u duk se Stalini ia kishte "ngecur" Kinës. Me nënshkrimin e kësaj aleance, Kina ishte e detyruar t'i jepte me koncession BS-së minierat, hekurudhat në Mançuri dhe Ksinjang. Gjithashtu, Kina ishte e detyruar të njihet pavarësinë e Mongolisë periferike dhe t'i jepte Stalinit bazën e Dalianit. Maoja nuk hezitoi t'i thoshte Hrushovit se kjo aleancë e kishte kthyer Kinën në një gjysëm koloni të Bashkimit Sovjetik (Kissinger, 2011:117).

Në fakt, asnë lidër rus nuk mund të anashkalonte faktin se kufiri ndërmjet Bashkimit Sovjetik dhe Kinës kishte një gjatësi prej 2 mijë miljesh (3000 kilometra). Popullsia e Kinës ishte rrreth 6 herë më e madhe se ajo e Bashkimit Sovjetik. Edhe po t'ia maste me pe kokën Maos, Stalini duhej të ishte i ndërgjegjshëm se lideri kinez nuk do t'i lëshonte asnjëherë rrugë kur të vinte momenti për përparësinë ideologjike.

Tek lindja e Kinës komuniste, Shtetet e Bashkuara të Amerikës panë një potencial të ri për ta përdorur kundër Bashkimit Sovjetik pa ndryshuar ideologjinë. Sekretari i Shtetit Din Acheson e përmblodhi në një mënyrë shumë origjinale situatën në Azi. Tre piketat thelbësore të politikës amerikane të kohës në atë kontinent do të ishin:

1. *Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kishin larë duart nga lufta civile kinezë.*
2. *Nacionalistët kinezë kishin treguar paqfësi të pamatë në këtë luftë.*
3. *Komunistët nuk ishin fajtorë për gjendjen e Kinës dhe me shkathtësi kishin shfrytëzuar situatën. Çan Kai Shia tashmë ishte një refugjat i cili ia kishte mbathur me mbeturinat e forcave të tij në një ishull të vogël përballë brigjeve të Kinës* (Acheson, 1950:113).

Me këto manovra gjeopolitike, po lindte një realitet i ri i cili do të pagëzohej me përplasjen në Kore. Koreja kishte qenë një pikë kyçe në krizat aziatike për thuajse 100 vjet. Në vitet e luftës ruso-japoneze 1904-1905, Koreja u kthye në një shesh beteje ndërmjet dy fuqive se kush do ta kontrollonte atë. Lufta përfundoi me fitoren e Japonisë dhe tre vjet më pas më 1908, Japonia e fshiu Korenë nga harta (Kissinger, 2002:127). Deri në vitin 1945, Koreja ishte një koloni japoneze dhe u çlirua nga aleatët. Gjysma veriore e Koresë ishte pushtuar

nga Bashkimi Sovjetik, gjysma jugore nga Shtetet e Bashkuara (Kissinger, 2014:288). Secila palë vendosi formën e vet të qeverisjes në zonën e vet të pushtimit. Duke marrë shkak nga tërheqja e forcave amerikane nga Koreja e Jugut në qershor 1949, Kil Il-sung-u u përpoq gjatë të gjithë vitit 1949 dhe gjysmës së parë të vitit 1950, të bindte Stalinin dhe Maon për të ndërmarrë një invazion në shkallë të gjerë në jug (Kissinger, 2011:123). Stalini i kërkoi Maos mendim lidhur me planin e liderit koreano verior. Maoja argumentonte se një gjë e tillë nuk mund të bëhej pa u çliruar e tërë Kina (lideri kinez kishte parasysh marrjen e Tajvanit dhe dënimin e Çai Kai Shisë). Ishte pikërisht ky qëndrim i Maos që shërbeu si nxitje për Kim Il-sung-un për të avancuar projektin e tij. Lideri korean ishte i bindur se amerikanët nuk do të lejonin dy fuqi komuniste të bashkëjetonin njëra me tjetrën. Një fuqi e tretë do të ishte e papranueshme. Me fitoren e tij dhe kthimin e të gjithë gadishullit korean në komunizëm, aleanca sovjeto-kino-koreane do të përbyste raportin e forcave në Azi dhe rrjedhimisht, trupat amerikane do të kthehen në shtëpi.

Deri në vitin 1941 dhe më pas deri më 1945-ën, Stalini kishte qenë një udhëheqës që gjithmonë i kishte hequr gështenjat nga zjarri me duart e të tjerëve. Pas vizitës së Kim Il-sungut në Moskë në prill të 1950-ës, Stalini kishte hapur dritën jeshile për planin e liderit komunist korean (Kissinger, 2011:123). Bashkimi Sovjetik nuk do të hynte në luftë. Si përherë, udhëheqësi sovjetik do të priste për ecurinë e luftës dhe pastaj do të merrte një vendim. Edhe pse ishte i vendosur të priste, një dokument i kohës vërteton bindjen e Stalinit se as Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do të ndërhynin (Kissinger, 2011:124). Kjo lidhej me faktin se tashmë Bashkimi Sovjetik kishte ndërtuar bombën e vet atomike, çka e bënte vetëpërbajtjen amerikane të detyrueshme. Por, ka edhe një hollësi tjetër që vlen të përmendet në këtë çështje. Stalini nxiti Maon të ndihmonte hapur Kim Il-sungun për

të arritur synimin e tij. Ky do të ishte gabimi i vetëm i Maos në marrëdhëniet ndërkontebtare. Ndërhyrja kineze nxiti angazhimin e fortë amerikan për të mbrojtur gjysmën e gadishullit korean dhe mbi të gjitha për të përforuar pavarësinë e Tajvanit dhe për ta njojur atë ishull si përfaqësuesin e të gjithë Kinës. Ky qëndrim amerikan do të mbetej i pandryshuar deri më 25 tetor 1971 kur Kina do të pranohet me të drejta të plota në OKB. (Boriçi, 2016:258). Duke marë "bekimin" e Stalinit për ndërhyrje, më 25 qershor 1950, trupat koreano veriore kaluan paralelin 38° (Boriçi, 2006:149).

Shtetet e Bashkuara të Amerikës i mahnitën të gjithë me qëndrimin e tyre. Kombet e Bashkuara i dhanë dritën jeshile veprimit amerikan. Forca e ndërhyrjes amerikane i shastisi komunistët. Duke ndjerë rrezikun, Kina në fund të korrikut 1950, kishte përqëndruar në kufirin korean 250 mijë trupa (Kissinger, 2014:291). Në një mbledhje të 4 gushtit 1950 në Byronë Politike, Mao Ce Duni u shpreh:

*"Nëse imperialistët amerikanë dalin fitimtarë, ata do të trallisen nga suksesi dhe do të janë në një pozitë për të na kërcënuar. Ne duhet ta ndihmojmë Korenë. Kjo mund të bëhet me anën e një force vullnetare dhe kur ta vendosim ne, por na duhet të përgatitemi"* (Zhihua, 2012:140).

Maoja kishte të drejtë. Kongresi amerikan ratifikoi kërkësen e MekArturit (gjeneralit amerikan në krye të forcave) për të kaluar paralelin 38 (vija kufitare ndërmjet dy Koreve) madje, të avanconte deri në brendësi të kufirit kinez (Kissinger, 2014:291). Për Maon, ky veprim ishte më shumë se një kërcënim. Amerikanët shkuan edhe më tej. Flota e 7-të amerikane u pozicionua në mes Kinës dhe Tajvanit për të parandaluar një agresion të mundshëm kundër ishullit. Lufta e Koresë tregoi edhe një herë për vendosmërinë amerikane për të mbrojtur të gjithë ato vende që kërcënoheshin nga agresioni komunist. Shtetet e Bashkuara të Amerikës po ndiqnin me besnikëri doktrinën Truman. Presidenti

amerikan më 12 mars 1947 kishte deklaruar frazën e mëposhtme që do të quhej ndryshe edhe doktrina me emrin e tij:

*"Unë mendoj se duhet të jetë politika e Shteteve të Bashkuara për të mbështetur popujt e lirë që po i rezistojnë presioneve të jashtme. Çdo sulum ndaj miqve të SHBA-ve është sulum kundër SHBA-ve"* (Weiner, 2007:22).

Gadishulli korean konsiderohej si një pikë strategjike edhe në shekujt e mëparshëm. Në vitin 1593, gjenerali japonez Tojotomi Hideyoshi (Toyotomi Hideyoshi) kishte sulmuar vendin për ta kthyer në zonë japoneze kur ndodhej nën sundimin e Kinës (Kissinger, 2014:292). Maoja filloi të zbatonte një strategji që e kishin aplikuar gjeneralët kinezë në ato vite, tërheqjen për ta detyruar armikun të futej thellë në tokë. Por, kohërat kishin ndryshuar. Teknologja kishte bërë të vetën. Në fakt, tek amerikanët pati disa mosmarrëveshje ndërmjet gjeneralit në terren MekArtur dhe shefave të shtabit të përgjithshëm. MekArturi dëshironë fitore të plotë. Shtabi i përgjithshëm me ndihmën e administratës politike në Uashington dëshironë thjesht të rivendosej status quo-ja. Duke parë rritjen e mosmarrëveshjes, presidenti Truman më 11 prill 1951, e liroi nga komanda gjeneralin MekArtur (Kissinger, 2014:293). Duke qenë se kishin kaluar një provë të vështirë në Berlin, shefi i shtabit të përgjithshëm, gjenerali Omar Bredli (Bradly) shqiptoi frazën e famshme që u shfrytëzua nga liberalët në SHBA:

*"Luftë e gabuar, në vendin e gabuar, në kohën e gabuar dhe kundër armikut të gabuar"* (Kissinger, 2014:293).

Suksesi i pjesshëm amerikan i kishte dhënën të drejtë vetëpërbajtjes së Stalinit dhe humbjes së Maos. Deri në atë moment, lideri kinez ngatërronte paqen me luftën duke i konsideruar pjesë të së njëjtës medalje. Qëndrimi amerikan ishte ndryshe. Sipas amerikanëve lufta dhe paqja ishin faza të ndryshme të politikës. Kur fillonin bisedimet, përdorimi i forcës pushonte dhe diplomacia triumfonte. Edhe një herë u dëshmua se e drejta e pambështetur në forcë është e destinuar të humbasë. Stalini e kishte kuptuar pasi për herë

të dytë brenda dy vjetësh ishte dëshmitar i forcës amerikane. Ai e kuptoi se nuk mund të tolerohej, as në Evropën perëndimore, veçanërisht në Gjermani dhe, as në ndonjë pjesë tjetër të globit. Udhëheqësi sovjetik ishte i detyruar të vetëpërmbahej.

### **5.5. Ndërtimi i ushtrisë gjermane (Bundeswehr)**

Ngjarjet dramatike në Azi u priten me ankth të madh në botë. Sulmi koreano verior, e bindi presidentin amerikan Herri Truman që të ndërmerrte hapa konkretë për mbrojtjen e të gjithë botës së lirë në çdo cep të planetit. Lufta e komunistëve në Kore, nuk kishte sesi të mos ndikonte në ngjarjet në Gjermaninë e ndarë. Valter Ulbrihti dëshironte të përdorte sulmin korean për të bindur të gjithë gjermanët se fitorja e komunistëve në Kore dhe jo vetëm aty ishte e afërt (Smyser, 1999:106). Për të qenë sa më bindës, ai bëri lidhje mes situatës së Koresë dhe Gjermanisë. Në një konferencë të mbajtur në gusht të vitit 1950, ai bëri thirrje të hapur për likujdimin e Gjermanisë perëndimore dhe nxori si shembull sulmin e Koresë së Veriut kundër Koresë së Jugut. Ai u bëri thirrje gjermano-perëndimorëve që të bëhen në gati të mbështesnin Bashkimin Sovjetik (Loth, 1994:479). Si për të qenë në koherencë me komunistët gjermanë, Bashkimi Sovjetik doli me një deklaratë duke cituar shembullin korean që të ndiqej nga gjermanët (Loth, 1994: 479).

Gjermanët dhe berlinezët e perëndimit u drodhën nga frika. Ata që banonin në zonat kufitare u përgatitën për t'u larguar. Forcat ushtarake amerikane filluan përgatitjet në shkallë të gjërë. Këto veprime u ndërmorën për të siguruar publikun gjerman se amerikanët nuk do ta braktisin Gjermaninë. Gjermania po jetonte në një gjendje ankthi pasi mendohej se Stalini mund të niste Luftën e Tretë Botërore. Më 30 shtator 1950, presidenti Truman lëshoi urdhrin e sigurisë kombëtare NSC 68 për të riaktivizuar programet e mbrojtjes në

gjendje të menjëhershme për katër ose pesë vitet e ardhshme (May, 1993:14). Presidenti Truman i tronditi të gjithë politikanët kur u shpreh se Evropa perëndimore nuk mund të mbrohej pa trupat gjerman (May, 1993:15). Kur Trumani fliste në këtë mënyrë, trupat koreano veriore kishin kaluar paralelin 38° dhe amerikanët filluan përgatitjet për të ringritur ushtrinë gjermane. Ky akt do të haste patjetër në shumë vështirësi. Sekretari i Shtetit, Din Açosen, e dinte mirë se Franca nuk do të pranonte menjëherë krijimin e ushtrisë gjermane dhe rrjedhimisht anëtarësimin e Gjermanisë perëndimore në NATO. Në shtator 1950, Açoseni u takua me Bevinin dhe Shumanin në Nju Jork dhe u shpjegoi rëndësinë e integrimit të Gjermanisë në NATO nën komandën e gjeneralit Duajt Ajzenhauer, heroit të Luftës II Botërore. Të dy ministrat e jashtëm evropianë pranuan me ngurrim pasi ishin të pasigurtë për të ardhmen (Smyser, 1999:107).

Lideri sovjetik Jozef Stalin, nuk e kishte parashikuar këtë lëvizje amerikane kur i kishte dhënë leje Kim Il-sungut të sulmonte Korenë e Jugut. Librat e botuar së fundmi lidhur me këtë çështje, jepin drithë mbi taktikën e Stalinit për ta mbajtur luftën thjesht në terma aziatikë (Weathersby, 1993:30). Mesa dukej, Stalini kishte filluar të plakej dhe tensioni me të cilin kishte drejtuar dhe drejtonte Bashkimin Sovjetik padyshim kishte lënë gjurmët e veta. Ai gaboi përsëri në përllogaritjet e tij. Ndryshe nga udhëheqësi sovjetik, kancelari gjermano-perëndimor Konrad Adenauer, kishte kohë që kishte shfaqur idenë e një riarmatimi gjerman. Në dhjetor të vitit 1949, ai ishte shprehur hapur në një intervistë se duhej mbajtur në konsideratë ideja e një kontributi gjerman në ushtrinë evropiane nëse më e keqja mund të ndodhte (Bark, 1989:275). Edhe pse intervista e tij provokoi një kundërshtim të ashpër në Gjermaninë perëndimore ku një shumicë e konsiderueshme e hodhi poshtë këtë ide. Gjenerali Hans Shpajdel (Speidel) ish shefi i shtatmadhorisë së

Feldmarshallit të famshëm Ervin Romel, ishte një nga gjeneralët gjermanë që nuk ishte njollosur me krimë kundër njerëzimit dhe ishte një nga komplotistët kryesorë në atentatin të dështuar kundër Hitlerit më 20 korrik 1944. Shpajdeli ishte partizan i flaktë i anëtarësimit të Gjermanisë në NATO. Mendimin e tij, gjenerali e përmblodhi në një memorandum të cilit ia dërgoi kancelarit Adenauer. Kancelari u impresionua së tepërti dhe ka shumë mundësi që ky memoradum të ketë ndikuar në vendimin e tij (Smyser, 1999:108).

Adenaueri i kërkoi Shpajdelit dhe gjeneralëve të tjera që të bënin propozime konkrete për organizimin e ushtrisë gjermane. Në tetor 1950, kur sulmi koreano verior ishte në kulmin e tij, gjenerali Shpajdel propozoi krijimin e një force prej 500 mijë vetash të mbështetur me 12 njësi tankesh. Gjeneralët gjermanë shpresonin se do të gjenin mirëkuptimin e perëndimorëve për të ndërtuar një forcë të përbashkët për të ndalur një sulm të mundshëm sovjetik në perëndim. Kancelari Adenauer dhe gjeneralët perëndimorë ia kishin frikën rritjes së fuqisë së ushtrisë së kazermave gjermane të lindjes. Nëse Stalini ia kishte lejuar Koresë së Veriut të pushtonte jugun, çfarë do ta ndalonte liderin sovjetik të lejonte Ulbrihtin për të vepruar njëlloj si Kim Il-sung?

Pas sulmit koreano verior, Adenaueri u bind se riarmatimi gjerman nuk ishte vetëm i nevojshëm, por edhe i pashmangshëm. Ai e kërkonte riorganizimin e ushtrisë gjermane edhe për të ringritur statusin e Gjermanisë. Ai besonte se aleatët kishin nevojë për ushtrinë gjermane për të mbrojtur perëndimin dhe në këmbim do të fitonte sovranitetin e plotë të vendit. Ai kërkonte që ushtria gjermane të ndihmonte në integrimin evropian. Ai e konceptonte krijimin e ushtrisë gjermane në terma politikë dhe të sigurisë. Kancelari gjerman kërkonte barazi që më datë 21 shtator 1949 kur e kishte prezantuar kabinetin e tij qeveritar përpara komisionerëve të lartë perëndimorë (Smyser, 1999:108). Gjermanët e

ndjenin se aleatët do të silleshin me një ndjenjë të tepruar superioriteti ndaj tyre. Qeveria e Bonit nuk do të ishte asnijëherë e lirë në kuptimin e plotë të fjalës përsa kohë që komisionerët e lartë do të qëndronin në tokën gjermane. Adenaueri kërkonte që gjermanët të mos ndjeheshin inferiorë, por tmerret e luftës dhe përgjegjësia e popullit gjerman, për momentin ia bënин të pamundur një gjë të tillë. Moralisht, kancelari gjerman nuk ndihej inferior. Ai kishte qenë i burgosur nga nazistët dhe në burg i kishte vdekur edhe gruaja. Në mënyrë konstante ai kërkonte fuqi më të mëdha për Republikën Federale Gjermane.

Pas ngjarjeve në Kore, domosdoshmëria për një riarmatim gjerman ia bënin më të thjeshtë kërkeshën Adenauerit për barazi. Ai nuk do të pranonte që ushtria e re gjermane të ishte vasale apo mercenare. Aleatët e kuptuan se kancelari i fortë gjerman nuk do të lejonte një ushtri kukullash në mëshirë të tyre (Bird, 1992:317). Adenaueri i paraqiti dy memorandume komisionerit të lartë amerikan Xhon MekKlo (McCloy) më 30 gusht 1950 që t'ja paraqiste komisionit të ministrave të jashtëm të fuqive aleate (Smyser, 1999:109). Memorandumi i parë propozonte një kontribut gjerman për një ushtri të përbashkët evropiane dhe hidhte poshtë çdo nocion për një ushtri të veçantë gjermano perëndimore. I dyti, kërkonte t'i jepej fund statusit të pushtimit dhe gjermanët të ishin vetë zotër të vendit të tyre (Smyser, 1999:109).

Këmbëngulja e kancelarit u shpërblye. Aleatët perëndimore ranë dakord që Gjermania perëndimore të kishte Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe shërbimin e pavarur diplomatik. Gjithashtu, ata pranuan në parim edhe një kontribut gjerman në NATO. Presidenti Truman ra dakord që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të shtonin praninë e tyre në Gjermaninë perëndimore dhe kjo u bë për të siguruar Francën e cila pa këtë lëvizje nuk e jepte votën e saj për pavarësinë e Gjermanisë. Sulmi koreano verior i Kim Il-sungut kishte sjellë një

rezultat sa të papritur, aq të pakëndshëm për Stalinin dhe Ulbrihtin. Me një veprim të pamatur, Stalini kishte vënë përsëri në lëvizje industrinë e rëndë gjermane e cila do t'i sillte shumë përfitime në dekadat që do të pasonin Gjermanisë perëndimore. Mund të thuhet me plot gojën se lufta e Koresë i hapi derën "bumit" ekonomik gjerman duke forcuar pozitën e Adenauerit dhe të politikave të tij.

### **5.6. Hapi i fundit i Stalinit**

Duke parë avancimin evropian, udhëheqësi sovjetik Jozef Stalin pati frikë se EDC-ja do ta përfshinte RFGJ-në në strukturat e saj me kapacitet të plotë. Kjo do të thoshte se pas vitit 1945, trupat sovjetike do të kishin përsëri përballë ushtarë gjermanë. Stalini vendosi të vepronë shpejt. Ai e kishte kuptuar se kush do të mbështeste bashkimin e Gjermanisë do të fitonte edhe popullin gjerman (Smyser, 1999:113). Të vonohej për këtë projekt do të thoshte fund i supremacisë sovjetike edhe në anën tjeter të kufirit. Stalini e udhëzoi Molotovin të përgatiste një draft propozim me një formulë të besueshme lidhur me bashkimin e Gjermanisë. Ai donte që ky propozim të bëhej publik dhe të tërhqite vëmendjen e opinionit në RFGJ (Mastny, 1998:47).

Drafti që paraqiti Molotovi nuk i pëlqeu Stalinit. Ai e urdhëroi ministrin e tij të jashtëm të përgatiste një draft më të kompletuar dhe që të ofronte konkretisht bashkimin e Gjermanisë. Më 10 mars 1952, Stalini për habinë e perëndimit i ofroi gjermano perëndimorëve bashkimin aq shumë të dëshiruar prej tyre. Gjithashtu, me anë të zv/ministrat të jashtëm Gromiko, Stalini u dorëzoi një notë zyrtare fuqive të mëdha aleate në Gjermani. Termat e notës ishin si vijon:

1. Gjermania duhet të ribashkohet me kufijtë e përcaktuar nga Konferenca e Potsdamit.
2. Një qeveri e unifikuar gjermane do të përfaqësonte Gjermaninë në traktatin përfundimtar të paqes.
3. Të gjitha forcat e pushtimit do të tërhiqeshin brenda një viti të hyrjes në fuqi të traktatit të paqes.
4. Partitë dhe organizatat demokratike do të kishin liri të plotë në Gjermani.
5. Gjermania nuk do të bënte pjesë në asnjë koalicion ushtarak kundër fuqive fituese të Luftës II Botërore.
6. Gjermania do të kishte forcat e saj që do të shërbenin thjesht si mbrojtëse.
7. Gjermania do të lejohej të kishte fabrika të kufizuara armësh për forcat e saj mbrojtëse.
8. Gjermania do të kishte akses të plotë në tregjet ndërkombëtare.
9. Ish anëtarë të forcave të armatosura gjermane dhe të partisë naziste përvëç atyre që ishin dënuar për krime lufte, mund të përfshiheshin në restaurimin e një Gjermanie të lirë dhe demokratike (Boriçi, 2006:152).

Nota sovjetike ishte shumë joshëse dhe në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare është quajtur 'Nota e Stalinit'. Pështjellimi që kjo notë solli në Gjermaninë Perëndimore ishte i përmasave të paparashikuara. Kontrasti ishte i madh. Stalini kërkonte bashkimin e Gjermanisë, ndërsa politika sovjetike kishte çuar në ndarjen e vendit. Megjithatë, kishte disa pikë tek kjo notë të cilat gjermano perëndimorët nuk i pëlqenin. Gjermania nuk mund të lidhte aleancë kundër ish armiqve të saj të dikurshëm dhe kjo ishte një pengesë me të cilën Stalini donte ta mbante larg vendin nga përpjekja për integrim në organizatat

ndërkombëtare. Gjithashtu, edhe gjuha e përdorur në notë linte shumë hapësira interpretimi. Fjalët "e lirë" apo "armiqësore" ndaj çdo fuqie nuk i lejonin asnjë rrugë tjetër vendit. Dhe mbi të gjitha, çfarë forcash mbrojtëse do t'i lejoheshin Gjermanisë? Edhe EDC-ja mendonte se Gjermanisë i duhej një ushtri e vogël nëse do të inkuadrohej plotësisht në strukturat euro-atlantike dhe një e madhe nëse do të ishte vend neutral. Një ushtri e madhe gjermane do të tmerronte Francën, Bashkimin Sovjetik dhe Vendet e Ulta. Edhe kështu, këto vende e kishin të vështirë të pranonin trupa gjermane brenda kuadrit të EDC-së.

Duke parë pavendosmërinë e palëve, aleatët e kishin të vështirë të hidhnin poshtë notën e Stalinit. Integrimi i Gjermanisë duhej të vazhdonte dhe nota e Stalinit duhej refuzuar, por me çfarë arsyje? Sekretari amerikan i shtetit Din Açosen mendonte se bisedimet me Moskën do të ishin të pavlera nëse vihej në rrezik uniteti evropian në një kohë kaq kritike. Ai kishte frikë se mos Gjermania binte nën ndikimin e forcave sovjetike ndërsa lejohej bashkimi i vendit. Për më tepër, SHBA-të nuk mund të gjenin vend më të përshtatshëm për të patur bazat e tyre në zemër të Evropës si në Gjermani. Nota e Stalinit duhej hedhur poshtë patjetër (Smyser, 1999:115).

Ministri i jashtëm britanik Entoni Iden i cili ishte rikthyer në post së bashku me Çërçillin si kryeministër, mendonte njëlloj si Açoseni. Me Moskën duhej vijuar të ecej me hapa të kujdeshëm. Por, problemi më i madh qëndronte tek opinioni publik britanik i cili nuk e pranonte një ushtri të përbashkët evropiane. Madje, disa diplomatë britanikë dilnin hapur kundër integrimit evropian. Nota e Stalinit i kishte tunduar edhe ata (Smyser, 1999:115).

Shumani dhe qeveria franceze panë tek nota e Stalinit një element shumë të rrezikshëm. Ajo krijonte një Gjermani të bashkuar dhe një ushtri të pavarur gjermane. Për të kundërshtuar këtë kombinim, Franca duhej të mbante në këmbë në kufi një forcë të madhe

ushtarake me shpenzime marramendëse të cilën ajo nuk mund ta përballonte. Nota e Stalinit solli edhe një herë kompleksin e Rapallos që krijonte një Evropë të dominuar nga Gjermania dhe të mbështetur nga Rusia. Gjermania dhe Bashkimi Sovjetik do të marginalizonin Francën, Italinë dhe vendet e Beneluksit. Edhe pse Shumani kishte besim tek Adenaueri, qeveria franceze kishte frikë se mos opinioni publik në Gjermani e përkrahte fuqimisht notën e Stalinit.

Më 17 mars 1952, ishte vetë Adenaueri që i dha fund dilemave evropiane dhe amerikane. Ai u bë i pari lider gjerman që hodhi poshtë notën e Stalinit (Smyser, 1999:116). Edhe pse Stalini nuk ia kishte dërguar notën RFGJ-së, Adenaueri donte të shpëtonte pikëpamjet e tij. Asgjë nuk e tundte atë nga mendimi se RFGJ-ja duhej integruar plotësisht në strukturat euro-atlantike. Duke ndjerë pasigurinë e opinionit publik në vend, kancelari vendosi të demaskonte dyfytirësinë e notës së Stalinit. Dhjetë ditë para dërgimit të notës, më 1 mars 1952, në një fjalim të mbajtur në kongresin e CDU-së, kancelari e kishte parashikuar se Moska do të reagonte ndaj riarmatimit perëndimor duke deklaruar:

*"Kur perëndimi të bëhet më i fortë se Rusia Sovjetike, negociatat me ta do t'i kemi në dorë. Frika ndaj Gjermanisë do të largohet. Pastaj nuk do të jetë e vështirë t'i shpjegohet Rusisë Sovjetike se s'mund ta mbajë gjysmën e Evropës në skllavëri" (Smyser, 1999:116).*

Që të bëhej e mundur kjo, duhej akoma kohë. Aleatët perëndimorë ranë dakord. Ata as që e morën mundimin të diskutonin me Molotovin notën e Stalinit. Duke qenë se Stalini priste përgjigje, perëndimorët u mjaftuan duke bërë pyetje se ç'lloj qeverie do të kishte Gjermania e bashkuar (Smyser, 1999:116). Perëndimorët kërkonin zgjedhje të lira e të ndershme në të gjithë Gjermaninë. Ky ishte një luks të cilin Stalini me Ulbrihtin nuk do ta lejonin në Repubikën Demokratike Gjermane. Këmbimi i notave mes perëndimit dhe Bashkimit Sovjetik lidhur me notën e Stalinit zgjati gjashtë muaj. Në fillim të verës të vitit 1952,

Stalini e humbi interesin për të shkëmbyer nota. Më 28 maj 1952, Entoni Iden shpalli fitoren e perëndimit ndaj "betejës të notës së Stalinit" (Smyser, 1999:117). Udhëheqësi sovjetik nuk do t'i pranonte termat perëndimorë dhe perëndimi nuk do të pranonte të tijat.

As SHBA-ja as Evropa perëndimore nuk dëshironin të lejonin diktatin e Stalinit në Gjermani. RFGJ-ja e kishte të hapur rrugën për integrimin e saj të plotë në strukturat euro-atlantike. Perëndimorët ranë dakord njëzëri që të hidhnin poshtë notën e Stalinit (Smyser, 1999:117).

Çfarëdo qëllimi të vërtetë që duhej të kishte patur Stalini, nota e tij e forcoi akoma më shumë unitetin perëndimor. Disa gjermanë e panë atë si një ftesë të hapur për bashkim. Disa të tjerë si një mundësi për ta mbajtur jashtë Gjermaninë blloqeve kundërshtare. Disa analistë e akuzuan hapur kancelarin Adenauer se humbi një mundësi të artë për bashkimin e vendit. Koha i dha të drejtë kancelarit edhe pse social demokratët e perëndimit nuk kishin besim tek Stalini. Adenaueri e konsideronte notën e Stalinit si një kurth. Bashkimi i vendit do të bëhej në një të ardhme afatgjatë, jo për momentin. Ai mendonte se Gjermania e pasluftës kishte nevojë për demokraci që të forconte institucionet, më pas të mendonte për bashkimin. Dokumentet e botuara nga arkivat e Gjermanisë lindore nuk japid asnjë të dhënë se Stalini pas bashkimit të vendit do të bratiste politikat e tij në Gjermani. Interesat sovjetike kishin shkuar shumë larg në kontinent dhe nuk mund të kthehen mbrapsht (Smyser, 1999:118).

Në shtypin sovjetik të kohës nuk shprehej as edhe një fjalë e mirë për Amerikën dhe perëndimin. Si mendonte Stalini të bashkonte Gjermaninë duke njollosur në shtyp SHBA-të? Nota e tij nuk e zgjidhi dilemën gjermane në të cilën bashkimi do të arrihej vetëm po të largohej Ushtria e Kuqe nga RDGJ-ja. Një gjë e tillë nuk kishte shanse që të ndodhë, ndaj

edhe nota e liderit suprem sovjetik bëhej e pabesueshme. Ulbrihti ishte ai që menaxhonte politikën e Stalinit në RDGJ. Në fund të vitit 1952, lideri sovjetik e kuptoi se një Gjermani e bashkuar nukdo të ishte miqësore ndaj Bashkimit Sovjetik siç mund të kishte qenë në vitin 1945. Një Gjermani e bashkuar nuk i shërbente interesave të Rusisë Sovjetike.

### **5.7. Kryengritja e Berlinit dhe eleminimi i Berias**

Përpjekjet e Ulbrihitit për të rritur aftësinë prodhuese të RDGJ-së duke përshpejtuar socializmin dështuan keqas. Prodhami gjermano lindor ra në mënyrë drastike në vend që të rritej. Recesioni ishte i pashmangshëm. Në fund të vitit 1952 dhe në fillim të vitit 1953, ekonomia e Gjermanisë lindore rrezikonte falimentimin. Numri i refugjatëve që largoheshin nga lindja për në perëndim kapi shifrën e 100 mijë vetave (Smyser, 1999:119). Gjermanët as "vija e vdekjes" nuk i sprapste. Ky lajm tronditi lajmet botërore. Në një njoftim të Radio Moskës të 5 marsit 1953, u dha lajmi i trishtueshëm për të gjithë komunistët e botës se Jozef Stalini kishte vdekur. Padyshim që ishte një humbje e madhe për politikën sovjetike në përgjithësi. Shumë pikëpyetje u ngritën në perëndim se kush do të ishte ai burrë që do të zëvendësonte udhëheqësin suprem të vdekur. Kasta e mbetur e politikanëve sovjetikë jepte shumë pak shpresa për ulje tensionesh. Georgi Malenkov, kryetari i sekretariatit të partisë dukej se do të ishte zëvendësuesi. Por, dy ishin figurat qëndrore që luftonin fort për pushtetin absolut në Bashkimin Sovjetik; Vjaçesllav Molotovi dhe Lavrenti Beria.

Në fjalimin e ceremonisë mortore për Stalinin, Malenkov i shpreh se Bashkimi Sovjetik dëshironte marrëdhënie të mira me perëndimin, madje u dhanë instruksione për t'i dhënë fund luftës në Kore. Molotovi nuk ishte për ndryshim të kursit të Stalinit, ndërsa çuditërisht

Beria ishte për një fryshtë të re në marrëdhëniet ndërkombëtare (Smyser, 1999:119). Presidenti i ri Duajt Ajzenhauer i cili kishte zëvendësuar Herri Trumanin, dëshironte t'i jepë një shans paqes duke ulur tensionet ndërmjet lindjes dhe perëndimit. Sekretari amerikan i shtetit Xhon Foster Dallas e pa me dyshim këtë politikë të re të presidentit. Një nga qëllimet e presidentit amerikan ishte avancimi drejt bashkimit të Gjermanisë siç e ka përmendur edhe në kujtimet e tij (Eisenhower, 1963:143).

Fjalimi inagurues i Ajzenhauerit nuk i bindi sovjetikët. Madje ata e quajtën atë provokativ (Eisenhower, 1963:143). Malenkovi dhe Beria e panë me sy tjetër, më dashamirës ardhjen në pushtet të Ajzenhauerit. Ndërsa tek sekretari i shtetit Dallas ata bashkoheshin me kolegët e tyre. Imazhi i tij ishte tepër negativ për Bashkimin Sovjetik. Ndërkohë, Uinston Çërçilli ishte rikthyer si kryeministër i Britanisë së Madhe në vitin 1951. Miqësia e tij e hershme me Ajzenhauerin e shtynte të aplikonte një politikë të plotë Euro-Atlantike me Gjermaninë e bashkuar në qendër të saj (Eisenhower, 1963:144). Megjithatë, Britania e Madhe nuk do të hiqte dorë nga supremacia e saj në botë dhe Parisi e Boni nuk konsideroheshin të barabartë me të. Më 11 maj 1953, Çërçilli filloi të lëvizë duke kërkuar një takim të tre të mëdhenjve sipas stilit të vjetër për të diskutuar problemet në botë. Problemi aktual i Çërçillit ishte se nuk ofronte asnjë plan specifik për të ulur tensionet lindje perëndim (Smyser, 1999:120).

Franca nuk e përkrahu idenë e Çërçillit. Ajo kërkonte që së paku të organizohej një takim mes tre fuqive perëndimore si parapërgatitje për takimin me Moskën. Madje, as ministri i jashtëm Entoni Iden nuk e përkrahu idenë e kryeministrit të tij. Gjithashtu, edhe nga Moska erdhën refuzime (Smyser, 1999:120). Moska refuzoi, por nuk ofroi asnjë alternativë. Madje edhe politika e saj për Gjermaninë kishte rënë në stanjacion. Kriza ekonomike në

Gjermaninë lindore i acaroi edhe më shumë gjërat. Në fillim të prillit 1953, Ulbrihti i kërroi Moskës ndihma masive për të ndalur reçesionin dhe për të shpëtuar nga kolapsi RDGJ-në. Lidershipi i ri sovjetik që ende nuk e kishte zgjedhur kryetarin, nuk i besoi raporteve të Ulbrihitit dhe kërroi informacion më të detajuar. Kur informacioni erdhi siç e kerkuan, ata fajësuan Ulbrihtin dhe SED-in për krizën. Por, më e keqja sipas tyre qëndronte në faktin se 500 mijë njerëz ishin larguar nga lindja për në perëndim nga janari 1951 deri në prill 1953. Më shumë se 125 mijë gjermanë ishin dënuar për "krime masive ekonomike". 7% e tokës së punueshme ishte lënë djerrë pasi fermerët kishin iku (Smyser, 1999:121). Udhëheqësit e Bashkimit Sovjetik në mënyrë sekrete ranë dakord që të dënonin masivisht Ulbrihtin pasi me politikat e tij kishte vënë në rrezik ekzistencën e RDGJ-së. Madje puna shkoi deri aty sa u tha se vigjilanca ideologjike dhe politike nuk kishte sjellë forcimin e RDGJ-së. Sovjetikët listuan disa akuza mjaft të rënda ndaj Ulbrihitit. Sipas tyre ai kishte mbjellë frikë ndaj punëtorëve, fermerëve dhe rinisë duke sjellë natyrshëm numrin në rritje të refugjatëve. Po ashtu, ai e kishte tepruar me luftën e klasave (Smyser, 1999:121).

Duke u përballur me këtë realitet të trishtë në këshillin e presidiumit të Bashkimit Sovjetik, Beria dhe Molotovi më 27 maj 1953, u përplasën ashpër njëri me tjetrin dhe jo vetëm për Ulbrihtin. Beria argumentonte se lidershipi i RDGJ-së kishte dështuar turpshëm dhe në mënyrë të dukshme. Beria shkoi deri aty sa kërroi heqjen e Ulbrihitit dhe Grotewohlit. Shefi famëkeq i shërbimit sekret sovjetik me emrin e të cilit lidheshin mijëra viktima, bëri edhe një propozim tjetër që i la komunistët me gojë hapur. Duke parë rënien e lirë të RDGJ-së, ai propozoi që të pushonte së ekzistuari dhe të kthehej në një provincë të pavarur të RFGJ-së derisa të gjendej një zgjidhje përfundimtare (Smyser, 1999:121). Akoma edhe sot është i

pashpjegueshëm fakti se përse Lavrenti Beria, krimineli më famëkeq pas Stalinit kishte bërë një kthesë të tillë. Malenkovi, Molotovi dhe mbi të gjithë Hrushovi ishin kundër Berias. Kjo gjë mund të ketë çuar në komplotin e tyre për ta ekzekutuar.

Molotovi doli i pari hapur. Ai u shpreh se Bashkimi Sovjetik duhej të vazhdonte të ndërtonte socializmin në RDGJ, por jo nëpërmjet Ulbrihit (Smyser, 1999:122). Ai vijonte ta kundërshtonte bashkimin e Gjermanisë. Hrushovi, i cili synonte rolin e liderit, mbështeti pa hezitim Molotovin. Për liderin e ardhshëm, eliminimi i Berias përbënte përparësinë maksimale. Liderët sovjetikë vetëm në një pikë ranë dakord. RDGJ-ja duhej të ndryshonte kurs dhe shpejt madje. Qeveria sovjetike e distancoi veten nga Ulbrihti. Komisioneri i lartë sovjetik Semjonov u instruktua që të mbante lidhje më të ngushta me komisionerët perëndimorë dhe t'i përmbahej marrëveshjes së Potsdamit. Më 2 qershor 1953, Malenkoi nënshkroi një dekret që lejonte ndryshimin e kursit në RDGJ (Smyser, 1999:122). Ky dekret urdhëronte Ulbrihtin dhe Grotewohlin të ndryshonin kurs. Por, si do të ndryshohej ky kurs nuk shpjegohej. Çfarë duhej të kuptionin liderët gjermano lindorë me ndryshim kursi? Heqje dorë nga socializmi dhe kalim në kapitalizëm? Bashkim pa kushte me RFGJ-në? Vilhelm Zaiseri, ministri i brendshëm dhe shefi i STAS-it i cili ishte i lidhur kokë e këmbë me Berian, akuzoi hapur Ulbrihin se kishte shkaktuar një hendek të thellë ndërmjet partisë dhe popullit. Konfuzioni dukej se po dilte jashtë kontrollit. Ulbrihti dukej si i mpirë. Ai e dinte fort mirë se ç'fat e priste nëse humbte pushtetin e tij.

Më 16 qershor 1953, shpërtheu demonstrata e parë anti qeveri. Më 17 qershor ajo u bë e papërmbajtshme. Më shumë se gjysmë milion punëtorë gjermanë të lindjes dolën në sheshet e 400 qyteteve në të gjithë RDGJ-në. Punëtorët gjermanë kërkonin që t'u jepej fund jetesës së keqe dhe kushteve të tmerrshme të punës në vend. Duke dëgjuar me ëndje radion

amerikane në sektorin e Berlinit perëndimor, ata shpresonin edhe nga një ndihmë eventuale (Smyser, 1999:123). Sovjetikët u kapën në befasi. Vetëm kur u plasi në dorë demonstrata e parë anti komunizëm, e kuptuan sesa e rëndë ishte situata. Ata e kishin keqinterpretuar gjendjen. Sovjetikët mendonin se asnjëherë gjermanët nuk do të ngriheshin kundër tyre. Stalini ishte tallur duke thënë se pa dalë drita jeshile, gjermanët nuk e kalonin rrugën, ndërsa dikur Lenini thoshte se gjermanët nuk hipnin në tram pa blerë biletën (Smyser, 1999:124). Padyshim, një popull me rregulla të forta civilizimi e qytetarie i bënte për të qeshur liderët sovjetikë. Demonstrata tregoi brishtësinë e regjimit të Ulbrihitit, por në vend që të sillte rënien e tij, ia forcoi pozitat. Vërtet liderët sovjetikë kishin kërkuar heqjen e tij, por nuk kishin me kë ta zëvendësonin. Në fund të korrikut dhe në fillim të gushtit 1953, trupat sovjetike të mbështetura nga tanket dolën nëpër qytete. Perëndimi nuk bëri asgjë për të mbrojtur berlinezët lindorë. Ndoshta, ishte tepër herët për një konfrontim të hapur me komunistët. Bota nuk mund t'ja lejonte vetes një tjetër katastrofë botërore. Dëshira e Berias për një politikë të re në Gjermani u shua bashkë me të. Shtypja e kryengritjes së Berlinit lindor çoi edhe në rënien e Berias dhe të shokëve të tij në Moskë dhe RDGJ. Beria u akuzua për disfatizëm në një mbledhje të Byrosë Politike të datës 26 qershor 1953 dhe u ekzekutua brenda ditës. Gazeta Pravda, e raportoi vdekjen e tij më 24 dhjetor 1953 (Smyser, 1999:125). Molotovi dukej se kishte triumfuar, por në fakt fitimtari i vërtetë ishte Nikita Hrushovi.

Me ekzekutimin e Berias merr fund edhe tentativa e fundit e Bashkimit Sovjetik për një bashkim të Gjermanisë. Dështimi i notës së Stalinit dhe rezultatet perverse të përpjekjeve sovjetike për të moderuar përpjekjet e Ulbrihitit për të ndryshuar politikat e tij sollën një hendek të madh në politikat e BS-së. Pas fitores mbi Hitlerin, Stalini kishte shpresuar në

një Gjermani të bashkuar e cila do të mbështete politikisht dhe ekonomikisht Bashkimin Sovjetik. Tetë vjet pas lufte dhe me punëtorët gjermanë që bllokuan sheshet, liderësi sovjetik e kuptoi se vetëm Ushtria e Kuqe mund ta mbante në pushtet partinë komuniste të Gjermanisë lindore.

Ulbrihti dhe Molotovi kishin penguar planet e Berias. Spastrimi që lideri i RDGJ-së bëri në radhët e partisë ishte i tmerrshëm. Ai promovoi komunistin e ri Erih Honeker (Honecker) i cili i kishte dalë në krah. Po ashtu, ai vijoi me politikat e "rripit të shtrënguar". Mrekullia ekonomike e RFGJ-së nuk kishte vend në RDGJ. Dështimi politik i RDGJ-së ishte i plotë. Frazën më të bukur për këtë dështim e ka shkruar shkrimtari majtist Bertold Brecht që asokohe jetonte në lindje:

*"Populli ka humbur besimin tek qeveria. Përse qeveria nuk e heq qafe popullin dhe të zgjedhë një popull të ri" (Boriçi, 2019)?*

### **5.8. Gjermania perëndimore hyn në NATO dhe ndarja e Evropës**

Përpjekjet evropiane për të të ndërtuar një komunitet të përbashkët mbrojtjeje u vonuan për shkak të hezitimit francez. Dallasi ushtron te pareshtur presion, veçanërisht mbi Francën duke kërcënuar edhe me ndryshim të politikës amerikane nëse asambleja kombëtare franceze nuk ratifikonte EDC-në. Franca nuk mund ta pranonte këtë kërcënim pa patur siguri maksimale se Gjermania qoftë edhe e ndarë nuk do të përbënte më kërcënim për ekzistencën e saj. Ministri i jashtëm britanik Entoni Iden pati frikë se mos EDC-ja dështonte dhe filloi të punonte një plan të veçantë për këtë (Eden, 1960:61).

Kryeministri i ri francez, Pier Mendes-Frans, vendosi që Franca të mos e shtynte për më tutje vendimin e saj. Ai e solli projektin e EDC-së përpëra asamblesë kombëtare më datë 30 gusht 1954. Parlamenti francez e hodhi poshtë dhe tashmë aleatëve iu desh të punonin për

të gjetur një mënyrë tjetër për të bindur Francën. Dallasi u ndje tepër i zhgënjer dhe nuk e fshehu, edhe pse në Uashington po punohej për të gjetur një formulë më bindëse (Guhin, 1972:219). Ministri i jashtëm britanik Entoni Iden u kthye në njeriun kyç të zhbllokimit të situatës. Ai mendonte se Trakatai i Brukselit i cili kishte themeluar Bashkimin Perëndimor Evropian, mund të trasnformohej duke futur RFGJ-në në sistemin perëndimor ushtarak dhe në NATO. Me aprovimin e Çërcillit, ai iu vu punës për ta tejkaluar këtë pengesë (Eden, 1960:174).

Ideni konsiderohej një mik i mirë në kryeqytetin e RFGJ-së. Kancelari Adenauer dëshironte që vendi i tij të integrohej plotësisht në strukturat perëndimore. Përsa i përket çështjeve ushtarake, ai preferonte që forcat gjermane të ishin të integruara brenda sistemit evropian të mbrojtjes. Për të arritur këtë synim, ai ishte gati t'i bënte Francës të gjitha lëshimet që kërkonte ajo. Në RFGJ dhe në Itali, misioni i Idenit ishte i thjeshtë. Tjetër histori e priste ministrin britanik në Francë. Kryeministri francez i tha hapur se Franca nuk do të lejonte ushtri të veçantë gjermane edhe brenda NATO-s pa garancitë e duhura. Me këtë, kryeministri francez donte të thoshte se Franca nuk ishte gati të përballej edhe një herë e vetme me Gjermaninë (Eden, 1960:175).

Si për t'ja komplikuar akoma më shumë punën Idenit, sekretari amerikan i shtetit Dallas e paralajmëroi se Kongresi amerikan do të binte dakord të mbante trupa ushtarake në Evropë vetëm nëse evropianët binin dakord të integroheshin ushtarakisht ndërmjet tyre duke i dhënë fund lojërave nacionaliste (Guhin, 1972:222). Edhe pse Dallasi mbështete hapur misionin e Idenit, Kongresi në SHBA ishte përherë e më skeptik. Më 28 shtator 1954, në konferencën që u mbajt në Londër, Ideni shpalosi të njëjtin premtim siç kishte bërë presidenti Herri Truman pas luftës së Koresë (Eden, 1960:178). Trupat amerikane do të

qëndronin në Evropë, por kjo varej vetëm nga evropianët dhe integrimi ndërmjet tyre. Qëndrimi britanik qetësoi Francën. Britania e Madhe do të qëndronte në Evropë me një forcë ushtarake për të ekuilibruar gjermanët dhe për të bindur amerikanët se trupat e tyre nuk do të ishin të vetmet që do të siguronin kontinentin (Eden, 1960:178). Qëndrimi i vendosur i Idenit e bindi Mendes Fransin se më në fund do të arrihej një marrëveshje dhe asambleja kombëtare në Francë do të binte dakord me këtë plan. Konferanca ia ndaloi RFGJ-së që të ndërtonte bombën atomike, armë bakteriologjike dhe armë kimike. Por, të bindje popullin gjerman se do të ndërtonte edhe një herë një ushtri, ishte një mision thuajse i pamundur. Ambasadori amerikan në Bon, Xhejms B. Konant (Conant) e pa veten në një situatë ironike kur iu desh të bindte popullin gjerman që të armatosej kur e kishte kundërshtuar gjithë jetën fuqinë ushtarake gjermane (Hershberg, 1993:675).

Më 20 tetor 1954, në Paris, aleatët nënshkruan traktatin që zgjeronte Bashkimin Perëndimor Evropian dhe e bënte partner të NATO-s. Traktati ftonte RFGJ-në t'i bashkohej aleancës. Kjo ishte një arritje e madhe për kancelarin Adenauer pasi i jepte zyrtarisht fund pushtimit të perëndimit. Në konferencë u ra dakord që krahina e Saarës t'i kthehej RFGJ-së më 1 janar 1957 (Guhin, 1972: 219). Kur asambleja kombëtare në Francë e votoi planin më 29 dhjetor 1954, beteja për Gjermaninë ndryshoi. RFGJ-ja u kthyte në një aset të rëndësishëm për Evropën perëndimore dhe strukturat atlantike. Kishte sovranitet të plotë dhe shumë pak kufizime. Sekretari amerikan i shtetit i mirëpriti ngjarjet. Amerikanët e kishin arritur synimin e tyre. Një Evropë perëndimore të bashkuar ushtarakisht që përfshinte në të RFGJ-në dhe praninë amerikane si forcën kryesore të sigurisë.

Ndërsa perëndimi forconte strukturën e vet të sigurisë, Bashkimi Sovjetik e futi RDGJ-në në sistemin e vet ushtarak. Më 14 maj 1955, RDGJ-ja u pranua në Traktatin e Varshavës

dhe Bashkimi Sovjetik njohu përfundimisht pavarësinë e Gjermanisë lindore në shtator (Smyser, 1999:129). Ky hap ishte në logjikën e Hrushovit dhe Molotovit që kërkonin të mbanin Gjermaninë të ndarë pasi nuk mund të pengonin integrimin e RFGJ-së në strukturat euro-atlantike. Megjithatë, në konferencën e Gjenevës që u mbajt në korrik 1955, delegatët e fuqive fituese duke filluar nga presidenti amerikan Ajzenhauer, kryeministri i ri francez Edgar Fore (Faure) dhe liderët sovjetikë Nikita Hrushov dhe Nikolaj Bulganin, firmosën një dokument ku thuhej:

*"Kryetarët e qeverive bien dakord se rregullimi përfundimtar i çështjes gjermane dhe bashkimi i Gjermanisë do të ndodhë me vullnetin e popullit gjerman me zgjedhje të lira konform interesave evropiane të sigurisë"* (Eisenhower, 1963:319).

Sigurisht nuk bëhej fjalë që kjo gjë të ndodhët sa hap e mbyll sytë. Duhej të kalonin 35 vjet që vullneti i përbashkët i të dy Gjermanive të bëhej realitet. Këtë gjë, Ajzenhaueri dhe Dallasi e dinin fort mirë. Për zgjedhje të lira, sovjetikët as që donin t'ja dinin. Në kthimin e tij nga Gjeneva, Hrushovi u ndal në Berlinin lindor ku riafirmoi vendosmërinë e tij për ta mbajtur të ndarë Gjermaninë në dy shtete. Në konceptin e tij, bashkimi i vendit do të ndodhët vetëm nëse do të krijohej sistemi kolektiv evropian i sigurisë në marrëveshje direkte ndërmjet dy Gjermanive). Nga ana e tij, kancelari Adenauer nëpërmjet kanaleve dytësore, por edhe nëpërmjet deklaratave publike, kërkonte bashkimin e Gjermanisë, por asnjëherë nuk do të pranonte një Gjermani jodemokratike. Më 19 mars 1958, kancaleri shkoi larg duke u takuar në mënyrë sekrete me ambasadorin sovjetik në Bon, për t'i kërkuar një status neutral të RDGJ-së sipas modelit austriak, deri në bashkimin e plotë të vendit (Smyser, 1999:130).

Nga ana tij Ulbrihti mendonte njëlloj si Hrushovi. Ai thoshte se bashkimi do të ndodhet vetëm nëpërmjet bisedimeve direkte lindje-perëndim. Më 30 nëntor 1956, gazeta zyrtare e

partisë komuniste të RDGJ-së Neues Deutschland (Gjermania e Re) propozoi të ndërtohej një konfederatë ndërmjet dy shteteve gjermane. Edhe këtë kërkesë Adenaueri e hodhi poshtë njëlloj si notën e Stalinit sepse e detyronte të njihte RDGJ-në dhe nuk lejonte zgjedhje të lira atje (Von Siegler, 1957:55). Përgjatë viteve, lindja dhe perëndimi do të vijonin me shkëmbimin e notave diplomatike ku në qendër do të ishte bashkimi, por asgjë nuk do të ndodhte deri në vitin 1990. RFGJ-ja dhe RDGJ-ja do të mbanin lidhje të ngushta tregtare edhe pse zyrtarisht nuk kishin njohje reciproke. RDGJ-ja tregtinë me RFGJ-në e quante tregti të jashtme, ndërsa RFGJ-ja jo. Gjermania Federale e mbështeti shumë ekonominë e RDGJ-së duke ia lehtesar edhe pagesat. Nga ky fakt përfitoi shumë edhe Bashkimi Sovjetik.

RFGJ-ja nuk e njihte RDGJ-në pasi sipas saj ajo nuk shprehte aspiratat e popullit gjerman. RFGJ-ja aplikonte doktrinën Hallshtajn (mori këtë emër sipas sekretarit të shtetit në zyrën e jashtme të Gjermanisë, Valter Hallshtajn (Hallstein) (Smyser, 1999:131). Sipas kësaj doktrine, Gjermania Federale e shikonte si akt jo miqësor ndaj saj nëse shtetet e tjera njihnin zyrtarisht RDGJ-në. Adenaueri mund të injoronte RDGJ-në, por s'mund të injoronte Bashkimin Sovjetik. Shumë të burgosur lufte gjermanë gjendeshin ende në BS. Moska e kishte ndalur riatdhesimin e tyre më 1950 (Smyser, 1999:131). Asnjë kancelar gjerman që dëshironë të kishte një politikë të jashtme të pavarur nuk mund të kishte marrëdhënie me Moskën nëpërmjet palëve të treta. As Bashkimi Sovjetik nuk mund ta shpërfillte RFGJ-në sepse që nga mesi i viteve '50 ishte kthyer në një yll të shndritshëm evropian, ndërsa RDGJ-ja akoma po lëpinte plagët e kryengritjes së 1953-it.

Marrëdhënet e Adenauerit me Hrushovin nuk ishin të qeta. Në jo pak raste bisedimesh të hidhura, Hrushovi i qunte gjermanët si pasues të Hitlerit, ndërsa Adenauri i kujtonte se

kishte qenë Bashkimi Sovjetik që kishte nënshkruar marrëveshjen me nazistët për pushtimin e Polonisë më 1939. Adenaueri kritikonte sjelljen e ushtarëve sovjetikë në Gjermani. Hrushovi pa delikatesë i kujtonte sjelljen e ushtarëve gjermanë në Bashkimin Sovjetik. Në jo pak raste, Adenaueri e udhëzonte pilotin e avionit që të kthehej pasi nuk donte të takohej me Hrushovin. Të gjitha debatet sovjeto-gjermane ishin kundërshtuese. Nga një milion e gjysëm ushtarë gjermanë që mbaheshint të burgosur në BS, Hrushovi dha urdhër të liroheshin vetëm 9626 (Smyser, 1999:132). Për frymën pajtuese të Gjenevës as që mund të flitej. Gjermanët dhe sovjetikët e kishin dëmtuar shumë njëri tjetrin gjatë viteve të luftës. E gjithë kjo nuk mund të kalohej vetëm më një shtrëngim duarsh dhe më një buzëqeshje të hidhur. Gjermania ishte ndarë në dy shtete, po ashtu edhe Evropa u nda plotësisht në dy zona ndikimi siç kishte deklaruar para disa vitesh Çerçilli.

### **5.9. Heqja e ligjit të luftës ndërmjet Gjermanisë dhe Shqipërisë**

Në këtë temë, mendojmë se është e nevojshme brenda kuadrit të analizës së problemit gjerman, të prezantojmë një çështje e cila në historiografinë shqiptare ka ngjallur jo pak debat dhe interes. Shqipëria ishte përfshirë totalisht në bllokun lindor dhe akti përfundimtar në përfshirjen e vendit në këtë bllok ishte anëtarësimi i plotë i saj në Traktatin e Varshavës më 14 maj 1955. Afrimiti i Shqipërisë me të gjitha strukturat të kampit socialist nën drejtimin e Bashkimit Sovjetik ishte i gjithanshëm. Me Republikën Demokratike Gjermane veçanërisht marrëdhëniet duhet të ishin edhe më miqësore pasi ishte shteti në të cilin Bashkimin Sovjetik ishte më i pranishëm ushtarakisht dhe ekonomikisht krahasuar me çdo shtet tjetër satelit të kampit. Për këtë arsy, në vitin 1955, qeveritë e dy vendeve vendosën që legatat respektive në të dy kryeqytetet të ngriheshin në nivelin e ambasadave dhe të

shkëmbenin ambasadorë të jashtëzakonshëm dhe fuqipotë (Arkivi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme Viti 1955, Dosja 101, fl. 5).

Megjithatë, Shqipëria nuk mund të linte pas dore përsa i lejohej nga Bashkimi Sovjetik, edhe marrëdhëniet ekonomike me Republikën Federale Gjermane. Për këtë arsy, në vitin 1954 dhe saktësish me 17 dhjetor, në kryeqytetin e Gjermanisë Federale, në Bon, me rastin e konferencës mbi shkëmbimet tregtare ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit e cila ishte mbledhur fillimisht në Gjenevë të Zvicrës, u muar vendimi që të rregulloheshin marrëdhëniet ekonomike ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Federale Gjermane. Sipas shifrave të paraqitura nga ambasadori i Republikës Popullore të Shqipërisë në Paris, Shemsi Totozani, tregohej se Shqipëria kishte interes të bënte tregti me RFGJ-në dhe se kjo e fundit kishte shprehur interes për disa prej produkteve shqiptare, sidomos në bimë medicinale, lëkura, lëndë druri dhe sidomos dru shqope. (Arkivi MEPJ, V. 1955, D. 227, fl. 3) Nga ana tjeter, Shqipëria kërkonte të blinte nga RFGJ-ja makineri për të ndërtuar në të ardhmen centrale elektrikë, si dhe për rafiniritë e naftës dhe të uzinave ku do të prodhoheshin materiale ndërtimi. (Arkivi MEPJ, V. 1955, D. 227, fl. 4)

Megjithatë, nevojat e Shqipërisë për të marrë produkte nga Gjermania ishte shumë herë më të mëdha. Shqipëria ishte një vend tepër i varfër, dhe për të patur një lloj industrializimi, kërkoheshin patjetër investime të mëdha. Shqipërisë i duhej të importonte nga RFGJ-ja makineri dhe produkte për industrinë kimike dhe të veshjes, për industrinë e metaleve, për industrinë e prodhimeve ushqimore, materiale për ndërtimin e hekurudhave, për instalimin e sinjalistikës, kamionë, materiale elektrike, makineri bujqësore, barna etj. (Arkivi MEPJ, V. 1955, D. 227, fl. 4). Me gjithë këto kërkesa që kishte Republika Popullore e Shqipërisë për të bërë tregti me Republikën Federale Gjermane, vështirë se dilnin disa lëndë drusore dhe medicinale për të bërë qoftë edhe klering me shtetin gjerman perëndimor.

Në vetë deklaratën gjermane, cilësohej qartë se të gjitha kërkesat e Shqipërisë ishin lehtësishët të mundura për t'u përbushur nga ana e qeverisë së Republikës Federale Gjermane. Mjaftonte që për të gjitha këto që përmendëm më lart, Republika Popullore e Shqipërisë të paguante 2 milion dollarë amerikanë. Nga ana e saj, Republika Federale Gjermane ishte menjëherë e gatshme t'i paguante Shqipërisë shumën për lëndët drusore që kishte porositur (Arkivi MEPJ, V. 1955, D. 227, fl. 5). Shqipëria në këtë kohë, e kishte totalisht e pamundur të paguante një shumë e tillë kur vetë ishte e varur kokë e këmbë nga ndihmat dhe kreditë e të gjitha vendeve të kampit socialist. Megjithatë, udhëheqja komuniste shqiptare dhe qeveria e saj, ishin të prirura të bënин tregti me Republikën Federale Gjermane edhe pse të dy vendet nuk kishin marrëdhënie diplomatike.

Bisedimet në Paris siç njoftonte ambasadori Totozani kishin filluar që në datë 12 shkurt 1955, ndërmjet palës shqiptare dhe asaj gjermane për propozimet e shkëmbimeve tregtare të lartpërmendura (Arkivi MEPJ, V. 1955, D. 227, fl. 14). Në një shkresë sekrete të datës 7 mars 1955, qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë nëpërmjet Ministrisë së Tregtisë njoftonte se ishte dakord për vendosjen e marrëdhënieve tregtare me Gjermaninë Perëndimore ose me firma tregtare në Gjermaninë Perëndimore (Arkivi MEPJ, V. 1955, D. 227, fl. 19). Sipas këtij njoftimi, qeveria shqiptare mendonte se ishte në gjendje që brenda vitit 1955 të eksportonte në RFGJ mallrat e mëposhtme:

1. Kompensatë ahu	M3	200
2. Rimeso	M2	60.000
3. Shqopë 1/2 e punuar	Dyz.	50.000
4. Zorrë të thata	Ml.	30.000
5. Bimë	\$	10.000.

Kushti që vendoste qeveria shqiptare ishte që këto mallra të kompensoheshin në vlerën e tyre me kimikate të ndryshme, auto-pastruese rrugësh, litar çeliku, brisqe, lima dhe gurë çakmaku. (Arkivi MEPJ, V. 1955, D. 227, fl. 3)

Duke qenë se Republika Popullore e Shqipërisë nuk kishte marrëdhënie diplomatike me Republikën Federale Gjermane, gjithçka do të kryhej nëpërmjet ambasadave respektive në Gjeneve ose në Paris. Këtë fakt, na e bën të njohur një informacion që promemoria e zëvendësministrit shqiptar të Punëve të Jashtme në atë kohë, Vasil Nathanaili, i cili më datë 9 shtator 1955 i kërkonte qeverisë të shikonte mundësinë e zhvillimit të mëtejshëm të bisedimeve tregtare me RFGJ-në (Arkivi MEPJ, V. 1955, D. 227, fl. 31). Siç shikohet, për palën shqiptare nuk përbente ndonjë vështirësi afrimi tregtar e Republikën Federale Gjermane. Si kishte mundësi që Shqipëria kërkonte të afrohej nga ana tregtare me RFGJ-në kur nuk kishte marrëdhënie diplomatike me të dhe nuk humbte rastin që në çdo mbledhje të fliste kundër ringjalljes së revanshizmit gjerman?

Përgjigja është e thjeshtë. Në datën 5 shkurt 1955, Sekretari i Parë i Komitetit Qendoror të PPSH-së, Enver Hoxha, njoftohet nga ministri i Punëve të Jashtme Behar Shtylla se, më 25 janar 1955, Sovieti Suprem (parlamenti) i BRSS me dekret të veçantë kishte shpallur mbarimin e gjendjes së luftës midis Bashkimit Sovjetik dhe Gjermanisë (Arkivi MEPJ, V. 1955, D. 105, fl. 3). Gjithashtu, më 1 dhe 3 shkurt 1955, qëndrim të njëjtë kishin mbajtur respektivisht edhe Republika Popullore e Polonisë, dhe Republika Çekoslovake. Përveç shteteve të mësipërme, nga vendet e demokrative popullore evropiane ishte njohur edhe Republika Popullore e Shqipërisë si shtet aleat në Luftën e Dytë Botërore. Ministri Shtylla sugjeronte se ishte në interesin e Shqipërisë ta përforconte pozitën ku ndodhej dhe do të ishte e vlefshme sipas tij që Presidiumi i Kuvendit Popullor të shpallte me dekret të

posaçëm mbarimin e gjendjes së luftës midis Shqipërisë dhe Gjermanisë (Arkivi MEPJ, V. 1955, D. 105, fl. 3).

Po sipas ministrit të jashtëm të Republikës Popullore të Shqipërisë, bazat politike dhe juridike për të ndërmarrë një hap të tillë ekzistonin dhe Shqipëria dispononte dokumente dhe argumente mjaft të qarta në këtë drejtim. Me shumë interes ishte fakti se Shqipëria bënte pjesë si Fuqi aleate në Agjencinë ndër aleate të reparacioneve nga Gjermania dhe kishte marrë e po merrte reparacione nga kjo e fundit. Gjithashtu, Shqipëria ishte Fuqi shoqe në Traktatin e paqes me Italinë, aleaten kryesore të Gjermanisë. Po ashtu, sipas ministrit Shtylla, edhe Franca e kishte mbështetur të drejtën e Shqipërisë për të marrë pjesë në përpunimin e Traktatit të paqes me Gjermaninë (Arkivi MEPJ, V. 1955, D. 105, fl. 3).

Në fund të njoftimit, ministri i Jashtëm i Republikës Popullore të Shqipërisë, propozonte në emër të dikasterit që drejtonte, që Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH-së të merrte menjëherë në shqyrtim këtë problem dhe të vendoste që Këshilli i Ministrave të bënte paravonesë propozimin përkatës për shpalljen e dekretit në fjalë. Enver Hoxha nuk kishte sesi të mos e përkrahte propozimin e ministrit të Jashtëm Behar Shtylla. Duke patur parasysh informacionin që ishte dhënë nga ministri i Jashtëm i RPSH-së, Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë, më datë 14 mars 1955, shpalli dekretin me numër 2014 mbi përfundimin e gjendjes së luftës me Gjermaninë (Arkivi MEPJ, V. 1955, D. 105, fl. 13).

Në dekretin e miratuar, theksohej se për këtë hap ishin marrë parasysh vendimet e Konferencës së Potsdamit të vitit 1945 që përcaktonin rrugën e zhvillimit të mëtejshëm të Gjermanisë, si një shtet i bashkuar, paqedashës dhe demokratik, duke vërtetuar nevojën e përfundimit të një traktati të paqes me Gjermaninë. (Arkivi MEPJ, V. 1955, D. 105, fl. 12)

Por, ky dekret kishte një mangësi pasi theksonte mbarimin e gjendjes së luftës me Gjermaninë, por me cilën prej të dyjave? Edhe pse kishte dhjetë vjet që kishte përfunduar Lufta e Dytë Botërore, sipas dekretit ende nuk ishte bërë i mundur bashkimi i Gjermanisë mbi baza paqësore demokratike dhe për këtë fajësonte qeveritë perëndimore që ishin bërë pengesë. Një tjetër defekt i këtij dekreti është pika ku theksohet se "Duke marrë parasysh forcimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve miqësore midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Demokratike Gjermane, të cilat vazhdimisht forcohen edhe më tepër për interes të dy popujve të të dy vendeve, me qëllim që të vendosen marrëdhënie të mira dhe bashkëpunimin në mes të popullit shqiptar dhe të popullit gjerman...Presidiumi i Kuvendit Popullor nxjerr këtë dekret: Dekret mbi mbarimin e gjendjes së luftës midis Shqipërisë dhe Gjermanisë". Lind përsëri pyetje; Dekreti për përfundimin e gjendjes së luftës u miratua vetëm me Republikën Demokratike Gjermane apo me të gjithë popullin gjerman? Pasi me shumë se gjysma e popullit gjerman kishte një tjetër qeveri e cila nuk kishte marrëdhënie diplomatike me Republikën Popullore të Shqipërisë.

Kishte edhe një problem tjetër që del nga dy pyetje të paraqitura në dokumentet që kemi hulumtuar. A ishte Lëvizja Nacional Çlirimtare një organ me pushtet që të fliste në emër të Shtetit shqiptar dhe ta përfaqësonte atë në marrëdhënie me shtetet e tjera? Dhe së dyti, a kishte qenë Shqipëria në gjendje lufte me Gjermaninë (Arkivi MEPJ, V. 1955, D. 105, fl. 3)? Përgjigja mendojmë është e thjeshtë, jo. Vetë justifikimi i paraqitur në këtë dokument e vërteton këtë kur pranohet se "*qeveria tradhtare e Ahmet Zogut tradhtoi popullin dhe iku dhe e la. Ajo nuk formoi jashtë shtetit një Qeveri që të përfaqësonte Shtetin shqiptar pranë fuqive aleate*" (Arkivi MEPJ, V. 1955, D. 105, fl. 3).

Që këtu kemi të bëjmë me një ngërç të rëndësishëm politik. Lëvizja Antifashiste Nacional Çlirimtare u bë qeveri zyrtare vetëm në nëntor 1944, jo më përpara. Shqipëria kishte qeveritë e saj bashkëpunëtore me pushtuesit dhe në një farë mënyre ato ishin përfaqësueset legjitime të popullit shqiptar. Le të themi se gjatë viteve të luftës, Lëvizja Antifashiste Nacional Çlirimtare ishte "opozita" e pushtetit të atëhershëm. Nuk kishte në dorë as të shpalte luftë dhe as të miratonte paqen. Pjesëmarrja e Shqipërisë në Luftën e Dytë Botërore ishte njojur si kontribut i Lëvizjes Nacional Çlirimtare dhe nga tre aleatët e mëdhenj, por jo si qeveri.

Lëvizja nacional çlirimtare e Shqipërisë u vetëpërfaqësua si qeveri në mbledhjen e Beratit të tetorit 1944 duke përfaqësuar shtetin shqiptar dhe sipas saj mund të fliste në emër të shtetit dhe ta përfaqësonë atë në marrëdhëni ndërkombëtare. Sipas këtij mendimi të ekspertëve shqiptarë të atëhershëm, gjendja e luftës ndërmjet Shqipërisë dhe Gjermanisë kishte filluar që me hyrjen e saj në luftë (Arkivi MEPJ, V. 1955, D. 105, fl. 3), edhe pse nuk kishte asnjë akt të shkruar mbi shpalljen e gjendjes së luftës ndërmjet të dy vendeve. Megjithatë, derisa ekzistonin dy Gjermani me parlament, qeveri dhe simbole të ndryshme shtetërore, dhënia fund e gjendjes së luftës ndërmjet dy vendeve mbetej të kryhej e plotë kur të bashkoheshin në një dy Gjermanitë.

### **5.10. Parimi apo interes? - Revolucioni hungarez dhe Kriza e Suezit**

Themelimi i Traktatit të Varshavës nga Bashkimi Sovjetik si kundërpeshë ndaj NATO-s dhe anëtarësimit të RFGJ-së në të, i shtyu akoma më shumë dy superfuqitë drejt një gare të ethshme gjopolitike. Lufta e Koresë dhe acarimet në Gjermani, padyshim që nuk do të linin në harresë edhe vendet e tjera në pjesë të ndryshme të globit. Përplasja e dytë

gjeopolitike ndërmjet dy superfuqive dhe aleatëve të tyre u bë në Afrikë. Në vitin 1955, vetëm dy muaj pas konferencës së Gjenevës, Bashkimi Sovjetik shkeli frymën mbi të cilën u mbajt kjo konferencë duke i shitur një sasi të madhe armatimi Egjiptit që në terma politikë përkthehej - avancimi i BS-së për të shtrirë ndikimin e tij në vendin më të rëndësishëm të kontinentit afrikan. Përpara se të analizojmë ndërhyrjen sovjetike në Egjipt dhe rrjedhimisht në Lindjen e Mesme dhe më pas në Hungari, është e nevojshme të bëjmë një sqarim historik të situatës së këtij territori dhe pse ishte aq i domosdoshëm për sovjetikët.

Në vitin 1920, Traktati i Sevrës i dha fund jetës së Perandorisë Osmane pas Luftës I Botërore. Ky traktat rikonceptoi Lindjen e Mesme si një territor shtetesh lara-lara. Disa vende si Egjipti dhe Irani kishin eksperiencë të hershme historike si perandori dhe entitete kulturore (Kissinger, 2014:111). Vendet e tjera arabe ishin ish ose koloni të francezëve dhe anglezëve. Sistemi i mandateve që u sankzionua nga Lidhja e Kombeve më 1920-ën i ndau në këtë mënyrë territorët arabe të Lindjes së Mesme: Siria dhe Libani iu dhanë Francës; Mesopotamia që u quajt më vonë Irak u vu nën protektoratin britanik; Palestina dhe Tansjordania iu dhanë gjithashtu Britanisë (Kissinger, 2014:112). Të gjitha këto entitete përmbanin shumë grupe sektare etnike, disa prej të cilëve kishin histori të shumta dhune kundër njëri tjetrit. Përveç grupeve sektare, një tjetër problem ekzistonte në Lindjen e Mesme; problemi Zionist (hebre).

Nacionalistët hebrenj kërkonin krijimin e shtetit të Izraelit bazuar edhe në 'Deklaratën e Balfurit (Ministri i i Jashtëm britanik) më 1917 në një letër dërguar lordit Rothçilld ku i deklaronte hapur se ishte në favor të krijimit të një shteti izraelit në territorin palestinez duke i ofruar siguri për një bashkëjetesë arabo-hebreje (Kissinger, 2014:112).

"Rregullimet" territoriale të Lidhjes së Kombeve në favor të Francës dhe Anglisë, shkaktuan përplasjet e para. Më 1924-ën, Republika e Turqisë e kryesuar nga Mustafa Qemal Ataturku hodhi tej parimin e bashkimit pan-islamik kalifatin dhe, shpalli shtetin laik. Kështu, bota myslimanë u nda ndërmjet konceptit ndërkombëtar të Vestfalise dhe konceptit të parealizueshëm dar al-Islam. Me një eksperiencë të pamjaftueshme, shoqëritë në Lindjen e Mesme filluan përpjekjet për të ndërtuar shtetet e tyre me kufij problematikë.

Arabët filluan të lëvizin dhe të kërkonin një sërë gjërash ku më të rëndësishmet ishin:

- Mbështetja për Izraelin dobësonte lidhjet amerikane me botën arabe.
- Izraeli, konflikti Arabo-Izraelit dhe çështja palestinezë ishin në qendër të problematikës në Lindjen e Mesme.
- Amerika duhej të ndryshonte qëndrim dhe të braktiste mbështetjen për Izraelin dhe t'i jepte më shumë suport vendeve arabe dhe Palestinës.
- Amerika duhej të bënte presion mbi Izraelin dhe ky i fundit të përmbushte kërkesat e arabëve.
- Amerika kishte nevojë për naftë dhe për këtë duhej të merrej vesh me arabët.
- Mbështetja e vazhdueshme për Izraelin do të rriste armiqësinë e Bashkimit Sovjetik dhe të arabëve në dëm të interesave amerikane.
- Mbështetja për Izraelin provokonte ndjenja anti amerikane tek popujt e Lindjes së Mesme dhe është shkak terrori kundër Amerikës.
- Izraelitët nuk e dinin se ç'ishte më e mira për ta, prandaj amerikanët duhet t'i shpëtonin ata nga vetvetja duke u imponuar politika të cilat duhet të kënaqnin interesat amerikane dhe arabe në botë (Bard, 2010:38).

Lindja e shteteve laike të stilit evropiano perëndimor nuk kishte precedentë në historinë arabe. Lëvizja e parë e arabëve ishte t'ia përshtatnin pavarësinë dhe shtetformimin qëllimeve të tyre. Elitat tregtare dhe politike filluan të veprojnë brenda kuadrit vestfalian të shtetit dhe ekonomisë. Ata vetëm kërkonin barazi me kombet e Evropës dhe të botës. Kombinimet e tyre politike nuk i afroheshin rendit vestfalian. Megjithë përpjekjet, rendi politik pluralist nuk u arrit të vendosej në vendet arabe. Këtë përpjekje e pengonin dy rryma. Së pari, pan-arabistët të cilët synonin krijimin e një shteti total arab, me një territor, një gjuhë dhe entitet kulturor (Bard, 2010:113). Rryma e dytë dhe më problematikja ishte ajo pan-islame e cila ishte për një bashkim të kombit arab me bazë fenë. Islamistët të cilët në Egjipt përfaqësoheshin nga vëllazëria myslimanë kërkonin një identitet modern arab me bazë fenë. Ata e konsideronin islamizimin si të vetmen rrugë për të dalë nga problemet e luftës pa braktisur vlerat e tyre dhe mbi të gjitha pa iu dashur të bëheshin perëndimorë.

Deri në përfundim të Luftës II Botërore, fuqitë evropiane ishin mjaftueshëm të fuqishme të mbanin kontrollin rajonal të përcaktuar në Lindjen e Mesme. Pas luftës, aftësia e evropianëve sidomos e francezëve dhe britanikëve për të kontrolluar atë territor u dobësua në nivele të paimagjinueshme më parë. Si pasojë e kësaj dobësie, vitet '50, '60 shënuan rënien e monarkive pak a shumë feudale në Egjipt, Siri, Irak, Jemen dhe Libi të cilat u zëvendësuan nga udhëheqës ushtarakë të cilët i hapën udhë regjimeve diktoriale laike. Lideri më i rëndësishëm i kësaj epoke për botën arabe ishte koloneli Gamal Abdel Naser i Egjiptit. Shfaqja e Naserit nxori në pah konfliktin e fjetur midis Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve kryesorë të NATO-s për kolonializmin (Kissinger, 1999:524). Në prill të vitit 1951, Uinston Çërçilli i cili ende ishte lider i opozitës kishte bërë thirrje për veprime të përbashkëta në Lindjen e Mesme:

*"Ne vetë nuk jemi aq të fuqishëm, sa të mbajmë gjithë barrën politike që kemi mbajtur deri tanë në Mesdhe apo edhe të drejtojmë kontrollin diplomatik të këtij teatri. Por, Shtetet e Bashkuara dhe Britania së bashku me ndihmën e Francës... të tre do të jemi në një pozitë të fuqishme të merremi të themi, me problemin egjiptian dhe gjithë çështjen e mbrojtjes së Kanalit të Suezit" (Kissinger, 1999:524).*

Në Lindjen e Mesme, Amerika nuk kishte ndërmend t'i mbante hatrin Britanisë së Madhe dhe Francës dhe politikave të tyre kolonialiste. Vendet arabe e kishin kuptuar se qëndrimi amerikan ndryshonte nga ai evropian për çështjen e kolonializmit. Por, këtu kishte një dallim. Udhëheqësit e rinj të vendeve arabe si Naseri nuk ishin demokratë. Me plot gojën mund të thuhet se ishin marksistë dhe tek revolucioni shikonin mundësinë e vetme të përbysjes së rendit imperialist. Bashkimi Sovjetik ishte vendi tek i cili Naseri shikonte forcimin e pushtetit të tij. Hrushovi pa tek lideri i ri egjiptian mundësinë e një goditjeje të re kundër rendit kapitalist pas dështimeve në Kore dhe Gjermani. Armatimi sovjetik në Egjipt shmangu izolimin e Naserit. Lideri egjiptian nuhati edhe mosmarrëveshjet ndërmjet franko-britanikëve dhe amerikanëve. Sa më shumë thelloheshin mosmarrëveshjet ndërmjet tre anëtarëve kryesorë të NATO-s, aq më shumë anonte ai nga sovjetikët. Naseri e kishte identifikuar veten si një lider nationalist arab që kundërshtonte krijimin e shtetit të Izraelit. Një nga arsyet e triumfit të tij ishte pikërisht armiqësia ndaj shtetit të ri në Lindjen e Mesme.

Izraeli nuk do të pranonë të hiqte dorë nga ekzistenca e tij e cila ishte larë me gjakun e 6 milion hebrejve martirë të Luftës II Botërore. Acarimi dhe mbi të gjitha armatosja e Egjiptit nga sovjetikët e kthente këtë shtet në rrezikun numër një të ekzistencës së Izraelit i cili mbahej në këmbë nga anglo-amerikanët. Anglo-amerikanët të shqetësuar për unitetin e tyre të prishur iu vunë punës për të ndërtuar Digën e Lartë të Asuanit në Nilin e Sipërm afér kufirit të Egjiptit me Sudanin (Kissinger, 1999:528). Ky projekt, në fakt ishte edhe një ofertë për Naserin që të shkëputej nga orbita sovjetike. Por, përsëri Naseri i shtangu anglo-

amerikanët. Më 26 korrik 1956, Naseri i dha përgjigje Dallasit përpara një turme të madhe në Aleksandri, duke e formuluar reagimin e tij në një thirrje drejtuar nacionalizmit arab:

*"Qytetarë, kjo është një luftë ku tani ne jemi futur. Është një luftë kundër imperializmit dhe metodave taktike të imperializmit, një luftë kundër Izraelit, pararojës së imperializmit...Nacionalizmi arab përparon. Nacionalizmi arab triumfon. Nacionalizmi arab marphon përpara; ai e di rrugën e tij, ai e di forcën e tij. Nacionalizmi arab e di kush janë armiqtë dhe kush janë miqtë e tij..."* (Kissinger, 1999:530).

Duke iu kundërvënë hapur Francës, ai i tha turmës se "Ne kurrë s'mund të themi se beteja e Algjerit nuk është beteja jonë" (Kissinger, 1999:530).

Gjatë fjalimit ai përdori edhe emrin e inxhinierit Ferdinand Lëseps i cili kishte ndërtuar kanalin e Suezit. Ky ishte emri i koduar për forcat egjiptiane të ushtrisë për të pushtuar kanalin (Kissinger, 1999:530). Britania e Madhe dhe Franca u tërbuan nga ky akt i Naserit.

Në një telegram dërguar presidentit Ajzenhauer, Ideni i shkruante:

*"Në qoftë se ne nuk mbajmë një qëndrim të vendosur, jemi të bindur se influenca jonë dhe e juaja në Lindjen e Mesme do të shkatërrohen"* (Kissinger, 1999:531).

Më 29 korrik, ambasadori francez në Londër njoftoi sekretarin e jashtëm britanik se Franca ishte e gatshme t'i vinte forcat e saj nën komandën britanike dhe të tërhiqte trupat e saj nga Algjeria për veprime të përbashkëta kundër Egjiptit (Kissinger, 1999:531). Financimi sovjetik i Naserit e bindi akoma më shumë Entoni Idenin se tashmë problemi nuk ishte lideri egjiptian, por Bashkimi Sovjetik. Sipas ministrit të jashtëm britanik, të lejoje triumfin e Naserit ishte të lejoje shkatërrimin e ekuilibrit në Lindjen e Mesme. Presidentit Ajzenhauer nuk i interesonte politika e vjetër evropiane e ekuilibrit të forcave, kështu që nuk e mbështeste një sulm ushtarak kundër Naserit. Duke parë mosangazhimin amerikan, më 2 tetor 1956, Franca dhe Britania e Madhe vendosën të vepronin vetëm (Kissinger, 1999:531). Në këtë ndërhyrje, ata deklaruan në përputhje të plotë me deklaratën e Ben

Gurionit, kryeministrat të Izraelit se po mbronin edhe vetë ekzistencën e shtetit të ri hebre (Kissinger, 1999:543).

Angazhimi luftarak britaniko-franko-izraelit me baza tregtare zgjati deri javën e parë të nëntorit 1956. Interesat e vjetra të fuqive kolonialiste perëndimore po dilnin edhe një herë në pah. Ajo që kishte filluar si një tregti armësh ndërmjet Bashkimit Sovjetik me Egjiptin, u kthye në një goditje strategjike sovjetike e cila solli përçarjen e parë të Aleancës së Atlantikut të Veriut. Kriza e Suezit solli edhe çlirimin e SHBA-së nga aleatët për të vepruar e vetme në interesat e saj globale. Franca dhe Britania e Madhe nuk kishin marrë aprovimin e OKB-së për të luftuar në Egjipt. As Amerika nuk do të merrte leje nga OKB-ja për të mbrojtur interesat e saj globale. Në kulmin e acarimit për kanalin e Suezit, një tjetër problem u doli aleatëve perëndimorë, kësaj here në Evropën qendrore.

Populli i çdo vendi në Evropën Lindore ishte i bindur se po sakrifikonte mirëqenien e tij për hir të ideologjisë komuniste e të hegemonisë sovjetike (Kissinger, 1999:551). Ky fakt u duk fillimisht në Poznan të Polonisë më 1955 dhe mbi të gjitha në Hungari më 1956. Historia e Evropës lindore nuk është një histori dashurie në marrëdhëniet e Bashkimin Sovjetik. Që nga koha e fitores kundër Napoleon Bonapartit, Rusia ka luajtur një rol parësor në Evropën lindore. Në veprën e udhëtarit francez markezit dë Kystin (Custine) të shkruar më 1843, Rusia konceptohej në këtë mënyrë:

*"Një përbërje e përbindshme e kombinimit të poshtërsisë bizantine me egërsinë barbare aziatike, një thurje e etiketës së ulët të perandorisë bizantine me veset e egra të Azisë, lindën këtë shtet të fuqishëm që qëndron mbi kryet e Evropës, ndikimi i të cilit do të ndjehet aq fort pa qenë i aftë të kuptojë se përse veproi. (Kissinger, 2014:50).*

Çdo gjë në Rusi lidhej me absolutizmin, përmasat e tij, përhapjen e ambicjes globale dhe pasigurinë. Rusia dhe në shekullin e XX Bashkimi Sovjetik, ishte fuqi euro-aziatike, por pa u ndjerë asnjëherë pjesë e ndonjërs. Pushtimi mongol që zgjati dy shekuj (1237-1480)

nxori në pah dukatin e Moskës dhe i imponoi Rusingë një orientim lindor, ndërkokë që në Evropën perëndimore po shkëllqente Rilindja. Ideja ruse e madhështisë dhe e trashëgimisë bizantine u hartua nga murgu Filofei i cili në vitin 1500 i shkruante carit Ivan duke e qujtur "të vetmin perandor të të gjithë të krishterëve" (Kissinger, 2014:51). Në konceptin vestfalian të rendit botëror, shtetarët evropiano perëndimorë e identifikojnë sigurinë me ekilibrin e forcave dhe me vetëpërbajtjen e ushtrimit të tij. Në eksperiencën historike të Rusingë, përbajtja ishte sinonim i katastrofës. Çdo gjë që konsiderohej si trofe lufte e Rusingë duhej mbajtur me çdo çmim. Duke mos patur kufij natyralë të përcaktuar përveç oqeaneve Arktik dhe Paqësor, Rusia ishte në një pozitë përfshirë e përmbytjeve avancimin e saj në Azinë qendrore, Kaukaz, Ballkan, Evropë lindore, Skandinavi, në detin Ballistik, në oqeanin Paqësor dhe në kufijtë e Kinës dhe Japonisë dhe në shekullin e XVIII dhe XIX në Alaskë. Nga viti 1552 deri më 1917 territori i Rusingë u zgjerua me një mesatare prej 100 mijë kilometra katrorë (Kissinger, 1999:53). Kur ishte e fortë, Rusia tregonte një lloj përbajtjeje të statusit të saj. Kur ishte e dobët, e fshihte vulnerabilitetin e saj duke kërcitur dhëmbët e duke marrë masa drastike. E tillë do të ishte situata edhe në tetor-nëntor 1956 gjatë krizës hungareze.

Lufta e pabarabartë e hungarezëve trima kundër një kundërshtari shumë herë më tepër superior në armatime, por jo në vlera, fitoi simpatinë e botës mbarë. Simpatia nuk ishte e vetmja gjë përfshirë cilën kishin nevojë hungarezët. Planifikimi ekonomik ishte i papranueshëm edhe përfshirë ekonominë e BS-së, ndërsa përfshirë satelitetët ishte shkatërrimtar. Prova përfshirë këtë ishte dështimi ekonomik i RDGJ-së që kishte çuar në kryengritjen e Berlinit më 1953. Përfshirë strategët perëndimorë, Evropa Lindore e cila ishte fituar në fushën e betejës nga Bashkimi Sovjetik, ishte kthyer më shumë në një barrë sesa në një përfshirë strategjik dhe

ekonomik. Titoja ishte i vetmi udhëheqës i Evropës lindore i cili në vitin 1948 kishte patur guximin të largohej nga orbita sovjetike. Mendimi i pavarrur do të ishte i patolerueshëm për Moskën.

Pas vdekjes së Stalinit, në Kremlin pas një tranzicioni të shkurtër, në pushtet kishte ardhur Hrushovi. Nikita Hrushov (17 prill 1894 – 11 shtator 1971) do të ishte një figurë politike komplekse në marrëdhëniet ndërkombëtare. Me emrin e tij lidhen edhe acarimet më të mëdha në përplasjen ideologjike ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, por edhe vetë strukturave komuniste botërore. Veçanërisht acarimet më të mëdha Hrushovi dhe Bashkimi Sovjetik do t'i kishte me Shqipërinë në Ballkan dhe Kinën në Azi. Ngjarja kryesore që e bëri Nikita Hrushovin lider të dyzuar në marrëdhëniet ndërkombëtare ishte padyshim Kongresi XX i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Ky kongres u mbajt në datat 14 – 25 shkurt 1956. Në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare u njoh me termin “fjalimi sekret i Hrushovit”. Ky fjalim sulmonte më së shumti kultin e individit dhe pasojat e tij. Më 25 shkurt 1956 që ishte edhe dita e fundit e Kongresit, u lajmërua se do të kishte një sesion të paprogramuar, kështu që u thirrën të gjithë delegatët sovjetikë. Fjalimi i Hrushovit në këtë sesion filloi me një hyrje të gjatë ku specifikoheshin dëmet që sillte kulti i individit duke marrë edhe “përmasat e një perëndie”. Në fjalimin e tij, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të BS-së tha se Stalini e kishte bërë një gabim të tillë. Sipas tij ai kishte tradhtuar parimet bazë të Marksizëm-Leninizmit ([www.marxist.org/reference/archieve/hoxha/works/nov1960](http://www.marxist.org/reference/archieve/hoxha/works/nov1960)).

Delegatëve iu tërroq vëmendja lidhur me Testamentin e Leninit kopje të cilil iu shpërndanë sallës. Aty flitej qartë për kritikat e ashpra që i kishte dhënë Stalinit ku e kishte cilësuar si brutal. Akuza shumë të ashpra ndaj udhëheqësit të vdekur u dhanë sidomos për vrasjen e

Sergej Kirovit më 1934, ngjarja e cila i hapi rrugën terrorist të madh. Ndërsa akuzonte Stalinin, me shumë kujdes, Hrushovi ngriti lart rolin e Partisë Komuniste e cila i kishte mbijetuar të gjitha sulmeve dhe akuzave të ndryshme. Sipas konceptit të Hrushovit, Partia kishte qenë viktimë e Stalinit dhe jo pjesëmarrëse në krimet e tij. Në fund të fjalimit të tij ai bëri thirrje që të shkulej me rrënje “kulti i individit” dhe komunistët e vërtetë t’i kthehen në luftës revolucionare për transformimin e shoqërisë.

Fjalimi i Hrushovit tronditi të gjithë kongresin, delegatët dhe të ftuarit nga partitë komuniste të Evropës Lindore dhe të botës. Aq e madhe ishte tronditja saqë teksti i plotë i fjalimit të Hrushovit u botua vetëm në vitin 1989. Asnjë udhëheqës komunist i botës nuk tha fjalë të ashpra për fjalimin ([www.marxist.org/reference/archieve/hoxha/works/nov1960](http://www.marxist.org/reference/archieve/hoxha/works/nov1960)).

Më 1 mars 1956, teksti i lexuar nga Hrushovi në Kongres u shpërndar tek të gjithë funksionarët e Komitetit Qendror të Partisë, por me mbishkrinin “Tepër Sekret” dhe “Jo për botim”. Anëtarët e Komitetit Qendror u instruktuan që ta lexonin raportin në të gjitha mbledhjet e lagjes dhe organizatat bazë të partisë. I ashtuquajturi “fjalim sekret” tashmë nuk ishte më sekret. Një formë e rezervuar sekreti u mbajt ndaj vendeve të Evropës Lindore. Ky fjalim asnjëherë nuk u shfaq publikisht dhe në qarqe të larta mohohej menjëherë. Për botën perëndimore nuk ishte sekret. Gazeta prestigjioze Nju Jork Tajms e batoi të plotë fjalimin e Hrushovit më 5 qershor 1956 (Boriçi, 2016:32). Botimi i fjalimit të plotë nga Nju Jork Tajmsi i futi në një rrëth vicioz shërbimet secrete dhe diplomacinë sovjetike. Si kishte mundësi që ata të kishin patur një informacion të plotë? Përveç liderëve të Bashkimit Sovjetik, shumë pak udhëheqës të Evropës Lindore kishin patur dijeni për këtë fjalim. Nga dokumentet e fundit të botuara, burimi kishte dalë nga Polonia. Gazetari i ri polak komunist Viktor Grajevksi (Grayevsky) kishte qenë për takim në shtëpinë e të

dashurës së tij e cila punonte si sekretare e Eduard Oçab, sekretar i parë i Varshavës. Në mënyrë të pakujdeshme ajo e kishte lënë fjalimin mbi tavolinë dhe Grajevskit i ra në sy titulli “Kongresi XX i Partisë Komuniste të BS-së”. Ai kishte dëgjuar fjalë përfundimtari sekret dhe iu lut të dashurës që t’ja jepte që ta lexonte në shtëpi. Pas shumë përpjekjesh ajo pranoi. Por, ajo që e dashura nuk e dinte ishte se Grajevksi ishte hebre dhe punonte përfundimtari Mosadin (shërbimin sekret izraelit). Ai kishte babain të sëmurë në Izrael dhe i duhej të shkonte atje përfundimtari ta parë. Përfaqësuesi i ambasadës izraelite e ndihmoi të merrte vizën përkatëse dhe në këmbim të nderit i bëri fotografitë e duhura materialit dhe i dërgoi në Izrael (Boriçi, 2016:33). Më 13 prill 1956, materiali ishte në duart e CIA-s. Alen Dallasi i cili në atë kohë ishte drejtor i CIA-s, ia dërgoi materialin presidentit Duajt Ajzenhauer. Pasi u bindën se fjalimi ishte autentik, CIA mori leje që fjalimi t’i dërgohej Nju Jork Tajmsit. (Boriçi, 2016:33).

Botimi i fjalimit ‘sekret’ të Hrushovit shkaktoi një tërmet të tmerrshëm në botën komuniste. Struktura bazike e fjalimit ishte si vijon:

1. Hedhja poshtë e kultit të individit të Stalinit.
2. Citime nga klasikët e marksizëm-leninizmit të cilët denonconin “kultin e individit”, veçanërisht citohej letra e Karl Marksit drejtuar punëtorëve gjermanë ku shprehte të gjithë antipatinë përfundimtare.
3. Testamenti i Leninit dhe citimet e Nadezhda Krupskajës, ish Komisari i Popullit përfundimtare (gruaja e Leninit) që vinte në pah karakterin e Stalinit.
4. Përpara Stalinit, lufta kundër trockizmit ishte qartësisht ideologjike; Stalini futi nacionin e “armikut të popullit” që u përdor si artileri e rëndë në fundin e viteve ’20.
5. Stalini kishte dhunuar normat e partisë dhe lidershipin kolektivist.

6. Represioni mbi shumicën e bolshevikëve të vjetër dhe delegatëve të Kongresit XVII të Partisë ku shumica e tyre u dënuan shumë ashpër përpara vitit 1920. Nga 1966 delegatë, 1108 u deklaruan “kundër-revolucionarë”, 848 u ekzekutuan, 98 nga 139 anëtarët dhe kandidatët për Komitetin Qendror u quajtën “armiq të popullit”.

7. Pas këtij represioni, Stalini pushoi së marri parasysh mendimet e kolektivit.
8. Shembuj të represionit të disa prej bolshevikëve më të shquar u lexuan hollësisht.
9. Stalini kishte urdhëruar persekutim pambarim. Sipas tij, “NKDV-ja ishte katër vjet e vonuar në shtypjen e çdo forme opozite” dhe parimi i tij ishte “forcimi i luftës së klasave”.
10. Roli i Stalinit në Luftën e Madhe Patriotike (Lufta II Botërore) ishte i ekzagjeruar.
11. Çdo kombësi kishte pësuar deportime masive.
12. Ishin ekzekutuar doktorë pas zbulimit të të ashtuquajturit “komplot i mjekëve”.
13. Manifestimi i kultit të individit: këngë, emra qytetesh etj.
14. Vargjet e Himnit Kombëtar Sovjetik (versioni i parë 1944-1953) i bënин elozhe Stalinit.
15. Mosdhënia që nga viti 1935 i dekoratës “Urdhri i Leninit” duhej të ndreqej menjëherë nga Sovjeti Suprem (parlamenti) dhe Këshilli i Ministrave (Thurston, 2006: 4). Fjalimi i Hrushovit u interpretua në Hungari si frysë e liberalizimit të politikës sovjetike në Bashkimin Sovjetik. E nëse liberalizohej politika në Bashkimin Sovjetik, atëherë edhe në Evropën lindore duhej të ndodhë e njëjtë gjë. Hungaria ishte një vend me 9 milion banorë që jetonte nën shtypjen e tmerrshme sovjetike. Imre Nagi i cili kishte zëvendësuar Matias Rakoshin vendosi të ecët në hap me situatën. Më 23 tetor 1956, studentët në Budapest listuan disa kërkesa që shkonin shumë më larg se reformat e propozuara nga

Bashkimi Sovjetik. Imre Nagi përkrahu kërkesat e studentëve. Besimi i partisë komuniste hungareze në popull kishte marrë fund me fjalimin e Nagit. Udhëheqësi hungarez u kthyte në një hero të turmës dhe siç ndodh rëndom me heronjtë, ata asnjëherë nuk i mbijetojnë revolucionit që e kanë drejtuar vetë. Dukej sikur revolucioni po triumfonte. Më 28 tetor 1956, tanket sovjetike u larguan nga Budapesti. Kjo ishte periudha më e mirë kur bota perëndimore mund të lëvizte për të ndihmuar Hungarinë, por asgjë nuk ndodhi. Perëndimi ishte tepër i zënë për t'u marrë me krizën e kanalit të Suezit dhe me konsolidimin e shtetit të Izraelit. Duke parë palëvizshmërinë e botës perëndimore dhe veçanërisht të NATO-s, Hrushovi vendosi të ndërhynte.

Më 1 nëntor 1956, Imre Nagi me një hap të paprecedent, shpalli daljen e njëanshme të Hungarisë nga Traktati i Varshavës dhe neutralitetin e saj. Për Hrushovin kjo ishte e tepërt.

Më 4 nëntor, tanket sovjetike goditën pa mëshirë Budapestin dhe e rrafshuan në pjesën më të madhe të tij. Revolucioni hungarez u shtyp pa mëshirë. Imre Nagi u ekzekutua. Në momentin kur tanket sovjetike rrafshonin Budapestin, Kombet e Bashkuara bënë një deklaratë në favor të Hungarisë, por tashmë ishte tepër vonë. Sovjetikët kishin marrë Hungarinë dhe kishin lëshuar Egjiptin. Kompromisi i heshtur ishte bërë.

Në marrëdhëni ndërkombëtare, parimi nuk pranon as mëdyshje as shkallëzim (Kissinger, 1999:565). Interesi kërkon përllogaritje. Një shtetar e ka të domosdoshme t'i shpjegojë popullit të tij dhe mbi të gjitha vetes raportin ndërmjet parimit dhe interesit. Këtë, Imre Nagi nuk e bëri.

Që një udhëheqës të ketë sensin e demokracisë e ka të nevojshme që vendi i tij i origjinës të ketë një eksperiencë të tillë. Në Evropën perëndimore, katolicizmi ishte baza e përmirësimit të ndërgjegjes njerëzore. Në fillesat e ushtrimit të mendimit politik modern,

Kisha Katolike ishte pak e aspak e modifikuar, por brenda saj u gjetën mekanizmat e duhur që sollën shkëlqimin e saj karakteristik, human, shkencor, politik dhe ekonomik. Shembullin e Kishës Katolike e ndoqën të gjithë shtetet e perëndimit secili duke e përshtatur këtë eksperiencë sipas karakteristikave të popullit të tij. Fazat e ndryshme politike që ka kaluar njerëzimi janë vyrtut i përmirësimit të ndërgjegjes njerëzore që filloime Rilindjen, Reformacionin, Iluminizmin, dhe Kapitalizmin. Deri më sot kjo fazë e fundit është edhe shkalla më e lartë e zhvillimit të ndërgjegjes njerëzore.

Diversiteti politik i globit tonë është rrjedhim i shoqërive të ndryshme që jetojnë në të. Në shoqërítë islamike ndarje e shtetit nga feja është paksa e komplikuar pasi për besimtarët e vërtetë të kësaj feje, në fjalët e Kuranit feja duhet të jetë e pranishme në çdo sferë të jetës shoqërore. Ndërsa në shoqërítë budiste sipas parimeve të Konfucit as feja e as grupet politike nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë në qëndrën e vendimmarjes politike.

Kur një politikan udhëheqës ka në plan të parë politikën e jashtme, ankthi i tij madh është që në arenën ndërkombëtare të mos duket sikur nuk është kompetitiv. Të qenurit kompetitiv do të thotë të kuqtohet në kohën e duhur veprimin që është i nevojshëm të kryhet në marrëdhënie me të tjerët, qofshin këta partnerë apo kundërshtarë. E thënë ndryshtë, duhet të jesh i pranishëm. Refuzimi për të qenë i pranishëm në çështje me rëndësi politike dhe ndërkombëtare ndërlikon në masë të konsiderueshme suksesin në politikë dhe në diplomaci.

Ndërthurja e politikës së brendshme me atë të jashtme në jetën e çdo politikani përbën një ndryshim. Për çdokënd që njeh historinë, ndryshimi është ligji i jetës. Ndryshimi në politikë dhe në diplomaci nuk duhet të sjellë me domosdo përbysje. Ndryshimi në politikë dhe në diplomaci sjell në të shumtën e rasteve fitore. Fitorja është çmimi i

vazhdimësisë. Në politikë, kundërshtarët e ndryshimit thjesht largohen nga skena, nuk persekutohen. Simbolet e ndryshimit janë forca e mendimit dhe aftësia e përshtatjes me të renë. Dikur simbolet e mëdha të ndryshimit kanë qenë profecia dhe pushtimi. Pushtuesi nuk i fshihe aspak qëllimet e tij. Misioni i tij ishte të impononte vullnetin. Nëse pushtimi i tij zgjaste, herët a vonë ai e kthente dominimin në një ndjenjë detyrimi. Në këtë mënyrë perandoritë e së kaluarës kanë arritur të kthejnë pushtimin në ligjshmëri. Në politikë morali rrjedh prej ligjshmërisë së veprimit, ndërsa pragmatizmi nga aftësia e përshtatjes. Në politikë, pragmatizmi i pashoqëruar nga elementët moralë çon në brutalitet dhe në stanjacion. Ndërsa moraliteti pa pragmatizëm çon në mendjemadhësi, fanatizëm dhe mungesë vetëpërbajtjeje.

Çdo gjeneratë politike duhet të zbulojë ndjenjën e proporcionit në vetvete. Çdo brez i përgjigjet politikës aktuale. E ardhmja ndërtohet mbi bazën e së tashmes dhe mbi eksperiencën e së kaluarës. Sado të ndryshëm të kenë qenë burrat e mëdhenj të historisë ata kanë patur një sens të përbashkët për të shkuarën dhe një vizion të qartë për të ardhmen. Shtetarët bashkëkohorë janë gjithnjë në pritje të taktikave të reja. Problemi është se ndryshimi i fakteve mund t'i çojë në zgjedhjen e taktikave të gabuara. Problemet e mëdha të së kaluarës kanë qenë si pasojë e paditurisë dhe mungesës së informacionit. Në kohën e sotme atë çka një politikan udhëheqës duhet ta ketë mirë parasysh është që të dijë të mpleksë diturinë dhe informacionin që duhet ta shoqërojë. (Boriçi, 2009:233).

## **5.11. Pikëpyetja evropiane**

Mund të thuhet se Stalini pati fat që nuk e pa triumfin politik të RFGJ-së. Bashkimi Sovjetik pas vdekjes së tij kishte ende kontrollin mbi RDGJ-në dhe në Evropën lindore, por

nuk kishte asnjë lloj ndikimi mbi RFGJ-në dhe Evropën perëndimore. Partia komuniste gjermane në Gjermaninë Federale nuk ishte votuar as 5%, kështu që kishte humbur të drejtën për t'u përfaqësuar në parlament (Smyser, 1999:133). Repubika Federale Gjermane tashmë ishte inkorporuar në sistemin euro-atlantik të sigurisë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke qenë edhe fuqia më e madhe ushtarake e kohës, kishin nevojë për baza të sigurta nëpër botë. Tek Gjermania perëndimore, SHBA-ja gjeti partnerin ideal. RFGJ-ja kishte mjaftueshëm territor ku amerikanët të vendosnin armët e tyre strategjike bërthamore. RFGJ-ja së bashku me Britaninë e Madhe u bënë partnerët kryesorë të SHBA-ve në Evropë. Edhe pse Stalini i druhej më së shumti kësaj aleance të fuqishme, nuk mundi të bënte asgjë për ta parandaluar. Me Gjermaninë perëndimore totalisht të integruar në strukturat euro-atlantike, SHBA-të mund të vendosnin trupa të mjaftueshme ushtarake për të mbrojtur jo vetëm RFGJ-në, por të gjithë Evropën perëndimore. Prej andej, amerikanët i kishin të hapura rrugët strategjike drejt Lindjes së Mesme, Afrikës dhe përtej (Smyser, 1999:51).

Me ndihmën amerikane, RFGJ-ja po kthehej në një faktor të rëndësishëm ushtarak. Me kalimin e kohës, ushtria e re gjermane kapi shifrën e 500 mijë vetëve në fund të viteve '50. Demokratizimi i plotë i vendit i hapi rrugën edhe mundësisë që Gjermania perëndimore të posedonte armë bërthamore. Ministri gjerman i mbrojtjes, Franc Jozef Shtraus kërkonte që vendi i tij të trajtohej njëlloj si aleatët përsa i përket armatimit. (Smyser, 1999:51). Duke marrë parasysh edhe kundërshtimet e Moskës, aleatët fillimisht nuk ishin dakord që të pajisnin RFGJ-në me armë bërthamore. Edhe për disa kohë, RFGJ-ja duhej të kënaqej me ndihmën që do t'i jepnin aleatët perëndimorë. Për të mbrojtur vendin, dilnin e mjaftonin armët amerikane. Vendosja e armëve bërthamore amerikane në RFGJ, solli një debat të

ashpër në Evropë. Kancelari Adenauer kërkonte që armët bërthamore të shërbenin vetëm për të përmbajtur Bashkimin Sovjetik. Ai shpresonte që ato të mos përdoreshin asnjëherë. Kancelari i mençur gjerman e dinte mirë se çdo të bëhej me vendin e tij nëse kthehej edhe një herë në shesh lufte; do të shfarosej i téri. Nëse do të ndodhte për arsyet madhore përdorimi i armëve bërthamore, perëndimi duhej t'i përdorte ato përpara se ta bënte Bashkimi Sovjetik. Doktrina e "përdorimit i pari" që u quajt në atë kohë, ishte një sinjal i qartë dërguar Moskës se perëndimi në rast lufte do të angazhohej me të gjitha armët atomike pavarësisht nëse Traktati i Varshavës do t'i përdorte ato. Rreziku kryesor rëndonte mbi kryet e RFGJ-së. Në rast të një lufte bërthamore ndërmjet SHBA-së dhe BS-së, gjermanët ishin ata që rrezikonin shuarjen. Vija e frontit ndërmjet NATO-s dhe Traktatit të Varshavës binte direkt në mes të Gjermanisë. Vetëpërmbajtja nuk ishte e vtmja zgjidhje. Zgjidhja ishte vetëm mospërdorimi i tyre.

Duke parë stacionimin e armëve bërthamore amerikane në RFGJ, edhe Moska nuk hezitoi të dërgonte armë bërthamore në RDGJ. Bashkimi Sovjetik po tregonte me këtë akt se nuk do t'i shmangej një ballafaqimi atomik me perëndimin nëse do të shpërthente lufta. Me armët bërthamore të drejtuara kundër njëri tjetrit, Evropa u gjend përsëri në një dilemë të madhe. Nuk kishin kaluar as 12 vjet nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore dhe tashmë bota po gjendej përballë një rreziku me përmasa pakrahasimisht më katastrofike. Lordi Ismaj (Lord Ismay) që asokohe ishte Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s, duke parë pasigurinë në rritje të opinionit publik evropian u shpreh:

*"NATO-ja shërbën për të mbajtur amerikanët brenda, sovjetikët jashtë dhe gjermanët poshtë" (Smyser, 1999:135).*

Por, gjermanët nuk mund të mbaheshin poshtë. Aleatët e Gjermanisë perëndimore, veçanërisht amerikanët duhet ta kuptionin rëndësinë strategjike të RFGJ-së në NATO dhe

në interesat globale të SHBA-ve. Në gjysmën e dytë të viteve '50, Gjermania dhe Evropa mbetën politikisht dhe ushtarakisht të ndara në dy kampe kundërshtare politike, sociale dhe ekonomike. Perëndimi ishte lidhur ushtarakisht dhe ekonomikisht me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Lindja ishte lidhur me Bashkimin Sovjetik. Në perëndim ishte krijuar Komuniteti Evropian i Qymyrit dhe Çelikut, ndërsa në lindje nga Bashkimi Sovjetik ishte krijuar Këshilli për Ndihmën Ekonomike Reciproke (KNER). Stalin kishte dështuar në politikat e tij të pasluftës. Ai nuk kishte arritur të mbante të bashkuar Gjermaninë as me diplomaci e as me forcë. Edhe me notën e tij të vitit 1952, lideri sovjetik nuk e kishte qartësuar nëse donte një Gjermani të bashkuar komuniste apo të pavarur në kuptimin e plotë të fjalës. Në dallim nga ai, kancelari Adenauer e kishte bërë të qartë se demokracia dhe stabiliteti ishin në rend të parë për të, jo bashkimi (Smyser, 1999:135).

Nga ana tjetër, Ulbrihti sipas idesë së tij ia kishte dalë mbanë. Duhej që të humbte Stalini e të fitonte ai. Dega e tij e komunizmit në zonën sovjetike ia kishte bërë të pamundur Stalinit që të negaciononte çdo lloj lirie me të dhe me perëndimorët. Atij i duhej të negaciononte një rezultat, jo një proces politik. Për sovjetikët, Ulbrihti ishte ose shumë i trashë ose shumë i zgjuar. Në fakt doli kjo e dyta. Lideri komunist gjerman i RDGJ-së i bëri sovjetikët të besonin tek ai pavarësisht dështimit ekonomik dhe numrit në rritje të refugjatëve. Ai nuk sillte as demokraci, as prosperitet. Megjithatë, ai ishte i pazëvendësueshëm. Paradoksalisht, si lindja ashtu edhe perëndimi kërkonin të ishin të ndarë. RFGJ-ja ishte kthyer në shtetin më të rëndësishëm të Evropës perëndimore dhe Dojçmarka ishte monedha më e rëndësishme në botë pas dollarit amerikan. Në dallim nga RFGJ-ja, RDGJ-ja ishte kthyer në bastionin më të rëndësishëm sovjetik në Evropë që thithë burime financiare të panumërt me gjithë dështimet e njëpasnjëshme ekonomike.

Valter Ulbrihti e egërsoi akoma më shumë sistemin komunist në vitin 1956. "Vija" e vdekjes nuk u hoq. Ata që kërkonin ta kalonin atë vriteshin në vend. Për të kaluar në perëndim vetëm një derë qëndronte ende hapur; sektori Çarli që ndante Berlinin perëndimor nga ai lindor. Shumë shpejt edhe ajo derë do të mbyllej.

### **5.12. Reagimi britanik në epokën bërthamore**

Gjatë Luftës së Ftohtë, dilemat që u ngritën lidhur me organizimin e një strategjie gjithëpërfshirëse më së shumti përfshinë Britaninë e Madhe. Pas Luftës II Botërore ajo doli shumë e dobësuar dhe e kishte mëse të nevojshme të ripërtërinte relativisht forcën e saj. Britania ishte shumë e bindur se edhe po të bënte përpjekje maksimale nuk do të mund të fitonte në një luftë gjithëpërfshirëse kundër Bashkimit Sovjetik. Në epokën atomike koncepti i dikurshëm se lufta fitohej duke shkatërruar me goditje nga ajri rezervat industriale të shtetit armik kishte rënë poshtë. Tashmë ishte evident fakti se në rast të një sulmi bërthamor, do të ishte e kotë çdo formë hakmarrjeje ndaj një vendi agresor pasi shkatërrimi i botës do të ishte i pashmangshëm.

Në Britani, ashtu si në Amerikë, kishte mirëkuptim përsa i përket strategjisë ndërmjet vetëpërbajtjes dhe fuqisë goditëse që duhej të shoqëronte një sulm. Në një deklaratë të vitit 1955 të Ministrisë së Mbrojtjes Britanike thuhej:

*"Fuqia e forcave tona e kombinuar me atë të aleatëve duhet zhvilluar dhe mbështetur në çdo kohë për të përballuar një sulm apo një luftë gjithëpërfshirëse" (Kissinger, 1957:275). "Për këtë arsy - vijonte më tej deklarata - është e arsyeshme të tregohemi gjithnjë të vetëpërbajtur" (Kissinger, 1957:278).*

Dokumentet britanikë të muajit prill 1957 na tregojnë këtë konkluzion logjik, por të mbështetur me një fuqi të konsiderueshme ushtarake (Kissinger, 1957:278). Identifikimi i përbajtjes i shoqëruar me kërcënimin për goditje bërthamore tregon thelbin e problemit

në konceptin britanik të mbrojtjes. Armët bërthamore revolucionarizuan pozicionin strategjik të Britanisë më shumë se pozicionin strategjik të SHBA-ve. Madhësia e Amerikës dhe pozicioni i saj strategjik i jepnin një lloj përparësie për mbrojtje në një luftë gjithëpërfshirëse. Britania e Madhe nuk mund t’ia lejonte vetes një luks të tillë. Edhe pse është ishull i cili në rast konfliktesh të mëparshme në shekujt e historisë gjithnjë e ka shpëtuar, në epokën bërthamore gjatë Luftës së Ftohtë pozicioni i saj strategjik ishte dhe mbeti i papërfillshëm. Në atë epokë, edhe sikur Britania e Madhe të lëshonte të gjitha bombat e saj kundër BS-së, ajo nuk do të mund ta shkatërronte tërësisht atë vend, ndërsa Britania nga bombat sovjetike do të fshihej nga faqja e dheut. Duke parë vulnerabilitetin britanik, në një luftë të mundshme gjithëpërfshirëse pyetjet që shtroheshin ishin; çfarë sigurie do të kishte Anglia për mbijetesë? A do të mund të ringrihej më Britania në statusin e një fuqie të madhe si dikur?

Vendimi i Britanisë së Madhe për të patur armë bërthamore edhe aftësi për shpagim reflektoi një problem të madh për të gjithë aleatët evropianë të Amerikës. Ky fakt shprehte dëshirën e Britanisë për të qëndruar forcë e madhe në botë me gjithë problemet dhe humbjet e rënda që kishte pësuar gjatë dy luftërave botërore. Kështu që, ishte shumë e nevojshme të kishte mbështetjen e një force të madhe ushtarake që të detyronte vetëpërmbytjen e Bashkimit Sovjetik. Edhe pse koncepti britanik për mbrojtjen kërkonte shumë sakrifica, përsëri buxheti i Anglisë krahasuar me atë të Amerikës ishte sa 1/10. Këtu shtrohej dilema britanike për të mbajtur forca mbrojtëse në Evropë dhe për t’iu përgjigjur sfidës sovjetike anembanë botës. Në fakt, këtë afërsi gjatë epokës së Luftës së Ftohtë e kishin vetëm Shtetet e Bashkuara që dhe sot e kësaj dite mbeten forca me aftësi goditëse më të fortë se të gjithë aleatët e tjerë. Për një fuqi me burime të kufizuara ushtarake mënyra më e zgjuar për të

mbijetuar është identifikimi i rreziqeve më eminente dhe aty të përqendrojë të gjitha forcat e veta për t'i shmangur ato. Fiaskoja që pësoi ushtria britanike gjatë luftës për kanalin e Suezit më 1956 tregoi se forca ushtarake britanike kishte dy standarde. Forca e saj strategjike tregoi se nuk kishte aftësi të mjaftueshme për të përmbajtur kërcënimin sovjetik në furnizimin e kolonelit Naser me raketa si dhe kishte nevojë për ndërhyrjen e Francës për të arritur rezultatet e dëshiruara.

Dallimet ndërmjet amerikanëve dhe britanikëve në fushën e strategjisë bërthamore kishin të bënин me superioritetin e padiskutueshëm amerikan në këtë fushë. Për më tepër britanikët gabuan në konceptin e ndërtimit të armëve bërthamore pasi edhe pse i patën, përdorimi i tyre në kuadër të NATO-s ishte ekskluzivisht urdhër i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në rast së shpërthente një krizë, Anglia nuk mund të vepronë e vetme për të ndërmarrë hapa të njëanshëm pa u konsultuar me SHBA-në edhe si pasojë e “Special Relationship” të sanksionuar gjatë Luftës II Botërore. I vetmi që e kuptonte këtë pa pikë dyshimi ishte sër Uinston Çërçill kur thoshte më 1955-ën:

*“Ka shumë interesa industriale në këtë anë të Perdes së Hekurt që duhen mbrojtur. Çdo përmbajtje për t’ju shmangur kërcënimeve duhet patjetër që të shoqërohet me fuqinë që duhet treguar për të paralizuar kërcënimin” (Kissinger, 1957:278).*

Gjatë marrëdhënieve ndërmjet SHBA-ve dhe aleatit të tyre më të besuar gjatë epokës së konfrontimit ideologjik në fazën e parë të Luftës së Ftohtë, ishte duplikimi i funksioneve në mungesë të një doktrinë strategjike britanike. Përderisa ekzistonte ideja se dhe fuqitë e interesave strategjike nuk ishin të njëjta ndërmjet SHBA-ve dhe Britanisë, ishte e nevojshme të përafroheshin interpretimet lidhur me rreziqet strategjike. Edhe pse Britania gjatë Luftës së Ftohtë kishte ndërtuar armë strategjike përsa i përket pjesëmarrjes në një luftë të kufizuar, ajo nuk kishte mundësi të bënte një luftë gjithëpërfshirëse bërthamore. Por

kjo nuk do të thoshte se megjithëse Britania nuk mund të bënte një luftë gjithëpërfsirëse bërthamore të mos hynte në garën për të patur armë të tilla. Shtetarët britanikë e kishin kuptuar se pa armë bërthamore Anglia do të ishte kthyer në një fuqi të rangut të tretë. Por, të paturit armë bërthamore do të thoshte se Britania ishte fuqi e madhe, por jo superfuqi. Për këtë arsy, aleanca në NATO ishte domosdoshmëri vitale për sigurinë e Britanisë dhe jo vetëm të saj.

Përpjekja britanike për të ndërtuar një mbrojtje efikase jo vetëm për veten, por për mbarë Evropën Perëndimore krijoj një disproporcion të madh në forcat ushtarake britanike. Ushtria britanike që ishte përqendruar në Rin me katër divizione ishte nën komandën amerikane prej pesë divizionesh që gjendej në Gjermani pas Luftës II Botërore. Vështirësia e këtyre forcave ishte se ekzistonte një diversion strategjik prej sovjetikëve nga i cili mund të destabilizohej përsëri e gjithë Evropa. Një nga arsyet se përse forcat anglo-amerikane u stacionuan në Gjermani (në qendër të Evropës) ishte pikërisht ky, frenimi i ekspansionit të mëtejshëm sovjetik. Politika britanike ishte e vetëdijshme se në rast konflikti ajo mund të bënte thjesht luftë të kufizuar dhe jo gjithëpërfsirëse. Në deklaratat e Ministrisë së Mbrojtjes Britanike në vitet 1954 dhe 1955 tregohet qartë synimi britanik për të qenë fuqi e konsiderueshme, por me angazhim të kufizuar (Buzzard, 1956:230).

Të gjitha këto argumente asokohe ngritën shumë pikëpyetje shumica e tyre pa përgjigje. Duke parë shkallën e shkatërrimit që kishte lënë pas Lufta II Botërore dhe duke patur frikën e një luftë termo-bërthamore, Anglia filloi të marrë qëndrimin e saj tipik që e kishte karakterizuar gjatë shekujve, vëzhgimin e situatës botërore. Ndoshta një konfrontim me BS-në do të ishte i pashmangshëm së pari për arsyet ideologjike dhe së dyti, sepse forcat anglo-amerikane nuk e kishin çliruar vetëm Evropën nga nazizmi. Tani nuk bëhej më fjalë

për një luftë gjithëpërfshirëse, por për vetëpërmbajtje (Buzzard, 1956:230) (Leghorn 38, 1955:84). Dallimet ndërmjet mbrojtësve të idesë për vetëpërmbajtje dhe eksponentëve të qeverisë që kërkonin një pozicion më të vendosur u kthye në një çështje të brendshme për politikën britanike. Kush mund të ishte vija ndarëse për mbajtjen e ekuilibrit ndërmjet këtyre dy rrymave? Sipas eksponentëve të vetëpërmbajtjes, strategjia e ndërhyrjes do të sillte edhe shkatërrimin e aftësisë për të bërë luftë mbrojtëse. Në këtë rast, jo vetëm Evropa që do të ishte e humbur, por edhe vetë Britania e Madhe bashkë me të (Buzzard, 1956:230). Kjo strategji bëhej më e kuptueshme në fjalët e sër Uollter Monkton (Monckton) ministër i mbrojtjes i qeverisë britanike në vitet '50:

*“Jam larg nga të thënët se çdo lëvizje kundër Perëndimit do të kishte si kundërpërgjigje përdorimin e bombës me hidrogen. Askush nuk mund të jetë i sigurtë për këtë, por mund të imagjinohen rrëthanat e agresionit i cili nëse është lokal mund të përballohet suksesshëm me një luftë të kufizuar. Askush nuk thotë se tashmë lufta e kufizuar e përjashton përdorimin e armëve bërthamore. Megjithatë... unë nuk mendoj ... se do të jetë e thjeshtë për çdo qeveri të përcaktojë se kur mund të përdoren armët bërthamore dhe armët e tjera. Çdo përpjekje për të dhënë një përcaktim të tillë në avancë... do të ishte një ndihmesë për kundërshtarin dhe nuk do të ishim të papërgatitur për të kuptuar sesa larg mund të shkohet nga kundërshtarët pa patur mundësi të aplikojmë strategjinë e vetëpërmbajtjes. Edhe nëse vetëpërmbahemi, askush nuk na siguron që kjo lloj politike mban në vetvete vetëpërmbajtjen. Po palët e tjera a do të vetëpërbahen? Mendoj se ka dhe duhet të ketë opsione të tjera”* (Kissinger, 1957:284).

Siq shikohet, doktrina strategjike britanike gjatë fazës së parë të Luftës së Ftohtë vuante nga po të njëjtat dilema që kishin Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndryshimi i koncepteve për luftën solli nostalginë e ditëve të kaluara kur mbrojtja dhe mbijetesa e një shteti vareshin tërësisht nga aftësia e tij. Kur Britania mori vendim të shkurtonte buxhetin e saj të mbrojtjes, këtë e bëri me arsyetimin se raketat strategjike kishin arritur një fuqi që e bënte të kotë numrin e ushtarëve të angazhuar. Por, ky shkurtim ia uli efikasitetin Britanisë në vendimmarrjen në NATO. Gjithashtu, edhe forca negociuese e Britanisë së Madhe ra dhe e bëri të varur nga aftësia amerikane për të qëndruar e patundur në pozicion nga një kërcënim

i mundshëm. Përpjekjet britanike për mbrojtjen tregonin për mungesën e një strategje me aleatët e tjerë evropianë. Duke adoptuar teorinë e vetëpërmajtjes në stilin e vet, Britania flaku nevojën urgjente të NATO-s për të zhvilluar një ide të re për mbrojtjen e Evropës.

### **5.13. Reagimi gjerman në epokën bërthamore**

Gjermania pas Luftës II Botërore doli një vend totalisht i shkatërruar. Në gjysmën e dytë të viteve '50 dhe pas pranimit të saj në NATO, dilemat që përfshinë dy aleatët më të fuqishëm të kësaj organizate padyshim do të preknin edhe Gjermaninë Federale. Dilema gjermane në ato vite vërtet endej ndërmjet dëshirës për siguri dhe shmangies së përgjegjësisë për t'u përfshirë në një luftë gjithëpërfshirëse. Strategja që kishin ndërmend SHBA-ja dhe Britania e Madhe përfshinte dy opsione; luftë lokale dhe vetëpërmajtje ndaj një rreziku që mund ta çonte botën në katastrofë (Frankfurter Allgemeine Zeitung, 1955) Sado korrekt që të ishte ky koncept i alternativave të lartpërmendura për Britaninë e Madhe, kjo nuk do të thoshte se ky do të ishte elementi që do të aplikohet edhe nga aleatët kontinentalë. Qysh në kohët e viteve të ashpra në luftën kundër Napolon Bonapartit, dallimi mes Britanisë së Madhe dhe vendeve kontinentale evropiane ishte se për Anglinë kishte rëndësi ekuilibri, ndërsa për vendet e Evropës kujdesi (Boriçi, 2010:163). Duke qenë se vendet e Evropës kishin mangësi në resurset ushtarake, siguria e tyre do të varej nga përballja përfundimtare ndërmjet SHBA-ve dhe BS-së. Fuqia atomike ishte e një niveli të tillë saqë edhe gjeneralët më të ashpër prusianë nuk do të guxonin ta përdornin.

Papërputhshmërinë që kishte asokohe strategja e NATO-s për mbrojtjen e Evropës u duk shumë qartë në Gjermani. Lufta e Ftohtë filloi për shkak të Gjermanisë dhe do të përfundonte po për shkak të saj. Trupat sovjetike ishin stacionuar në Gjermaninë Lindore

dhe mbrojtja e pjesës tjetër të Gjermanisë ishin detyrat parësore të NATO-s. Impakti i strategjisë bërthamore në opinionin publik gjerman ishte i nxehtë edhe për faktin se Gjermania apo kishte dalë nga një tragedi që e kishte damkosur përfjetë. Apatia që ekzistoi në Gjermani atë kohë kishte të bënte edhe me disfatën e pësuar, por edhe me pjekjen e mendimit se Gjermania Federale mbrohej nga monopolii atomik amerikan dhe nuk kishte nevojë të ndërtonte të vetin. Humbja e luftës dhe diskreditimi i trupës së oficerëve gjermanë çoi në injorimin e teknologjisë së re ushtarake dhe rrjedhimisht në prapambetjen e Gjermanisë në këtë fushë për vitet '50 (Oppenheimer, 1953:525).

Kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës filluan të këmbëngulin për anëtarësimin e Gjermanisë në NATO, aleatët e tjerë filluan të shikonin me dyshim pasi frika e një riarmatimi të mundshëm të kolosit evropian në qendër të kontinentit riktheu në kujtesën e të gjithëve tmerret e 50 viteve të fundit. Për të qetësuar aleatët dhe vetë gjermanët, NATO-ja justifikoi aderimin e Gjermanisë në organizatë si masë mbrojtëse dhe jo rikthimin e vendit në statusin e një force globale. Por, dyshimi mbetej i madh. Një ish ushtarak gjerman që kishte komanduar një divizion tankesh në Luftën II Botërore i quajtur Geje fon Shvepenburg u shpreh hapur duke u munduar që t'i dalë në krah të Organizatës së Atlantikut të Veriut ndaj këtij qëndrimi:

*“Gjermanët nuk janë të interesuar të fitojnë betejën e fundit. Ata duan që të mbrohen, jo të çliron” (Sueddeutsche Zeitung, 1955).*

Si rezultat, brenda Gjermanisë, aleatët perëndimore dolën në mbrojtje për të arsyetur riarmatimin gjerman se përse ishte një kërkesë e kohës për t'u mbrojtur ndaj kërcënimit sovjetik. Sipas logjikës që përdorën aleatët, nëse Gjermania Federale binte, atëherë e gjithë Evropa perëndimore do të pushtohej ose në rastin më të keq do të shkatërrrohej nga Bashkimi Sovjetik. Pozicioni gjeografik i Gjermanisë ishte i tillë saqë nuk duhesin marrë

në konsideratë hezitimet e opinionit publik në vend dhe në Evropë. Duke qenë se Gjermania ndodhet në qendër të Evropës, ishte e natyrshme që duhej të kthehej në një ledh për të penguar avancimin e mëtejshëm sovjetik në Evropë. Në Luftën II Botërore kur ndodhi çarja e madhe ndërmjet feldmarshallit Ervin Romel (Erwin Rommel) dhe Hitlerit, Romeli i tha adjutantit të tij:

*“Të bëjmë ç’është e mundur që anglo-amerikanët të hyjnë në Berlin përpara se të mbërrinë rusët.” (Irving, 1999:377).*

Në këtë logjikë, koloneli fon Bonin argumentonte në korrik 1954 përpara superiorëve të tij në Ministrinë e Mbrojtjes se:

*“Riarmatimi nuk ka për qëllim ta kthejë Gjermaninë në një zonë mburojë për të mbrojtur Evropën Perëndimore. As ka për qëllim të përbajë e vetme agresionin sovjetik. Ne e shikojmë riarmatin si një mjet për të mbrojtur vendin tonë dhe për të kursyer kufijtë tanë për aq sa mundemi nga tmerret e një lufte të tillë [bërthamore]. Ne shikojmë si zgjidhje të vetme të problemit hyrjen në NATO dhe organizimin e ushtrisë në formacione bllokuese me armë nga më modernet. Forcat gjermane do të ishin thjesht mbrojtëse për të penguar çdo avancim të Ushtrisë së Kuqe” (Der Spiegel 9, 1955).*

Plani i kolonelit fon Bonin pasqyronte realitetin e situatës psikologjike në të cilën ndodhej Gjermania. Riarmatimi gjerman duhej arsyetuar se ishte i vlefshëm për vetë vendin dhe se siguronte mbrojtjen e tij. Në diskutimet që janë kryer asokohe për këtë çështje, vetëpërbajtja e mospërdorimit të armëve strategjike ishte sa për sy e faqe. “*Sapo Gjermania të përfshihet në NATO*”, shkruante një organ zyrtar i Shoqatës për Shkencën Ushtarake i përbërë nga ish oficerë, “*asnjë komandant ushtarak nuk do të jetë i aftë të mbrojë zonën e tij të kufirit. Edhe nëse angazhimi bën pjesë në interesat e vendit, kjo duhet të justifikohet vetëm me arsyetimin e mbrojtjes së zonës së lirë evropiano-perëndimore. Në këtë pikë interesat gjermane me ato të aleatëve përpushten plotësisht*” (Kissinger, 1957:291).

Epoka atomike ishte një trishtim i vërtetë për Gjermaninë e pas Luftës II Botërore. Deri në fund të vitit 1954, të gjitha diskutimet strategjike përqendroheshin në betejën finale

ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Ideja për përdorimin e armëve bërthamore sa vinte e zbehej pasi askush nuk do të ishte imun ndaj tyre. Koncepti i luftës kishte ndryshuar një herë e përgjithmonë. Kërkesa nga ana e NATO-s për anëtarësim të Gjermanisë në strukturat e saj ishte një tronditje e vërtetë për opinionin publik gjerman. Krijimi i një strategjie të re ushtarake padyshim u krijuar me emrin e koduar “Carte Blanche” (Kissinger, 1957:291). Me këtë emër të koduar në vitin 1955, u bënë simulimet e para për hedhjen e bombave atomike nga ana e BS-së në Gjermaninë perëndimore dhe Francën lindore. Impakti tek publiku kishte efekte zhgënjiuese. Gjermania qysh nga përfundimi i Luftës II po përballej me impaktin psikologjik të një lufte të re, por shumë të ndryshme nga ato që kishte marrë pjesë më parë ku padyshim kishte patur rol kryesor. Çështja që shtrohej ishte: çfarë vlere do të kishte fitorja nëse zhdukeshin nga faqja e dheut qytete si Helgoland, Salzburgu, Dankërk u Dizhoni (Kissinger, 1957:291) ?

Mendimi strategjik gjerman u përball me realitetin bërthamor në të cilin u ndodh bota pas përfundimit të Luftës II Botërore. Eksposimi ndaj këtij rreziku kishte qenë kaq i menjëherëshëm saqë përfundimet që u arritën kaluan nga një strategji për mbrojtje lokale, në një luftë gjithëpërfshirëse vunë në dyshim se përse duhej riarmatimi i Gjermanisë. “Carte Blanche” u projektua si një kërcënim për liderët sovjetikë dhe për të siguruar Gjermaninë se për mbrojtjen e saj NATO-ja do të përdorte armët strategjike. Në fakt, vërtetoi se armët strategjike dhe bërthamore do të ishin të papërdorshme deri në momentin që të shpikej një doktrinë e re në të cilën të tregohej se ekzistonte një mundësi e re përvçe shkatërrimit total. Rreziku i përmbajtjes strategjike të NATO-s, ndeshi në frikën e justifikueshme të Republikës Federale Gjermane se lufta bërthamore nuk do të ishte diçka që duhej marrë lehtë, përkundrazi.

Asokohe për fat të keq, qeveria e Republikës Federale Gjermane nuk ishte në gjendje të merrej me këtë problem për të njëjtat arsy që kishin shfaqur dyshime qeveritë e Britanisë dhe SHBA-ve. Qeveria gjermane nuk ishte e aftë për të patur një qasje të qartë lidhur me mundësinë e luftës së kufizuar në Evropë, pasi i druhej një lufte gjithëpërfshirëse. Ministri i mbrojtjes Dr. Teodor Blank argumentoi se në rast të një sulm atomik edhe nëse është i kufizuar asnjë trupë ushtarake nuk do të mund të mbijetonte (Kissinger, 1957:294). Këto argumente tregonin qartë se Gjermania ashtu si aleatët e saj perëndimorë po përgatitej për çdo të papritur të mundshme për t'i shpëtuar çdo sulmi bërthamor. Ministri i Mbrotjjes gjerman ndoshta kishte patur të drejtë kur deklaronte se duhej organizuar një mburojë ndaj një lufte të mundshme bërthamore dhe jo të luftohej një luftë gjithëpërfshirëse. Por, natyra e luftës nuk varet vetëm nga qëllimet e një njeriu, por edhe tek vlerësimet e sakta që i bëhen palës tjetër. Prania e armëve bërthamore tek NATO-ja dhe elementi “Carte Blanche” e bënин shumë të vështirë mundësinë e përdorimit të armëve bërthamore nga ana e Bashkimit Sovjetik pasi edhe ai vetë do të pësonte një shkatërrim masiv.

Problemi gjerman nxori në pah dy pyetje që kishin të bënin me sigurinë: së pari, a ishte e mundur një mbrojtje lokale në Evropë? Së dyti, a ishte strategjia bërthamore kuptimplotë? Kancelari i atëhershëm gjerman Konrad Adenauer ia kishte frikën një lufte të kufizuar dhe dëshironë një ushtri efikase gjermane. Por, ajo që ndoshta nuk kuptohej mirë atëherë ishte se përdorimi i armëve bërthamore në çfarëdo lloj lufte do të nxirrte jashtë interesit çdo shtet pavarësisht se çfarë pozite strategjike kishte ai. “Carte Blanche” dhe vendimi i NATO-s për të përdorur armët bërthamore ishin thjesht çështje për të siguruar Gjermaninë se nuk do të pushtohej nga Bashkimi Sovjetik, por çfarë vlere do të kishte pushtimi kur qytetet që do të goditeshin nuk do të ekzistonin më? Riarmatimi gjerman në gjysmën e dytë të viteve '50

dhe pranimi në NATO ishin thjesht përpjekje për të shtyrë sa të ishte e mundur përplasjen bërthamore. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik si të vetmet fuqi që kishin aftesinë për të bërë luftë gjithëpërfshirëse e dinin shumë mirë se një luftë bërthamore nuk do të ishte, as lokale dhe as konvencionale. Në epokën e Luftës së Ftohtë çështja e sigurisë ishte thjesht një lojë nervash ndërmjet dy superfuqive dhe një mjet ankthi për të ruajtur balancat e bipolaritetit. Në ato vite, NATO-ja ishte thjesht një aleance e cila ishte në kërkim të një qëllimi.

#### **5.14. Reagimi francez në epokën bërthamore**

Nëse në Britaninë e Madhe dhe në Shtetet e Bashkuara impakti i armëve bërthamore prodhoi një debat ndërmjet ithtarëve të luftës gjithëpërfshirëse dhe “partisë” së vetëpërbajtjes, dhe në Gjermani mendohej vetëm pér mbrojtje lokale, në Francë çështja e përdorimit të armëve bërthamore u kthyte në një debat të ashpër pér t'i shpëtuar dilemës së strategjisë bërthamore duke u vetëpërjashtuar nga pjesëmarrja në një luftë të tillë.

Fillimisht, Franca refuzoi të ndërtonte kokat e para të armëve bërthamore në vitet '50, por ky vendim vetëm sa e shtyu pér më tej dilemën e saj. Përsa i përket vendimit pér të marrë vendime angazhimi, Franca u gjend përballe dilemës së dallimit të objektivave civilë dhe atyre ushtarakë. Një tjetër dilemë me të cilën përballej Franca në epokën bërthamore, ishte edhe natyra e sigurisë.

Fillimisht, Franca mori vendim që të mos prodhonte armë bërthamore, por ky vendim nuk solli zgjidhje strategjike të problemit politik. Disa ushtarakë francezë ku më i spikaturi i atyre viteve ishte gjenerali Pol Zherardó solli një ide në të cilën shprehu hapur se strategjia në epokën bërthamore ishte thjesht një abstrakt i parimeve morale:

*“Është e nevojshme të flasim hapur. A duam ne që Franca të ketë armë bërthamore madje nëse është e mundur tipin më të fundit të tyre për të mbrojtur integritetin dhe sovranitetin e saj? Apo mos duam që Franca të ketë armë që s’përdoren më dhe t’u nënshtronhet fuqive të mëdha duke humbur prestigjin e saj? Nëse nuk duam të prodhojmë armët bërthamore që na duhen patjetër, është humbje kohe të flasësh për pavarësinë e Francës në terma politikë dhe ekonomikë sepse ne nuk kemi minimumin e pavarësisë ushtarake” (Geradot, 1955).*

Si replikë ndaj kësaj sfide doli Partia Socialiste në Francë nëpërmjet zëdhënësit Marsel Rubolt:

*“Përsa kohë që aspekti diplomatik i kësaj çështjeje është i qartë, ne do ta humbim besueshmërinë tonë si vend paqësor dhe që duam t’i zgjidhim çështjet memarrëveshje. Nëse do të ndërtojmë armë bërthamore do të quhem vend që nxit garën e armatimeve, tensionet dhe përfat të keq këto gjëra do të ndodhin edhe nëse nuk do të kemi bombën atomike”. (Roubault, 1955).*

Argumenti që përdori Partia Socialiste në Francë shikohej si zgjidhje për të mos patur armë bërthamore nëse u bëhej bisht angazhimeve ndërkombëtare. Por, Franca nuk mund ta bënte një gjë të tillë. Për shekuj me radhë i kishte dhënë tonin diplomacisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare në Evropë dhe në botë. Franca nuk mund të tërhoiqej nga një angazhim i tillë. Deputeti i së djathtës Andre Filip në një letër të hapur botuar në ato vite tek prestigjozja Le Monde u shpreh:

*“Nëse Franca dhe Evropa Perëndimore duan të jenë të respektuara dhe të luajnë një rol të rëndësishëm në botë, ata duhet të kenë armë bërthamore dhe jo armë si në këto momente që s’i hyjnë në punë askujt. Si mundet Evropa Perëndimore të luajë një rol si forcë e tretë në botë për ruajtjen e pages siç aspiron nëse mbetet në mëshirë edhe të një sulmi gjysmak atomik” (Philip, 1954)?*

Siq shikohet, Franca donte t’i kishte të dyja; dëshironte të luante një rol parësor në çështjet ndërkombëtare, por pa marrë përgjegjësinë e të paturit një mbrojtje efektive. Ajo dëshironte të ishte siq kishte qenë, fuqi e madhe, por duke ndjekur një politike të rrezikut minimal. Një tjetër ushtarak francez në përpjekje e sipër për të treguar se Franca nuk kishte dilema shkruante:

*“Është ...normale se zërat që qarkullojnë në Francë janë për një armatim bërthamor. Ajo që të habit është irritimi që ka shkaktuar ky debat. Këto nuk janë*

*dyshime si ato që kishim në vitin 1940 të cilët i paguam shtrenjtë. Sot, në këtë epokë ne nuk duhet të kemi më dyshime, pasi ato paguhen akoma më shtrenjtë”* (Debeau, 1955)

Çuditërisht, mbrojtësi më i flaktë i ideve goliste për prodhimin e armëve bërthamore në Francë ishte deputeti socialist Zhyl Mosh i cili kishte përfaqësuar Francën në Kombet e Bashkuara në debatet për çarmatin. Idetë e tij i shprehu në librin “Human Folly: To disarm or perish” (Kissinger, 1957:302)? Problemet e epokës bërthamore për Francën nuk mund të zgjidheshin me burokraci. Vendimi për të mos hedhur hapa të mëtejshëm në prodhimin e armëve bërthamore ngriti pikëpyetje lidhur me të ardhmen e Francës dhe varësinë e skajshme të klasës politike nga opioni publik. Qeveria franceze u detyrua të bëjë kompromisin ndërmjet nxitjes për të patur armë bërthamore dhe kundërshtimit të opinionit publik dhe disa forcave politike. Vendimi francez për refuzimin e armëve bërthamore solli padyshim shkëputjen e Francës nga alternativat për zgjidhje të çështjeve të mëdha botërore. Franca në emër të parimeve të mëdha morale nuk arriti t'i shpëtojë dilemave të epokës bërthamore. Zhvillimi i teknologjisë bërthamore për Francën u bë i pashmangshëm. Në më pak se një vit nga dilemat e mësipërme gazeta Le Monde shkruante:

*“Përjashtim bëjnë vetëm komunistët, e gjithë klasa politike tregoi se duhet të zgjedhim ose armët bërthamore ose braktisjen e mbrojtjes kombëtare”* (Le Monde, 1956).

Ndërsa kryeministri Gi Molé në parlamentin francez u shpreh për këtë çështje:

*“Posicioni i qeverisë është si vijon: Franca zotohet që të mos shpërthejë një bombë bërthamore përpëra 1 janarit 1961. Duke marrë parasysh vonesat që zë ndërtimi i saj ...ky moratorium nuk do ta vonojë më në Francë ndërtimin e bombës bërthamore. Sapo ta ndërtojmë, ne do të jemi të lirë të ndjekim politikat tona të pavarura...Gjatë periudhës së moratoriumit ne do të nderojmë të gjitha angazhimet ushtarake. Asgjë nuk na pengon që të arrijmë synimet tona strategjike...”* (Kissinger, 1957:305).

Fjala e Molesë nuk la asnë dyshim se Franca po përgatitej për të patur armë bërthamore.

Qysh nga përfundimi i Luftës II Botërore, Franca kishte mësuar se armiku duhej përballur qysh në fillim, pa pritur që të forcohej dhe të bëhej e pashpresë përballja me të. Por, edhe

prodhimi i armëve bërthamore nuk e largoi dilemën e Francës. Tashmë, strategjia si për Francën ashtu edhe për aleatët perëndimorë ishte për të gjetur një të ndërmjetme mes shkatërrimit dhe dorëzimit.

### **5.15. Roli i Shteteve të Bashkuara në strategjinë e NATO-s**

Nisur nga pikëpamjet ushtarake gjatë epokës së tensionit Lindje-Perëndim në Luftën e Ftohtë, vështirësitë me të cilat u përball NATO-ja ishin kuptimplotë për të gjithë partnerët. Qëllimi i një vendosjeje të një establishmenti ushtarak në kontinentin e vjetër dhe implikimi në të i nevojës për përdorim të armëve bërthamore, vunë në dilemë strategjinë e aleatëve perëndimorë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe e kishin bazuar strategjinë e tyre në vlerësimin se çdo konflikt në Evropë do të sillte një luftë gjithëpërfshirëse. Nëse arrihej tek kjo pikë, për aleatët nuk kishte kthim prapa. Prandaj ishte shumë e rëndësishme të qartësohej qysh në fillim të ekzistencës roli i NATO-s dhe specifisht i SHBA-ve në strategjinë e marrëdhënieve me kampin komunist. Ishte e qartë se për amerikanët duhej të ishte prioritet të bindej Bashkimi Sovjetik se një sulm i tij ndaj Evropës Perëndimore do të thoshte luftë konvencionale gjithëpërfshirëse dhe shkatërrim total i çdo lloj gjëje në tokë.

Qysh nga fundi i Luftës II Botërore, nocioni i vetëm që është përmendur shumë shpesh, ka qenë statusi i dogmës se vetëm bomba atomike dhe fuqia shpaguese e Shteteve të Bashkuara të Amerikës mbante larg Ushtrinë e Kuqe nga pushtimi i Evropës dhe vetëm një sulm ndaj kësaj të fundit do të shpërthente luftën gjithëpërfshirëse. Në emër të kësaj dogme shumë strategji amerikane u përhapën në treg. Evropa për Amerikën ishte e një rëndësie të veçantë pasi shkëmbimet ekonomike kishin shumë rëndësi për statusin e jetesës së

hemisferit perëndimor. Amerikanët shpikën strategjinë e luftës ajrore strategjike si një mjet presioni ndaj Bashkimit Sovjetik nëse ky i fundit sulmonte Evropën. Në gjysmën e parë të viteve '50, duke parë edhe rrezikun e kërcënimit komunist në Azi, amerikanët mendonin se lufta lokale bërthamore nuk do të ishte e mjaftueshme për të përmbajtur Bashkimin Sovjetik nga pushimi i pjesës së mbetur të Evropës. Edhe argumenti më i pasfidueshëm sjell pasiguri kur bëhet fjalë për luftë. Është çudi e madhe të mendosh se interesat më jetësore mund të mbrohen vetëm duke përdorur strategjitet më katastrofike. Asokohe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës mendonin se mund të mbronin interesat më vitale duke u futur në një luftë gjithëpërfshirëse. Por si mund të mbrohen interesat vitale duke u shkatërruar? Asokohe nuk kuptohej mirë kjo strategji pasi bomba atomike ishte përdorur vetëm një herë në fund të Luftës II kundër Japonisë dhe ishte në embrionin e saj. Tani flitej me terma krejt të tjerë. Fuqia e atomit aq më tepër kur ishte shpikur bomba me hidrogjen nëse do të përdorej, do të sillte një holokaust termobërthamor që do të zhdukte bashkë me strategjitet edhe jetën njerëzore. Armët bërthamore të cilat u shpikën në gjysmën e dytë të viteve '40 sollën elementin e shumëpritur në sfidat mes fuqive të mëdha, vetëpërmbajtjen e tyre. Strategjia amerikane në NATO lidhej me kombinimin e fuqisë së armëve bërthamore në dorë të aleatëve të cilat së bashku e kalonin disa herë fuqinë e Bashkimit Sovjetik. Edhe lufta e kufizuar siç besohej në fillim se do të ndodhë, nuk ndodhi. Nuk mund të kishte kufizime në një luftë në të cilën civilizimi s'mund të mbijetonte. Bota do të kthehej në një gërmadhë radioaktive. Mësimet që u nxorën nga "Carte Blanche" ishin zhgënjenyese. Koha tregoi se brenda një dhjetëvjeçari me perfeksionimin e armatimit bërthamor, lufta u bë krejtësisht e paimagjinueshme dhe e kotë. Fitues nuk do të kishte. Shkatërrimi do të ishte i plotë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët evropianë ranë dakord se nuk ia vlente

të hidheshin 300 bomba atomike në botë brenda një harku kohor prej 48 orësh (Slessor, 1956:158).

Një nga detyrat kryesore që shtroheshin përpara Shteteve të Bashkuara të Amerikës në politikat e NATO-s ishte dhe sesi të evitohej trauma në rast të përdorimit të armëve. Asgjë më shumë se ideja për shkatërrimin e pamëshirshëm të botës nuk sillte më shumë trishtim. Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk e kishin më monopolin e bombës atomike. Me rritjen e fuqisë bërthamore të Bashkimit Sovjetik aleatët evropianë u bënë viktimat e vërteta të kërcënimit bërthamor. Shtetet e Evropës perëndimore ashtu si çdo vend i botës që mbante krahun e njërs apo tjetrës palë rronte në mëshirën e marrëveshjeve amerikano-sovjetike. Ky fakt, do të shoqëronte të gjithë historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare gjatë Luftës së Ftohtë.

Sa e rëndësishme ishte të kiske në përdorim armë bërthamore aq e domosdoshme ishte kuptimi i vetëpërbajtjes nga përdorimi i tyre prej anëtarëve të NATO-s. Derisa pjesa më e madhe e Rusisë evropiane ishte lehtësisht e arritshme prej aleancës, Evropa perëndimore do të ishte në një pozicion më të favorshëm për t'i rezistuar një kërcënim i prej Bashkimit Sovjetik. Ky fakt u përforcua nga marrëveshja ndërmjet presidentit Ajzenhauer dhe kryeministrit Harold Makmillan për të instaluar në Britani armë bërthamore me rreze të mesme veprimi. Ky veprim do të shërbente edhe si model për forcat e tjera aleate të Evropës (Kissinger, 1957:312). Posedimi i armëve bërthamore dhe raketave strategjike nuk do t'i zgjidhte vështirësitë e NATO-s dhe aleatëve. Përkundrazi, mund të shërbente edhe si argument për një reduktim forcash sesa të rrezikohej gjithçka në një luftë gjithëpërfshirëse. Strategjia e kundërgoditjes masive mund ta detyronte aleancën të tërhipej përpara se t'i rezistonte sfidës së kërcënimit. Në mënyrë që të shmangej paraliza e një prospekti të tillë,

NATO-ja e kishte të nevojshme të adoptonte një politikë ku të tregohej lidhja e armëve të reja me strategjinë më pak të dëmshme se një luftë gjithëpërfshirëse.

Lidershipin për këtë përpjekje e morën Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Vetëm ato kishin armët strategjike për të përbushur një strategji të tillë dhe për ta mbajtur të pacënuar Evropën perëndimore nga kërcënimi sovjetik. Vetëm SHBA-të kishin armë për t'u hakmarrë në rast të një “aventure” sovjetike ndaj sigurisë në Evropë. Mbrojtjes së Evropës i shërbeu qysh në vitin 1947 bashkimi i zonave të pushtimit anglo-amerikan dhe në korrik ajo franceze me themelimin një vit më pas të Republikës Federale Gjermane. Sistemi logistik i Luftës II Botërore kishte përfunduar një herë e përgjithmonë. Tani do të ishte tepër e rrezikshme të përfshiheshin disa qendra në një luftë gjithëpërfshirëse. Pajisja me armë bërthamore e aleatëve evropianë të NATO-s prej SHBA-ve rezultoi me një vetëpërmbytje të admirueshme e domosdoshme për ringritjen ekonomike të Evropës perëndimore. Ushtritë e reja evropiane u trajnuan për luftë bërthamore. Dyshimet e fundit të viteve '40 dhe fillimit të viteve '50 u zhdukën. Çdo qeveri evropiane anëtarë e NATO-s u bind se armët bërthamore në epokën e fazës së parë të Luftës së Ftohtë ishin të domosdoshme. Tashmë, mbrojtja e Evropës u bë efikase. Bashkimi Sovjetik kishte thjesht propagandën. Aleatët evropianë e kuptuan rrugën e NATO-s dhe domosdoshmërinë e ekzistencës së saj. Politikë ambige nuk mund të kishte më. Aleatët evropianë të SHBA-ve e kuptuan se në epokën bërthamore ata nuk kishin resurset e mjaftueshme për t'u përfshirë në një luftë konvencionale e cila do të kishte qenë shkatërrimtare për ta. Fuqia e tyre tashmë ishte relative. Edhe për Shtetet e Bashkuara në këto fillime të epokës bërthamore gjithçka po bëhej më e vështirë si pasojë e angazhimeve përherë e më botërore. Megjithatë, një lajm ishte i sigurtë. Luftë bërthamore nuk do të kishte dhe konfliktet do të ishin thjesht

lokale në garën për supremaci të superfuqive ku vendet e dyta dhe të treta do të shërbën si mish për top.

Vullneti për të mbrojtur lokalish Evropën perëndimore ishte testi i parë i vështirë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në epokën bërthamore kur aleati i dikurshëm do të shikohej si armik. Krijimi i NATO-s për t'i shërbyer strategjisë së mësipërme rezultoi me shumë dyshime përsa i përket idesë ku asnje vend i botës nuk e kishte monopolin bërthamor. Bota e lirë e cila u detyrua të riarmatosej për të mbrojtur besimin e saj politik, iu desh të tregonte elasticitet në mendimin e saj strategjik. Nëse NATO-ja asokohe nuk mund të krijonte një strategji më pak katastrofike sesa lufta konvencionale, e bëri sepse nuk mund t'i mbijetonte rreziqeve nga një ndërmarrje e tillë. Ajo që shpëtoi aleancën ishte zgjedhja për të aplikuar një strategji më pak problematike siç ishte ajo e vetëpërmnjatjes. Rezultati për t'i shpëtuar problemit strategjik mund të rezultonte katastrofike në ato vite për Evropën perëndimore dhe për botën e lirë në përgjithësi. Strategja e ardhshme e NATO-s nuk u përcaktua nga vendosmëria e aleatëve, por nga sfidat dhe antagonizmat revolucionare ndërmjet Bashkimit Sovjetik dhe Republikës Popullore të Kinës.

## **Kapitulli VI - Krizat e mëdha ndërkombëtare 1958 - 1968**

### **6.1. Ultimatumi i Hrushovit për Berlinin**

Më 28 tetor 1958 një punonjëse gjermane e misionit amerikan në Berlinin perëndimor kërkoi takim me urgjencë me shefin e saj amerikan. Ajo kërkoi që së bashku me familjen të largohej nga Berlini. Superiori i saj i kërkoi shpjegime dhe ajo u përgjigj se kishte dëgjuar në radio Ulbrihtin duke dekluaruar se "do ta neutralizonte Berlinin perëndimor". (Smyser, 1999:137). Çfarëdo që të kishte patur në mendje Valter Ulbrihti, fjalët e shqiptuara prej tij

tregonin arrogancë dhe agresivitet ndaj Berlinit perëndimor. Punonjësi amerikan ishte i bindur se udhëheqësi gjermano-lindor po bënte bllof (Trivers, 1970:3). Por, ajo që nuk dinte punonjësi amerikan ishte se, Ulbrihti, me kohë i ishte ankuar Moskës lidhur me sektorin Çarli në Berlinin perëndimor. Qysh më 1957-ën i kishte kërkuar Traktatit të Varshavës që të mbyllte atë portë (Trivers, 1970:3). Hrushovi dhe udhëheqës të tjerë lindorë nuk e kishin aprovuar kërkësen e Ulbrihit sepse një veprim i tillë do të hidhte poshtë vlerësimin e liderit sovjetik lidhur me një sulm të mundshëm të lindjes kundër perëndimit (Zubok, 1993:passim).

Shumë gjëra ndryshuan gjatë viteve 1957-1958. Prestigji sovjetik në botë ishte rritur. Ndërmjet muajve maj dhe gusht, sovjetikët kishin testuar me sukses raketat balistike kontinentale (ICBM-Inter Continental Ballistic Missiles) (Trivers, 1970:4). Në tetor 1957, Bashkimi Sovjetik krijoi sensacion botëror duke lëshuar në orbitë dy satelitë Sputnik, në një kohë kur programi hapësinor amerikan ishte shumë mbrapa. Hrushovi kishte lidhur marrëveshje me udhëheqës të shumtë botërorë, veçanërisht nga vendet e botës së tretë që luftonin kundër kolonializmit. Por, megjithë këtë zhvillim të madh politiko-ekonomik në Bashkimin Sovjetik, gjërat nuk kishin ndryshuar për mirë në Republikën Demokratike Gjermane. Në fillimtë vitit 1958, vlerësohej se 4 milion gjermano lindorë ishin arratisur për në perëndim dhe 2.3 milion ishin larguar që nga themelimi i RDGJ-së (Catudal, 1980:48). Juri Andropov (Yuri Andropov) i cili ishte shpërblyer me postin e drejtorit të KGB-së pas suksesit në shtypjen e Revolucionit hungarez (atë kohë shërbente si ambasador i BS-së në Hungari), lajmëroi udhëheqjen e RDGJ-së se numri i refugjatëve gjermano lindorë për në RFGJ kishte arritur pikën kritike (Harrison, 1993:17). Ulbrihti ia hidhte fajin "portës" së hapur në Berlin dhe i thotë Hrushovit se diçka duhej të ndryshonte.

Më 27 nëntor 1958, Hrushovi u dërgoi një letër fuqive pushtuese perëndimore të shkruar me një gjuhë të ashpër dhe mbi të gjitha me një ultimatum. Duke akuzuar Gjermaninë Federale si Hitlerin e ri të Gjermanisë, ai kërkoi një traktat paqeje me të dyja Gjermanitë brenda gjashtë muajve (Smyser, 1999:139). Kërcënimi i tij kundër Berlinit perëndimor ishte i hapur. Ai vlerësoi në mënyrë të gabuar se perëndimorët nuk do të ndërhytin për të mbrojtur një territor që kishte thyer sipas tij rregullat e pushtimit duke pritur miliona të larguar nga lindja. Sipas tij, nëse traktati i paqes nuk nënshkruhej brenda gjashtë muajve, atëherë forcat sovjetike kishin të drejtën të ndërhytin ushtarakisht në Berlinin perëndimor duke transferuar në këtë mënyrë autoritetin e tyre atje. Nëse RFGJ-ja nuk do ta pranonte autoritetin e RDGJ-së, atëherë Bashkimi Sovjetik do të ndërhynte në krah të aleatit të saj komunist. Sipas Hrushovit, Berlini perëndimor gjendej në territorin e RDGJ-së prandaj duhej të ishte pjesë e Gjermanisë lindore (Smyser, 1999:139).

Karakteristika kryesore e Hrushovit në Luftën e Ftohtë ishte se kishte aftësi të mëdha për të inicuar një krizë, por ishte krejtësisht i paaftë për ta menaxhuar atë. Në rastin e krizës së dytë të Berlinit, lideri sovjetik nuk i kishte të qarta termat që duhet të ofronte për të patur një zgjidhje të krizës në favor të tij. Për të qenë i sigurtë, ai përgatiti dy draftë. I pari kishte të bënte me nënshkrimin e paqes me të dyja Gjermanitë prej katër fuqive pushtuese. Në konceptin e Gromikos, ky akt do të sillte kolapsin e NATO-s (Smyser, 1999:139). Por, duke qenë të sigurtë se ky draft i parë nuk do të pranohej as nga RFGJ-ja as nga NATO-ja, Hrushovi dhe Gromiko hartuan një draft të dytë. Drafti i dytë përbante një marëveshje të veçantë me Ulbrihtin. E veçanta e këtij drafti ishte se, do të hynte në fuqi vetëm kur të gjitha mundësitë e luftës politike me RFGJ-në do të ishin shterur (Smyser, 1999:139). Ky draft i shërbente më shumë një fushatë politike sesa një strategje largpamëse.

Lideri komunist gjerman Ulbriht, kërkonte një veprim të shpejtë. Ai filloi të vlerësonte ekuilibrin e forcave në Berlin. RDGJ-ja dhe BS-ja kishin fuqi shumë herë më të madhe. Ata kontrollonin rrugët hyrëse dhe dalëse në qytet dhe kishin forca rezervë në afërsi. Sipas tij, garnizonet gjermano lindore dhe trupat sovjetike mund ta merrnin qytetin brenda një dite. Ulbrihti kërkonte veprim të menjëhershëm për të sfiduar aleatët perëndimorë. Shumë herë ai i përsëriti Hrushovit se Berlini perëndimor gjendej në territorin e RDGJ-së dhe duhej përfshirë brenda sistemit të saj politik (Heidelmeyer, 1963:197). Hrushovi u tregua më i matur se kolegu i tij gjerman. Mjaftueshëm i bindur për dobësitë perëndimore në Berlin, por i duhej të shihte përtej malit. Ai nuk donte një përplasje me SHBA-në. Edhe pse fliste sikur BS-ja ishte superiore nga ana atomike, ai e dinte se kjo nuk ishte e vërtetë. Ai dëshironte të negaciononte, duke shpresuar të përdorte prestigjin hapësinor të arritur nga Bashkimi Sovjetik për të frikësuar perëndimin. Ulbrihti ndoshta nuk donte t'ja dinte nga kriza që dëshironte të provokonte, kurse Hrushovi po. Lideri sovjetik ishte i frikësuar. Ai do të kishte bërë mirë sikur të mos ishte tërhequr prej hunde nga kolegu i tij komunist gjerman. Paaftësia për të vepruar e liderit sovjetik do të sillte padyshim edhe dështimin e kësaj ndërmarrje gjermano- sovjetike. Hrushovi dëshironte ta përdorte krizën e Berlinit përsye strategjike. Ai donte të ndryshonte situatën në Berlin dhe të përqante NATO-n. Gjithashtu, ai donte të poshtëronte Shtetet e Bashkuara të Amerikës aq sa t'i detyronte të tërhiqeshin nga Gjermania dhe nga Evropa. Me t'u aritur kjo, Gjermania perëndimore do të binte në kthetrat e Moskës. Ky akt do t'i lejonte një domimin Bashkimit Sovjetik në Evropë të cilin Rusia e dikurshme nuk e kishte gëzuar kurrë. Ky akt do t'i jepte mundësi Hrushovit të rinvonte lidhjen e dikurshme ndërmjet Rusisë dhe Gjermanisë. Ekuilibri i forcave do të

ndryshonte dramatikisht në favor të Rúsise sovjetike. Hrushovi dëshironte të fitonte me presion dhe negociatë, ndërsa Ulbrihti me veprim të menjëherëshëm ushtarak.

Hrushovi duhej të mendohej edhe për Kinën. Viti 1958, nuk ishte i mbarë për marrëdhëniet kino-sovjetike. Çarja e pësuar në vitin 1957 me vizitën e dështuar të Hrushovit në Pekin, kishte ndarë de facto botën komuniste në dy qendra (Boriçi, 2016:159). Një nga mosmarrëveshjet ndërmjet Kinës dhe BS-së ishte se Mao Ce Duni i kishte quajtur Shtetet e Bashkuara të Amerikës 'tigër prej letre', ndërsa Hrushovi ia kishte kthyer se 'tigri prej letre kishte dhëmbë atomikë' (Boriçi, 2016:159). Hrushovi vijonte të këmbëngulte që ta zgjidhë problemin gjerman me negociata, por kërkesat e tij nuk linin vend për një gjë të tillë. E vetmja mënyrë ishte lufta. Ai ishte i gatshmë lideri sovjetik t'i futej një aventure të tillë për një qytet? Cilado qofshin dallimet mes Hrushovit dhe Ulbrihitit në vitin 1958, ata vendosën të vepronin. Ata iu futën një aventure të rrezikshme e cila do të çonte luftën për Gjermaninë në një nivel të ri. Fjalimi në radio i Ulbrihitit që kishte dëgjuar punonjësja gjermane e misionit amerikan ishte vetëm fillimi.

Ultimatumi i Hrushovit i gjeti aleatët perëndimorë të papërgatitur. Nuk ishin të paktë disa prej anëtarëve të NATO-s që qëndruan indiferentë. Nga fuqitë krysore të Aleancës, interesat për Gjermaninë nuk përkonin në këtë moment. Nuk ishin të pakta rastet kur ndërmjet aleatëve perëndimorë kishte dyshime (Burr, 1994:177). Hrushovi i kishte prekur liderët perëndimorë në një moment të papërshtatshëm. Presidenti amerikan Ajzenhauer ishte në prag të përfundimit të mandatit të tij të dytë, e thënë ndryshtë në prag të pensionit. Dallasi besonte në të qëndruarit fort ndaj kërkesave sovjetike, por nuk dëshironte luftë. Presidenti francez dë Gol i cili ishte rikthyer në pushtet më 1958-ën ishte i zënë me problemin francez në Algjeri. Kryeministri britanik Harold Makmillan dëshironte të ngrinte

statusin e Britanisë së Madhe në nivelin e dikurshëm. Kancelari Adenauer besonte se Gjermania perëndimore gjendej në një pozicon të fortë, por kishte frikë se mos aleatët e braktisin. Si për t'i komplikuar ngjarjet më shumë, forcat gjermano lindore dhe sovjetike filluan të lëvizin për të bllokuar rrugët hyrëse dhe dalëse të qytetit. Kjo lëvizje hodhi poshtë tezën perëndimore se komunistët nuk do të guxonin të bënин një veprim të tillë (Burr, 1994:177). Sovjetikët filluan të ngurronin t'u jepnin garanci perëndimorëve edhe për fluturimet ajrore.

Perëndimorët u gjendën përballë dilemës se ç'duhej të bënин. Zyrtarisht, Bashkimi Sovjetik dhe Gjermania Lindore nuk i kishin shpallur luftë perëndimit. Lëvizja e tankeve dhe e mjeteve të motorizuara ishte një lloj shpallje lufte. Ç'duhej bërë? Presidenti Ajzenhauer besonte se superioriteti atomik amerikan mjaftonte për ta mbajtur urtë Hrushovin. Para dhjetë vjetësh ai e kishte mbështetur gjeneralin Lusjus Klei për të ndihmuar berlinezët. Edhe tani, ai do të vepronte pa hequr asnje presje. Për Ajzenhauerin, Gjermania përfaqësonte një pengesë të fortë për të sprapsur çdo invazion të mundshëm sovjetik. Ajo duhej mbrojtur me çdo kusht. Sekretari i Shtetit Dallas, e dinte se SHBA-të nuk mund të humbnin Berlinin pa vënë në rrezik pozitat e tyre në botë. Për të testuar amerikanët, Hrushovi dërgoi në Uashington në janar 1959 Anastas Mikojanin dhe përgjigja që i dërguari i tij i solli ishte zhgënjuese. Dallasi kishte qenë i prerë. Aleatët perëndimorë nuk do të lejonin që të prekej Berlini dhe të drejtat e aleatëve atje. Kancelari gjerman Adenauer dhe kryetari i bashkisë së Berlinit perëndimor Vili Brand kërkonin më shumë garanci nga amerikanët. Sipas tyre, çdo lëshim ndaj kërkësave sovjetike do të sillte përforcimin e pozitave të RDGJ-së dhe rrjedhimisht njojjen e saj. Këtë fakt, Adenaueri ia tha hapur edhe ambasadorit amerikan në RFGJ, Dejvid Brus (David Bruce) (Burr, 1994:177).

Më shumë se çdo lider tjetër perëndimor, kryeministri britanik Harold Makmillan, donte që Berlini të ishte pjesë e RFGJ-së (Macmillan, 1972:61). Ai u takua me Hrushovin në mars 1959, por u tregua jo i fortë kur pranoi se perëndimorët mund të bënин lëshime për të shmangur luftën (Macmillan, 1972:61). Por, kryeministri britanik harronte se nuk mund të luante rolin e ndërmjetësit mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik pasi Britania nuk ishte më fuqia e dikurshme botërore. Makmillani besonte se Gjermania duhej mbajtur e ndarë për një kohë të gjatë dhe se perëndimi duhej të merrej vetëm me RDGJ-në (Macmillan, 1972:61). Makmillani e quante garën për supremaci ndërmjet dy Gjermanive si "garë se kush do të përfshihej në pasaportën e tjetrit" (Macmillan, 1972:62). Gjithashtu, kryeministri britanik e konsideronte bombën atomike si armën më të frikshme të shpikur ndonjëherë nga njerëzimi. Sipas tij, në një luftë atomike, Britania e Madhe mund të humbte 25-30 milion vetë (Macmillan, 1972:63).

Më i rreptë se kryeministri britanik, u tregua presidenti Sharl dë Gol. Lidhur me krizën e dytë të Berlinit, presidenti francez tha fjalinë e famshme: "*Nëse ne pranojmë diktatin rus, aleanca perëndimore merr fund*" (Smyser, 1999:142).

Dë Goli e mbështeti Adenauerin dhe insistoi se çdo gjë që lidhej me të ardhmen e Gjermanisë duhej të merrej vetëm nga vetë gjermanët. Ai paralajmëroi perëndimin se çdo ndjenjë për të braktisur Gjermaninë do të risillte në kujtesën gjermane tradhtinë e Versajës dhe rrjedhimisht rënien e demokracisë së sapolindur si në rastin e Republikës së Vajmarit duke i hapur edhe një herë rrugë ekstremizmave. Duke dashur të punonte fort për një lidhje të re franko-gjermane, presidenti francez u përpoq që të bindte Adenauerin se Franca ishte gjithnjë në krah të tij (Smyser, 1999:143).

Kancelari gjerman e konsideronte situatën të padurueshme. Ai besonte se e ardhmja e Gjermanisë ishte në rrezik gjatë krizës së dytë të Berlinit. Ai gjithashtu, i druhej rrëzimit të demokracisë gjermane duke sjellë në pushtet një të djathëtë ekstreme. Gjermania duhet të kishte zë të fortë për veten e saj dhe vetëm në këtë mënyrë sipas tij, demokracia gjermane do të mbijeton. Por, nga të gjithë aleatët, vetëm dë Goli kishte sensin e historisë për të kuptuar dhe mbështetur argumentet e Adenauerit. Liderët perëndimorë ishin akoma në dilemë për të pranuar apo hedhur poshtë draftet e Hrushovit. Ndërsa, kriza e Berlinit sa vinte e thellohej, kërkohej një dorë e fortë për të vënë rregull në shtëpinë e përbashkët të aleancës për të shpëtuar edhe një herë Gjermaninë.

## 6.2. Përpjekja e Ajzenhauerit

Përballë acarimit të situatës lindje-perëndim si pasojë e krizës së dytë të Berlinit, aleatët perëndimorë e kuptuan se të përçarë nuk mund të përballonin Hrushovin. Në dhjetor të vitit 1958, NATO-ja mori vendim unanim që të hidhte poshtë propozimet e liderit sovjetik me arsyetimin se Aleanca e Atlantikut të Veriut nuk mund të tërhiqej në mënyrë të njëanshme nga angazhimet ndërkombëtare (Smyser, 1999:143). Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Gjermania perëndimore i dërguan Hrushovit nota pothuajse identike lidhur me hedhjen poshtë të propozimeve të tij. Lideri sovjetik iu përgjigj duke urdhëruar Gromikon që t'u dërgonte fuqive fituese kundër Gjermanisë naziste draftin e traktatit të paqes ku pëfshihej edhe Bashkimi Sovjetik. (Bark, 1989:439). Edhe pse pas vizitës së Makmillanit në Moskë, Aleanca nuk dukej në unison, në maj 1959, tre fuqitë perëndimore të pranishme në Gjermani i dërguan në ftesë për bisedime Bashkimit Sovjetik. Bisedimet do të zhvilloheshin në Gjenevë të Zvicrës. Me këtë takim, aleatët perëndimorë shpresonin që

Hrushovi tē hiqte ultimatumin pēr Berlinin. Konferenca zgjati deri nē gusht 1959 me vetëm një tē prapritur, vdekjen e Xhon Dallasit dhe zëvendësimit tē tij nga Kristian Herter (Smyser, 1999:144).

Në këtë takim, aleatët perëndimorë u përpoqën tē kuptonin pozitat e Hrushovit. Pozitat e liderit sovjetik nē Moskë pas kongresit tē famshëm XX tē Partisë Komuniste ishin tē lëkundura. Ai kishte nevojë pēr kredibilitet ndërkombëtar nē mënyrë që tē forconte pozitat e tij tē dobëta nē Bashkimin Sovjetik. Aleatët menduan që Bashkimi Sovjetik dhe Gjermania Lindore tē mund tē kishin një zë konsultativ nē Berlinin perëndimor. Shumë berlinezë këtë lëvizje e konsideruan tē rrezikshme. Në këmbim, aleatët perëndimorë i kërkuan Bashkimit Sovjetik që tē njihte autoritetin perëndimor tē tyre nē Berlin. Por, Gromiko i hodhi poshtë propozimet duke kërkuar heqjen e çdo lloj autoriteti perëndimor nē qytet. Po bëhej pérherë e më i kuptueshëm fakti se pa praninë dhe zërin e barabartë tē gjermanëve nē çdo konferencë kur flitej pēr vendin e tyre, nuk mund tē arrihej asnjë lloj marrëveshjeje. Sa më shumë zgjatej konferenca, aq më shumë e kuptonte Ajzenhaueri se nuk do tē arrihej asnjë lloj mirëkuptimi. Fillimisht, Makmillani e konsideroi naiv veprimin e presidentit amerikan pēr tē ftuar Hrushovin nē Uashington, por më pas u pendua dhe e konsideroi si një lëvizje tē zgjuar pēr tē zgjatur përtëj mundësive sovjetike krizën e Berlinit (Macmillan, 1972:78).

Konferenca e katër ministrave tē jashtëm dhe vizita e Hrushovit nē Uashington, e shfryu ultimatumin pēr Berlinin. Koha kishte bërë tē vetën. Pas kthimit, Hrushvoi u tha gjermano lindorëve se ishte bërë progres. Ultimatumi u shty edhe pēr një vit. Ulbrihti vari buzët, por nuk kishte zgjidhje tjeter (Smyser, 1999:145). Bashkimi nē një zë i aleatëve perëndimorë kishte detyruar Hrushovin tē shtynte ultimatimin. Lideri sovjetik e kishte kuptuar se një

ballafaqim ushtarak me NATO-n sillte rreziqe të mëdha (Burr, 1994:189). Me këtë akt, Hrushovi e mbajti nën fre Ulbrihtin pasi ky i fundit dëshironte që t'i hynte me kokë një aventure ushtarake. Ambasadori sovjetik në Uashington, Anatoli Dobrinin në kujtimet e tij ka shkruar se Hrushovi nuk dëshironte luftë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gatë gjithë kohës sipas ambasadorit, ai ka luajtur me bllofin me shpresë se mos perëndimi binte në grackë. Madje, në një bisedë me të, lideri sovjetik i ishte shprehur se një luftë me SHBA-në ishte e papranueshme (Dobrynin, 1995:51).

Për të avancuar konsultimet me aleatët, presidenti francez dë Gol, ftoi në Paris në dhjetor 1959, Ajzenhauerin dhe Makmillanin. Adenaueri iu bashkua treshes perëndimore më vonë. Ultimatumi i Hrushovit duhej hedhur poshtë, por jo pa praninë e tij. Pas këtij takimi, në maj 1960, dë Goli ftoi të gjithë fitimtarët e mëdhenj në Paris. Ftesa e tij u pranua (Smyser, 1999:145). Kthimi i situatës në favor të perëndimorëve e vuri në dilemë Hrushovin. Ai filloi të mendojë se mos kishte bërë gabim që kishte pranuar ftesën e dë Golit. Qysh në fund të vitit 1959, ai e kuptoi se perëndimorët nuk do të ndryshonin qëndrim për Berlinin. Pa luftë, asgjë nuk do të arrihej. Pikërisht këtë donte të shhangtë dhe e shhangtë lideri sovjetik. Për Hrushovin nuk mjaftonte vetëm presioni në shtëpi, i duhej të duronte edhe ankimet e Ulbrihit. Refugjatët gjermano lindorë drejt perëndimit po shtoheshin pa pushim. Shumë shpejt, Berlini lindor do të ishte një qytet bosh. Hrushovi nuk mund të arrinte asnjë lloj marrëveshje në Paris për të patur të gjitha ato që donte në Berlin. Atij iu dha mundësia për t'u larguar nga Parisi kur u njoftua se një avion spiun amerikan U-2 ishte rrëzuar në territorin e Bashkimit Sovjetik dhe presidenti Ajzenhauer refuzoi t'i kërkonte ndjesë (Smyser, 1999:146).

Nëse Hrushovi do të kishte qëndruar në Paris, do të kishte humbur imazhin ndërkombëtarisht. Të paktën, kështu siç ndodhi kishte një arsyé për çfarë të justifikohej. Takimi i Parisit shërbeu për të afruar akoma më shumë dë Golin me Adenauerin. Presidenti francez iu shpreh kancelarit gjerman se në takim do të mbronte interesat gjermane dhe do ta njoftonte për gjithçka. Rrugës për në kthim nga Parisi, Hrushovi u ndal në Berlinin Lindor për të takuar Ulbrihtin i cili në inat e sipër i tha se BS-ja duhej të hakmerrej për poshtërimin e avionit spiuun dhe të vepronë edhe në mënyrë të njëanshme (Bark, 1989:454). Komunistët gjermano lindorë ishin bërë gati për sulm. Madje, SED-i kishte bërë plane edhe për "pastrimin" e Berlinit perëndimor pas firmosjes eventuale të traktatit të paqes. Por, ajo që nuk kuptionin lindorët ishte se situata e tyre ekonomike nuk mund të përballonte një luftë. Vetëm kur Ulbrihti i kërkoi ndihmë ekonomike Hrushovit, atëherë ky i fundit e kuptoi sesa në gjendje të keqe ndodhej aleati e tij. Me këtë kërkesë, Hrushovi kuptoi edhe diçka tjetër; sesa e rrezikshme do të ishte për Bashkimin Sovjetik t'i hynte aventurës së përplasjes ushtarake me perëndimin siç e kërkonte aleati i tij gjerman (Zubok, 1993:13).

Kur një muaj më vonë, Ulbrihti i bëri një vizitë Hrushovit në Moskë dhe i kërkoi ndihmë ushtarake për të pushtuar Berlinin perëndimor, Hrushovi ia preu shkurt duke i thënë se në asnjë rast trupat sovjetike nuk do të lëviznin kundër qytetit (Zubok, 1993:14). Madje, Hrushovi refuzoi të nënshkruante edhe një traktat të veçantë paqje me RDGJ-në. Ulbrihit nuk i mbetej gjë tjetër veçse për momentin të dorëzohej (Zubok, 1993:14). Ndërkaq, situata në Gjermaninë lindore sa vinte e rëndohej. Socializmi i Ulbrihit po dështonte me shpejtësi. Zgjedhjet presidenciale në SHBA dhe fitorja e Kenedit i dhanë shpresë dyshes Hrushov. Ulbriht se diçka do të mund të ndryshonte në politikën amerikane ndaj botës komuniste,

por do ta kishin gabim. Si për t'i vënë vulën ndarjes lindje-perëndim, ata në gjysmën e dytë të vitit 1961 bënë aktin e fundit të lidershipit të tyre të dështuar në arenën ndërkombëtare.

### **6.3. Acarim marrëdhëniesh RDGJ-Shqipëri**

Në acarimin e marrëdhënieve ndërmjet dy kampeve dhe me ndërtimin e Murit të Berlinit, në kuadër të kësaj situate, na duket me vend të bëjmë një analizë të acarimit të marrëdhënieve të Republikës Demokratike Gjermane dhe Republikës Popullore të Shqipërisë. Viti 1961, ishte një vit shumë problematik për Republikën Popullore të Shqipërisë. Acarimi i marrëdhënieve ndërkombëtare me ndërtimin e Murit të Berlinit, acaroi edhe marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik. Në fakt, acarimi shqiptaro-sovjetik kishte rrënë shumë të thella që fillon që pas vdekjes së Stalinit në vitin 1953. Kursi i ri i Nikita Hrushovit nuk i shkonte për shtat lidershipit politik shqiptar. Është interesant fakti se udhëheqësi komunist shqiptar Enver Hoxha, përfitoi nga grindja sovjeto-kineze në qershor të vitit 1960 në mbledhjen e Bukureshtit (Boriçi, 2016, 94) dhe mbajti më pas hapur qëndrim anti sovjetik në mbledhjen e nëntorit në Moskë të po atij viti. Që nga kongresi XX i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, udhëheqësit sovjetikë dhe ata kinezë kishin patur mosmarrëvesje të mëdha përsa i takonte situatës ndërkombëtare, si në rastin e bashkë ekzistencës paqësore ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, mbi çarmatimin e përgjithshëm, luftën kundër imperializmit etj. Acarimi në Bukuresht, kaloi çdo limit, ku vetë lideri sovjetik nuk hezitoi ta quante kryetarin kinez Mao De Dun (i cili nuk ishte i pranishëm në këtë mbledhje) si “ultra majtist, ultra dogmatist, dhe një revizionist të majtë” (Boriçi, 2016, 95).

Duke parë përplasjen e madhe ndërmjet dy gjigantëve të komunizmit botëror, lideri shqiptar Enver Hoxha, vendosi të bënte kthesën e madhe: ta lidhte kokë e këmbë popullin

shqiptar me Republikën Popullore të Kinës. Për këtë, duhej të bënte një veprim të fortë dhe të dukshëm. Dhe ky veprim u krye në mbledhjen e 81 partive komuniste dhe punëtore në Moskë më 16 nëntor 1960 (Boriçi, 2016, 100). Fjalimi i Enver Hoxhës përbante akuza të rënda kundër Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në përgjithësi dhe, në veçanti kundër Nikita Hrushovit. Shumë nga të pranishmit e dënuan fjalimin e Enver Hoxhës. Vladislav Gomulka e quajti të neveritshëm, ndërsa heroina e Luftës Civile Spanjolle, Dolores Ibrarruri theksoi se "Hoxha ishte si një qen që kafshon dorën që e ushqen".

Pas kësaj, ishte normale që muajt e parë të viti 1961 në marrëdhëni me Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik do të kishte tensione të mëdha. Më 27 mars 1961, shefi i përgjithshëm i shtabit të ushtrisë sovjetike, Andrej Greçko në një takim me ministrin shqiptar të Mbrojtjes Popullore, Beqir Balluku, i kërkoi këtij të fundit të vërtetonte akuzat se po përpiquej të destabilizohej Shqipëria, dhe t'i jepte fund kësaj situatë jo normale, ose ndryshe Bashkimi Sovjetik do të tërhiqte të gjitha anijet nga vendi (Boriçi, 2016, 103).

Shqipërisë dhe mbi të gjitha Enver Hoxhës, kjo situatë e turbullt i shkonte shumë për shtat. Duhej filluar një aksion i gjerë diplomatik shoqëruar edhe me propagandë të fortë për të demaskuar presionin sovjetik ndaj Shqipërisë. Në vjeshtën e vitit 1961 dhe saktësisht më 3 tetor 1961, diplomi shqiptar Vasil Skorovoti, sipas një informacioni dërguar Enver Hoxhës nga zëvendësministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Vasil Nathanaili, priti në një takim ambasadorin e Republikës Demokratike Gjermane në Shqipëri, Ana Kunderman, që në fakt takimin e kishte kërkuar kjo e fundit (Arkivi MEPJ, 1961, D 97, 1).

Ambasadorja Kunderman i lexoi diplomatit shqiptar deklaratën e mëposhtme:

*"Qeveria ime ka marrë vesh për një shkelje të re nga ana e Qeverisë Shqiptare të detyrimeve të saj që rrjedhin nga Traktati i Varshavës. Qeveria ime më ka thirrur të shkoj*

*në Berlin për të raportuar për këtë shkelje të hapur të Traktatit të Varshavës nga ana e Qeverisë Shqiptare. Prandaj nesër në mëngjes do të shkoj për në Berlin".*

Vasil Skorovoti u përpoq të pyeste ambasadoren gjermane se çfarë shkeljesh kishte bërë Shqipëria, por kjo e fundit iu përgjigj se nuk ishte detyra e saj ta informonte për këtë, pasi kjo ishte detyrë e qeverisë shqiptare. Nga ana e tij Vasil Skorovoti, u përgjigj se Shqipëria nuk kishte bërë asnjë shkelje të detyrimeve të saj që rridhnin nga Traktati i Varshavës. Madje kishin qenë qeveritë e tjera anëtare të Traktatit të Varshavës që kishin shkelur haptazi detyrimet e tyre kundrejt Republikës Popullore të Shqipërisë. Sipas tij, këto shkelje ishin të padrejta dhe nuk pajtoheshin aspak me marrëdhëniet midis vendeve socialiste, madje po sipas tij ishin presione politike të hapura deri dhe presione ekonomike dhe ushtarake. Ambasadorja gjermane nuk i pranoi justifikimet e paraqitura nga diplomi Skorovoti pasi sipas saj qeveria demokratike gjermane kishte informata të sakta. (Arkivi MEPJ, 1961, D 97, 1).

Por ç'kishte ndodhur në të vërtetë? Në gusht të vitit 1961, në Berlinin lindor, ishte organizuar një mbledhje e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës, e nivelit më të lartë, ku do të merrnin pjesë edhe të gjithë sekretarët e parë të partive komuniste të vendeve të Traktatit të Varshavës (Boriçi, 2016, 104). Enver Hoxha nuk shkoi në këtë mbledhje vetë siç e kërkonte rregulli i vendosur, por dërgoi në Berlinin lindor për të marrë pjesë Ramiz Alinë si kryetar të delegacionit shqiptar. Kjo gjë u konsiderua fyerje sidomos për autoritetin e Hrushovit i cili nuk mund ta pranonte një gjë të tillë dhe Shqipëria u përjashtua qysh ditën e parë nga punimet e konferencës së Traktatit të Varshavës. Më 19 gusht 1961, Bashkimi Sovjetik tërroqi zyrtarisht ambasadorin nga Tirana dhe pesë ditë më

vonë në një letër dërguar Komitetit Qendror të PPSH-së, Shqipëria akuzohej nga Bashkimi Sovjetik për shtrembërim të fakteve lidhur me tërheqjen e anijeve sovjetike nga Vlora.

Në fakt, qeveria e Republikës Demokratike Gjermane kishte vendosur të ndiqte hapat sovjetikë në lidhje me Shqipërinë. Zyrtarisht, marrëdhëniet diplomatike ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik u prenë nga ky i fundit më datë 3 dhjetor 1961 në mënyrë të njëanshme (Boriçi, 2016, 105). Ky akt u pasua nga tërheqja e ambasadorëve të tjera të vendeve socialiste nga Shqipëria. Qeveria e Republikës Demokratike Gjermane tërroqi ambasadorin e saj më datë 18 dhjetor 1961 (Arkivi MEPJ, 1961, D 97, 2).

Po ashtu, më datë 20 dhjetor 1961, Qeveria e Republikës Popullore të Hungarisë kishte njoftuar Qeverinë e Republikës Popullore të Shqipërisë se kishte vendosur të tërhiqte ambasadorin e saj në Shqipëri, Nandor Zhatkullak dhe njëkohësisht, kishte kërkuar largimin e ambasadorit shqiptar nga Budapesti, Edip Çuçi, si dhe të këshilltarit tregtar Çelo Cukalla me akuza të padrejta dhe tendencioze sipas palës shqiptare. Largimit të ambasadores Ana Kunderman nga Shqipëria i bënë jehonë sipas Agjencisë Telegrafike Shqiptare edhe agjencitë e lajmeve gjermano-lindore. (Arkivi MEPJ, 1961, D 97, 5).

Në deklaratën që zëvendësministri i jashtëm i Republikës Demokratike Gjermane paraqiti, u dha si shkak për tërheqjen e ambasadorit nga Shqipëria arsyeva se "*qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë e ka bërë veprimtarinë diplomatike normale të ambasadës së Republikës Demokratike Gjermane të pamundur me anën e masave të veta kufizuese, që janë drejtuar kundër punës së ambasadës, pasi ajo ka shkelur brutalisht vendimet e shteteve anëtare të traktatit të Varshavës që është aprovuar dhe nënshkruar prej saj dhe ka*

*zhevilluar një fushatë shpifjesh dhe gënjeshtash kundër Republikës Demokratike Gjermane, Bashkimit Sovjetik dhe shteteve të tjera socialiste".*(Arkivi MEPJ, 1961, D 97, 5).

Padyshim që Shqipëria nuk ishte dakord me këtë deklaratë të zëvendësministrit të jashtëm të RDGJ-së. Me anë të një promemorie dorëzuar ambasadorit Gaqo Paze në Berlin për t'ia dorëzuar qeverisë së RDGJ-së, Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës Popullore të Shqipërisë, njoftonte se këtë vendim të qeverisë së RDGJ-së e quante të çuditshëm si dhe hidhët poshtë kategorikisht akuzat e paraqitura nga nota gjermane dhe madje i quante të pathemelta dhe fye. (Arkivi MEPJ, 1961, D 97, 63-63/1).

Sipas notës shqiptare, Republika Popullore Demokratike Gjermane e dinte fare mirë se Shqipëria si shtet socialist dhe aleat besnik i saj i kishte kryer gjithmonë pa ngurrim dhe me përpikmëri të gjitha detyrimet e saj si anëtare e Traktatit të Varshavës (Arkivi MEPJ, 1961, D 97, 64).

Po sipas notës shqiptare, Traktatin e Varshavës nuk e kishte shkelur Shqipëria, por Nikita Hrushovi dhe grupei i tij në dëm të Shqipërisë dhe qeveria e RDGJ-së sipas notës shqiptare duket sikur kishte marrë rolin e provokuesit për të përjashtuar me çdo mjet Republikën Popullore të Shqipërisë nga Traktati i Varshavës. Sipas notës së MPJ-së, Shqipëria dispononte dokumente për këtë çështje dhe opinioni botëror do të njihej me to në kohën e përshtatshme (Arkivi MEPJ, 1961, D 97, 64).

Kishte qenë Hrushovi sipas notës shqiptare që kishte shtyrë më 17 tetor 1961 dhe më pas më 31 dhjetor 1961 nënshkrimin e Traktatit të Paqes ndërmjet Shqipërisë dhe RDGJ-së, vendim që ishte aprovar edhe nga shtetet e tjera sociale (Arkivi MEPJ, 1961, D 97, 66).

Në fakt, viti 1961 ishte një vit acarimesh ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe vendeve të kampit socialist. Ky fakt vërtetohet nga një letër e datës 18 maj 1961, të

firmosur nga kryeministri i Republikës Popullore të Shqipërisë, Mehmet Shehu, në të cilën nën vizonte provokimin e qeverisë së Republikës Demokratike Gjermane e cila "shprehte bindjen se populli shqiptar, i cili është i frysmezuar nga ndjenjat e miqësisë kundrejt Bashkimit Sovjetik dhe shteteve të tjera socialiste, nuk do të lejojë që rruga në të cilën kanë hyrë udhëheqësit e Republikës Popullore të Shqipërisë t'i sjellë atij gjënë më të keqe".<sup>1</sup> Një qëndrim i tillë sipas udhëheqjes shqiptare përbënte një provokim dhe ndërhyrje të palejueshme në punët e brendshme të Shqipërisë, qëndrim sipas tij që nuk kishte asgjë të përbashkët me parimet e marrëdhënieve midis shteteve socialiste (Arkivi MEPJ, 1961, D 97, 140).

#### **6.4. Muri i Berlinit**

Fillimi i viteve '60 solli një ndryshim të fortë brezash në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Fitorja e Xhon Ficxherald Kenedit në 8 nëntor 1960, bëri që shumëkush të besonte se do të kishte një situatë të re në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ky besim mbizotëronte edhe në Gjermani. Por nuk do të ndodhët kështu. Kenedi ishte një pacifist i lindur. Me besim katolik, ai dhe këshilltarët e tij i druheshin një përshkallëzimi të mëtejshëm të situatës në Berlin. Në konceptin e tij, vetëm përpikmëria dhe vetëpërmajtja do të shpëtonin paqen (Beschloss, 1991:195). Me këto parime, ai shpresonte të ndiqte një politikë paqtimi në Berlin dhe në botë.

Presidentët e mëparshëm Truman dhe Ajzenhauer, besonin se Hitleri ishte shkaktari i shpërthimit të Luftës II Botërore pasi mendonte se kundërshtarët ishin të dobët dhe nuk kishin mundësi reagimi. Të dy presidentët i treguan Moskës se nuk ishte në gjendje të bënte

---

<sup>1</sup> AMEPJ, V. 1961, D. 102, fl. 140. Tepër Sekret. Letër dërguar Këshillit të Ministrave të Republikës Demokratike Gjermane, Berlin, më 12 korrik 1961.

gabimin e Hitlerit. Kenedi dhe këshilltarët e tij, nuk e mendonin situatën njëloj si presidentët që kishin inicuar Luftën e Ftohtë. Presidenti i ri amerikan nuk e njihte mirë historinë. Sipas tij, edhe Lufta I Botërore kishte filluar si pasojë e keqkuptimeve dhe jo garës së armatimeve (Holosti, 1965:365). Edhe pse gjatë fushatës elektorale kishte premtuar për rritje të fuqisë ushtarake amerikane, Kenedi sapo u zgjodh e drejtoi vëmendjen e qeverisë tek problemet e brendshme të Amerikës sesa tek pozicioni i saj në botë. Presidenti Kenedi donte me çdo kusht të shhangtë çdo krizë pasi nuk kishte asnjë lloj eksperience në menaxhim. I lindur dhe i rritur në një familje shumë të pasur me origjinë irlandeze që kishte emigruar shpejt në Shtetet e Bashkuara, Kenedit më së shumti iu dhurua nga i ati posti i presidentit sesa e fitoi vetë. Për Kenedin, rëndësi kishte vetëm kompromisi, pa marrë parasysh sesa ishte çmimi i tij. Megjithatë, ai nuk mund t'u bënte koncesione pa fund sovjetikëve për Berlinin. Këshilltarët e tij të çështjeve sovjetike e këshillonin që për Berlinin dhe Gjermaninë qëndrimi duhej të ishte i prerë. Problemi më i madh që kishte presidenti me këshilltarët ishte se ata ishin adhurues të shteteve të veçanta. Psh, MekXhorxh Bandi (McGeorge Bundy) që ishte asistenti i tij për sigurinë kombëtare njihte më mirë Britaninë e Madhe dhe kulturën e saj sesa kontinentin amerikan. Sekretari i Shtetit Din Rask (Dean Rusk) nuk ishte një ekspert i çështjes gjermane dhe e konsideronte këtë problem si një kockë në fytin amerikan dhe në atë të Hrushovit (Smyser, 1999:150). Rasku kishte kaluar tre vjet në Universitetin e Oksfordit dhe kishte antipati për kontinentalët. Ai kishte shërbyer në Azi gjatë luftës dhe e çmonte atë kontinent më shumë se Evropë (Cate, 1975:321). Foi Kohler (Foy Kohler) u emërua asistent i sekretarit të shtetit për çështjet evropiane dhe ishte më së shumti një njoħes i Bashkimit Sovjetik sesa i Gjermanisë. Atij i duhej të merrej me Gjermaninë në kontekstin sovjetik. Asnjë prej këtyre burrave nuk kishte

qenë i përfshirë në pazaret e viteve 1945-1955 që çuan në ndarjen e Gjermanisë dhe përfshirjen e RFGJ-së në NATO si çmim i ruajtjes së sovranitetit të saj (Cate, 1975:322).

Nga këshilltarët e tij, Kenedi më shumë njoftohej për Azinë dhe çështjet e saj sesa për Gjermaninë. Ata e nxitën që të afrohej më shumë me Moskën dhe më pas e shtynë drejt Laosit dhe më pas drejt Vietnamit. Lëvizja drejt Vietnamit rezultoi një politikë e gabuar e cila do t'i kushtonte SHBA-ve një krizë që do të kulmonte në vitin 1975. Duke patur shumë pak informacion për Evropën, Kenedi filloi të mbështetet tek britanikët si këshilltarë jo zyrtarë. Kryeministri Makmillan u bë shumë i afërt, gati si një baba për presidentin e ri. David Ormsby-Gore i cili u emërua ambasador i Britanisë në SHBA, e njihte Kenedin qysh nga koha kur kishte qenë në shkollë në Londër (Cate, 1975:321). Kishte edhe një arsyse se përse Kenedi u mbëshet kaq fort tek britanikët. I ati i tij Xhozef Kenedi, kishte qenë ambasador në Britani në vitet '30 dhe kishte shumë njohje atje. Makmillani kishte treguar dobësi përsa i përket çështjes së Berlindi dhe ushtroi ndikimin e tij nëpërmjet ambasadorit Ormsby-Gore që të përmirësoheshin marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik (Cate, 1975:321).

Duke dashur të kishte një qasje të re për Berlinin dhe Gjermaninë, Kenedi dëshironte të dinte se për cilat interesa amerikane ia viente të rrezikonte një luftë. Fjalët "keqllogaritje" dhe "përshkallëzim" u ktheyen në rend të ditës. Çdo opzion politik që hidhej në tavolinë duhej të merrej me këto dy "rreziqe" (Smyser, 1999:151). Presidenti dhe këshilltarët e tij mendonin se tre ishin interesat amerikane në Berlin që ia viente rreziku i një lufte bërthamore: prania e aleatëve në Berlinin perëndimor; aksesi i aleatëve perëndimorë nga ajri dhe toka në Berlinin perëndimor; liria dhe viabiliteti i Berlinit perëndimor (Smyser,

1999:151). Këto të treja konsideroheshin si thelbësore. Ndaj çdo agresioni sovjetik ndaj këtyre interesave, Amerika do të vepronnte.

Në marrëdhëniet ndërmjet presidentit Kenedi dhe kancelarit Adenauer nuk kishte afrimitet. Kenedi kishte shkruar për kancelarin se "epoka e Adenauerit kishte përfunduar". Ai besonte se kancelari kishte qenë shumë i afërt me Ajzenhauerin dhe Dallasin dhe se kishte mbështetur Niksonin në zgjedhjet presidenciale të 1960-ës. Kenedit, Adenaueri i dukej i plakur, pa imagjinatë dhe i prirur për të mbyllur çdo lloj marrëveshjeje me paraardhësit e tij. Presidenti nuk hezitonte të shprehej se Herman Greve (Hermann Grewe) ambasadori gjerman në Uashington, i ngrinte nervat (Smyser, 1999:151).

Nënvlërësimi për Adenauerin nuk ishte në favor të Kenedit. Nënvlërësim do të thoshte braktisje dhe rrjedhimisht luftë. Kenedit nuk i pëlqente gishti gjerman në "këmbëzën" atomike (Bark 2, 1993:483). Po në lidhje me Gjermaninë, Kenedi braktisi edhe poziconin amerikan të gjysmës së dytë të viteve '40 lidhur me bashkimin e vendit. Ai nuk e konsideronte si vendim praktik. Qëndrimi i presidentit, i shkaktoi jo pak telashe Adenauerit. Edhe pse i ndërgjegjshëm se bashkimi nuk do të kryhej në terma afatshkurtër, ai kishte nevojë për mbështetje që të mbrohej nga e djathta ekstreme gjermane të cilët e konsideronin tradhtar të çështjes kombëtare. Kenedi e mbante pareshtur të painformuar kancelarin lidhur me planet e aleatëve për Berlinin dhe Gjermaninë. Në takimin mes tyre të ndodhur në prill 1961, kancelari i kërkoi presidentit që të përfshihej në axhendën e konsultimeve me aleatët. Kenedi e injoroi kërkesën e Adenauerit, por nuk e refuzoi publikisht (Bark 2, 1993:483). Vetëm pasi të ndërtohej Muri i Berlinit, Kenedi do ta kuptonte gabimin dhe do ta ftonte Adenauerin të ishte pjesë e konsultimeve dhe e çdo lloj strategjie, por do të ishte tepër vonë.

Kenedi mendonte se çështja gjermane do të zgjidhej në marrëveshje me Moskën. Këtu nuk e kishte gabim. Për këtë arsy, më 22 shkurt 1961, Kenedi i dërgoi një ftesë për takim Hrushovit. U ra dakord që të dy liderët të takoheshin në Vjenë, kryeqytetin e Austrisë i cili ishte një vend neutral. Takimi në Vjenë me Hrushovin e tronditi Kenedin. Lideri sovjetik dëshironte të negaciononte për Berlinin dhe në varësi të negociatave mund të merrte një pozicion më fleksibël sesa në vitet e mëparshme (Smyser, 1999:152). Në negociata, Hrushovi ishte shumë arrogant, madje më shumë nga ç'kishte qenë në bisedat me Ajzenhauerin në Gjenevë dhe Kemp Dejvid. Kërcënimi kryesor që bëri kishte të bënte me Berlinin (Smyser, 1999:153). Lideri sovjetik, parlajmëroi se do të nënshkruante një traktat të njëanshëm paqeje me RDGJ-në dhe çdo refuzim i perëndimit për të bërë një gjë të tillë do të konsiderohej si "shpallje lufte". S'kishte ndodhur më parë që një lider sovjetik të kërcënonte kaq hapur një president amerikan.

Përpara takimit, Kenedi ishte njoftuar për superioritetin amerikan në armatimin bërthamor, por nuk e dinte nëse Hrushovi ishte në dijeni të supremacisë amerikane. Derisa udhëheqësi sovjetik nuk po tregonte asnjë shenjë frike dhe rrjedhimisht as vetëpërmbarjje, Kenedi mendoi se diçka ishte llogaritur gabim në strategjinë amerikane. "Lufta e keqllogaritur" filloj të ishte shqetësimi i tij më i madh (Zubok, 1996:246). Ajo që ra në sy në këto bisedime ishte tallja me të cilën u sollën delegacionet e superfuqive me gjermanët. Ambasadori amerikan Ljuellin Tompson (Lewellyn Thompson) i tha Hrushovit se amerikanët donin t'i trajtonin çështjet e Evropës qendrore me sovjetikët sesa t'jua linin gjermanëve. Ai shtoi se '*refuzoj të besoj se gjermanët tuaj* [në zonën sovjetike] *ishin më të mirë se tonët*'. '*Toke këtu*' i tha Hrushovi duke i zgjatur dorën (Zubok, 1996:246).

Superioriteti që kishte treguar Hrushovi ishte i patolerueshëm. Xhorxh Kinan (George Kennan) dhe ekspertë të tjerë të çështjeve sovjetike privatisht e kritikuan qëndrimin e Kenedit (Smyser, 1999:153). Përpara Hrushovit, Kenedi dukej si çunak. Gjithashtu, edhe eksperienca bënte të vetën. Krahasimi i përvojës së dy liderëve do të ishte një shpenzim i tepërt kohe në këtë vëllim. Për presidentin amerikan, Samiti i Vjenës ishte një katastrofë, ndërsa për Hrushovin një triumf. Lideri sovjetik nuk do të ndalej me kaq. Pas kthimit në Moskë, agjensia e lajmeve TASS boti më 9 qershor 1961, një notë kërcënuese që Hrushovi ia kishte dhënë Kenedit. Ky lajm e kapi në befasi Raskun i cili besonte se nuk do të mund të bëhej publike. Në notë thuhej se gjërat kishin ndryshuar dhe se Bashkimi Sovjetik do të vepronë për të mbrojtur interesat e veta (Smyser, 1999:154). Hrushovi nuk kishte gabuar në gjykimin e tij për Kenedin. Vetëpërmajtja e tij e tepruar kishte nxitur arrogancën sovjetike. Hrushovi ishte i bindur se po të bënte presion të vazhdueshëm mbi Kenedin, presidenti do të térhiqej.

Edhe lideri gjermano-lindor Valter Ulbriht e konsideroi takimin e Vjenës si një triumf. Duke parë dobësinë e Kenedit, ai mendonte se tashmë perëndimi nuk do ta pengonte lindjen për të avancuar në Berlin. Si për ta bërë punën më te lehtë, me një komunikatë ai iu drejtua qytetarëve të Berlinit perëndimor:

*"Qyteti i lirë i Berlinit perëndimor, pas përfundimit të traktatit të pages, nuk do të shqetësohet nga forcat e pushtimit dhe as nga qendrat e agenturave apo nga radio stacionet e organizuesve të Luftës së Ftohtë apo nga mjete të tjera që mund të shërbijnë për të nisur luftën. Kështu pra, mund të thuhet se Berlini perëndimor nuk duhet të përdoret ... kundër interesave të RDGJ-së dhe shteteve të tjera socialiste... Berlini Perëndimor duhet të jetë një qytet neutral" (Slusser, 1973:10).*

Entuziazmi i Ulbrihit pas Samitit të Vjenës u duk në konferencën e shtypit të 15 qershor 1961. Në përgjigje të pyetjes rrëth largimit në masë të lindorëve, ai u përgjigj se nuk do të pengonte largimin e njerëzve nga lindja drejt perëndimit (Slusser, 1973:11). Ngjarjet që

rrodhën treguan dyfytyrësinë e Ulbrihit. Lideri komunist gjerman mendonte se mund ta kontrollonte qytetin duke e kthyer fillimisht në një zonë neutrale. Hrushovi nga ana e tij bëri një provokim të pazakonte më 22 qershor 1961. Kjo datë ishte simbolike pasi shënonte 20 vjetorin e sulmit nazist mbi Bashkimin Sovjetik. Ai doli në tribunë i veshur me uniformën e gjeneral/lejtnantit (Slusser, 1973:12). Një gjeneral sovjetik u shpreh se vetëm sovjetikët kishin të drejtë të ishin në Berlin pasi e kishin pushtuar të parët kryeqytetin gjerman dhe vetëm në mirëbesim u kishin dhënë aleatëve perëndimorë sektorët e tjerë në qytet (Smyser, 1999:156). Diçka po përgatitej për Berlinin, por as ekspertit më të mirë nuk i shkonte në mendje se qyteti do të ndahej përfundimisht për një kohë të pacaktuar.

Edhe përpara takimit të Vjenës, numri i refugjatëve nga lindja e Gjermanisë në drejtim të perëndimit po bëhej përherë e më i madh. Në një mbledhje të Traktatit të Varshavës datë 30 mars 1961, Ulbrihti kërkoi përsëri mbylljen e sektorit (Smyser, 1999:156). Presioni i liderit komunist gjerman u bë edhe më i fortë pas samitit të Vjenës duke ia vështirësuar vendimmarrjen aleatit të tij sovjetik. Shifrat që dha Ulbrihti në konferencën për shtyp të 15 qershorit ishin alarmante. 100 mijë gjermano lindorë ishin larguar në gjysmën e parë të vitit 1961 ku 20 mijë ishin larguar vetëm në qershor. Në korrik u larguan edhe 30 mijë të tjerë (Smyser, 1999:157). Tre deklaratat thelbësore amerikane e ndihmuan Hrushovin t'i jepte rrugë "çështjes" së Berlinit.

Deklarata e parë ishte e presidentit Kenedi më 25 korrik 1961. Presidenti përsëri edhe një herë tri çështjet thelbësore amerikane lidhur me Berlinin dhe Gjermaninë perëndimore. Zëri i vendosur i Kenedit i la një përshtypje të hidhur Hrushovit (Smyser, 1999:157). Deklarata e dytë erdhi nga Uilliam Fullbrajt (William Fulbright) kryetari i komisionit të senatit për çështjet e jashtme. Më 30 korrik 1961, ai u shpreh publikisht se nuk e kuptonte përse

gjermano lindorët nuk e mbyllnin kufirin e tyre për të ndaluar fluksin e refugjatëve. Për më tepër ai shtoi se ata, [lindorët] kishin të drejtë të bënин një gjë të tillë pa cënuar ndonjë traktat. Deklarata e tretë erdhi përsëri nga Kenedi vetë ku një jave pas fjalëve të Fullbrajtit, refuzoi të distancohej nga fjalët e senatorit kur u pyet në një konferencë shtypi ç'mendonte për to (Smyser, 1999:157).

Reagimi i Ulbrihtit ishte i menjëhershëm. Më 31 korrik 1961, duke cituar fjalët e Fullbrajtit që tregonin se SHBA-të nuk do t'i ndihmonin refugjatët, ai i kërkoi Hrushovit të mbyllte korridorët ajrorë ndërmjet Berlinit dhe Gjermanisë perëndimore sepse ata mbartnin refugjatë. Përgjigja e Hrushovit ishte përsëri e kujdeshme. Ai i tha liderit gjerman se kishte nevojë për aprovin e Traktatit të Varshavës që të mund të ndërmerrte një hap të tillë (Smyser, 1999:158). Por, Ulbrihti këmbënguli. Në takimin e datave 3 dhe 5 gusht 1961, ai i tha liderit sovjetik se gjermano perëndimorët po minonin përpjekjet e Kenedit dhe Makmillanit për të firmosur një traktat paqeje me Gjermaninë. Gjithashtu, ai paralajmëroi se RFGJ-ja po negacione që të merrte armë bërthamore nga aleatët perëndimorë për t'i përdorur kundër Traktatit të Varshavës. Për Ulbrihtin, problemi që duhej zgjidhur quhej Berlin perëndimor. Në takimet me aleatët e Traktatit të Varshavës ai tha se duhej bllokuar i tërë trafiku ajror i Berlinit perëndimor. Për t'ja mbushur më shumë mendjen aleatëve, Ulbrihti e kaloi çështjen në terma ekonomikë. Ai tha se ekzistanca e Berlinit perëndimor i impononte shtrëngesë ekonomike lindjes duke e detyruar të riste standartet gjë që nuk kishte mundësi ta bënte. (Smyser, 1999:158). Madje sipas tij, edhe KNER-i kërcënohej nga Berlini perëndimor.

Duke dëgjuar të gjithë këto argumente, Hrushovi dhe aleatët e tjerë lindorë i hapën rrugë ndërtimit të një muri ndarës. Fillimisht, lideri sovjetik kërkoi që të avancohej me kujdes,

duke vendosur rrëthim me tela me gjemba dhe më pas të shtrohej me beton. Më parë ai donte të shikonte sesi do të vepronin aleatët perëndimorë. Ulbrihti u instruktua që të vepronte me kujdes dhe të mos merrte asnje centimetër territor më shumë nga ndërtimi i murit. Puna nuk dukej kaq e thjeshtë. Hrushovi kërkonte garanci. Ai e pyeti aleatin e tij gjerman nëse policia e Berlinit lindor ishte gati për të shtypur çdo kryengritje që mund të shpërthente. Ai nuk dëshironte të përdoreshin tanket sovjetike si në 1953-shin. Ulbrihti u lejua të shkojë në Berlin për të verifikuar situatën. Pas tre ditësh, ai u rikthyen përsëri në Moskë duke argumentuar se deklaratat e Fullbrajtit dhe të Kenedit ishin ftesë për të mbyllur kufirin. Kryengritje nuk do të kishte (Filitov, 1994:18). Ulbrihti u rikthyen në Berlinin lindor i ngazëllyer. Ai kishte marrë leje nga Hrushovi për të ndalur fluksin e refugjatëve. Ndërtimi i një muri do të bëhej realitet. Por, në vend që të vepronte më me mençuri duke ndërprerë thjesht rrugët ajrore të komunikimit, Ulbrihti vendosi të betononte Berlinin lindor.

Më 5 gusht 1961, ministrat e jashtëm të Francës, Britanisë së Madhe dhe SHBA-ve u takuan fshehtasi në Paris për të diskutuar se çfarë lëvizjesh duhej të kryenin nëse Hrushovi dhe Traktati i Varshavës lëviznin kundër Berlinit perëndimor. Pas diskutimesh të gjata, ata ranë dakord që çdo lloj mase që do të merrte Hrushovi dhe Ulbrihti do të ishte thjesht e natyrës mbrojtëse dhe nuk kishte rrezik për luftë. Brenda tre javësh nga mbledhja e tyre sekrete, Hrushovi kishte në dorë një raport të plotë të këtij takimi (Filitov, 1994:28).

Për ta mbajtur nën kontroll Ulbrihtin dhe situatën në Berlin, Hrushovi dërgoi në vend marshallin Ivan Konjev (Ivan Konev) për të marrë kontrollin e forcave sovjetike në RDGJ. Konjevi ishte një gjeneral i zoti i cili kishte korru fitore të rëndësishme ndaj nazistëve në luftë dhe kishte nofkën 'tanku' (Smyser, 1999:159). Ardhja e gjeneralit sovjetik tregonte se

gjermano-lindorët ishin në dorë të sovjetikëve dhe nuk pyeteshin aspak se ç'mendonin për situatën. Por, Ulbrihitit aq i bënte. Mjafton që ai të ishte në krye dhe të siguronte akoma më shumë pushtetin e tij. Ai nuk kishte besim tek policia e Berlinit Lindor kështu që iu drejtua për ndihmë atyre që e kishin vënë dhe po e mbanin në pushtet. Policia sekrete Stasi u instruktua që të qëndronte në gadishmëri. Emri i koduar për fillimin e ndërtimit të murit ishte "trëndafili" (Smyser, 1999:160).

Shumë pak pas mesnate, më datë 13 gusht 1961 (e djelë), policia sekrete e RDGJ-së me urdhër të Ulbrihitit filloi të rrethojë të gjithë kufirin mes Berlinit lindor dhe atij perëndimor me tela me gjemba. Njëkohësisht, u mbyllën të gjithë stacionet e trenave dhe metrove kufitare. I rëndësishëm për t'u përmendur është fakti se trupat sovjetike nuk morën pjesë në këtë aksion. Në të njëjtën kohë, u lëshua një komunikatë e cila lajméronte se për gjermano lindorët kufiri ishte mbylur, por jo për gjermano perëndimorët, dhe berlinezët perëndimorë. Gjithashtu, komunikata lajméronte se mbyllja e kufirit nuk ia kufizonte të drejtën aleatëve perëndimorë për të hyrë në Berlinin lindor. Njëkohësisht, Traktati i Varshavës mbështeti lëvizjen e qeverisë gjermano lindore (Smyser, 1999:160).

Zhgënjimi i berlinezëve dhe gjermanëve të lindjes ishte i madh. Ata mbetën si peshku pa ujë në dyert e trenave dhe të metrove duke parë sesi u shkrumbua ëndrra e tyre për të kaluar në perëndim. Qindra familje të Berlinit u ndanë në dy anët e kufirit për t'u ritakuar pas 28 vjetësh kur do të shembej edhe sistemi komunist në RDGJ. Policië e të dyja anëve të kufirit ishin në gadishmëri numër një. Veçanërisht, policia e Berlinit perëndimor u mundua të mos lejonte asnjë turmë t'i afrohej telave me gjemba pasi mund t'i mësynte ato duke nxitur bashkëqytetarët e tyre nga ana tjetër dhe duke rrezikuar që të kishte viktima (Cate, 1978:205).

Kryetari i Bashkisë së Berlinit Perëndimor dhe kancelari i ardhshëm Vili Brand (Willy Brandt) u përpoq të kontrollonte situatën. Zyrat e ndërlidhjes së informacionit të aleatëve në Berlinin perëndimor njoftuan qendrat e tyre lidhur me atë që po ndodhët në pritje të urdhërave. Asnjë urdhër nuk erdhi. Uashingtoni e priti me një ftohtësi të akullt lajmin për ndarjen përfundimtare të Berlinit. Shpërfillja e Shtëpisë së Bardhë ishte acaruese deri në ofendim. Foi Kohleri, asistenti i sekretarit amerikan të shtetit u shreh edhe më me cinizëm duke thënë:

"Gjermano lindorët na bënë një nder" (Rusk, 1990:225).

Kenedi, Fullbrajti, Kohleri dhe Din Rasku kishin lejuar me veprimet e tyre të çimentohej copëtimi i çështjes gjermane. Populli gjerman po vijonte të fyhej dhe të poshtërohej. Ende emri i këtij populli të jashtëzakonshëm kishte nevojë të pastrohej nga mëkatë i madh i Luftës së Dytë Botërore. Ende perëndimi dhe mbarë bota ndjenin neveri dhe frikë kur përmendej emri gjerman. Aq i madh ishte cinizmi i amerikanëve saqë Din Rasku i tha presidentit Kenedi se '*gjermano-lindorët nuk përbën rrezik për paqen*' (Rusk, 1990:225).

Për të përforcuar mendimin e tij, Din Rasku shtoi se me mbylljen e kufirit nuk cënohej e drejta e aleatëve për në Berlinin lindor duke cituar deklaratën e Traktatit të Varshavës. Kenedi dhe Rasku arritën në përfundimin se mbyllja e kufirit në Berlin i jepte fund njëherë e përgjithmonë krizave në atë qytet (Rusk, 1990:225). Miopia politike e Kenedit dhe Raskut i shkonte për shtat Ulbrihtit. Sapo u njoftua se amerikanët nuk do të lëviznin as gishtin e vogël për t'u dalë në krah berlinezëve, fshehtasi lideri gjerman filloi të propagandojë në Berlinin perëndimor se amerikanët e kishin ditur qysh në fillim se çfarë do të ndodhë, por nuk kishin vepruar (Smyser, 1999:162). I dëshpëruar, Vili Brandi i shkroi presidendid Kenendi. Ky i fundit e konsideroi letrën e Brandit si kurth pasi po afronin dhe zgjedhjet dhe lutja e kryebashkiakut për një status të barabartë të Berlinit me të tria fuqitë

aleate u hodh poshtë. Kenedi sapo e kishte shitur Berlinin lindor dhe nuk do të ishte hera e parë që vepronte politikisht në këtë mënyrë përballë një krize. Dërgimi në vend i zv/presidentit Lindon Xhonson nuk e rregulloi situatën. Kenedi me pacifizmin e tij të tepruar nuk e kuptonte se fuqia e Bashkimit Sovjetik qëndronte tek frika që impononte, jo tek respekti. Këtë presidenti do ta mësonte një vit më vonë kur Bashkimi Sovjetik do të dërgonte raketa me mbushje bërthamore në Kubë nën hundën e tij. Edhe dy aleatët e tjerë perëndimorë Franca dhe Britania e Madhe (sidomos kjo e fundit) mbajtën një qëndrim të ftohtë.

Ngjarjet e 13 gushtit 1961 shpërthyen një debat të madh tek aleatët perëndimorë. Makmillani këmbëngulte për negociata më të dendura me Hrushovin. Dë Goli mbante qëndimin e tij të vakët duke i kujtar Kenedit në një letër tre çështje thelbësore: 1)Hapja e negociatave nën presion do të merrej si shenjë braktisjeje të Berlinit dhe mund të interpretohej si dorëzim. 2)Bashkimi Sovjetik mund të konkludonte marrëveshje me çdo aleat perëndimor veçmas (duke aluduar këtu Gjermaninë Perëndimore duke parë braktisjen e saj nga ana e aleatëve). 3)Franca nuk do të merrte pjesë në bisedime të cilat do të drejtohen nga Moska (Smyser, 1999:164). Në fakt, me këtë letër, presidenti dë Gol po i ngrinte një kurth Kenedit. Ai synonte të shkaktonte mosbesimin gjerman tek amerikanët dhe rikthimin përfundimtar të Bonit drejt Parisit.

Adenaueri nuk kishte rrugë tjetër. Ai e dinte se aleatët perëndimorë nuk kishin asnje strategji për të kundërshtuar Bashkimin Sovjetik lidhur me situatën në Berlin. Kenedi dhe Makmillani më parë binin dakord me Hrushovin sesa mbronin interesat e vendit të tij. Gjermania duhej të bënte durim dhe të forcohej akoma më shumë ekonomikisht. Sa më shumë të forcohej, aq më e pavarur do të ishte në politikën e jashtme. Por, duhej të kalonte

ende kohë. Kenedi do të shkonte akoma më larg dhe do të njihet edhe Gjermaninë lindore si shtet për hir të paqes në Berlin duke i dhënë një tjetër grusht të rëndë RFGJ-së. Koncessionet e shumta të Kenedit ndaj Bashkimit Sovjetik nuk do të shikoheshin me sy të mirë në strukturat vendimmarrëse në SHBA dhe Gjermaninë Perëndimore. Hrushovi dhe Ulbrihti kishin korrur një fitore të madhe. Tashmë, ata ndjeheshin të sigurtë se mund të ushtronin presion diplomatik ndaj Kenendit që të hiqte dorë nga tre parimet e tij për Gjermaninë. Me të mbyllur kufirin me perëndimin, ata iu vunë punës për të minuar autoritetin e aleatëve perëndimorë në Berlin.

## 6.5. Beteja për Berlinin perëndimor

Një muaj pas fillimit të ndërtimit të Murit të Berlinit, dukej sikur lindja po mbizotëronte në perëndim. Për të menaxhuar situatën e krijuar dhe për t'u treguar gjermano perëndimorëve se SHBA-të nuk i kishin braktisur, presidenti Kenedi dërgoi në qytet më 19 shtator 1961 si përfaqësues personal të tij, gjeneralin e famshëm Lusjus Klei (Smyser, 1999:167). Gjenerali ishte një figurë e njohur dhe e respektuar nga gjermanët pasi në krizën e parë të Berlinit të pas luftës më 1948, kishte dhënë kontributin e tij personal në furnizimin e qytetit me ushqime e ilaçë pas bllokadës së Stalinit. Për ndër të tij, kryebashkiaku Vili Brandt, ftoi bashkëqytetarët të dilnin në rrugë për të përshëndetur një mik.

Sapo mori detyrën, Klei e kuptoi se Ulbrihti nuk kishte vetëm për qëllim të çimentonte Berlinin lindor, por të neutralizonte edhe perëndimorin. Ndryshe nga ç'mendonin superiorët e tij në Uashington, gjenerali mendonte se ndërtimi i Murit ishte vetëm fillimi i një beteje të gjatë për Berlinin. Ai besonte se shefi i RDGJ-së do ta rriste presionin e tij mbi perëndimin. Kjo ishte një betejë morale e cila duhej të fitohej patjetër. Për momentin Ulbrihti po fitonte

pasi aleatët perëndimorë kishin hezituar. Muri po ndërtohej me shpejtësi dhe pikë-kalimet po zvogëloheshin. Trafiku në portën e famshme të Brandenburgut u pezullua. Madje për të treguar sesa të dobët ishin perëndimorët, Ulbrihti lejoi që ata të kalonin për në Berlinin lindor vetëm nga një pikë. Pika e kufirit më e famshme ishte Checkpoint Charlie që në ditët në vijim do të kthehej në simbol të rezistencës perëndimore. Sikur të mos mjaftonte kjo, Ulbrihti "urdhëroi" berlinezët perëndimorë që të qëndronin jo më afër se 100 metra larg murit. Ata që do t'i afroheshin më shumë, do të qëlloheshin. Ata që kishin shtëpitë afër, duhej të bënin kujdes që të numëronin edhe hapat.

Ndërtimi i Murit e zgjidhi problemin e refugjatëve në Berlinin lindor. Gjithnjë e më pak njerëz po gjenin ndonjë mënyrë për të kaluar në perëndim. Numri i të pushkatuarve në përpjekje për të kaluar murin sa vinte e rritej dhe perëndimorët nuk bënin asgjë. Berlinezët perëndimorë e kuptuan se Ulbrihti ishte me të vërtetë i fortë. Më 16 shtator 1961, Ulbrihti i shkruante Hrushovit se "armiku ka marrë masa më pak nga ç'e prisnim". Ai gjithashtu, sugjeroi se masat duheshin rritur edhe në pikë-kalimet e mbetur. Sipas ambasadorit, sovjetik në RDGJ, e vetmja gjë që kishte mbetur ishte nënshkrimi i njëanshëm i traktatit të paqes dhe Ulbrihti nuk mund të bënte asgjë për ta ndaluar atë. (Smyser, 1999:168).

Klei nuk kishte shumë kohë për t'i treguar dhëmbët Ulbrihitit. Rasti erdhi më 21 shtator 1961 kur rojet gjermano lindore të kufirit po provokonin disa punonjës të misioneve perëndimore duke kaluar nga lindja në perëndim. Madje, ata që ishin amerikanë u mbajtën për orë të izoluar dhe gjermanët e panë me sy sesi policia sekrete Stasi tallej me amerikanët (Smyser, 1999:169). Si kundërpërgjigje megjithë protestat sovjetike, Klei dërgoi patrulla të armatosura për të liruar amerikanët. Vendosmëria amerikane bëri që Stasi të mendohej dy herë përpara se merrej më me ta. Klei gjithashtu, rriti praninë e forcave amerikane në çdo

pikë kufitare. Sovjetikëve që kalonin kufirin nga lindja për në perëndim, ia bëri jetën ferr aq sa Konjevi i kërkoj Ulbrihit që të mos ngacmoheshin më amerikanët. Por, ajo që e bëri Ulbrihtin të besonte se Klei nuk po tallej ishte rasti i një refugjati lindor i cili ia kishte dalë mbanë të kalonte pikat dhe kishte ngecur në zonën neutrale të Shtainshtyken shumë pranë zonës amerikane. Megjithë kërcënimet e Stasit, Klei dërgoi një pilot të vetëm të shoqëruar nga asistenti i tij për të marrë refugjatin m'u përpara hundës së lindorëve. Kërcënimet dhe drejtimet e armëve kundër helikopterit nuk e prapsën misionin edhe për faktin se Stasit nuk ia mbante të qëllonte një mjet fluturues amerikan (Smith, 1990:658).

Me këtë akt, Klei kishte nxjerrë konkluzionet e veta lidhur me problemin në fjalë. Ai u bind përfundimisht se Hrushovi nuk do ta përshkallëzonte më tej situatën në Berlin. Ndryshe nga këshilltarët e Kenedit, ai u bashkua me mendimin e dë Golit se lideri sovjetik nuk donte luftë. Konkluzioni i tij ishte se çdo lëvizje e Hrushovit sado e fortë që të dukej, ishte thjesht një bllof. Gjenerali, ndër të tjera mendonte se çdo lëvizje perëndimore do t'ia prishte gjumin Hrushovit. Pëpara ardhjes së Kleit, Hrushovi dhe Ulbrihti besonin se perëndimoret nuk do të guxonin të vepronin kundër provokimeve sovjetike. Më e shumta që ata mund të bënin ishte protesta nëpërmjet notave zyrtare. Klei nuk e kishte ndërmend të dërgonte nota në rast provikimi, por tanke. Për t'i dhënë fund krizës së Berlinit, Klei duhej të tregohej në sytë e Hrushovit dhe Konjevit sa më i rrezikshëm që të mundej. Një përplasje në Berlin nuk do t'i hapte rrugë përplasjes bërthamore. Sikur të mos i mjaftonin telashet në Berlin, Kleit i duhej të merrej edhe me këshilltarët frikacakë të Kenedit. Ata e kishin këshilluar keq presidentin duke i mbushur mendjen se Hrushovi do të lëvizte sy për sy e dhëmb për dhëmb për Berlinin. Por, Klei i njihte më mirë se këshilltarët e Uashingtonit ushtarakët e

Hrushovi. Botimi i kujtimeve të gjeneralit në biografinë e referuar, i jep plotësisht të drejtë atij (Smith, 1990:600).

Ministri sovjetik i mbrojtjes, marshalli Rodion Malinovksi, e bindi Hrushovin që t'i tërhiqte vëmendjen Ulbrihit që të mos provokonte më amerikanët. Sipas tij, Klei priste vetëm rastin për të hyrë në luftë (Smith, 1990:602). Andrei Gromiko shpresonte akoma që nëpërmjet negociatave t'i detyronte aleatët perëndimorë të braktisin Berlinin. Valter Ulbrihti as që donte t'ia dinte për paralajmërimet sovjetike (Cate, 1978:476). Në raportin e tij të parë të plotë për Kenedin të shkruar më 18 tetor 1961, gjenerali Klei argumentonte se ndaj veprimeve të Ulbrihit duhej vepruar fort dhe pa mëdyshje. Madje, Klei shkoi deri aty sa kërcënoi me dorëheqje nëse Kenedi nuk do ta mbështeste (Smith, 1990:610).

Shansi më dramatik që vuri vërtet në provë aftësitë e Kleit në menaxhimin e situatave të rrezikshme u paraqit në tetor 1961. Më 16 tetor 1961, kishte nisur punimet Kongresi XXII i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ku Hrushovi deklaroi publikisht se nuk do të nxiste një konflikt për Berlinin dhe se ultimatumi që skadonte më 31 dhjetor për të nënshkruar traktatin e paqes shtyhej për një kohë të pacaktuar (Smyser, 1999:172). Ky fjalim ishte një goditje e fortë për Ulbrihtin i cili kërkonte me doemos veprim kundër perëndimit. Të ushtroje presion pa vendosur një afat për trakatin e paqes ishte shumë e rëndë (Slusser, 1973:179). Lideri gjerman vendosi të veprojë me kokën e tij. Ai donte t'u tregonte berlinezëve perëndimorë sesa të pafuqishëm ishin amerikanët. Më 17 tetor 1961, forcat e Stasit në Checkpoint Charlie ndaluan një zyrtar amerikan të quajtur Lajtner (Lightner). Ata i kërkuan t'u jepte dokumentet e identifikimit, por ai refuzoi t'jua tregonte pasi targat e makinës mjaftonin që të identifikohej si zyrtar amerikan i forcave të pushtimit (Slusser, 1973:180). Stasi e mbajti të izoluar Lajtnerin. Kur e mësoi Klei, dërgoi me

urgjencë një skuadër të armatosur për ta marrë edhe me forcë në rast nevoje zyrtarin amerikan. Në këtë situatë të pakëndshme, sovjetikët nuk kishin të bënин fare. Kur u shfaqën amerikanët, gjermanët u prapsën. Sovjetikët u justifikuan se ndalimi i Lajtnerit kishte qenë gabim (Slusser, 1973:180).

Por Ulbrihti nuk u mjaftua me kaq. Ai mendoi ta përshkallëzonte konfliktin deri në pikën sa ta detyronte Hrushovin që të përfshihej. Më datë 23 tetor 1961 (e hënë), gazeta zyrtare e RDGJ-së Neues Deutschland, botoi dekretin në të cilin shkruhej se të gjithë pa përjashtim kur kalonin kufirin duhej të paraqitnin kartën e identitetit (Smyser, 1999:173). Në këtë moment, Hrushovi nuk mund të lejonte që aleatit të tij më të afërt në përplasjen me perëndimin t'i merrej fytyra.

Sikur të mos i mjaftonin telashet me Ulbrihtin, Klei duhej të merrej edhe me Uashingtonin. Për t'u treguar këshilltarëve të Kenedit se e kishin gabim, Klei bëri një provë. Mëngjesin e 25 tetorit 1961, misioni amerikan dërgoi dy ushtarë në Checkpoint Charlie, por të veshur civilë. Kësaj here sovjetikët mbështetën Stasin. Hrushovi i kishte dalë në krah të aleatit të tij. Klei duke parë situatën dërgoi dhjetë tanke në pikën e kalimit. Prania e tankeve i alarmoi sovjetikët. Gjermano lindorët nuk kishin asnjë autoritet të përplaseshin me amerikanët. Çështja shtrohej; ose sovjetikët do të përballeshin me tanket amerikane, ose t'ja linin në dorë aleatëve të tyre komunistë këtë gjë. Klei dëshironte që sovjetikët të dilnin hapur. Si për t'i provokuar më tej sovjetikët, ai dërgoi përsëri një makinë të kalonte kufirin. Edhe një herë policia gjermane e bllokoi makinën. Trupat amerikane e shoqëruan deri sa doli nga bllokimi. Konjevi nuk donte t'ja linte në dorë situatën Ulbrihit dhe me inisitivën e vet dërgoi dhjetë tanke pak më tutje Checkpoint Charlie.

Mbërritja e tankeve sovjetike i shkoi për shtat Kleit. Ai vijoi ta përsërítë testin e tij. Edhe një herë gjermanët e bllokuan makinën e dërguar prej tij dhe përsëri amerikanët e liruan atë pa folur fare. Tanket sovjetike u shtuan në numër dhe u afroan tek pika e kufirit. Kur ra mbrëmja tanket amerikane dhe sovjetike ishin përballë njëri tjetrit. Klei u kënaq pa masë kur pa tanket. Ai menjeherë thirri një konfrencë për shtyp ku deklaroit se më në fund sovjetikët kishin marrë përgjegjësitë e tyre për funksionimin normal të kufirit. (Clay, 1950:614). Por shtypi në Uashington, Londër dhe Paris kishte dhënë lajme alarmuese. Kenedi i telefonoi Kleit në Berlin për t'i kërkuar sqarime. Klei tha se nuk kishte asgjë për t'u shqetësuar pasi tanket sovjetike kishin shmangur një përplasje mes amerikanëve dhe provokatorëve gjermano lindorë. Si për ta shtruar pak më në humor bisedën, Klei i tha Kenedit se nuk e kishin lëshuar nervat, por shqetësohej se mos nervat kishin lëshuar këshilltarët e presidentit. Kenedi e kuptoi dhe i tha duke qeshur:

*"Mua nuk më kanë lëshuar nervat, por shumë të tjerë këtu po"* (Clay, 1950:661).

Ballafaqimi nuk zgjati shumë. Në orën dhjetë e gjysëm të mëngjesit tjetër, tanket sovjetike filluan të tërhiqen. Në më pak se gjysëm ore, të gjithë tanket ishin larguar nga Checkpoint Charlie. Triumfi në pikën e kalimit forcoi moralin e berlinezëve perëndimorë dhe tek gjenerali Klei panë një njeri që nuk do t'i braktiste. E vetmja gjë që fitoi Ulbrihti ishte urdhri i Kenedit që zyrtarët amerikanë në Berlin të mos e kalonin më kufirin me rroba civile. Nga përballja në Checkpoint Charlie, Kenedi nxori një mësim të mirë. Deri në atë moment ai besonte se sovjetikët mund të përshkallëzonin situatat deri në shpërthimin e një lufte, por situata e 25 tectorit i provoi të kundërtën. Ky test do t'i viente shumë Kenedit një vit më vonë.

Nikita Hrushovi u justifikua se urdhëroi tërheqjen e tankeve si shenjë për të mos vrarë paqen. Padyshim që ai e kuptonte se kishte humbur shumë. Aleatët perëndimorë ishin

trembur jo pak. Makmillani shkoi deri aty sa nëpërmjet ambasadorit britanik në Berlin në takimin me ambasadorin sovjetik u shpreh se Klei kishte vepruar me kokën e tij dhe së shpejti do të largohej nga detyra (Macmillan, 1972:405). Përballja në Checkpoint Charlie ishte një fitore e madhe për Berlinin Perëndimor. Hrushovi u njoh me limitet e forcës së tij në Berlin. Ai mësoi se më mirë ishte t'i menaxhonte krizat në marrëveshje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës sesa t'ua linte të tjerëve këto punë.

## **6.6. Dueli Kenedi vs. Hrushov**

Përplasja e akullt SHBA - BS do të ishte kryefjala e 25 viteve të para të Luftës së Ftohtë. Në qendër të këtij konfrontimi ishte Gjermania. Por, vendi teuton nuk ishte qendra e botës dhe nuk përfshinte të gjithë gamën e gjerë të garës për mbizotërim botëror të dy superfuqive. Vdekja e Stalinit më 5 mars 1953, padyshim që kishte sjellë një shpresë për shmangje të çdo konflikti mes dy shteteve më të fuqishme të botës. Fatkeqësisht, një gjë e tillë nuk ndodhi.

Ekperienca e diplomacisë botërore dhe e marrëdhënieve ndërkombëtare në shekuj, ka treguar se e drejta e pa mbështetur në forcë është e destinuar të vdesë. Pas përfundimit të Luftës II Botërore, Shtetet e Bashkuara të Amerikës iu vunë punës për të ndërtuar një arsenal të qëndrueshëm bërthamor. Në mesin e viteve '50 numri i armëve bërthamore në posedim të SHBA-ve ishte më shumë se 300 nga 13 që kishte qenë deri në vitin 1947 (Stone, 2012:227). Teknologjia për të lëshuar këto bomba në kohë sa më të shpejtë u përmirësua ndjeshëm. Atëkohë, një bombë e tillë e lëshuar mbi një qytet sovjetik, kishte aftësinë të vriste sa hap e myll sytë 2.5 milion njerëz (Stone, 2012:228).

Xhejms Forestall (James Forrestal) sekretari i mbrojtjes i atyre viteve, kishte këshilluar presidentin Ajzenhauer se 'një sulm masiv mbi Bashkimin Sovjetik do të legjitimonte propagandën komuniste dhe do të shuanë lëvizjet e popujve kundër tiranisë' (Herken, 1982:279). Në gusht të vitit 1949, Bashkimi Sovjetik e testoi me sukses bombën atomike duke ia shkëputur Amerikës monopolin e saj. Barazia atomike do të shtynte një sërë njerëzish me ndikim të madh në ushtri dhe shkencë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës që të hidhnin idenë e ndërtimit të bombës me hidrogen. Në një mbledhje me dyer të myllura të Senatit për çështje të sigurisë, gjenerali Xhejms MekKormak (James McCormack), drejtor i divizionit ushtarak të energjisë së aplikuar, deklaroi se nga ky moment gara e armatimeve do të kishte si limit diellin (Herken, 1982:280). Gara ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik nuk do të kufizohej vetëm në armatime, por edhe në ideologji. Nëse në Bashkimin Sovjetik ndalohej çdo formë e pluralizmit, edhe SHBA-të nuk mbetën më prapa në të luftuarit e çdo simptome komuniste në vend. Senatori Xhozef MekKarti (Joseph McCarthy) u kthye në simbol të luftës politike antikomuniste me metoda jo-ortodokse. Lufta kundër komunizmit në SHBA mori formën e një gjuetie shtrigash. Në janar të vitit 1950, ish zyrtari i Departamentit të Shtetit Alxher His (Alger Hiss) në përplasjen me senatorin Riçard Nikson (Richard Nixon) do të akuzohej për dëshmi të rreme. Fizikanti Klaus Fuks (Klaus Fuchs) do të arrestohej me akuzën se i kishte dhënë Bashkimit Sovjetik formulën e ndërtimit të bombës bërthamore. Arrestimi i tij çoi në një varg arrestesh ndërmjet të cilëve edhe çifti i famshëm Etel dhe Xhulius Rozenberg (Stone, 2012:231).

Rritja ekonomike e Shteteve të Bashkuara të Amerikës po rriste edhe prestigjin e saj ushtarak. Megjithatë, situata nuk dukej shumë optimiste. Në vitin 1952, president i

Shteteve të Bashkuara të Amerikës zgjidhet gjenerali i famshëm i Luftës II Botërore, Duajt Ajzenhauer (Dwight Eisenhower). Në kujtimet e tij për gjeneralin, marshalli i famshëm sovjetik Georgij Zhukov ka shkruar:

*"Gjenerali Ajzenhauer është një njeri i madh jo vetëm prej arritjeve të tij ushtarake, por sepse është njerëzor, miqësor, i sjellshëm dhe i çiltër"* (Ambrose, 1999:55).

Në fjalimin e tij të lamtumirës përpara ushtarakëve ish kolegë tij, presidenti e tregoi humanizmin duke bërë deklaratën e bujshme:

*"Siguri kombëtare nuk do të thotë militarizëm apo çdo gjë të ngjashme me të. Siguria nuk matet me numrin e kokave bërrthamore apo me numrin e ushtarëve dhe me monopolin e armës më të fuqishme. Kjo ishte ideja gjermane dhe japoneze e fuqisë e cila në provën e luftës, tregoi se nuk funksionon. Edhe në kohë paqeje, treguesi i fuqisë materiale është i pamjaftueshëm pasi armët harrohen dhe kthehen në të pavlera. Ushtritë e mëdha bien nga forca e kombeve të tyre, monopoli i armës së shpejti thyhet"* (Ambrose, 1999:60).

Gjatë kohës që shërbeu si president, Ajzenhaueri u përball me garën e armatimeve. Të jesh kryetari i kombit më të fortë në të gjithë historinë njerëzore është detyra më e vështirë në botë. Menaxhimi i forcës në kohë paqeje është më i vështirë se komandimi i ushtrive në kohë lufte. Çdo shtet përgatitet për luftë. Ndodh, që lufta del jashtë kontrollit pasi nuk menaxhohet mirë paqja. Në një nga fjalimet e tij më të ndritshme të bëra ndonjëherë nga një president konservator, Ajzenhaueri është shprehur më 17 prill 1953:

*"Çdo pushkë që bëhet, çdo anije lufte që ndërtohet, çdo raketë e lëshuar është vjedhje ndaj atyre që kanë uri dhe nuk ushqehen, është kundër atyre që kanë ftohtë dhe janë zhveshur. Kjo botë...po çon dëm djersën e punëtorëve të saj, gjenialitetin e shkencëtarëve, shpresën e fëmijëve. Çmimi i ndërtimit të një bombe të rëndë është sa të ndërtosh shkolla në më shumë se 30 qytete. Është i barabartë me dy stacione elektrike në shërbim të 60 mijë qytetarëve. Është i barabartë me dy spitale të mirëpajisur. Është i barabartë me 100 km rrugë të shtruar. Ne paguajmë për një avion gjuatjës sa për gjysëm milioni shinik grurë. Ne paguajmë për një destrojer të vetëm sa për shtëpi ku strehohen 8 mijë njerëz...Kjo nuk është mënyrë jetese...Nën renë e kërcënimit të luftës, njerëzimi varet nga një kryq hekuri"* (Ambrose, 1999:60).

Edhe pse e dinte se çfarë do të thoshte luftë, në epokën e Ajzenhauerit kapaciteti bërthamor amerikan u rrit disa dhjetëra herë me çmime astronomike dhe me baza në çdo cep të botës.

Kjo ishte trashëgimia që Ajzenhaueri i la presidentit Xhon Kenedi.

Të menaxhoje një megastrukturë atomike dhe ekonomike siç ishin dhe janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, padyshim që ishte një përpjekje titanike. Xhon Kenedi ishte presidenti më i ri i zgjedhur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në duelin me liderin sovjetik, Kenedi ishte i papërvojë. Nikita Hrushovi kishte shumë të përbashkëta me paraardhësin e Kenedit. Të dy kishin patur arsimim të thjeshtë. Kenedi vinte nga tjetër shtresë. Atij nuk i ishte dashur të luftonte fort për t'i arritur gjërat. Familja dhe veçanërisht i ati, do të kujdeseshin deri në detaje për karrierën e tij. Në vitin 1957, Bashkimi Sovjetik testoi me sukses të madh raketën e parë ndërkontinentale balistike (ISBM) (Stone, 2012:275). Kjo ishte një goditje e madhe për industrinë atomike amerikane. Me këtë hap, sovjetikët hodhën poshtë idenë se SHBA-të ishin superiore ndaj BS-së dhe në rast të një lufte bërthamore, amerikanët do të fitonin. Raketat balistike u kthyen në një problem real për sigurinë amerikane. Hapësira ishte ambjenti i ri ku do të zhvillohej gara. Më 3 nëntor 1957, sovjetikët testuan për herë të parë një qenie tokësore (qeni Laika) në hapësirë me misionin e suksesshëm Sputnik II ku i treguan botës sesa larg kishte ecur teknologjia sovjetike (Stone, 2012:276).

Në këtë situatë aspak premtuese, Xhon Kenedi mori pushtetin në SHBA. Në fjalimin e tij inagurues, presidenti i ri shpalosi doktrinën e cila ka hyrë në histori me emrin e tij duke deklaruar:

*"Për të mbrojtur lirinë në orën e saj më të rrezikshme, ne do të paguajmë çdo çmim, do të mbajmë çdo peshë dhe do të tejkalojmë çdo vështirësi"* (Stone, 2012:291).

Ishte padyshim një deklaratë e fuqishme që tregonte se edhe Kenedi do të ekte në hapat e Trumanit dhe Ajzenhauerit. Përplasja e parë e Kenedit me botën komuniste do të ishte në ishullin e Kubës në jug të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Fillimisht, Kenedi nuk e anuloi planin e Ajzenhauerit për të stërvitur 1500 emigrantë kubanezë në Guatemalë. Fidel Castro kishte hyrë në vitin e dytë të pushtetit të tij dhe kishte shtetëzuar të gjitha kompanitë amerikane në vend. Rënia e Fulgencio Batistës nga pushteti ditën e Vtit të Ri 1959, i kishte hapur rrugën një diktature komuniste në ishull, përpara hundës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Një kërcënim komunist qoftë edhe nga një ishull i vogël ishte i papranueshëm për Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kenedi fillimisht, ishte dyshues për suksesin e këtij aksioni, por shefi i CIA-s Alen Dallas e siguroi se ishin marrë masat dhe se një pushtim i ishullit nga jashtë do të nxiste revoltën e popullsise brenda (Stone, 2012:291). Por, gjërat do të shkonin shumë ndryshe. Fidel Castro duhej eliminuar dhe së bashku me të i jepej një mesazh i qartë të gjithë Amerikës Latine se SHBA-të nuk do të toleronin komunizmin në kontinentin amerikan. Më 15 prill 1961, operacioni ushtarak amerikan në Gjirin e Derrave filloi me bombardimin e fushave të vogla të aviacionit për të neutralizuar kundërpërgjigjen kubane. 1.511 kubanë të stërvitur zbarkuan në gjii (Weiner, 2007:174).

Qysh në fillim u pa se operacioni ishte tërësisht i keqorganizuar. Më datë 16 prill në orën 18:00, ambasadori i SHBA-ve në Kombet e Bashkuara i dërgoi me kabllogram njoftimin Din Raskut se "ekzistonte rreziku i një dështimi të bujshëm si në rastin e avionit U-2". (Weiner, 2007:175). Trupat nuk po avanconin pasi mbështetja ajrore ishte ndalur. Në orën 4:30 të mëngjesit të datës 17 prill situata e luftëtarëve kubanë ishte në rrezik asgjësimi. Kenedi nuk po urdhëronte sulmin ajror të ndjekur nga një pushtim eventual i ishullit.

Megjithë kërkesën e dëshpëruar të komandantit të luftëtarëve kubanë të trajnuar nga CIA, ndihma nuk erdhi. Më 19 prill 1961, gjithçka kishte marrë fund. Operacioni Gjiri i Derrave kishte zgjatur vetëm 60 orë. Nga luftëtarët kubanë të stërvitur nga CIA, 1189 ishin zënë robër dhe 114 ishin vrarë në luftim (Weiner, 2007:176). Amerikanët humbën 4 pilotë të kontraktuar nga CIA nga qendra kombëtare e fluturimit në Alabama. Për vite me radhë CIA e fshehu të vërtetën e vdekjes së tyre prej familjarëve dhe vejushave. Një prej vétéranëve të CIA-s dhe hartues i projektit për të rrëzuar Kastron i quajtur Grejston Linç (Grayston Lynch) do të shkruante në ditarin e tij:

*"Më vjen turp prej vendit tim"* (Weiner, 2007:177).

Dështimi i operacionit Gjiri i Derrave për rrëzimin e Fidel Kastros pushtoi faqet e para të gazetave anembanë SHBA-ve dhe botës. Gazeta Chicago Tribune, të nesërmën e dështimit shkroi:

*"Rezultati i "pushtimit" të Kubës tregoi se diktatura kastriste është më e fortë se kurrë dhe komunistët anembanë botës i kanë dhënë një shkelm të fortë dhëmbëve të Amerikës"* (Stone, 2012:293).

Aleatët evropianë u tronditën së tepërm nga fiaskoja amerikane. Nga Evropa, Din Acesoni raportonte se 'evropianët ishin shtangur' (Brinkley, 1994:127). Nëse një vend aq i vogël ia kishte dalë mbanë t'i bënte ballë fuqisë amerikane, çfarë do të ndodhët nëse vërtet Bashkimi Sovjetik do të kërcënonte Amerikën? A do të mund të mbijetonte NATO-ja dhe strukturat e tjera euro-atlantike?

Refuzimi i Kenedit për të ndihmuar luftëtarët kubanë anti Kastro u muar si shenjë dobësie e presidentit. Puna shkoi deri aty sa në shtyp u bënë aludime lidhur me dobësinë e familjes Kenedi në politikë duke sjellë ndërmend edhe qëndrimin e butë të ambasadorit Kenedi (të atit të Xhonit) në kohën e krizës çekosllovake më 1938, kur deklaroi se përmbrushja e dëshirave nacionaliste të Hitlerit do të shmangete luftën. Ballafaqimi i parë i Kenedit me

Hrushovin u bë në Vjenë në qershori të vitit 1961. Çështja gjermane zuri gati të gjithë formatin e e takimit ku superioriteti politik i Hrushovit doli shumë në dukje. Në një debat me gazetarët amerikanë, Hrushovi lidhur me Gjermaninë shtoi:

*"Unë mund ta kuptoj se përse amerikanët e shikojnë Gjermaninë si një vend ndryshe nga sa e shohim ne... Ne kemi një histori shumë më të gjatë me Gjermaninë. Ne e kemi parë sesa shpejt ndryshonin qeveritë në Gjermani dhe sa e thjeshtë ishte për Gjermaninë të kthehej në vrasëse masive. Është e vështirë edhe për ne të numërojmë sesa është numri i të vrarëve prej Gjermanisë në luftën e fundit... Ne kemi një shprehje: "Jepini një pushkë një gjermani dhe herët a vonë do ta drejtojë nga Rusia". Kjo nuk është thjesht ndjenja ime. Nuk besoj se ka ndjenjë që e shqetëson më shumë popullin rus sesa riarmatimi i Gjermanisë. Juve në Amerikë ju pëlqen të thoni se ne nuk kemi opinion publik. Mos jini kaq të sigurtë për këtë. Për çështjen e Gjermanisë populli ynë i ka idetë e qarta. Nuk mendoj se ka ndonjë qeveri që do të mbijetojë në Rusi nëse pajtohet me këtë. Këtë ia kam thënë edhe një guvernatorit tuaj dhe ai më tha se nuk e kuptonte sesi Bashkimi Sovjetik megjithë këto bomba bërthamore që ka, i frikësitet sërisht Gjermanisë. I thashë se nuk e kishte kuptuar situatën. Sigurisht, ne mund ta shtypim Gjermaninë për disa minuta. Ajo që na shqetëson është aftësia e Gjermanisë për të përfshirë Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krah të saj. Ne e kemi frikë aftësinë e Gjermanisë për të filluar një lufi bërthamore. Ajo që më shqetëson është se si ka mundësi që ekzistojnë amerikanë që nuk e kuptojnë se Gjermania dëshiron ta shkatërrrojë Bashkimin Sovjetik. Sa herë ju duhet të digjeni në mënyrë që të respektoni zjarrin?" (Stone, 2012:297).*

Pas këtyre fjalëve të Hrushovit, Kenedi me një pamje për të ardhur keq, shtoi:

*"Do të jetë një dimër shumë i ftohtë" (Stone, 2012:297).*

Dështimi i bisedimeve të Vjenës çoi në ndërtimin e Murit të Berlinit. Dukej sikur brishtësia politike e Kenedit po fundoste botën euro-atlantike. Por, drama e vërtetë në përballjen Kenedi vs Hrushov do të ndodhë në vjeshtën e vitit 1962. Kriza e raketave në Kubë në tetor të vitit 1962, për pak sa nuk e çoi botën drejt katastrofës bërthamore.

Më 14 tetor 1962, një avion zbulues amerikan tek po fluturonte sipër hapësirës ajrore të Kubës fotografoi pamje shqetësuese mbi ishull. Ditën tjetër, fotoanalistët përcaktuan se sovjetikët kishin vendosur raketa SS-4 balistike me rreze të mesme veprimi të afta për të lëshuar 1 megaton fuqi bërthamore mbi Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Stone, 2012:306). Kenedi, kur mori vesh lajmin mbeti si i shtangur. Drejtori i CIA-s dhe ekspertët më të mirë të çështjeve sovjetike që i përkisnin Partisë Republikane, e kishin paralajmëruar

se nuk do të ishte e largët dita kur Bashkimi Sovjetik do ta pajiste ishullin e vogël me armë të fuqishme për t'u mbrojtur prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Duke patur frikë për një pushtim të mundshëm të ishullit dhe nga ngjarjet e një viti më parë në Gjirin e Derrave, sovjetikët e kishin furnizuar Kastron me armë moderne dhe me raketa bërthamore të cilat po të bëheshin operative do ta bënин të brishtë sigurinë e Amerikës. Hrushovi i kishte premtuar Kenedit se në asnjë mënyrë apo formë do të vendoste armë ofensive në Kubë. Kësaj here, Hrushovi e shkeli fjalën dhe u justifikua me fjalët se "*do t'i jepte amerikanëve pak nga ilaçi i tyre*" (Maddock, 2010:197). Hrushovi kishte ndërmend të deklaronte hapur praninë e raketave bërthamore në Kubë më 7 nëntor 1962 ditën e përkujtimit të triumfit të revolucionit bolshevik.

Kenedit i duhej të peshonte rrezikun sovjetik. Padyshim që në këmbim të heqjes së tyre pa luftë, Bashkimi Sovjetik do t'i kërkonte SHBA-ve një çmim të rëndë. Gjeneralët e ushtrisë amerikane, veçanërisht komandanti i hapësirës ajrore, gjen. Kërtis LiMej (Curtis LeMay) shkoi më larg duke këshilluar presidentin që të niste luftën kundër Kubës me premtimin se sovjetikët nuk do të guxonin të kundërvepronin (Stone, 2012:307). Por, Kenedi nuk mund të pranonte një risk të tillë. Toleranca e tij ndaj Bashkimit Sovjetik kishte dhënë produktin e vet; kërcënimin direkt të sigurisë amerikane. Sovjetikët kishin dërguar nën hundën e tij armë bërthamore në territorin më të afërt komunist me SHBA-në.

Më 22 tetor, i pashpresë për të gjetur një zgjidhje, Kenedi urdhëroi bllokadën ndaj Kubës. Të gjitha anijet që i drejtoheshin ishullit do të inspektoheshin nga marina ushtarake amerikane. Tensionet u shtuan akoma më shumë. Një luftë bërthamore ishte shumë e afërt. Më 25 tetor, sovjetikët i bënë Kenedit një propozim se ishin gati të largonin raketat nga Kuba nëse Amerika hiqte raketat bërthamore në Turqi (Stone, 2012:308). Ky ishte një

çmim shumë i lartë. Më e keqja pritej të vinte. Më datë 27 tetor ndodhi edhe momenti më i rrezikshëm në histori. Në mëngjes, marina amerikane pikasi në thellësi një nëndetëse sovjetike B-59 e cila kishte misionin të mbronte anijet që po i afroheshin Kubës. Luftanija amerikane USS Randolph filloi të hedhë ngarkesa shpërthyese në thellësi për ta detyruar nëndetësen të dilte në sipërfaqe. Shpërthimet ndodhën shumë pranë nëndetëses e cila ishte pajisur me armë bërthamore. Tronditja ishte shumë e madhe dhe bombolat e oksigjenit u dëmtuan nga shpërthimet. Komandanti i nëndetëses Valentin Savitski (Savitsky) u përpoq pa sukses të lajmëronte shtabin e përgjithshëm sovjetik. Pa informacion dhe pa urdhra, gjithçka mbeti në dorë të tij. Zv/komandanti, Vasili Arkhirpov e bindi të mos jepte urdhër për zjarr. Ky burrë, shpëtoi njerëzimin nga katastrofa nukleare (Stone, 2012:309).

Ndërkaq Fidel Castro po përpinqej të bindte Hrushovin që të fillonte sulmin bërthmamor kundër imperialistëve amerikanë. Hrushovi refuzoi dhe i dërgoi një letër Kenedit ku e ftonte për marrëveshje. Sovjetikët hiqnin raketat nga Kuba, amerikanët hiqnin raketat Jupiter nga Turqia. Kenedi ndodhej në dilemë. T'i bindej shantazhit sovjetik do të thoshte dalje e Turqisë nga NATO-ja dhe shkatërrim i aleancës. Edhe shpartallimi që i bëri në OKB Adlei Stivenson ambasadorit sovjetik nuk e zbuti situatën. Duhet të kishte ose marrëveshje, ose luftë. Kenedi pranoi marrëveshjen. Bota shpëtoi, por prestigji amerikan u zhyt. Dështimi i një viti më parë për të pushtuar ishullin dhe për të larguar Fidel Kastron nga pushteti dha frytet e veta negative në politikën e presidentit Kenedi. Çfarë do të ndodhë sikur Hrushovi të kishte kërkuar largimin e amerikanëve nga Berlini? A do ta kishte pranuar Kenedi? Kësaj pyetjeje nuk i përgjigjemi dot, veçse e sigurtë është se po të kishte shpërthyer lufta bërthamore, njerëzimi do të ishte zhdukur. Politika amerikane nxori një mësim; kurrë t'i lëshonte pe shantazheve sado me rrezik të lartë që të ishin ato. Në vitin

1992, 29 vjet pas krizës kubane, ish sekretari i mbrojtjes Robert MekNamara zbuloi nga dokumentet sovjetike se në Kubë gjendeshin të mirëarmatosur 43 mijë ushtarë dhe oficerë sovjetikë dhe Fidel Castro kishte një ushtri prej 270 mijë vetësh të armatosur deri në dhëmbë. Në përllogaritjet e tij në rast të një sulmi amerikan, 100 mijë amerikanë do të kishin humbur jetën (Stone, 2012:312). Asnjëherë tjetër gjatë Luftës së Ftohtë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik nuk do të ishin kaq pranë konfrontimit ushtarak ndërmjet tyre për të paguar çmimin e dëmeve të pallogaritshme.

### **6.7. Adenaueri, dë Goli & Kenedi**

Krizat e Berlinit dhe të Kubës ndikuan në strukturimin e ardhshëm të Evropës perëndimore dhe rolin që do të kishte Gjermania në to dhe në botë. Evropa perëndimore po rindërtohej me vështirësi në kohë krizash. Britania e Madhe po negaciononte pareshtur për t'u pranuar në Komunitetin Ekonomik Evropian. Kryeministri Harold Makmilan e dëshironte anëtarësimin e Britanisë në këtë organizatë që vendi i tij të mos mbetej prapa zhvillimit të furishëm ekonomik që po përjetonte Evropa. Presidenti Kenedi, e mbështeste anëtarësimin e Britanisë së Madhe në Komunitetin Evropian pasi e konsideronte nyjen e forcimit të bashkëpunimit ndërmjet Amerikës dhe Evropës. Por, anëtarësimi i Britanisë së Madhe kishte një pengesë të fortë.

Presidenti francez Sharl dë Gol, e shikonte me dyshim të madh përpjekjen e Britanisë për t'u anëtarësuar në Komunitetin Ekonomik Evropian. "Anglo-sanksonët", siç i quante ai anglo-amerikanët, nuk ndanin sipas tij të njëjtat tradita, qëndrime dhe interesa me shtetet evropiane. Dë Goli ushtronte presion të fortë mbi komunitetin evropian që t'ja vështirësonte sa më shumë rrugën e anëtarësimit të Britanisë në organizatë. Shumë shtete evropiane nuk

ishin dakord me politikat e dë Golit dhe besonin se anëtarësimi i Britanisë do të ishte një vlerë e shtuar në komunitetin evropian. Anëtarësimi i Britanisë varej shumë edhe nga qëndrimi i kancelarit gjermano perëndimor Adenauer. Nëse ai mbështeste dë Golin, Makmilani dhe Britania e Madhe nuk kishin asnje shans anëtarësimi.

Dë Goli dhe Adenaueri nuk ndanin të njëjtin qëndrim për Evropën. Dë Goli fliste për mite, Adenaueri i kishte frikë mitet. Dë Goli ishte romantik, Adenaueri praktik. Dë Goli adhuronte kombin, Adenaueri e përbuzte. Dë Goli kërkonte një Evropë të drejtuar nga shtetet kryesore, Adenaueri një Evropë që të ishte mbi shtetet. Dë Goli i shikonte Atlantikun dhe Kanalin e La Manshit si hendeqe, Adenaueri i shikonte si ura. Kancelari kërkonte një Evropë që të tejkalonte të kaluarën, por të ndërtohej së bashku me shtetet e tjera. Kriza e Berlinit kishte shtruar problemin e rritjes së bashkëpunimit mes vendeve të Evropës perëndimore për të ndaluar rrezikun sovjetik. Evropa ishte e ndarë në dy blloqe. Nëse do të krijohej edhe një bllok tjetër brenda Evropës perëndimore do të kishte pasoja katastrofike për vijueshmërinë e demokracisë në kontinent. Dë Goli përpinqej të bindte Adenauerin se vetëm Franca kishte forcën për të mbrojtur interesat e Evropës. Kancelari gjerman ishte fillimisht i pavullnetshëm dhe i pa aftë për t'i rezistuar, për faktin se për momentin Dë Goli kishte të drejtë (Meyer, 1995:127).

Takimi i parë mes dë Golit dhe Adenauerit kishte ndodhur në vjeshtën e vitit 1958, në shtëpinë e presidentit francez në Kolombe-Le-Dë-Egliz. Në bisedën e zhvilluar, presidenti francez e kishte bindur kancelarin se për herë të parë përgjatë shekujve të tërë armiqësish, Franca nuk do të përpinqej që të dobësonte Gjermaninë (Smyser, 1999:194). Dy vjet më vonë, në takimin e Elizesë, dë Goli ishte përpjekur t'i shpjegonte Adenauerit se vetëm aleanca e fortë franko-gjermane do ta bënte Evropën të pathyeshme. Në takimin e vitit

1962, solidariteti franko-gjerman ishte në qendër të bisedës që dë Goli bëri me Adenauerin.

Në vizitën e kancelarit gjerman, Dë Goli u shpreh se Adenaueri ishte njeriu që kishte udhëhequr Gjermaninë drejt lirisë, prosperitetit dhe respektit. Trupat gjermane dhe franceze marshuan për herë të parë së bashku në shenjë respekti dhe nderimi të ndërsjellë. Në shtator 1962, dë Goli vizitoi Gjermaninë perëndimore që ishte e para vizitë ftesë e një zyrtari të lartë në postin e kryetarit të shtetit francez në një mijë vjet. E para vizitë e këtij niveli kishte ndodhur në vitin 921. Dë Goli shkoi edhe më tej për të treguar afrimitetin franko-gjerman, duke folur gjermanisht në takim. Në fjalimin që mbajti në Hamburg, dë Goli i quajti gjermanët "një popull i madh" (Bark, 2012:493). Për habinë e Londrës dhe të Uashingtonit, fjalimi i dë Golit pati një efekt të madh politik dhe njerëzor. Dë Goli ishte lideri politik që e mbështeti më shumë Adenauerin gjatë krizave të Berlinit të 1958-ës dhe 1961-shit. Kancelari i detyrohej shumë atij. Dë Goli kishte idenë e tij sesi duhej zgjidhur çështja gjermane. Zgjidhja ishte një urë solide e çeliktë ndëmjet Parisit dhe Bonit. Një lidhje e tillë do ta bënte Evropën kontinentale të pavarur nga Amerika dhe Bashkimi Sovjetik. Me këtë aleancë Evropa do të riafirmonte vetveten dhe do të rikthente madhështinë. Presidenti Kenedi dhe këshilltarët e tij pas krizës së raketave në Kubë, nuk e kishin më mendjen tek Evropa, por në Azi dhe tek lëvizjet e Bashkimit Sovjetik. Në vitin 1962, Kenedi paraqiti "projektin e madh" që konsistonte në aleancën e madhe ndërmjet Evropës perëndimore dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (Smyser, 1999:196). Britania e Madhe do të ishte në qendër të këtij projekti. Kundërshtimi politik franko-amerikan hyri në një fazë të re. Kenedi dëshironte që Adenaueri të përkrahte Makmilanin. Kërkesa shkoi deri në kërcënim të hapur kur Din Rasku paralajmëroi kancelarin për "pasojat e pallogaritshme që do të kishte Boni, nëse Gjermania Perëndimore ndihmonte Francën për të penguar në mënyrë të

paarsyeshme hyrjen e Britanisë në Komunitetin Evropian". Gjuha e ashpër e Raskut legitimoj idenë e dë Golit për mënyrën sesi duhej t'i trajtonin evropianët anglo-saksonët. Politikat e Kenedit dëmtuan aleancën e veçantë anglo-amerikane. Refuzimi i amerikan nëpërmjet Sekretarit të Mbrojtjes MekNamara për furnizimin e Britanisë me raketa 'Skybolt' i futi marrëdhëniet në krizë. Pak para Krishtlindjes së vitit 1962, Makmilani u takua me Kenedin në Bermuda. U ra dakord që SHBA-të të furnizonin Britaninë me raketa bërthamore 'Polaris'. Për këtë veprim nuk u njoftu as NATO-ja, as Franca dhe as Gjermania. Duke parë qëndrimin amerikan, më 14 janar 1963, dë Goli vuri veton për pranimin e Britanisë së Madhe në Komunitetin Evropian (Smyser, 1999:196).

Tetë ditë më vonë, dë Goli dhe Adenaueri nënshkruan në Elize' Traktatin Franko-Gjerman të bashkëpunimit. Adenaueri e nënshkroi traktatin me shpresën se po hidhte bazat e një paqeje jetëgjatë evropiane përpara se të dilte në pension. Duke qenë dëshmitar i shkatërrimit të ndërsjellë ndërmjet dy kombeve gjatë gjysmës së parë të shekullit XX, burri i moshuar dhe i mençur gjerman, i futi të dy kombet në udhën e pandryshueshme të bashkëpunimit. Kenedi dhe i tërë stafi i tij, reaguan sikur t'i kishte goditur rrufeja. Një javë përpara nënshkrimit të traktatit, Adenaueri ishte ftuar në Uashington për t'ju bashkuar forcës multilaterale bërthamore e cila do të ndihmonte më tej në pavarësinë e Gjermanisë perëndimore dhe Evropës kontinentale. Adenaueri kishte shkuar dhe për një javë e hodhi në erë projektin e Kenedit për Evropën. Nënshkrimi i Traktatit të Bashkëpunimit franko-gjerman kishte rritur shumë prestigjin e Dë Golit. Ai ia kishte dalë mbanë të mbante të bllokuar hyrjen e Britanisë së Madhe në Komunitetin Evropian dhe kishte tërhequr pas vetes Adeanuerin dhe Gjermaninë.

Por, kishte një pengesë në Gjermani ndaj projektit të dë Golit që quhej Bundestag (parlamenti). Shumica e deputetevë kishin dalë kundër Adenauerit. Marrëveshja me Francën ishte e mirëpritur, por nuk donin që të viheshin në rrezik marrëdhëniet me anglo-amerikanët. Kur Bundestagu ratifikoi traktatin me Francën, shtoi se të gjitha aleancat e tjera të Gjermanisë Federale ishin në fuqi. Gjithashtu, në deklaratën e Bundestagut gjerman shprehej edhe dëshira për anëtarësimin e Britanisë së Madhe në Komunitetin Evropian. Lidhjet me Francën u forcuan dhe lidhjet me Amerikën nuk u këpüten.

Duke patur frikën e një rrëshqitjeje përfundimtare të RFGJ-së drejt Francës, Kenedi zhvilloi një vizitë në Berlinin perëndimor më 26 qershori 1963 (Smyser, 1999:196). Kenedi mbajti dy fjalime në Berlin; një në shesh dhe tjetrin në Universitetin e Lirë të Berlinit. Ai donte t'u transmetonte gjermanëve se Amerika gjendej në krah tyre në përpjekjen për pavarësi e bashkim. Fjalia e tij e famshme "Unë jam një berlinez" e thënë përpara një milion vetëve pati një impakt drithëruesh. Presidenti amerikan bëri një gjest unik duke manipuluar edhe fuqinë e turmës. Ai ishte "armiqësuar" me Adenauerin, por kishte fituar gjermanët. Në fjalin, ai sfidoi të gjithë duke i ftuar të vinin në Berlin dhe të shikonin dallimin mes diktaturës dhe demokracisë (Reeves, 1992:535). Britania Ky fjalin ishte edhe akti i fundit i një presidenti tek i cili shpresonin të gjithë. Teksa largohej nga Berlini, si përti vënë vulën karrierës së tij politike dhe jo vetëm asaj, presidenti Kenedi i thotë Ted Sorensenit, këshilltarit të tij të shtypit:

*"Nuk do ta jetojmë më një ditë të tillë përsa kohë do të jemi gjallë"* (Reeves, 1992:537).

## 6.8. Evropa ndahet dy herë

Beteja politike për Gjermaninë ndryshoi kryekëput pas krizave të viteve 1958 dhe 1961 në Berlin. Për momentin çdo shpresë për të ribashkuar vendin u shua. Si pasojë e këtyre

krizave bota për pak sa nuk shkoi buzë konfrontimit në Checkpoint Charlie dhe në Kubë.

Ndërtimi i Murit të Berlinit kishte zyrtarizuar ndarjen e popullit gjerman, por ish kryeqyteti në pjesën e tij më të madhe mbetej perëndimor brenda strukturës komuniste lindore.

Asnjëri prej udhëheqësve gjermanë perëndimorë dhe lindorë nuk kishte arritur atë çfarë kërkonte. Për momentin nuk kishte të humbur dhe të fituar ndërmjet dy Gjermanive.

Përsa i përket udhëheqëve të blloqueve, Sharl dë Goli doli fituesi më i madh. Ai e kishte parashikuar saktë që Hrushovi as do të negaciononte as do të luftonte. Gjermania ishte ndarë ashtu siç dëshironte ai në mënyrë private (Smyser, 1999:199). Dë Goli kësaj here kishte avantazhin për t'u afruar më shumë se të tjerët me Gjermaninë pasi vendi i tij nuk ishte përgjegjës për ndarjen. Britania po mbahej larg strukturave evropiane. Adenaueri po mbante një ekuilibër të shkëlqyer ndërmjet Francës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Duke mbështetur Adenauerin, dë Goli e mbante lidhur RFGJ-në me perëndimin dhe me strukturat përkatëse. Presidenti francez anashkaloi presidentin Kenedi në garën për Evropën dhe Gjermaninë edhe për faktin se Kenedi ishte më shumë i përqëndruar tek Bashkimi Sovjetik. Me këto veprime, dë Goli kishte shkatërruar nocionin e Tre të Mëdhenjve në Jaltë të cilët kishin përjashtuar Francën nga vendimmarjet e mëdha se vetëm ata mund të vendosnin për Evropën dhe Gjermaninë.

Presidenti amerikan kishte treguar dobësi gjatë krizës së Berlinit të vitit 1961, por e kishte rimarrë veten pas krizës së raketave në Kubë. Fillimisht, i frikësuar nga një përplasje e mundshme dhe nga keqlogaritjet që mund të pasonin, ai lejoi që të ndërtohej Muri i Berlinit pa nxjerrë zë (Smyser, 1999:200). Gjatë krizës së raketave, ai mësoi se menaxhimi dhe kontrolli i situatës ishin politika më e mirë. Kur u zgjodh në vitin 1960, Kenedi e la veten të térhiqeja nga dëshira për të menduar se superfuqitë mund ta mbanin botën të

stabilizuar. Në vitin 1963, ai e kuptoi se kjo gjë nuk mund të bëhej edhe për faktin se Hrushovi nuk u tregua një partner i besueshëm për këtë lloj marrëveshjeje. Duke mos e realizuar dot planin e tij, Kenedi iu rikthyte edhe një herë mbrojtjes së strukturës perëndimore të ndërtuar prej Trumanit, Bevinit, Açosenit dhe Ajzenhauerit. Ai e kuptoi më në fund sesa e rëndësishme ishte pavarësia e Gjermanisë Perëndimore.

Lideri gjermano lindor Valter Ulbriht, lëvizi në drejtim të kundërt nga Kenedi. Ai e nisi punën mirë, por e përfundoi keq. Duke bllokuar fluksin e refugiatëve, ai zgjidhi për momentin problemin, por jo përfundimisht. Qenia e tij krye të RDGJ-së e mbushte me dyshim Moskën. Politika e aplikuar nga Ulbrihti ishte një dështim i madh. Me dëshirën e madhe për të neutralizuar Berlinin perëndimor, ai e largoi atë akoma më shumë nga vetja duke e hedhur përfundimisht në krahët e perëndimit. Lideri komunist gjermano lindor, e dinte më mirë se kushdo tjetër se pushteti i tij nuk do të ishte asnjëherë i sigurtë përsa kohë, Berlini perëndimor do të ishte një strukturë e pavarur. Ai kishte ndërtuar gardhet perfekte, por përsëri ato nuk ishin të mjaftueshme. Aleati i tij i madh sovjetik Nikita Hrushovi kishte nisur krizat e Berlinit, por pa ditur se çfarë kërkonte në të vërtetë. Ai fitoi Berlinin lindor për Ulbrihtin dhe asgjë për veten e tij. Me veprimet e tij ai kërcënonte shpresat për bashkë ekzistencën paqësore. Askush më mirë se Henri Kissinger nuk e ka portretizuar më mirë liderin sovjetik të kohës me fjalët:

*"Hrushovi dinte si të niste një krizë, por jo si ta përfundonte"* (Kissinger, 1999:592).

Hrushovi dhe Gromiko e treguan veten negociatorë të dobët. Taktikat e tyre njëlloj si të Molotovit, i vendosnin kundërshtarët në pozita mbrojtëse, por pa fituar asgjë për vete. Ajzenhaueri nuk mund të merrej vesh me ta edhe pse donte shumë. Në Vjenë, Kenedi ishte gati të bënte një marrëveshje për Berlinin, por sovjetikët nuk ia mundësuan. Hrushovi

kërkonte më shumë nga sa mund të jepte Kenedi. Hrushovi ia kishte dalë mbanë të kishte një Gjermani të ndarë, por e pa veten të mbërthyer në pjesën lindore të saj si Stalini përpara tij. Ndarja e Gjermanisë nuk e lejonte Bashkimin Sovjetik të bënte një hap më tutje. Bashkëjetesa paqësore mbeti një letër e vdekur.

Në takime të ndryshme, Hrushovi bisedonte veçmas me Adenauerin në përpjekje për ta bindur që RFGJ-ja të mbetet neutrale ndërmjet lindjes dhe perëndimit. Vetë dë Goli e kishte kuptuar këtë kurth të Hrushovit, gjithashtu edhe Adenaueri i cili e shmangu atë. (Smyser, 1999:201). Humbësi më i madh pas Kenedit në Evropë ishte padyshim Harold Makmillani. Nën ndikimin e presidentit amerikan, ai dominoi politikën perëndimore në Berlin dhe Gjermani gjatë viteve 1961 dhe 1962. E keqja e kryeministrit britanik ishte se, ai jetonte me të kaluarën dhe nuk shikonte nga e ardhmja. Kur kriza e Murit të Berlinit mori fund në vin 1962, politika britanike kishte humbur të gjithë kredibilitetin e saj në Gjermani dhe në Evropë. Duke dashur të kishte një rol global për Britaninë e Madhe, Makmillani shtyu RFGJ-në të pranonte përcaktimin e dë Golit për kontinentin. Trupat britanike mbetën në Gjermani, por politikisht Britania nuk kishte zë për të vendosur për të ardhmen e vendit. Vetëm tre vjet pas vdekjes së presidentit dë Gol, më 1973 Britania e Madhe u pranua në Komunitetin Evropian.

Muri i Berlinit ndau jo vetëm kontinentin në kufirin lindje - perëndim, por edhe përgjatë La Manshit. U bënë dy kufij. Një kufi ndante botën komuniste nga ajo perëndimore, tjetri ndante perëndimin nga Britania e Madhe. Muri i Berlinit shërbente edhe si zile alarmi për liderët gjermano perëndimorë. Reagimi i aleatëve perëndimorë tregoi se ishin të gatshëm të mbronin RFGJ-në në kuadër të NATO-s dhe në këtë mënyrë edhe interesat e tyre, por jo interesin e mbarë kombit gjerman. Kancelari Adenauer e kishte kuptuar më së miri këtë.

Kryebashkiaku Brand i Berlinti perëndimor, e kishte kuptuar nga mosreagimi i aleatëve kur po ndërtohej muri. Ribashkimi i Gjermanisë mund të ekzistonte në retorikën amerikane, por jo në politikën e saj. Sesi duhej ta ribashkonin vendin, ishte punë e gjermanëve. Për momentin ata [gjermanët] ishin shumë larg realizimit të kësaj detyre.

Gjermano perëndimorët mund të gëzoheshin se për momentin e ardhmja e vendit nuk do të vendosej mbi kokat e tyre. Pushtimi do të merrte fund një ditë. Për të arritur bashkimin ata duhej të mësonin nga historia e tyre duke filluar qysh nga viti 1871 (Boriçi, 2012:298). Ata duhej të vendosnin edhe për prioritetet e tyre strategjike politike dhe njerëzore si dhe të pranonin përgjegjësinë e vendimeve të tyre në shtëpi dhe jashtë saj.

## 6.9. Enigmatiku dhe kontroversi dë Gol

*"Gjatë të gjithë jetës time kam menduar për Francën në një lloj mënyrë i frysmezuar nga ndjenjat sesa nga arsyja. Ana emocionale e karakterit tim tenton ta imagjinojë Francën si princeshën e përrallave apo si Shën Mërinë e afreskeve, të prirur drej një fati të kremluar dhe të shkëlqyer. Instiktivisht, kam përshtypjen se Zoti e ka krijuar për suksese të mëdha ose për fatkeqësi shembulllore. Edhe pse në gjestet e saj del herë pas here mediokriteti, gjëja që më bën përshtypje më shumë është një anomali absurdë që i vërtitet francezëve dhe jo gjenisë së kombit. Për mua, Franca nuk është vetvetja po qe se nuk është në rreshth të parë. Vendi ynë i rrëthuar nga ata fqinj që ka, duhet të synojë sa më lart, të qëndrojë i bashkuar pa iu shmangur as rreziqeve vdekjeprurës. Shkurt, në gjykimin tim, Franca nuk mund të jetë Francë pa madhështi" (Cook, 1987:5).*

Kështu ishte mendimi i ekzagjeruar i dë Golit për Francën. I shtyrë më shumë nga një ndjenjë romantike, presidenti francez, lideri i rezistencës gjatë Luftës II Botërore, udhëhoqi vendin e tij e tij në dritëhijet e fazës së parë të Luftës së Ftohtë. Interesant është fakti se qysh nga bankat e shkollës dhe mbi të gjitha në ushtri, ai iu përkushtua me ndërgjegje të plotë dhe në mënyrë ekskluzive studimit historik të pushtetit duke analizuar teknikat dhe duke u përgatitur për të qenë pjesë e tij. Pa dyshim, në jetën e dë Golit ka ulje e ngritje, por asnjëherë nuk e braktisi prirjen për pushtet. Ai nuk pati asnjë luhatje, asnjë spekulim

intelektual, asnje ndryshim drejtimi, asnje jetë intensive shoqërore,asnje mik intim apo rastësor,asnje hobi apo interes sportiv dhe sigurisht asnje skandal dhe asnje kërkim kënaqësie. Për dë Golin, gjuetia e pushtetit ishte shumë serioze për t'u anashkaluar. "Nuk ka prestigj pa mister" (Cook, 1987:13), pati shkruar një herë gjenerali në ditarin e tij. Ndërsa Henri Kissinger ka thënë për dë Golin se "*ia dilte mbanë të dominonte një ambient me forcën gati të dukshme të autoritetit të tij*".

Një ndër idetë më të "çmendura" të tij lidhej me integrimin. Sipas tij, "*integrimi është diçka e keqe, pavarësia është forcë*" (Cook, 1987:19). Për të, Evropa do të forcohej vetëm nëse do të kishte shtete të forta e të pavarura kombëtare. Kulti i golizmit, me të gjithë të mirat dhe defektet e veta, ishte një pjesë konstante e politikës franceze për një kohë të gjatë. Për shumë vite, pyetja më e shpeshtë që bënин francezët e çdo rangu ishte: "*Pa dë Gol, a do të kishte Francë*" (Cook, 1987:22)? Dë Goli pas kthimit në Francë nga Anglia, e ushtroi pushtetin jo i bazuar në mekanizmat politikë, por si simbol dhe personifikim i bashkimit kombëtar. Republika e Katërt Franceze e themeluar pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore nuk ishte jetëgjatë. Presidenti francez i fillimit të viteve '50 Pier Mendes-Francs u përball me vështirësi të shumta dhe presion të madh ndërkombëtar. Atij iu desh t'i jepte fund në mënyrë jo dinjitoze kolonializmit francez në Indokinë (Vietnam) dhe të lejonte shpalljen e qeverisë së pavarur të Tunizisë. Gjatë presidencës së tij, RFGJ-ja hyri në NATO duke u bërë një element i patjetërsueshëm në politikën evropiane dhe botërore.

Në maj të vitit 1958, dë Goli u riangazhua edhe një herë fuqimisht në jetën politike të vendit. Zgjedhjen e tij në krye të Francës gjenerali e konsideronte si "*kthim në normalitet*" (Cook, 1987:442). Në fjalimin e tij publik ku riafirmoi angazhimin politik, dë Goli u shpreh:

*"Një herë, në të kaluarën nga thellësia e humnerës, vendi më dha besim për ta udhëhequr drejt shpëtimit. Sot, përbollë të gjitha provave që i qëndrojnë përpara vendit, është e drejtë që populli ta dijë se jam gati për të marrë pushtetet e ofruara nga Republika" (Cook, 1987:451).*

Në një intervistë televizive kur u pyet lidhur me liritë thelbësore, ai si asnijëherë tjetër, ngriti zërin duke thënë pa takt:

*"Kur i paskam kërcënuar ndonjëherë liritë thelbësore? Përkundrazi, i kam restauruar. Përse duhet që në moshën 67 vjeçare të filloj një karrierë si diktator? Nuk është e mundur të zgjidhen krizat e mëdha kombëtare brenda kufizimeve të sistemit. Kartat që kemi në dorë do të na çojnë drejt të ardhmes së Francës, prosperitetit të së cilës do t'i gjëzohen të gjithë francezët" (Cook, 1987:453).*

Në mbyllje të fjalës, mjeshtërisht tha:

*"Mendova se do të ishte e vlefshme për vendin për të thënë ato që thashë. Tani do të kthehem në fshatin tim e do të jem në dispozicion të kombit". (Cook, 1987:453).*

Viti 1958 nuk ishte një vit i lehtë për Francën. Humbjet në Indokinë dhe Tunizi kishin prekur thellë ndërgjegjen ushtarake franceze. Qeveria e kishte humbur besimin. Më 27 maj u hap fjala se gjeneralët po përgatiteshin për grusht shteti nga Algjeria. Duke e njojur me detaje forcën ushtarake të vendit dhe duke mos dashur që në Francë të mbizotëronte anarkia, ai vendosi të dilte edhe një herë publikisht në mbrojtje të kushtetutës dhe të Republikës së Katërt edhe pse e dinte se i kishte ardhur fundi. Në orën 12:30 të asaj date, në zyrën e tij në Paris, dë Goli foli hapur:

*"Jam për një proces të rregullt për të vendosur një qeveri republikane të aftë të sigurojë për vendin bashkimin dhe pavarësinë. Besoj se vendi do të tregojë me qetësi dhe dinjitet vullnetin për të patur sukses. Në kushte të tillë, çdo veprim që vë në rrezik rendin publik nga cilado parti qoftë, do të ketë pasoja të rënda. Edhe pse i mirëkuptoj rrëthanat, nuk e jap aprovimin tim. Uroj që forcat ushtarake tokësore, ajrore dhe detare në Algjeri të ruajnë një disiplinë shembulllore" (Cook, 1987:455).*

Një paralajmërim i tillë bllokoi çdo tentativë për gusht shteti. Gjenerali Salan dhe të tjërët rrëth tij, e kuptuan menjëherë se nëse do të dilnin kundër dë Golit, mund të humbnin dhe nëse ndodhët kjo do të përballeshin para gjyqit ushtarak me akuzën e rëndë për rebelim

kundër shtetit. Klasa politike në Francë nuk kishte besim tek dë Goli. Nuk ishin të paktë ata që e quanin se kishte "shpirt diktatori" (Cook, 1987:456). Dë Goli nuk e fshihte ambicien e tij për pushtet të plotë. Më 29 maj 1958 me një deklaratë të shkurtër në Asamblenë Kombëtare, u lexua akti i presidentit të Francës i cili i jepte dë Golit kompetenca të plota për ruajtjen e integritetit të vendit (Cook, 1987:456). Dë Goli po merrte atë që nuk ia kishte dalë dot të merrte pas çlirimtë të vendit. Pas revolucioneve të viteve 1789 dhe 1871, ky revolucion i ri kishte ndodhur pa gjakderdhje. Edhe një herë edhe pse pa pushtet, dë Goli kishte treguar se ishte i nevojshëm për Francën dhe se autoriteti i tij ishte i padiskutueshëm. Takimi mes presidentit Rène Coty (Coty) dhe dë Golit po atë mbrëmje ishte i njerëzishëm. Kushtet e dë Golit për të formuar një qeveri të re ishin shumë të favorshme. Ai do t'i kërkonte Asamblesë Kombëtare pushtet të plotë derisa të kalohej kriza. Qeveria e re duhej të hartonte një kushtetutë të vlefshme për një Republikë të Pestë dhe më pas do t'i nënshtrohej një referendumi kombëtar për aprovim. Me këtë akt Asambleja i mbylli punimet për t'i rifilluar në sesionin e vjeshtës më 7 tetor (Cook, 1987:457).

Me të mbyllur punët në Francë, dë Goli udhëtoi drejt zemrës së problemit, në Algjeri. Aty mbërriti më 4 qershor 1958 (Cook, 1987:459). Hyrja e tij në Algjer i ngjante hyrjes së tij në Paris më 25 gusht 1944. Pëershëndetja e tij në ballkonin e zyrës së guvernorit të përgjithshëm ndaj turmës 200 mijë vetëshe me grushtat lart në shenjë triumfi, i bindi të gjithë se ai mbetej i parezistueshëm. Duke ditur forcën e gjeneralit Salan (inicuesi i problemit), kur u kthyte në Paris e rikonfermoi në detyrën e shefit të ushtrisë në Algjeri duke i shtuar edhe një titull të ri "delegat i përgjithshëm" i Algjerisë. (Cook, 1987:461). Në fakt, kjo ishte një manovër për të nxjerrë në pension me nder gjeneralin e vjetër.

Akti i fundit për të vendosur republikën e re ndodhi më 21 dhjetor 1958 kur u mblodhën noterët e Këshillit të lartë për të numëruar 80 mijë skedat që zgjidhnin presidentin. Dë Goli mori 78% të votave (Cook, 1987:463). Më 8 janar 1959, presidenti në detyrë Koti' bëri dorëzimet e pushtetit me një ceremoni dinjitoze. Me këtë akt, mori fund edhe Republika e Katërt në Francë. Franca tashmë kishte një Republikë dhe Kushtetutë të re që e kthente vendin në Republikë Presidenciale. Qeveritë në Francë nuk mund të rrëzoheshin më pa aprovimin eksplisit të presidentit. Në këtë periudhë, dë Golit nuk iu desh vetëm të ecte në fushën e minuar të kompleksit ushtarak, politik dhe algjerian, por iu desh t'i bënte ballë edhe nëntë atentateve nga klandestinët politikë algjerianë. Duke parë rëndimin e situatës, në vitin 1962, dë Goli kërkoi ndryshimin e kushtetutës në të cilën kërkoi që presidenti të zgjidhej nga populli (Cook, 1987:465).

Lufta e Algjerisë për pavarësi përbënte një problem të trefishtë për presidentin francez. Së pari, duhej mbajtur nën kontroll të rreptë ushtria. E mësuar prej kohësh që të diktonte politikën në Paris, ushtarakët e lartë ishin të vendosur të vijonin luftën me qëllim që Algeria të mbetej franceze. Së dyti, ishte pengesa kushtetuese që e kishte deklaruar Algjerinë pjesë integrale të Francës. Së treti, negociatat për të arritur paqen kundërshtoheshin nga vetë golistët. Ushtarakët madhorë ishin të pakënaqur me politikat e dë Golit dhe nuk e mirëpritën kthimin e tij në pushtet. E vëtmja mënyrë ishte që të neutralizoheshin disa prej gjeneralëve duke i larguar nga fronti algjerian dhe duke i emëruar në detyra të reja. Lufta e tejzgjatur në Algjeri po tregonte se ishte e pamundur të bëhej për vete kombin algjerian. Algjerianët mund të bëheshin francezë aq sa francezët mund të bëheshin algjerianë. Në fund të vitit 1960, dë Goli i kishte të gjitha armët në dorë për t'i dhënë një zgjidhje problemit algjerian. Vetëvendosje do të thoshte Algjeri e pavarur.

Në këtë vit, gjenerali Salan ishte larguar nga posti. U tërhoq në Spanjë ku vijoi të udhëhiqte një grup ekstremistësh ushtarakë francezë për të vijuar luftën që Algjeria të mbetet franceze. Gjenerali Shale (Challe) i cili kishte zëvendësuar Salanin, ishte larguar nga posti i tij pasi kishte marrë një detyrë të re në NATO, por që u detyrua të dorëhiqej edhe prej atje pas acarimit të situatës nga dë Goli me amerikanët. Në mars të vitit 1961, Shaleja iu bashkua kërkësës së Salanit për të organizuar në grusht shteti për të rimarrë edhe një herë frenat e politikës në Algjeri.

Natën e 21 prillit 1961, Shaleja së bashku me Salanin zbarkuan në Algjer të mbështetur nga një grup parashutistësh veteranë të Legjonit të Huaj dhe arrestuan komandantin e përgjithshëm francez të Algjerisë, gjeneralin Gambje' (Gambiez) një golist i devotshëm (Cook, 1987:468). Pasi shtinë në dorë pallatin e qeverisë, katër gjeneralë dolën publikisht në ballkon parpara një turme të madhe. Por, ajo që nuk kishin llogaritur komplotistët ishte pjesa tjetër e ushtrisë që kishte kohë e angazhuar në luftë dhe donte paqe. Ata ishin besnikë të Gambjesë jo të Salanit dhe Shalesë. Reagimi i dë Golit ndaj grushtit të shtetit ishte i çuditshëm. Natën e 21 prillit ai zgjohet vrullshëm nga asitenti i tij Zhofri dë Kursel. "Qenka serioze" tha dhe pas pak mërmëriti "Mirë" dhe u shtrua përsëri në gjumë (Cook, 1987:468). Kjo skenë na kujton epokën kur Meterniku zgjohet vrullshëm nga shërbëtori i tij për t'u njoftuar lidhur me arratisjen e Napolonit nga Elba duke mos u shqetësuar aspak për një gjë të tillë. Dë Goli e dinte se situata për gjeneralët rebelë ishte e pashpresë. Brenda katër ditësh më 25 prill 1961, çdo gjë kishte marrë fund. Gjenerali Shale u arrestua dhe u burgos në Francë. Të gjithë gjeneralët rebelë dhe ndjekësit e tyre u burgosën dhe u liruan nga dë Goli vetëm në vitin 1968 në prag të zgjedhjeve të përgjithshme dhe si presion ndaj revoltës studentore e cila kishte tronditur regjimin në themele. Rruga për pavarësinë e Algjerisë

ishte e hapur. Më 18 mars 1962, 11 muaj pas revoltës së gjeneralëve, në Evian le Bë pranë Gjenevës u firmos marrëveshja për pushimin e zjarrit. Në prill, populli francez votoi unanimisht për të respektuar marrëveshjen e Evianit. Më 3 korrik 1962, pas 132 vitesh pushtimi francez, Algjeria u bë një shtet i pavarur (Cook, 1987:470). Me këtë akt, revolucioni golist mund të quhej i kompletuar.

Pas mbylljes së çështjes së Algjerisë, autoriteti presidencial qëndronte mbi autoritetin populor (Duby, 2006:1202). Republika e pestë franceze është vepër unike e gjeneralit dë Gol. Në kohën e pushtetit të dytë të tij, dë Goli u bë bashkëudhëheqës me aleatët e vjetër të kohës së luftës. Në SHBA, president vijonte të ishte Ajzenhaueri dhe në Londër Harold Makmillani. Ajzenhaueri dhe Makmilani e dinin se me t'u kthyer në pushtet dë Goli nuk do të ishte një njeri i thjeshtë për t'u marrë vesh. Dë Goli kërkonte një Francë të fortë, ndërsa anglo-amerikanët një Francë bashkëpunuese. As periudha e gjatë 12 vjeçare jashtë pushtetit, as ndryshimet e mëdha botërore nuk e kishin zbutur dë Golin për të qenë më i matur në politikën e jashtme. Ky fakt vërtetohet edhe nga ditari i tij i botuar pas vdekjes kur shkruan lidhur me vitet 1946-1958 se...

*"...gjithçka që kisha përbushur me stërmundime të mëdha që nga pavarësia lidhur me rolin dhe interesat e Francës, u vu në rrezik. Nga mungesa e iniciativës dhe e energjive, qeveritë thjesht ia bën qejfin të tjerëve. Siç ishte e dukshme, u shpikën lloj-lloj ideologjish për të fshehur vetëshuarjen. Mbi të gjitha, në emër të bashkimit evropian, shkatërruan avantazhet që kishte arritur Franca dhe më pas me pretekstin e solidaritetit atlantik ia falën Francën hegemonisë anglo-amerikane. Rivendosja e një administratë qendrore gjermane në të tria zonat e pushtimit ishte naive. Konferanca e Uashingtonit e cila themeloi NATO-n bëri të mundur që mbrojtja jonë dhe politika e jashtme të ishin në drejtimin e huaj me në krye një super gjeneral amerikan që drejton pak më tutje se Versaja prej ku ushtronë ndikimin ushtarak të botës së re ndaj së vjetrës" (Cook, 1987:473).*

Kësaj pjese të shkëputur nga ditari i tij, i shkon shumë për shtat fjala e Talejranit 145 vjet më parë për Burbonët:

*"Nuk kanë harruar asgjë, por as kanë kuptuar gjë" (Kissinger, 1999:178).*

I tillë mund të konsiderohet edhe qëndrimi i dë Golit. Kërkonte madhëshi për Francën kur kjo e fundit nuk i kishte mjetet që kërkonte koha në epokën e superfuqive. Vullneti vetëm nuk mjafton për të arritur fuqinë. Në epokën atomike ishin një sërë faktorësh që ndikonin drejtpërdrejt për të rritur prestigjin dhe fuqinë. Ekonomia ishte e para. Franca e fillimit të viteve '60 nuk ishte e krahasueshme ekonomikisht as me Gjermaninë Federale dhe ishte shumë larg suksesit ekonomik të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. "Pavarësia" që kërkonte dë Goli kishte një çmim shumë të shtrenjtë ose më mirë të themi nuk kishte çmim që Franca ta përballonte. NATO-ja për dë Golin ishte "delja e zezë" dhe struktura e komandës së saj me në krye gjithmonë një gjeneral amerikan dhe zëvendësi i tij gjithnjë britanik ishin të papranueshme. Vetë ai e shpjegon në ditar acarimin e Francës nën drejtimin e tij me NATO-n duke bërë të mundur edhe daljen e saj nga komanda efektive me fjalët:

*"Qëllimi im nuk ishte mosangazhimi i Francës në Aleancën Atlantike, por isha kundër mënyrës së integrimit të realizuar nga NATO-ja gjithnjë nën komandën amerikane. Kisha qëllim të avancoja gradualisht, duke lidhur çdo gjë me zhvillimet globale dhe duke kultivuar miqësitet tradicionale të Francës. Siç e prisja, dy kundërshtarët e memorandumit tim [SHBA dhe Britania e Madhe] ishin evazivë në përgjigje. Nuk kishte pra, asnjë gjë që të na pengonte të ndryshonim" (Cook, 1987:477).*

Qëndrimet kontroverse të presidentit francez nuk kishin sesi të kalonin pa shqetësim në botën euro-atlantike. I gjithë ky acarim po ndodhte në një kohë kur amerikanët po fillonin të vendosnin në Evropë armët e reja taktkike bërthamore. Mbas disa javësh, pas vendimit të dë Golit për të térhequr Francën nga komanda e NATO-s, amerikanët filluan të térheqin trupat e tyre nga Franca dhe u transferuan në Gjermani. Me këtë térheqje, Franca humbi miliarda dollarë investime amerikane në fushën ushtarakë. Tashmë, mosangazhimi i dë Golit në NATO ishte fakt i kryer.

Britania e Madhe dhe Gjermania Federale po gjëzonin frytet e bashkëpunimit të ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Edhe gjatë epokës së presidencës së shkurtër të Kenedit,

marrëdhëniet franko-amerikane nuk njohën përmirësimë të dukshme. Vizita e Kenedit më 31 maj 1961 në Paris ishte një sukses paraqitjeje, por jo përmbushjesh politike. Në vetvete, dë Goli e adhuronte Kenedin (një gjë e rrallë kjo për të moçmin e Elizesë), por e konsideronte edhe të llastuar (Cook, 1987:495). Sovjetikët u munduan ta shfrytëzonin në favor të tyre acarimin franko-amerikan. Këtë gjë e bënë zyrtarisht gjatë krizës së raketave në Kubë në vitin 1962. Në kohën e bllokadës së Kubës, kur anijet sovjetike po i afroheshin zonës së kuqe, Nikita Hrushovi udhëzoi ambasadorin sovjetik në Francë, Sergej Vinogradov që të takohej menjëherë me presidentin francez. Takimi u tendos menjëherë. Ishte në stilin e dë Golit që ta fillonte bisedën me fjalët: "*Epo, po ju dëgjoj zoti ambasador*" (Cook, 1987:593). Duke bërë një ekspoze të ngjarjeve, Vinogradovi krejt pa takt paralajmëroi presidentin francez lidhur me rreziqet që do të haste Franca deri në shkatërrim bërthamor. Dë Goli qëndroi i qetë, i patundur dhe i heshtur. Vinogradovi vijoi me argumente të tjera kërcënuese, por heshtja e dë Golit ishte shtypëse. Në fund, ambasadori sovjetik i ezauroi argumentet. Pasi mbaroi së foluri, dë Goli ngrihet në këmbë dhe me një lëvizje pedante i shtrin dorën për të mbyllur takimin dhe i thotë:

*"Sa keq zoti Ambasador, ne do të vdesim së bashku! Mirupafshim, zoti Ambasador".*  
(Cook, 1987:470).

Për një njeri që ka provuar shijen e hidhur të disfatës dhe rrezikun e vdekjes në luftë dhe që deri në atë vit i kishte shpëtuar nëntë atentateve, nuk i bënte më përshtypje asgjë lidhur me vdekjen. Dë Goli nuk mund të ishte aleat i sovjetikëve në acarimin e tyre me amerikanët. Fatmirësisht, nuk do të kishte luftë, por nëse do të ndodhë padyshim që i moçmi i Elizesë do të ishte në krah të SHBA-ve.

## **6.10. Vrasja e Kenedit-komplot apo rast banal?**

Nuk kanë qenë të pakta rastet kur në historinë botërore janë goditur dhe vrarë udhëheqës shtetesh. Nga vrasja e Jul Çezarit në vitin 44 p.K. e deri te vrasja e Kenedit më 22 nëntor 1963, shumë studjues të shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare i kanë kushtuar rëndësi studimi fenomenit të vrasjes së kryetarëve të shteteve. Padyshim, çdo vrasje ka patur bujën e vet, por vrasja e presidentit Kenedi ishte diçka që tronditi pamasë botën pasi u transmetua "live". Edhe sot, sa herë që e shikon edhe në Youtube atë video të tmerrshme, të duket sikur po asiston në një ekzekutim publik. Pyetja më e thjeshtë që shtrohet është: kujt i interesonte vdekja e presidentit Kenedi dhe çfarë të keqe mund të kishte bërë për të patur një fund tillë?

Në librin "Legacy of ashes", në një intervistë të autorit Tim Weiner (Weiner) me ish drejtorin e CIA-s Riçard Helms (Richard Helms), shtrohet pyetja: a e kishte dëshiruar Kenedi vdekjen e Fidel Kastros? Helmsi përgjigjet se në letër nuk ekziston asgjë, por sipas tij nuk ka dyshim që në mendjen e presidentit të ekzistonte një gjë e tillë. Ish drejtori Helms mendonte se vrasjet politike në kohë paqeje ishin një bjerrije morale, por gjithashtu me konsiderata praktike (Weiner, 2007:187). Lidhur me këtë fenomen, fjalët e tij janë shumë domethënëse:

*"Nëse përfshihesh në biznesin e eleminimit të udhëheqësve të huaj dhe po u muar parasyh kjo [vrasja] sesa bashkëpunimi me ta, duhet bërë gjithnjë e njëjtë pyetje: nëse vret udhëheqësin e një shteti përsë ai shtet nuk duhet të vrasë tëndin" (Weiner, 2007:187)*

Pas përfshirjes në çështjen e dështuar të Gjirit të Derrave në prill të vitit 1961, besueshmëria e CIA-s tek Kenedi pësoi një rënie të ndjeshme. Kur Xhon MekKon u emërua drejtor, puna e tij e parë ishte të rivendoste besimin mes agjencisë dhe presidentit. Qysh në vitin 1963, Helmsi i cili akoma nuk ishte emëruar drejtor i parë i agjencisë, kishte

neutralizuar biznesin e paligjshëm të armëve ndërmjet Fidel Kastros dhe Venezuelës (Weiner, 2007:122). Tregtia e armëve ishte një mjet që i mundësonte mbijetësën ekonomike liderit komunist kuban. Goditja ndaj trafikut të armëve të Kastros dhe parashtrimi i kësaj goditjeje tek Kenedi, përmirësuan marrëdhëniet ndërmjet presidentit dhe agjensisë. Më 19 nëntor 1963, një tip pushke belge gjysëm automatike e destinuar për tregti, iu dorëzua në shenjë trofeje presidentit (Weiner, 2007:122). Castro sapo kishte pësuar një humbje të tmerrshme financiare. Dikush duhet të paguante për të.

Presidenti Kenedi u qëllua për vdekje më 22 nëntor 1963 në Dallas të Teksasit teksha ndodhej për një vizitë së bashku me bashkëshorten e tij. Pamjet tronditëse nuk kanë nevojë për koment. Zv/presidenti Lindon Xhonson do të shkruante në ditarin e tij:

*"Nëse 'ata' arrijnë të qëllojnë për vdekje presidentin... kë do të qëllojmë më pas? Kur do të na godasin me raketa? Dhe unë që mendoja se ishte një konspiracion dhe të gjithë e menduan si të tillë". (Holland, 2004:23).*

Më 22 nëntor 1963, në telegramin që i dërgoi të gjitha stacioneve të CIA-s nëpër botë, Helmsi i ftonte të gjithë të jepnin maksimumin për të gjetur çdo element që do të conte në zbardhjen e këtij krimi shtetëror (Helms, 2003:227). Hetimet zyrtare kishin zbuluar se një person i quajtur Li Harvej Osvald (Lee Harvey Osvald) më 1 tetor 1963 kishte bërë një telefonatë në ambasadën sovjetike në Meksikë duke i pyetur se ç'ishte bërë me kërkësen e tij për një vizë udhëtimi në Bashkimin Sovjetik (Weiner, 2007:223). Shërbimi sekret meksikan, i cili ishte një aleat i ngushtë i CIA-s, e kishte përgjuar telefonatën dhe regjistruar atë. Në pak minuta CIA ishte njohur me bisedën.

Kësaj bisede nuk iu vu shumë veshi pasi agjensia merrte me mijëra përgjime telefonatash të regjistruara të cilat në jo pak raste konsideroheshin si të pavlera. Po kush ishte Li Harvej Osvald? Në vitin 1959, ai kishte shkuar me vullnet të lirë në Bashkimin Sovjetik pasi kishte kryer shërbimin e marinës në SHBA. Departamenti i Shtetit kishte informacion se ai donte

të hiqte dorë nga nënshtetësia amerikane. Gjatë qëndrimit të Osvaldit në BS, CIA dhe FBI nuk kishin informacion të saktë se çfarë pune bënte ai atje apo nëse ishte rekrutuar nga KGB-ja (Weiner, 2007:224). Në mëngjesin e 22 nëntorit, CIA kishte dijeni se Osvaldi kishte vizituar ambasadën e Kubës dhe të Bashkimit Sovjetik në pritje për të marrë vizën (Weiner, 2007:225). Po atë ditë, presidenti Kenedi vritet publikisht. Li Osvaldi arrestohet në një kinema. Në orën 1:35 pm., presidenti Xhonson (zëvendësoi automatikisht Kenedin sipas ligjt themeltar), bën një telefonatë e cila ngriti shumë dyshime. Ai i telefonoi një komisioneri të Uoll Strtit (Wall Street) në Nju Jork duke thënë:

*"Kjo puna e vrasësit...mund të jetë më e komplikuar sesa duket... mund të shkojë thellë"* (Weiner, 2007:225).

Po atë pasdite, ambasadori i SHBA-ve në Meksikë, Tom Men (Mann) i cili ishte edhe i besuari i Xhonsonit, dha dyshimin i pari se Kastroja mund të ishte urdhëruesi i vrasjes së Kenedit (Weiner, 2007:226). Presidenti Xhonson sipas raporteve të botuara në vitet 2000, nuk e kishte idenë se SHBA-të ishin përpjekur tre herë në tre vjet për të vrarë Fidel Kastron. Shumë pak veta e dinin. I pari ishte Alan Dallas, i dyti Riçard Helms dhe i treti Bobi Kenedi (Robert Kenedi vëllai i Xhonit) (Weiner, 2007:226). Pyetja që shtrohej ishte: a kishte dijeni Fidel Castro se SHBA-të donin ta vrisnin?

Edhe gjatë intervistave zyrtare të shumta që i janë bërë, lideri legjendar kuban nuk e ka mohuar faktin se SHBA-të janë përpjekur ta vrasin. Në një dokumentar të realizuar janë numëruar 637 tentativa për të vrarë Kastron. Ndoshta shifra është e ekzagjeruar, megjithatë lideri kuban asnjëherë nuk e ka akuzuar presidentin e ndjerë Kenedi dhe ka hedhur poshtë çdo akuzë ndaj tij si urdhërues të vrasjes. Interesant është fakti se, Osvaldi kishte takuar më 28 shtator 1963 agjentin rus Valeri Kostikov anëtar i Departamentit 13 të KGB-së, që merrej me eleminime fizike. U ngriten dyshime lidhur me agjentët kubanë që punonin për

CIA-n se mos bënin lojë të dyfishtë. Njëri prej tyre Rolando Kubela (Cubela) ishte porositur që të vriste Kastron me një penë e cila mbante një shiringë të mbushur me helm. Vrasja nuk u krye madje Kubela as iu afroa Kastros. Ky fakt ngriti dyshimin se mos agjenti kishte kompromentuar me dashje operacionin (Weiner, 2007:226).

Tre ditë pas vrasjes së Kenedit, presidenti Xhonson hodhi poshtë idenë e drejtorit Xhon MekKon për një hetim të pavarur lidhur me vrasjen. Lind pyetja: përsë? Por, përsëri tre ditë më vonë më 29 nëntor 1963, Xhonsoni ktheu mendje dhe lejoi hetimin e pavarur. Erl Uoren (Earl Warren) kryetari i Gjykatës së Lartë u ngarkua të hetonte çështjen. Dyshimet shkuan përtej Fidel Kastros. Bashkimi Sovjetik a ishte i interesuar për të vrarë Kenedin? Miku dhe mbrotjësi i presidentit Xhonson dhe kryetari i komisionit të Senatit për CIA-n, senatori i Xhorxhias, Riçard Rasëll (Russell) ishte i bindur se Kastro s'kishte të bënte fare me vrasjen (Weiner, 2007:229). Nga dokumentet e fundit të deklasifikuara dhe të botuara në vitet 2000, del emri i një agjenti dezertor rus i quajtur Juri Nosenko (Yuri Nosenko). Në vitin 1964, pas një trajtmi të gjatë deri në kufijtë e çmendurisë në shtëpitë e fshehta të CIA-s, ai iu rrëfyte Riçard Helmsit (Weiner, 2007:233). Rrëfimi i tij kishte të bënte me implikimin e qeverisë sovjetike, por komisioni Uoren asnjëherë nuk e përmendi këtë detaj të rëndësishëm. Në vitin 1998, u deklasifikua dëshmia e Riçard Helmsit dhënë kongresit lidhur me vrasjen. Një pjesë të dëshmisë po e japid në këtë disertacion:

**"Z. Helms:** Nëse informacioni që Nosenko ka dhënë për Osvaldinë është i vërtetë, atëherë ai çon në një përfundim se ai [Osvaldi] ka bashkëpunuar me autoritetet sovjetike. Nëse nuk është i saktë, nëse ai po ia servir këtë SHBA-ve sipas udhëzimeve të shërbimeve sovjetike, atëherë kjo na çon në një përfundim tjetër...Nëse vërtetohet se ai gënjen, atëherë Osvaldi

padyshim është agjent i BS-së, pasojat jo vetëm për CIA-n dhe FBI-në, por mbi të gjitha për presidentin e SHBA-ve do të kishin qenë kataklizmike.

**Pyetje:** A mund të jeni më specifik?

**Z. Helms:** Po, mund të jem më specifik. Me fjalë të tjera, qeveria sovjetike urdhëroi vrasjen e presidentit Kenedi" (Weiner, 2007:233).

Por, qeveria sovjetike dhe ajo ruse pas mbarimit të Luftës së Ftohtë gjithnjë kanë mohuar çdo angazhim dhe implikim në vrasjen e presidentit Kenedi. Për këtë çështje janë realizuar dhjetëra dokumentarë dhe filma. Regjisori i famshëm Oliver Stone në filmin e tij fitues i çmimit Oskar për vitin 1991 "JFK", bazuar dhe në bashkëpunimit e prokurorit Gerison që bëri një hetim të gjerë lidhur me çështjen, e tregon ngjarjen si pjesë e një komploti të brendshëm sesa një implikim ndërkombëtar. Në librin e tij "The untold story of the United States", ai shfajëson totalisht Kastron lidhur me ngjarjen. Madje sipas tij, kur Kastro mori vesh lajmin, ai përsëriti tri herë "*Sa lajm i keq*" (Stone, 2012:325).

Konspiracion apo rast banal? Që të besosh në konspiracion, janë të nevojshme që të vërtetohen katër elementë: së pari, nëse Moska ishte e implikuar nuk do të shiste të gjitha informacionet për të mbrojtur një agjent. Së dyti, të gjithë agjentët rusë që kishin dezertuar mund të ishin agjentë të dyfishtë. Së terti, i tërë aparati sovjetik i inteligencës ishte vënë në shërbim për të shpërqendruar Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Së katërti, një hipe e madhe dyshimi qëndronte pas qeverisë sovjetike lidhur me implikimin e saj në vrasjen e Kenedit. Vetëm kaq, asgjë më shumë. Për Riçard Helmsin, ky episod në marrëdhëniet ndërkombëtare mbeti një libër i hapur. Ai nuk e pa ditën kur arkivat sovetike dhe kubane do të hapeshinn. Ai rrinte të priste derisa ndërroi jetë më 23 tetor 2002 në moshën 89 vjeçare. Atij i dukej e pabesueshme që vrasjen ta kishte bërë një qyqar si Li Osvald. Deri në

këtë periudhë, fjalën e fundit derisa të hapen plotësisht arkivat, e ka thënë presidenti Lindon Xhonson:

*"Kenedi po përpiquej të vriste Kastron, por Kastroja e goditi i pari" (Weiner, 2007:235).*

## **6.11. Nga Atlantiku në Urale**

Kriza e raketave në Kubë në vend që të afronte më shumë politikisht presidentët Kenedi dhe dë Gol, shërbeu për ndarjen e mëtejshme ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Francës. Kriza e raketave për presidentin Kenedi ishte një fitore e solidaritetit të botës euro-atlantike. Qëndresa ndaj kërcënimive sovjetike në Berlin dhe Kubë pati edhe mbështetje botërore dhe tregoi qartësisht supremacinë amerikane në armët konvencionale. Sipas konceptit të Kenedit, kriza tregoi rëndësinë e madhe që kishte kontrolli amerikan mbi armët bërthamore në çdo konfrontim me Bashkimin Sovjetik. Paqja dhe siguria do të ishin të konsoliduara vetëm nëse tregohej kjo lloj force. Ndërsa, për presidentin e Francës, kriza e raketave në Kubë shënoi mbi të gjitha dhe parimi shumë fundin e Luftës së Ftohtë (Cook, 1987:505). Duke qenë e detyruar të tërhipej përballë fuqisë amerikane në Kubë, për dë Golin, Bashkimi Sovjetik nuk do të rrezikonte më një përballje në shkallë të gjerë për një periudhë të gjatë kohe. Kriza çelte siparin e një periudhe të re mundësie në Evropë, epokën e detantës dhe të bashkëpunimit që e kishte kërkuar në mënyrë sistematike me Bashkimin Sovjetik dhe që e quante si zgjidhjen e vërtetë të shëmangjes së konfrontimit. Gjithashtu, sipas dë Golit kriza e raketave tregoi sesa e brishtë ishte Evropa dhe se fati i saj mund të vendosej nga përplasja e dy superfuqive. Ai kishte mbajtur anën e SHBA-ve, por tanimë kishte vendosur se nuk do të mbante anën e askujt që të mund të vendoste kontinentin e vjetër në një rrezik të tillë.

Në verën e viti 1962, përpara krizës kubane, presidenti Kenedi kishte mbajtur një fjalim për politikën e jashtme duke vënë theksin tek ndërvarësia e bashkëpunimit ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Evropës perëndimore (Cook, 1987:506). Fjalimi kishte të bënte me synimin e SHBA-ve që Britania e Madhe të pranohej në Komunitetin Evropian. Por, presidenti francez refuzonte çdo iniciativë që mund të bënte të mundur pranimin e Britanisë në KE. Ajo që e frikësonte më shumë dë Golin ishte përpjekja e Kenedit për të forcuar hegemoninë anglo-amerikane mbi Evropën, për ta përjashtuar atë nga çdo marrëveshje që mund të bëhej me Bashkimin Sovjetik. Ai nuk e kishte harruar përjashtimin e Francës nga konferanca e Jaltës. Politika e dë Golit ishte krejtësisht e kundërt me atë të Kenedit. Me t'u mbyllur krizat e Berlinit dhe të Kubës, dë Goli mendoi se kishte ardhur momenti të tërhiqej nga NATO-ja dhe të fillonte një politikë të re të pavarur evropiane nga Atlantiku në Urale (Cook, 1987:507).

Në të gjithë jetën e dë Golit, koncepti "Evropë" kishte lidhje të ngushtë me ndryshimet ndërmjet shekujve XIX dhe XX, si dhe me konceptet historike të cilat i kishte studjuar. Sipas tij, Evropa ishte formuar nga Kongresi i Vjenës i 1815-ës deri tek Revoluconi Rus i 1917-ës. Evropa e shteteve kombëtare ishte sankzionuar nga Kongresii Vjenës në të cilin nacionalizmi ishte forca e vërtetë e qëndrueshme shumë më tepër se çdo lloj ideologjje tjeter. Interesant është fakti se, dë Goli asnjëherë nuk e përmendte Bashkimin Sovjetik, por thoshte gjithnjë "Rusia". Madje, edhe kur takohej me Vili Brandin në Berlin, e pyeste se si ishte situata në "Prusi dhe Saksoni", kurrë nuk e përmendte RDGJ-në. Dë Goli përbuzte hapur Belgikën pasi sipas tij nuk ishte një shtet i vërtetë kombëtar. Ushqente dyshime serioze për Italinë dhe kishte më shumë interes për Vatikanin. Sistemi shoqëror, zhvillimi i blloqeve të pushteteve politike për të nuk kishin ndonjë domethënie të madhe. Kombet,

popujt homogjenë, traditat dhe kohezionet e shteteve kombëtare, ato ishin të përhershëm, ishin gjithçka (Cook, 1987:507).

Për komunizmin e Evropës lindore, presidenti francez e quante si një fazë historike e cila do të përshpejtonte tranzisionin me shpërbërjen e blloqueve të pushtetit. Për të, qëndronte fikse ideja e një Evrope nationale nga Atlantiku në Urale. Komunizmin e përbuzte publikisht dhe në një intervistë të korrikut 1963, është shprehur:

*"Qëkur kam lindur, ideologja komuniste është personifikuar nga shumë individë. Ishte periudha e Leninit, Trockit, Stalinit që e kam njojur personalisht, e Berias, Malenkovit, Hrushovit, Titos, Nagit, dhe Mao Ce Dunit. Njoh kaq shumë elementë të ideologjisë komuniste aq sa janë etërit e Evropës dhe nuk janë pak. Çdonjëri nga këta individë sipas rastit ka dënuar, mallkuar, shtypur dhe vrasë të tjerët. Në çdo formë kanë luftuar kundër kultit të individit të të tjerëve. Standarti i ideologjisë në të vërtetë shërben për të mbuluar ambicjet personale" (Cook, 1987:507).*

Mendimi i dë Golit për komunizmin dhe mbi të kaluarën dhe të ardhmen e Evropës, ishte madhështor, romantik dhe tërheqës. Por, edhe pse përmbante në vetvete shpresa, ideja e tij nuk ishte realiste dhe e vlefshme për gjysmën e dytë të shekullit XX. Ideja e tij tregoi se Franca nuk ishte në gjendje të mbante një ekuilibër mes botës perëndimore dhe asaj lindore. Me kokëfortësinë e tij, gjenerali tregoi se e kishte më të thjeshtë të prishej me NATO-n sesa me Bashkimin Sovjetik. Veprimi që armiqësoi më shumë dë Golin me SHBA-në dhe Britaninë e Madhe, ishte padyshim vendimi për të mos pranuar në KE Anglinë. Harold Makmillani ishte i sinqertë në dëshirën e tij që Britania t'i bashkohej Komunitetit Evropian. Nëse do t'ia dilte mbanë të fuste Britaninë në KE, për Makmillanin do të ishte kurorëzimi i një karriere të shkëlqyer. Në takimin e fundit ndërmjet dy liderëve në Rambuje, në vitin 1962 që ishte edhe përplasja finale lidhur me refuzimin e dë Golit për të pranuar Anglinë, Makmillani e ka përshkruar në këtë mënyrë në kujtimet e tij këtë takim fatal:

*"Dë Goli afirmaoi se për momentin Franca mendonte se ishte e rëndishme për Tregun e Përbashkët Evropian që të mbetej i pandryshuar. Nuk kishte arsyet përshtypejtohej. Britania e Madhe ishte në rrugën e duhur, por duhej të bënte durim. Ndërmjet të gjashtëve [vendeve themelues] Franca mund t'u thoshte jo edhe gjermanëve, madje mund të bllokonte iniciativat politike me forcën e saj. Sapo Britania e Madhe të anëtarësohej, gjërat do të shkonin ndryshe. Vendet e tjera që do të anëtarësohen do të kërkonin kompromise të veçanta dhe Tregu i Përbashkët do të zgjerohej aq sa do të bëhej barrë. Do të krijohej një zonë e tregtisë së lirë e cila nuk do të ishte evropiane. Me indinjatë i thashë se ajo çfarë po kërkonte të bënte ishte një refuzim për të pranuar Britaninë në TPE. Nëse kjo ishte ideja franceze, atëherë duhej refuzuar qysh në fillim. Nuk ishte e ndershme që të shpenzohej më shumë se një vit negociata për të pritur si përgjigje një kundërshtim parimesh. Dë Goli u duk i tronditit dhe më tha se isha duke u ngatërruar" (Macmillan, 1972:459).*

Në fakt, Makmillani nuk po ngatërrrohej aspak. Arsyet përsë dë Goli refuzoi Anglinë qëndronte diku tjetër. Kryeministri britanik kishte në program të fluturonte direkt nga takimi i Rambujesë për në Bahamas për një takim me Kenedin për të bindur presidentin që Anglia të furnizohej me raketa bërthamore Polaris. Kenedi nuk ishte i prirur për t'ja plotësuar kërkesën kryeministrat britanik, megjithatë pranoi, por me çmim të rëndë. Anglezët lejoheshin të blinin armët amerikane dhe të ndërtonin raketat e tyre dhe nëndetëset bërthamore, por me kusht që këto të vendoseshin nën komandën e NATO-s (Cook, 1987:511). Makmillani pranoi, por pa qejf. Franca përjashtohej nga marrëveshja anglo-amerikane. Dë Goli këtë e dinte dhe si për të acaruar më shumë marrëdhëni me anglo-amerikanët, lajmëroi se më 14 janar 1963 do të mbante një konferencë të rëndësishme për shtyp në pallatin Elize (Cook, 1987:512). Kjo konferencë ishte padyshim më e rëndësishmja që kishte mbajtur ndonjëherë dë Goli. Gjatë saj, presidenti francez deklaroi hapur çarjen me anglo-amerikanët dhe vuri në pah se tashmë në qendër të politikës së Francës do të ishte Evropa dhe jo marrëdhëni euro-atlantike (Cook, 1987:513). Për më shumë se një çerek shekulli pas mbarimit të Luftës II Botërore, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Evropa perëndimore kishin bashkëpunuar ngushtësisht për të forcuar ekonomjinë dhe sigurinë e hemisferit perëndimor. Nën këtë frysë, Makmilani shpresonte që

Britania e Madhe të pranohej në TPE dhe bashkëpunimi atomik me Francën do të forcohej. Fjalimi i dë Golit përbënte një goditje të fortë për të gjitha përpjekjet e deritanishme. Dë Goli dëshironte që Franca të kishte arsenalin e vet të pavarur bërthamor. Kenedi kuptoi jo pa keqardhje se bashkëpunimi atomik mes Francës dhe SHBA-ve përsa kohë do të ishte në pushtet gjenerali do të ishte i pamundur. Si për t'u hakmarrë ndaj dë Golit, Kenedi pak ditë më pas lajmëroi një konferencë për shtyp ku jo pa zemërim u shpreh:

*"Presidenti dë Gol mund të besojë se angazhimet amerikane në Evropë nuk janë të vlefshme, por presidenti Hrushov e beson dhe ka të drejtë. Mund të ketë arsyse përsë një komb mund të kërkojë një arsenal bërthamor personal dhe Franca i ka dekluaruar arsyet e veta, por në gjykimin tim, nuk është e saktë dhe jo e drejtë të justifikohesh duke hamendësuar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do të mbrojnë Evropën me të gjitha mjetet e nevojshme" (Cook, 1987:516).*

Lufta e Ftohtë brenda kampit perëndimor u bë evidente. Dy javë më pas, ministri i jashtëm francez Kuv dë Myrvil, deklaroi në Bruksel se çdo negociatë për të pranuar Britaninë e Madhe në Komunitetin Evropian pezullohej në mënyrë permanente (Cook, 1987:516). Vetëm se Franca harronte se në politikë dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare nuk ka asgjë permanente. "Ngrirja" e marrëdhënieve me botën anglo-saksone padyshim që nuk do t'i sillte Evropës asgjë të mirë. Nuk kishte në fakt asnjë arsyë të vërtetë se përsë duhej të ndodhët një acarim i tillë në marrëdhëniet euro-atlantike. Marrëdhëniet politike u tensionuan, por marrëdhëniet njërezojo. Kjo u vërtetua kur Kenedi u vra. Në Francë pati mbështetje masive për SHBA-të nëpërmjet manifestimeve gjigande. Për të treguar madhështinë e tyre dhe sesa larg vështronin, anglo-amerikanët menduan të bëjnë një përkujtim madhështor me rastin e 20 vjetorit të zbarkimit në Normandi. Dë Goli u zungushtë. Aq shumë u prek nga inati, saqë i ndaloj edhe kryeministrin Zhorzh Pompidu të merrte pjesë. Nëse ai vetë nuk do të ishte, atëherë askush nga Franca nuk do të merrte pjesë. Me këtë akt, çarja mes Francës dhe anglo-amerikanëve ishte plotësuar.

Për të krijuar Evropën e tij nga 'Atlantiku në Urale', dë Goli ende nuk kishte marrë një përgjigje inkurajuese nga Bashkimi Sovjetik. Nikita Hrushovi më shumë shqetësohej nga superfuqia nukleare amerikane, sesa nga qëndrimet provokuese të dë Golit. Pas vrasjes së Kenedit, Hrushovi urdhëroi të ndaleshin të gjitha eksperimentet bërthamore në thellësitë detare. Kur në tetor të vitit 1964, Hrushovi u zëvendësua nga Brezhnjevi, interes i Moskës për dë Golin u rindez (Cook, 1987:525). Në prill të vitit 1965, Moska dërgoi në Paris një ambasador të ri. Valerin Zorin i cili zëvendësoi Vinogradovin, ishte një stalinist i hekurt i cili në vitin 1948 kishte marrë pjesë direkt në grushtin e shitet komunist në Çekosllovaki dhe kishte qenë ambasador i BS-së në Kombet e Bashkuara gjatë krizës kubane dhe gjithashtu kishte qenë ambasadori i parë sovjetik në RFGJ në vitin 1956 kur u rivendosën marrëdhënet diplomatike (Cook, 1987:525). Pak pas mbërritjes së Zorinit në Francë, erdhi përvizitë zyrtare ministri i jashtëm Andrej Gromiko. Qëllimi i vizitës së tij ishte të shtrohej rruga për një vizitë zyrtare të dë Golit në Bashkimin Sovjetik. Padyshim që Bashkimi Sovjetik nuk kishte sesi të ishte i qetë dhe i ftohtë ndaj politikës së re dë Golit "nga Atlantiku në Urale" pasi një politikë e tillë do të shembte arsyen e ekzistencës të bllokut sovjetik.

Ndërkohë, dë Goli filloi një fushatë të re kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në konferencën për shtyp të shkurtit 1965, kërkoi një reformë monetare botërore ndaj Bretton-Woods duke kërkuar kthimin e arit në bazën e një marrëveshjeje të re ndërkombëtare financiare. Kjo manovër e dë Golit ishte për t'i dhënë fund hegemonisë financiare të dollarit e cila sipas tij po ia merrte frymën botës (Cook, 1987:525). Por, dë Goli nuk merrte vesh shumë nga ekonomia. Që të bëhej një manovër e tillë duhej të merreshe vesh me fuqinë kryesore ekonomike botërore. Tregtia e lirë nuk ishte e dëshirueshme nga dë Goli.

Për të, teoria e Xhon Majnard Kejnsit nuk duhet të kishte ekzistuar asnjëherë. Bota duhej rikthyer në vitet '20. Për të treguar se e kishte seriozisht, dë Goli bëri edhe hapin e paprecedent të térheqjes së Francës nga udhëheqja treshe (së bashku me anglo-amerikanët) nga Banka Botërore. Kjo politikë monetare franceze nuk e pati jetën e gjatë pasi në vitin 1971, presidenti Nikson urdhëroi ndalimin e këmbimit të arit në dollarë. Dë Goli e dinte se të triumfosh mbi një shtet duhet ta kesh në dorë financiarisht. Ishte totalisht e pamundur për Francën që të mund t'ia kalonte ekonomikisht SHBA-ve. Madje, edhe në Evropë, Gjermania Federale ia kishte kaluar ekonomikisht dhe ishte kthyer në shtetin e dytë më të fuqishëm ekonomik pas SHBA-ve.

Franca nuk pati probleme vetëm me SHBA-në dhe Britaninë e Madhe. Edhe në Komunitetin Evropian, Franca bëri një acarim të panevojshëm të marrëdhënieve. Pas dështimit të negociatave lidhur me politikat e përbashkëta bujqësore, dë Goli kërcënoi me bojkotim të çdo mbledhjeje të KE-së deri në mospagimin e asnjë detyrimi nëse nuk plotësoheshin kërkesat e Francës. Kësaj here, gjenerali i kishte shtrirë këmbët më shumë se ç'kishte jorganin. Dicka tjetër ishte t'i dilje kundër SHBA-ve në NATO dhe dicka tjetër ishte të mos respektoje angazhimet franceze të firmosura në Traktatin e Romës. Në Evropë, dë Goli kishte të bënte me ekspertë të mirëfilltë si Henri Spaak dhe Jozef Luns për të cilët traktati ishte si kushtetuta, i shenjtë. Edhe anëtarët e tjerë të Komunitetit Evropian kundërshtuan. Dë Goli nuk mund të vendoste vetëm se çfarë ishte mirë apo keq për Evropën. Kontinenti i vjetër tashmë e kishte marrë rrugën e tij. Kthim prapa në vite nuk do të kishte. Luftërat dhe mosmarrëveshjet kishin marrë fund. Evropa nuk do të kishte më kriza katastrofike. Edhe mbështetja në Francë për të kishte filluar të binte ndjeshëm. Në zgjedhjet presidenciale të 1965-ës, zuri vendin e parë, por me vetëm 44% të votave. Ai

kishte shpresuar të zgjidhej qysh në votimin e parë, por nuk ndodhi kështu. Aq shumë u zhgënje nga zgjedhësit francezë saqë deklaroi në ambjente të brendshme se do të tërhiqej përfundimisht nga skena politike (Cook, 1987:535).

Gjenerali po mbetej përherë e më i vettuar. Në balotazh me Miteranin padiskutim që fitoi, por mbështetja ishte në rënien. Aleatët e vjetër politikë si ata kombëtarë dhe ata ndërkombëtarë po i largoheshin vazhdimisht. Franca po humbte shumë nën drejtimin e tij të dytë. Tashmë, kishte ardhur koha që ai të ndryshonte, por ishte shumë krenar për t'u kërkuar ndjesë aleatëve. Evropa që ai kërkoi të ndërtonte nga Atlantiku në Urale nuk u materializua asnjëherë gjatë viteve të tij në pushtet. Edhe sot e kësaj dite, përpjekja për një Evropë të bashkuar është në ndërtim e sipër.

## **6.12. Gjermanët përballë problemit gjerman**

Fjalimi i presidentit Kenedi në Berlin në qershor 1963, bindi gjermanët mbi atë se çfarë duhet dhe çfarë nuk duhet të prisnin nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Amerika do të mbronte viabilitetin e Berlinit perëndimor, do të mbronte Gjermaninë Perëndimore, por nuk do të negacione më me Hrushovin dhe lideripin sovjetik për Berlinin dhe çështjen gjermane. Për të bashkuar Gjermaninë as që bëhej fjalë. Ky qëndrim i amerikanëve e qetësoi kancelarin Adenauer. Atij nuk do t'i duhej më të përpiquej për të realizuar negociata të vëshira për çështjen e atdheut të tij. Vendi i tij tashmë kishte mundësinë të zhvillohej qetësisht. Çështja gjermane kishte turbulluar politikën e RFGJ-së për vite dhe për këtë përgjegjëse ishin fuqitë pushtuese. Tani, gjermanët kishin mundësinë të përgjigjeshin vetë për të ardhmen e tyre. Vendimet e vështira do t'u duhej t'i merrnin vetë dhe përsa i përket të ardhmes ishte ende herët për të dhënë vlerësimë të sakta. Kenedi u kishte dhënë

gjermanëve një kupë të helmuar lidhur me të ardhmen. Amerika nuk do të vendoste më për ta. "Kupa e helmuar" e vëtmisë për të marrë vendime ishte në tavolinën e tyre. Tashmë, ekzistonin dy shtete gjermane të ndara me politika të brendshme dhe të jashtme të pavarura. Vendi ishte i ndarë jo vetëm në terma politikë dhe ekonomikë, por edhe në terma njerezo. Ndërtimi i Murit, i kishte shërbyer shumë Valter Ulbrihit për të konsoliduar pushtetin e tij dhe për të mbajtur të ndarë Gjermaninë për një kohë të pacaktuar. Ata që dëshironin të ribashkonin vendin u duhej të lëviznin shpejt.

Aleatët e RFGJ-së, kishin bërë sa kishin mundur. Por, as ata e as sovjetikët nuk mund ta fitonin garën për Gjermaninë, as me diplomaci, as me forcë. Status quo-ja ishte politika më e pëlqyer si për Moskën ashtu dhe për perëndimin në lidhje me Gjermaninë. Politikanët e RFGJ-së duhej të vepronin vetë për të bashkuar vendin, apo të paktën të përpinqeshin sikur po punonin për këtë synim. Adenaueri vijonte të kishte si mision neutralizimin e RDGJ-së (Smyser, 1999:204). Që nga viti 1958, pas përfundimit të krizës së Berlinit, ai shpeshherë e kishte ftuar Hrushovin që të diskutonin për RDGJ-në një zgjidhje "alla austriake". Sipas kësaj oferte, RDGJ-ja do të ishte një vend i neutralizuar si Austria dhe do të kishte një regjim politik i cili do të përmirësonte jetën e popullit. Pak më vonë, ndoshta pas pesë apo dhjetë vjetësh sipas mendimit të Adenauerit, zgjedhjet e lira do të përcaktonin edhe fatin e Gjermanisë. Hrushovi, as e pranoi e as e hodhi poshtë këtë ofertë. Nga dokumentet e botuara nuk rezulton t'ja ketë përmendur as Ulbrihit. (Clemens, 1989:38). Ai e mbajti si zgjidhje rezervë, duke shpresuar se një ditë do ta përdorte si këmbim për të ndarë Gjermaninë perëndimore nga aleatët e saj.

Kancelari Adenauer i kishte të kufizuara opzionet e tij për vendin. Ai nuk donte të merrej vesh me RDGJ-në. Ai i hodhi poshtë propozimet e Ulbrihit për të themeluar një

konfederatë gjermane në të cilën RDGJ-ja dhe RFGJ-ja do të kishin status të barabartë. Madje, as mesazheve të dërguara prej zyrtarëve gjermano lindorë atyre perëndimorë nuk do t'u përgjigjej njeri. Adenaueri kishte vendosur demokracinë dhe ia kishte dalë mbanë që RFGJ-ja të ishte e respektuar në botë pas një imazhi katastrofik. Bashkimi i vendit duhej të priste. Pas 14 vitesh në pushtet, kancelari i moshuar e kishte kuptuar se tashmë duhet t'i hapte rrugën pasardhësit Ludvig Erhard. Idetë e Adenauerit mbeten në sirtar. Ambasadori amerikan në Bon, Xhorxh MekGi (George McGhee) u ankua se përse nuk ishin diskutar me të idetë e kancelarit (Smyser, 1999). Frika e amerikanëve lidhur me një marrëveshje të njëanshme mes RFGJ-së dhe RDGJ-së u rrit më tepër kur mësuan se kryebashkiaku i Berlinit perëndimor Vili Brand kishte teorinë e vet lidhur me bashkimin nëse do të merrte pushtetin. Megjithë këto dyshime, amerikanët ishin të bindur se gjermano perëndimorët nuk do ta tradhtonin besimin e tyre. Avancimi gjermano perëndimor drejt lindjes u bë i mundur kur Ludvig Erhardi u bë kancelar në vend të Adenauerit. Nga marsi i vitit 1963 deri në mars 1964, misionet tregtare të RFGJ-së u zgjeruan në Poloni, Hungari, Bullgari dhe Rumani. Vetëm Çekoslovakia e refuzoi bashkëpunimin me RFGJ-në sepse akoma nuk e kishin harruar historinë e pushtimit gjerman të vendit më 1938 dhe si pasojë e refuzimit për të pritur ata gjermanë që i kishte përzënë pas përfundimit të Luftës II Botërore.

Fitorja e pavarësisë së RFGJ-së për të lëvizuar vetëm në politikën e jashtme u pa me xhelozin nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Erhardi vijoi politikën në gjurmët e Adenauerit përsa i përket aleancës së ngushtë me amerikanët. Vendosja e 200 raketave bërthamore Polaris në territorin e RFGJ-së drejtuar kundër territoreve sovjetike padyshim që do ta vinte në diskutim idenë sovjetike të një sulmi të mundshëm kundër perëndimit. Me këtë lëvizje, Bashkimi Sovjetik nuk kishte rrugë tjetër veçse atë të përbajtjes. Edhe pse

Boni zyrtar pranoi raketat amerikane, përsëri nuk e kishte autoritetin për t'i lëshuar ato. Kjo tregonte se akoma amerikanët e konsideronin RFGJ-në si aleat të dorës së dytë. Gjermanët përsëri ishin në dilemën e madhe të konfrontimit. Kësaj here numri i të vdekurve nëse do të kishte luftë do të ishte i pallogaritshëm. Atëkohë, ishte në qarkullim doktrina MekNamara e "përgjigjes së lakueshme -flexible response" (Smyser, 1999:206). Gjermanët kishin frikë se mos do t'u duhej të përballonin të vetëm agresionin atomik sovjetik. Kancelari Erhard dëshironte mbi çdo gjë tjetër bashkëpunimin me Uashingtonin lidhur me mbrojtjen. Ai iftohu marrëdhëniet me dë Golin për të pranuar propozimin amerikan të Forcës Multilaterale në vend të planit francez për një mbrojtje evropiane bërthamore (Kissinger, 1962:517). Hrushovi u nxeh nga pranimi gjerman i raketave bërthamore. Shqetësimi më i madh i liderit sovjetik nuk ishte vendosja nga amerikanët e raketave, por sepse gjermanët do të mësonin të prodhonin vetë armë bërthamore. Për sovjetikët, Forca Multilaterale (Multilateral Force) paraqiste një rrezik strategjik gjerman. Hrushovi dhe Ulbrihti akuzuan Bonin se po përgatitej të fillonte një luftë revanshiste bërthamore.

Por, në fund të vitit 1964, presidenti amerikan Xhonson dhe Sekretari i Mbrojtjes MekNamara anulluan projektin MLF. Erhardi i quajti amerikanët të pabesueshëm duke lënë zbular Bonin përballë kërcënimeve sovjetike dhe gjermano lindore si dhe inatit të dë Golit. Sipas një sondazhi, shumë gjermanë e shikonin me dyshim pas kësaj tërheqjeje amerikane praninë permanente të RFGJ-së në NATO dhe në strukturat e tjera euro-atlantike. Në vend të MLF-së, SHBA-të programuan NATO Nuclear Planning Group i cili do të zëvendësonë projektin e mëparshëm, por edhe ky veprim nuk i bindi gjermanët (Smyser, 1999:206). Vendimet e amerikanëve rritën dyshimet në RFGJ dhe bindën

gjermanët se tashmë ata do të duhej të lëviznin vetëm në marrëdhëniet ndërkontinentare dhe në çështjet e sigurisë. Hapi i parë do të ishte një politikë e jashtme përherë e më autonome.

Ndaj këtij kuadri në dukje zhgënjes, Hrushovi nuk u mjaftua me kaq. Ai lëshoi një tjetër aventurë diplomatike kundër Gjermanisë. Në mars të vitit 1964, ai njoftoi se kishte dëshirë të viziton RFGJ-në. Ai dërgoi dhëndrin e tij Aleksej Adzhubei që mbante postin e kryeredaktorit të Izvestia-s që të përgatiste vizitën. Gjatë takimeve që zhvilloi në Bon, Adzhubei u shpreh se ishte në qëllimin e Hrushovit që të përmirëson marrëdhëniet me Gjermaninë Perëndimore dhe të gjente një zgjidhje lidhur me bashkimin e Gjermanisë (Sodaro, 1990:44). Hrushovi asnjëherë nuk dha shpjegime se përsë dëshironë të viziton RFGJ-në. Me hyrjen e ekonomisë sovjetike në të ashtuquajturën "rënie e madhe" ai ndoshta do të dëshironë më shumë investime gjermane në ekonominë sovjetike. Qysh në vitin 1963, ai kishte dekluaruar se Bashkimi Sovjetik kishte nevojë për më shumë importe në lëndë kimike, sidomos në fertilizues dhe pesticide (Smyser, 1999:206). Në mars të vitit 1964, ai lajmëroi lidhjen e një marrëveshjeje me firmën Krupp. Dhëndri i tij u takua me përfaqësuesit e industrive gjermane si Krupp, Thyssen dhe Hoechst. Kur mësoi për qëllimin e Hrushovit, Ulbrihti reagoi keq. Duke qenë se nuk donte që Bashkimi Sovjetik të lidhej me industrinë kimike gjermane, ai filloi një plan të gjerë zgjerimi të lëndëve kimike në RDGJ. Njëkohësisht, ai filloi një propagandë të egër kundër RFGJ-së duke i quajtur fashiste firmat që kishte vizituar Adzhubei. (Smyser, 1999:207).

Ulbrihti shkoi më tej në distancimin e tij nga Hrushovi. Në Berlin, ai zhvilloi biseda intensive me dy komunistë stalinistë ekspertë të sigurisë; ministrin e mbrojtjes Rodian Malinovski, dhe marshallin Andrej Greçko. Ulbrihti urdhëroi gazetën zyrtare të RDGJ-së që të shkruante një artikull të gjatë ku të denoncohej Beria si tradhtar pasi kishte dashur të

bënte një marrëveshje sekrete me RFGJ-në. Shkrimi në gazetë godiste dhe paralajmëronte tërthorazi Hrushovin që të mos bënte pazare ekonomike me Gjermaninë Federale pa njohur kjo e fundit plotësisht ekzistencën e RDGJ-së. Në qershor 1964, Ulbrihti vizitoi Moskën për të nënshkruar traktatin e miqësisë dhe të bashkëpunimit me Hrushovin që në fakt ishte ide e liderit sovjetik (Smyser, 1999:207).

Nga ky moment, marrëdhënet mes Hrushovit dhe Ulbrihit morën fund. Lideri gjerman e përbuzte Hrushovin pasi kishte dështuar për të marrë të gjithë Berlinin dhe këtë e thoshte hapur. Ndoshta Ulbrihti kishte dijeni se Hrushovi do të lëvizte nga pushteti. Nëse nuk do të ishte i sigurt për këtë, ai asnjëherë nuk do të fliste hapur kundër tij. Edhe Hrushovi nga ana e tij e përbuzte thellë Ulbrihtin. Lideri gjerman e kishte futur jo pak herë në qorrskakë lidhur me Berlinin dhe çështjen gjermane në tërësi. Nga ana e saj, apo mori vesh për nënshkrimin e trakatit të miqësisë mes BS-së dhe RDGJ-së, RFGJ-ja lajmëroi se kryeministri sovjetik do të vizitonte vendin në vitin 1965. Gjithashtu, në komunikatë u lajmërua se axhenda do të ishte e hapur, çka nënkuptonte se çështja gjermane do të shtrohej në bisedime.

Por, vizita e shumë kërkuar nuk do të zhvillohej. Natën ndërmjet 14 dhe 15 tetorit 1964, Hrushovi rrëzohet nga pushteti. Pasuesi i tij Leonid Brezhnjevi, bëri një deklaratë të shpejtë në mbështetje të Ulbrihit dhe politikave të tij. Rrëzimi i Hrushovit nga pushteti u justifikua për të ndaluar aventurën gjermane kushdo që të ishte ajo. Por, Brezhnjevi nuk kishte ndihmuar pa arsyenë rënien e Hrushovit. Kjo jo se kishte simpati për Ulbrihtin dhe as për RDGJ-në, por sepse ishte i gatshëm të përmbushte dëshirat e gardës së vjetër të stalinistëve të hekurt dhe jo sepse kishte një opinion të vetin për gjërat (Smyser, 1999:208).

Nikita Hrushovi e kishte mbyllur ciklin e vet. Mund të quhet një udhëheqës komunist me fat pasi nuk vdiq në karrigen e pushtetit nga ndonjë komplot i mundshëm. Ai kishte qenë përgjegjës për ekzekutimin e Berias pasi e kishte akuzuar se dëshironte të bashkëpunonte me RFGJ-në. Ai kishte ndikuar në ndarjen e Gjermanisë dhe në ndërtimin e Murit. Gjatë kohës së tij në pushtet ai kishte kaluar të njëjtën dilemë si Stalini; si të kishte ndikim në të gjithë Gjermaninë duke pasur vetëm nën kontroll një pjesë të saj? As Hrushovi nuk i dha zgjidhje kësaj dileme, njëloj si Stalini. Rënia e Hrushovit e poshtëroi Erhardin. Më 15 tetor kancelari kishte deklaruar në Bundestag se kishte ndërmend të hapte me liderin sovjetik negociatat për ribashkimin e vendit. Ndërkohë që Erhardi fliste, Hrushovi ishte rrëzuar (Smyser, 1999: 208). Për ta kthyer poshtërimin në dëmtim, kryeministri i ri sovjetik Aleksej Kosigin, refuzoi ftesën e Erhardtit për të vizituar Bonin. Pas këtij refuzimi, politika e jashtme e Erhardtit, ngeci në vend. Ndoshta faj për këtë nuk mund t'i vihet kancelarit. Adenaueri i kishte lënë trashëgimi një rrugë të vdekur përsa i përket bashkimit. Nëse mund të thuhet se Erhardi dështoi ishte se nuk pati ide të reja në një kohë kur Gjermania po i kërkonte me ngulm ato. Duhej kërkuar tjetër alternativë.

Duke mos parë asnjë perspektivë për bashkimin e Gjermanisë në të ardhmen e afërt, kryebashkiaku i Berlinit perëndimor Vili Brandt, vendosi të ndërmerrte disa hapa vetjakë në qytet në rast se Muri binte. Qëllimi i tij ishte të takoheshin familjet e ndara ditën e Krishtlindjes dhe Vtitit të Ri 1965. Vitin e Ri 1961, Brandi kishte bërë të mundur që familjet e ndara të takoheshin. Ndërtimi i Murit në gusht, e kishte ndaluar këtë mundësi. Një vit më parë më 5 dhjetor 1963, Brandi kishte marrë njoftim nga autoritetet lindore se familjet që jetonin në perëndim mund të kalonin për të takuar familjarët e tyre (Smyser, 1999:208). Edhe aleatët ranë dakord me këtë propozim. Pas rënies së Hrushovit dhe duke

mos dashur acarimin e mëtejshëm të situatës, me lejen sovjetike, autoritetet në RDGJ lejuan për Krishtlindje dhe Vit të Ri, familjarët në të dyja anët e Murit të takoheshin. Ky ishte një sukses i madh politik për Vili Brandin në sytë e të gjithë gjermanëve. Marrëveshje për takimin mes familjarëve në të dyja anët e Murit u nënshkruan për çdo festë të rëndësishme fetare (Pashkë, Rrëshaja) për dy vjet 1965-1966 (Smyser, 1999:209). Përpjekja e kryebashkiakut Brandt kishte dhënë frytet e veta. Gjermanët po fillonin të ritakoheshin edhe pse nën mbikqyje të rreptë. Rruga drejt bashkimit do të ishte ende shumë e gjatë. Afatet për këtë nuk ekzistonin. Sovjetikët ende nuk kishin besim tek gjermanët, përfshirë edhe ata që ishin nën diktatin e tyre. E rëndësishme ishte vendosja e një ure komunikimi ndërmjet autoriteteve në të dyja anët e Murit. Sovjetikët kjo gjë i tmerronte. Pyetja që ata i mundonte më shumë ishte: Për çfarë mund të bisedonin gjermanët përtej dyerve të mbyllura? Akoma edhe sot e kësaj dite botimet e fundit nuk hedhin dritë mbi takimet në Berlin, por një gjë është e sigurtë. Ato takime hapën rrugën drejt unifikimit të Gjermanisë, kësaj here si një komb fitimtar dhe jo i përbuzur.

### **6.13. Enigma diplomatike**

Partia Kristian Demokrate në Republikën Federale Gjermane po mbyllte një cikël të jashtëzakonshëm pushteti. Tashmë, me pushtetin e Adenauerit gjithnjë e më shumë në rënje, social demokratët panë një shans të mirë për të fituar zgjedhjet dhe për të marrë pushtetin. Tre social demokratët më të rëndësishëm të asaj periudhe Vili Brandt, Egon Bahr dhe Herbert Vehner e dinin mirë sesi duhet të vepronin për të kthyer në pushtet Partinë Social-Demokrate. Brandi besonte se brezi i ri i gjermanëve ia kishte borxh vetes dhe historisë për të ecur përpëra me ide të reja. Ai e kishte marrë shumë seriozisht dhe

personalisht mesazhin e presidentit të ndjerë Kenedi. Nëse epoka e akullt e Luftës së Ftohtë ishte në përfundim e sipër, gjermanët duhet të ishin ata që do të ndikonin të hidhej hapi tjetër.

Vili Brand ishte një politikan vizionar, por jo aq shumë i dhënë pas standardeve politike. Ai mund t'i jepte zgjidhje problemeve të vjetra në fryshtë e së ardhmes. Ai arriti të bindë edhe diplomatët më skeptikë se mund ta udhëhiqte vendin me forcën e idealeve të tij. Brandi në prioritetet e tij nuk ngjasonte as me Bismarkun as me Adenauerin. Bismarku kishte zgjedhur bashkimin gjerman, por kishte refuzuar demokracinë. Adenaueri kishte zgjedhur demokracinë, por kishte shtyrë bashkimin. Brandi dante t'i bënte të dyja. Ai besonte se mund të aplikonte politikën më të drejtë. Brandi ishte dakord me Adenauerin që refuzonte politikën e Bismarkut pasi realpolitika e zgjedhur si politikë nga kancelari i hekurt e kishte dëmtuar shumë Gjermaninë. Brandi nuk e kishte qejf politikën e kalkulimeve, të interesave, lëshimeve dhe kundërlëshimeve. Ai e ndiqte diplomacinë me besim dhe intuitë, duke qenë i bindur se mënyra e tij e të sjellurit mund të arrinte më shumë sesa manovrat kujdeshme e të kalibrura të të tjera (Smyser, 1999:210).

Frika më e madhe e Vili Brandit ishte se mos gjermanët humbnin ndjenjën e të qenurit një popull edhe pse i ndarë në dy shtete. Ai nuk dëshironte që ndjenja kombëtare gjermane të atrofizohej. Ndërsa Adenaueri e shikonte bashkimin si një mundësi të largët, Brandi e shikonte si një domosdoshmëri urgjente njerëzore. Ai besonte se mund të ofronte terma më të mirë sesa Adenaueri për bashkim (Brandt, 1992:83). Si këshilltarin më të afërt për të realizuar vizionin e tij, Brandi kishte zgjedhur Egon Bahr. Bahri e kishte filluar karrierën e tij si reporter radioje dhe në këtë profesion kishte kuptuar rëndësinë e fjalës së duhur në momentin e duhur (Brandt, 1992:83). Bahri kishte një talent të rrallë për politikën e

jashtme dhe ishte i aftë të gjente zgjidhje nëpërmjet formulave të komplikuara që të tjerët as nuk arrinin t'i imaginonin. Egon Bahri dhe Vili Brandi u morën vesh shkëlqyeshëm me njëri tjetrit. Politikisht, ata ishin në gjendje të mbanin mbi supe edhe përgjegjësitë e njëri tjetrit. Njerëzisht, ata do të fillonin një politikë të re e cila do të hidhte tej dogmat e vjetra.

Egon Bahri mbështeste pa rezerva politikat e Brandit. Ai kishte të drejtë të shtyhej edhe përtej asaj që urdhëronte ai pa i hyrë gjemb në këmbë. Shumë liderë po ta kishin patur Bahrain si këshilltar do ta kishin pushuar shumë herë, por jo Brandti. Besimi i tij tek kolegu shkonte përtej imagjinatës. Ndihmësi tjetër i Brandit ishte Herbert Vehneri. Ai nuk ngjasonte aspak politikisht me Bahrain dhe konsiderohej si politikan i ashpër, por që i vinte gjërat në lëvizje. Realizmi ishte arma e tij e fortë. Nga vizionet kishte kohë që kishte hequr dorë. Gjithashtu, atij nuk i pëlqenin rolet e prestigjatorit në politikë. Duke qenë një njeri që më shumë mbështetet tek realizmi, ai mund të kontrollonte SPD-në (Partinë Social-Demokrate) më mirë sesa Brandi dhe Bahri bashkë. Vehneri donte t'u tregonte gjermanëve dhe veçanërisht aleatëve se SPD-ja kishte aftësinë për të drejtuar Gjermaninë. Por, kishte një problem. Historia nuk ishte në anën e social-demokratëve. Qeveria e Republikës së Vajmarit që drejtohej nga social-demokratë dhe komunistë kishte dështuar që këto dy lampe të punonin së bashku dhe rrjedhoja kishte qenë ardhja e Hitlerit në pushtet. Nëse social-demokratët kishin dështuar një herë pëtë të qeverisur Gjermaninë, përsë gjermanët dhe perëndimi duhet t'u besonin një herë të dytë?

Përtej forcës së Vehnerit, makinacioneve të Bahrit dhe mirësisë së Brandtit, gjermanët duheshin bindur se të majtës së moderuar mund dhe duhej t'i besohej pushteti. Herbert Vehneri mori përsipër këtë detyrë titanike; të bindte opinionin publik. Gjatë kohës së Luftës II Botërore, ai kishte luftuar nazistët për llogari të KOMINTERN-it nga Praga,

Suedia dhe kudo ku i ishte kërkuar. Gjatë luftës kishte humbur shumë familjarë e miq të cilët për shkak të rezistencës së tij kundër Hitlerit ishin masakruar (Brandt, 1992:110). Me përjashtim të Adenauerit, Vehneri zotëronte mendjen më të mprehtë politike në Gjermaninë e pas luftës. Si një ish anëtar i Partisë Komuniste Gjermane, ish agjent i Stalinit dhe një marksist i regjur ai e kuptonte shumë mirë politikën dhe pushtetin (Smyser, 1999:212). Tragjedia e Gjermanisë e kishte bindur se elektorati gjerman nuk e përkrahte më ekstremizmin. Ekperimentet radikale nuk i vlenin më Gjermanisë. Ai gjithashtu, e kishte kuptuar se punëtori gjerman nuk dëshironte të braktiste perëndimin dhe NATO-n për hir të ideologjive politike.

Në partinë social-demokrate të gjithë e kishin frikë Vehnerin për shkak të kaluarës së tij. Askush nuk guxonë t'i kthente fjalën. Miqtë i kishte të paktë. Treshja e SPD-së e kuptonte se pushteti nuk mund të merrej vetëm. Ekonomisti i talentuar Helmut Shmid ofroi një frymë të re në parti. Më 1959, ai e kishte detyruar partinë që të adoptonte një program të ri i cili në thelb kishte braktisjen e marksizmit si ideologji themeluese të saj. Më 1960, Shmidi foli hapur në Bundestag duke deklaruar se SPD-ja përqafonte linjën pro-perëndimore të Adenauerit (Smyser, 1999:212).

Vili Brandtit mundësia për të treguar vizonin e tij politik i erdhi në korrik të vitit 1963 gjatë një fjalimi të mbajtur në Bavari (Brandt, 1992:73). Ai tha se forca dhe tensioni nuk do të mund të bashkonin gjermanët. Një politikë e tillë do të ashpërsonte gjërat dhe do të dëmtonte më shumë popullin (Brandt, 1992:75). Në këtë frymë, Brandi konkludoi se cilat do të ishin bazat e politikës së re të Partisë Social-Demokrate në krye të RFGJ-së në të ardhmen. Ato ishin:

- Ribashkimi si një problem i politikës së jashtme i cili mund të zgjidhej vetëm në marrëveshje me Bashkimin Sovjetik, jo pa të dhe jo kundër tij.
- Ribashkimi kërkonte ndërmarrjen e shumë hapave dhe shumë vendqendrimeve.
- Regjimi i përbuzshëm i Gjermanisë Lindore nuk mund të shkatërrrohej; me atë duhej punuar.
- Pakënaqësia dhe përballja nuk do ta shkatërronin atë regjim, por me disa hapa të kujdeshëm mund të përmirësohej jeta në RDGJ.
- Këto mendime janë të pakëndshme dhe shkojnë kundër ndjenjave tona më të thella, por ato janë të pashmangshme (Brandt, 1992:77).

Këto ide të Brandtit binin në kundërshtim me fjalët e tij në vitin 1953 kur e konsideronte Bashkimin Sovjetik si mbrojtës të interesave të tij. Me ndryshimin e pushtetit në RFGJ, ndoshta edhe Moska do të ndryshonte diçka nga politika e saj në Gjermani. Egon Bahri tek fjalimi i Brandtit kishte shtuar edhe frazën "ndryshim nëpërmjet qasjes reciproke" e cila mbeti për një kohë të gjatë e padeshifrueshme. Kjo fjali ishte një enigmë e vërtetë diplomatike. Për transformim ishin të gjithë, po kush tjetër veç SPD-së duhej të transformohej? Mos vallë kjo frazë i drejtohej regjimit të Ulbrihit që të bëhej më tolerant? Nëse ndryshimi mund të ndodhët në një parti të majtë të Gjermanisë Perëndimore, atëherë përsë një gjë e tillë nuk mund të ndodhët edhe në anën lindore të kombit? Ndryshimin e kërkuar, Brandti mos vallë e lidhte me njohjen zyrtare të RDGJ-së dhe hedhjen poshtë të doktrinës Hallshtajn? Fjalia e Bahrit kërkonte shpjegim dhe të hollësishëm madje. Vite më vonë, Brandi ka deklaruar se nuk ishte dakord me këtë frazë pasi sugjeronte që demokracitë të ndryshonin qëndrim ndaj Bashkimit Sovjetik dhe vendeve komuniste të Evropës lindore. Bahri kishte bërë edhe një veprim tjetër. Një ditë përpara se Brandi të lexonte fjalimin, një

kopje ia kishte dërguar zyrtarëve të Berlinit lindor. SED-i e kishte lexuar me kujdes të madh, por edhe me skepticizëm. Pas shumë hezitimesh, zyrtarët e SED-it thanë se teksti nuk përmbushte aspiratat dhe domosdoshmëritë e RDGJ-së (Brandt, 1992:77).

Ministri i jashtëm i i Gjermanisë Lindore, Oto Vincer (Otto Winzer) publikisht e denoncoi fjalimin e Brandtit dhe frazën "shterpë" sipas tij (Smyser, 1999:214). Ndërsa debati sa vinte e nxehet përfundim i fortë të Brandtit, Vehneri arriti në përfundimin se Bahri kishte folur shumë. Edhe pse pati shumë skepticizëm, opinioni publik gjerman e kuptoi se SPD-ja dhe Brandti do të kishin një qasje të re përsa i përket çështjes së bashkimit të kombit. Koha do të bënte të vetën, po ashtu edhe politika gjermane.

#### **6.14. Rënia e Erhardit dhe tranzicioni i Kiesingerit**

Zgjedhjet e vitit 1965 në RFGJ treguan se populli kishte ende besim tek CDU-ja dhe te Ludvig Erhardi. Duke qëndruar përfundimisht një kohë të gjatë nën hijen e Adenauerit, shumë pak besonin se kancelari i dytë i RFGJ-së do të mund të krijonte një profil të vetin politik. Por, fitori i Erhardit në këto zgjedhje ishte një fitore si e Pirros. Numri i vendeve të CDU-së në parlament nuk i jepte mundësi manovrimi dhe të krijonte një politikë të jashtme të pavarur.

Më 25 mars 1966, Erhardi dhe Shrëderi (ministri i jashtëm) u përpoqën të bëjnë një demarsh diplomatik duke i dërguar një notë paqeje të gjithë aleatëve dhe vendeve të Evropës lindore me përjashtim të RDGJ-së (Sommer, 1967:480). Në fakt, edhe po t'i ishte dërguar nota RDGJ-së, Ulbrihti mendonte se do të përfitonte më shumë nëse mund të priste. Ai kishte të drejtë. Tranzicionet e një pushteti të gjatë janë gjithnjë të sikletshme. Jetëgjatësia e një force dhe e një individi në pushtet përfundimisht është gjithnjë të gjatë.

demokraci jetëgjatësia në pushtet shikohet si një përpjekje për kult individi. Gjermania kishte kaluar një eksperiencë shumë negative e cila i kishte sjellë shumë probleme kombëtare dhe ndërkomëtare. Kjo provë duhej anashkaluar me çdo kusht.

Ngado që të sillej, Erhardi më shumë haste në probleme sesa në zgjidhje. Presidenti amerikan Lindon Xhonson i zgjedhur në vitin 1964(zëvendësoi Kenedin me të drejtën kushtetute pas vrasjes më 1963), i kishte kërkuar që RFGJ-ja t'i vinte SHBA-ve në dispozion të gjitha facilitetet ushtarake për ndihmë në luftën që kishte nisur në Vietnam. Presidenti i kishte kujtuar Erhardit se SHBA-ja ishte miku më i mirë i Gjermanisë në Evropë dhe në botë. Xhonsoni dhe MekNamara kërkonin bashkëpunimin e plotë të RFGJ-së dhe nuk donin t'ia dinin për justifikime (McGhee, 1997:176). Madje Xhonsoni shkoi edhe më tej. Me një deklaratë publike ai dëmtoi politikën e Erhardit duke thënë se detanta Lindje-Perëndim duhet të ishte mbi çdo zgjidhje të mundshme të çështjes gjermane. Erhardi mbeti i shokuar dhe pa alternativa (McGhee, 1997:177).

Probleme Erhardi nuk kishte vetëm në politikën e jashtme. Edhe në shtëpi politikisht ishte i dobët. Deputeti i Partisë së Lirë Demokratike, Valter Shili, u largua nga koalicioni. Ralf Dahrendorfi i cili ishte edhe mendja më intelektuale e kësaj partie së bashku me Ditrih Gensherin kërkonin një politikë më aktive drejt lindjes. Kur Erhardi deklaroit se do të rriste taksat për të kënaqur kërkuesat e Xhonsonit, edhe kryetari i PLD-së (FDP-Partia e Lirë Demokratike) Erih Mende u largua nga koalicioni. Shumë anëtarë të partisë CDU menduan me të drejtë se karrierës politike të Erhardit i kishte ardhur fundi. Ekonomikisht, RFGJ-ja po ecte mirë. Erhardi si kancelar kishte zgjatur vetëm tre vjet e gjysëm dhe drejtimi ekonomik i vendit kishte ecur mirë. Por, i ndodhur përballë opozitës në rritje brenda CDU-së, Erhardi dha dorëheqjen në nëntor të viti 1966 dhe u zëvendësua nga Kurt Kiesinger i

cili do të kryesonte të parin Kopcionion të Madh në historinë e Gjermanisë së pasluftës (Lakër, 1996:308). Më 1 dhjetor 1966, Kurt Kiesingeri u emërua kancelar (Smyser, 1999:216). Vili Brandi u emërua zv/kancelar dhe ministër i jashtëm. Vehneri u emërua ministër për të gjitha çështjet gjermane dhe Egon Bahri shef i planifikimit në politikën e jashtme.

Kiesingeri i përqëndroi forcat e tij më shumë në çështjet ekonomike sesa në politikën e jashtme. Ai bëri gjithçka kishte në dorë për të përmirësuar marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik dhe me shtetet e Evropës lindore. Ai vendosi marrëdhënie diplomatike me Rumaninë në vitin 1967 dhe me Jugosllavinë një vit më vonë (Smyser, 1999:216). Të dyja këto shtete kishin marrëdhënie me RDGJ-në. Në thelb, Kiesingeri e braktisi doktrinën Hallshtajn. Përpjekjet e tij për të përmirësuar marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik u ndërprenë kur në gusht të vitit 1968, trupat sovjetike pushtuan Pragën. Kiesingeri u përpoq të ishte fleksibël në marrëdhëniet brenda Gjermanisë. Ai filloi t'i referohej RDGJ-së si "pjesa tjetër e Gjermanisë" duke shmangur frazat pezhorative si "zona e pushtuar sovjetike" dhe "RDGJ". Kiesingeri premtoi se do të bënte ç'ishte e mundur për të përmirësuar marrëdhëniet njerëzore ndërmjet Gjermanisë perëndimore dhe Lindore si dhe u përpoq të nxiste takimet kulturore mes dy vendeve.

Pesë muaj pas emërimit të tij, Kiesingeri shpalli në Bundestag një listë me kërkesa specifike për marrëdhënie më të mira ndërmjet Gjermanisë perëndimore dhe lindore. Ai propozoi lehtësi udhëtimi, kalimi, transferta parash dhe ilaçesh, bashkime familjare, tregtare, postare dhe kontakte telefonike pa harruar shkëmbimet kulture dhe sportive (Smyser, 1999:216). Për të treguar vullnetin e tij të mirë, në maj të vitit 1967, Kiesingeri i shkroi kryeministrin të RDGJ-së Vili Stof (Stoph) për t'i kërkuar firmosjen e një traktati për

normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve gjermane madje duke i premtuar edhe fonde për të ndihmuar ekonominë e RDGJ-së. Por, Stofi nuk iu përgjigj pozitivisht letrës së Kiesingerit dhe avancimi në përmirësimin e marrëdhënieve ngeci përsëri. Ky dështim rriti përsëri temperaturën brenda koalicionit të madh (Bark 2, 1993:90). Për të treguar rëndësinë dhe sa për zemër e kishte çështjen gjermane, Kiesingeri në mars 1968 urdhëroi që të hartohej një raport i përvitshëm mbi situatën në të dy Gjermanitë. Kjo detyrë iu ngarkua Vehnerit dhe ministrisë nën drejtimin e tij (Bark 2, 1993:92).

Zv/kancelari Brandt donte të shkonte më tej në çështjen gjermane dhe në politikën e jashtme. Ai filloi bisedimet me ambasadorët sovjetikë në Bon dhe në Berlinin lindor. Të dy ambasadorët sovjetikë ishin të interesuar se ç'politikë do të ndiqte Brandti po të bëhej kancelar. Edhe pse nuk kishin leje për të folur përtej gjérave formale, në konfidencë të dy ambasadorët i deklaruan Brandtit se Brezhnjevi ishte i gatshëm të përmirësonë marrëdhëniet me RFGJ-në (Bark 2, 1993:92). Si për të ndihmuar Vili Brandtin në përpjekjen e tij, ministri i jashtëm sovjetik Andrey Gromiko deklaroi për gazeten Nju Jork Tajms se "BS-ja nuk e shikonte Gjermaninë Perëndimore si armikun e përjetshëm" (Bark, 1993:93).

Megjithë atrimet e tij me sovjetikët, Brandti e dinte mirë se RFGJ-ja nuk mund të kishte një detantë private, por besonte se detanta si koncept nuk do të kishte sukses global pa Gjermaninë. Në vitin 1967, gjatë një takimi të ministrave të jashtëm të NATO-s, Brandti propozi një politikë të re hapjeje me Bashkimin Sovjetik (Bark, 1993:94). Ministri i jashtëm belg në parim ra dakord, por me kushtin që të mos hiqej dorë nga përgatitjet dhe gadishmëria ushtarake e përbashkët. Detanta me sovjetikët u ndal në gusht të 1968-ës me pushtimin e Pragës dhe me shpalosjen e Doktrinës Brezhnev (Smyser, 1999:220). Me këtë

akt, politika e jashtme e Kurt Kiesingerit merr fund. Koalicioni i Madh nuk funksiononte më. Çështja gjermane kishte mbetur pezull dhe hapat në politikën e jashtme kishin mbetur në vend numëro. Lufta e Vietnamit kishte tërhequr pothuajse të gjithë politikën e jashtme amerikane nga Gjermania. Kërkohej një lidership i ri me ide të reja.

Edhe në Gjermaninë Lindore kërkohej një ndryshim në udhëheqje. Erih Honekeri pasuesi i zgjedhur i Valter Ulbrihit nuk e përkrahte tërësisht doktrinën Brezhnev dhe deklaratën e ish shefit të tij për barazi ideologjike me Moskën. Honekeri më të marrë pushtetin në RDGJ ndoqi një rrugë të pavarur nga shteti dhe ideologjia sovjetike. Sigurisht, kjo u bë pa rënë në sy pasi publikisht deklarohej se do të ndiqej shembulli progresist i Moskës (McAdams, 1984:82). Lufta në Vietnam paraqiste pasiguri për Gjermaninë perëndimore. Acarimi kinosovjetik paraqiste pasiguri për Gjermaninë lindore. Interesat e dy superfuqive tashmë nuk përplaseshin më në Gjermani si në fillimin e Luftës së Ftohtë. Epoka e acarimit mes dy kampeve po zhvendosej dhe do të merrte tjetër trajtë. Kjo zhvendosje do t'i hapte rrugën të dy shteteve gjermane të rritnin pavarësinë në politikën e jashtme. Por, për bashkimin, duhej akoma kohë të kalonte.

## Përfundime

Problemi gjerman në fillimet e Luftës së Ftohtë pati shumë probleme që famirësish u zgjidhën pa qenë nevoja e një konfrontimi global ushtarak ndërmjet SHBA-ve dhe BS-së.

Nga Konferenca e Jaltës deri tek qeveria e Koalcionit të Madh politik gjerman, acarimi Lindje-Perëndim pati zig-zaget e veta. Në Jaltë, tre fituesit e Luftës së Dytë Botërore i dhanë jetë një sistemi sipas një stili të vjetër diplomatik të ndarjes së territoreve në dukje sovrane, por nën një diktat të caktuar politik. Lufta e Ftohtë filloi për hir të Gjermanisë. Ky

vend doli tërësisht i shkatërruar nga Lufta II Botërore në kuptimin e plotë të fjalës. Ndërtimi ekonomik, politik dhe mbi të gjitha moral i Gjermanisë nuk do të ishte i lehtë. Gjermania e kishte përlyer veten me një njollë të turpshme e të padenjë për një komb që i kishte dhënë botës aq shumë dituri dhe kulturë. Gjermanisë i duhej të kalonte një kalvar të vërtetë politiko-ekonomik si dhe shoqëror për të tejkaluar tmerrin që i kishte shkaktuar botës dhe vetes.

Fituesit perëndimorë të Luftës II Botërore kishin nxjerrë mësimet e duhura nga eksperiencat e së kaluarës. Një Gjermani e cila brenda 25 vjetësh kishte humbur dy luftëra botërore, do të ishte e tepërt të shkaktonte një të tretë. Gjermania u nda në dy shtete me sisteme të ndryshme politike dhe ekonomike. Çmimi përfajin e luftës ishte tepër i rëndë për një popull që kishte vuajtur dhe kishte shkaktuar vuajtje të panumërtë. Gjermanët e përballuan me dinjitet këtë tragedji të re që i ra vendit të tyre. Ata u ringritën shumë shpejt përfi t'i treguar botës se ishin një komb që e meritonte vendin e respektuar në marrëdhëniet ndërkombëtare. Politikanët e Gjermanisë Perëndimore ditën të përballonin presionin e madh të opinionit publik kur refuzuan ftesën e Jozef Stalinit përfashkim, me kushtin që të largoheshin nga të gjitha aleancat ndërkombëtare. Ishte një zgjedhje e vështirë që kërkonte shumë forcë përfshirë t'u refuzuar. Kancelari i madh Konrad Adenauer e pranoi këtë çmim të rëndë mbi shpatulla. Ai ishte i vetëdijshëm se brenda një shteti të bashkuar nuk mund të jetonin dy sisteme të ndryshme politike dhe ekonomike. Sfida që lëshoi ishte e fortë; cilidori nga shtetet gjermane do të ishte fitimtar në Luftën e Ftohtë ai do të kishte të drejtën që të përfshinte politikisht dhe ekonomikisht shtetin tjeter. Me pak fjalë nëse Lufta e Ftohtë do të përfundonte me fitoren e Bashkimit Sovjetik dhe të aleatëve të tij, e gjithë Gjermania do të bashkohej nën siglën e komunizmit.

Fillimet e Luftës së Ftohtë treguan ekspansionin e fuqishëm sovjetik në të gjitha sferat e jetës. Viti 1949 ishte viti kur BS-ja testoi suksesshëm bombën bërthamore duke u barazuar me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shpikja e armës më të fuqishme që kishte njohur ndonjëherë njerëzimi do ta bënte të pamundur përdorimin e saj në rast të një konflikti të drejtpërdrejtë mes dy superfuqive. Kur ndodhi kriza e raketave në Kubë, bota mbajti frymën pasi përplasja ishte më pranë se asnëherë tjetër. Është shumë i qartë fakti se liderët e dy superfuqive ishin të ndërgjegjshëm se përdorimi i armëve bërthamore do të sillte në radhë të parë shkatërrimin e shteteve të tyre.

Kjo fazë e Luftës së Ftohtë solli edhe një unitet evropian të padëgjuar më parë në histori. Në vitin 1957, pas disa negociatave të suksesshme filloi hapat e parë i ardhshmi Bashkim Evropian me gjashtë shtete themeluese. Ky hap nxori në pah edhe disa divergjenca siç ishin ato franko-britanike kur Franca me në krye presidentin dë Gol refuzoi pranimin e Britanisë së Madhe në Tregun e Përbashkët Evropian. Acarime pati mes të dyja kampeve politike. Në kampin perëndimor pati acarim në marrëdhëniet franko-amerikane dhe në kampin komunist në marrëdhëniet kino-sovjetike. Konsolidimi i aleancave ishte një tjetër sfidë e vështirë për liderët përkatës të cilët jo pak herë u përfshinë emocionalisht në "zënka" të pafrytshme.

Gjysma e dytë e viteve '60 në epokën e Luftës së Ftohtë përfundon me angazhimin e madh e të paarsyeshëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Vietnam. Ishte një luftë që filloi në vitin 1965 dhe që do të përfundojë dhjetë vjet më vonë. Prestigji, imazhi dhe besimi i SHBA-ve në këtë konflikt do të pësojnë një çarje të thellë. Ishte një luftë që nuk i përkiste popullit amerikan dhe keqllogaritë politike të katër presidentëve sollën për pak një katastrofë të vërtetë në politikën e jashtme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në fazën e parë të Luftës së Ftohtë me gjithë gabimet dhe tensionet që i shoqëruan ato në të dyja kampet, u nxorën mësimë të vlefshme. Bota perëndimore kuptoi se nuk ishte i arsyeshëm një konflikt ushtarak për të përmbysur sistemin komunist. Bota lindore kuptoi se e kishte të nevojshme të strukej prapa perdes së hekurt për të ruajtur sistemin e vet për aq kohë sa do të mbante. Muri i Berlinit u kujtonte të gjithëve se cili ishte kriteri për të mbajtur paqen. Paqja mbahej vetëm me ndarje fiktive të njerëzve si pasojë e ideologjive të paefektshme. Tashmë, bota po hynte në një fazë të re nga e cila kush do të tregonte vetëpërbajtjen më të madhe dhe logjikën më të ftohtë, do të hidhte një hap akoma më të sigurtë drejt fitores. Fitorja duhet të ishte morale përpara se të ishte politike dhe ushtarake. Liderët e rinj perëndimorë të cilët morën pushtetin në vendet euro-atlantike ishin të ndërgjegjshëm për këtë.

## Bibliografia

- ACHESON, Dean - *Present at the Creation: My Years in the State Department*, Norton, New York: 1969.
- AMBROSE, Stephen E. - *Eisenhower; soldier and president*, Simon & Schuster, New York: 1990.
- BAKER, John H. - *The decision to divide Germany*, N.C.: Duke University Press 1978.
- BARD, Mitchell - *The Arab Lobby; the invisible alliance that undermines America's interests in the Middle East*, Harper: New York, 2010.
- BARK, Denis L. & GRESS, David R. - *From shadow to substance 1845-1963*, Blackwell: Oxford, 1989.
- BARK, Dennis L. & GRESS, David R. - *Democracy and its discontents*, Vol. II 1963-1991, Blackwell: Cambridge, MA, 1993.
- BESCHLOSS, Michael R. - *The crises years; Kennedy and Khrushchev 1961- 1963*, Edward Burlingam Books: New York, 1991.

- BIRD, Kai - *The Chairman*, New York: Simon & Schuster, 1992.
- BLACK, Cyril, HELMRICH, Jonathan, HELMRICH, Paul, ISSAI, Charles, MCADAMS, James - *Rebirth*: Westview, Boulder CO, 1992.
- BORIÇI, Gjon - *Marrëdhëniet ndërkombëtare në vorbullën e diplomacisë*, GEER: Tiranë, 2006.
- BORIÇI, Gjon - *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë 1956-1978*, GEER: Tiranë, 2016.
- BORIÇI, Gjon - *Politika, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomacia në shekujt e historisë 1600-1899*, Vol. I, Bot. II, Albanian University Press: Tiranë, 2010.
- BORIÇI, Gjon - *Pushteti & lidershipi*, Bot. II, UFOPress: Tiranë, 2009.
- BRANDS, H.W. - *Traitor to his class; the privileged life and radical presidency of Franklin Delano Roosevelt*, Anchor Books: New York, 2008.
- BRANDT, Willy - *My life in politics*, Viking: New York, 1992.
- BRINKLEY, Douglas - *Dean Acheson; the Cold War years*, New Haven, CT: Yale University Press, 1994.
- BROWN, Seyorn - *The Faces of Power*, Columbia University Press: New York, 1983.
- BULLOCK, Alan - *Ernest Bevin, Foreign Secretary 1945-1951*, Heinemann: London, 1983.
- BYRNES, James F. - *Speaking frankly*, Harper & Brothers: New York 1947.
- CATE, Curtis - *The ides of August; the Berlin wall crises 1961*, Evans: New York, 1978.
- CATUDAL, Honore M. - *Kennedy and the Berlin wall crises*, Berlin Verlag: Berlin, 1980.
- CHILDS, David - *The GDR: Moscow's German Ally*, London: George & Unwin, 1983.
- CLARK, Christopher - *Iron Kingdom; the rise and downfall of Prussia 1600-1947*, The Belknap Press of Harvard University Press: Cambridge, 2006.
- CLAY, Lucius D. - *Decision in Germany*, DoubleDay: New York, 1950.
- CLEMENS, Clay - *Reluctant realities; the CDU/CSU and West German Ostpolitik*, Duke University Press: Durham, NC, 1989.
- COLLIER, Richard - *Bridge across the sky*, Macmillan: London, 1978.
- COOK, Don - *De Gaulle*, Dall'Oglio: Milano, 1987.
- CORTI, Egon - *I Rothschild*, Dall'Oglio, Varese, 1974.
- DAVISON, W. Phillips - *The Berlin blockade*, Princeton University Press: New York, 1958.
- DE PORTE, A.W. - *De Gaulle's foreign policy, 1944-1946*, Harvard

- University Press: Cambridge, 1968.
- DEIGHTON, Anne - *Cold War diplomacy; British policy towards Germany's role in Europe 1945-1949*, Berg: Oxford, 1989.
- DEIGHTON, Anne - *The impossible peace*, Oxford: Clarendon Press, 1993.
- DEPORTE, A.W. - *De Gaulle's foreign policy 1944-1946*, Harvard University Press: Cambridge, 1968.
- DOBRYNIN, Anatoly - *In confidence*, Time Books: New York, 1995.
- DUBY, Georges - *Histoire de la France; des origines á nos jours*, Larousse: Paris, 2006.
- DUCHENE, François - *Jean Monnet*, Norton: New York, 1994.
- DULLAS, Allen - *The secret surrender*, Harper & Row: New York, 1966.
- EDEN, Anthony - *Full circle*, Houghton Mifflin: Boston, 1960.
- EISENHOWER, Dwight D. - *Mandate for change 1953-1956*, Doubleday: New York, 1963.
- FISCHER, Ruth - *Stalin and the German Communism*, vol. 2, Dietz: Berlin, 1991.
- GADDIS, John Lewis - *We now know*, Clarendon Press: Oxford, 1997.
- GUHIN, Michael - *John Foster Dulles; a statesman and his time*, Columbia University Press: New York, 1972.
- HEIDELMEYER, Wolfgang & HINDRICHSH, Günter - *Documents on Berlin 1943-1963*, R. Oldenbourg: Munich, 1963.
- HELMS, Richard & HOOD, William - *A look over my shoulder: a life in the Central Intelligence Agency*, Random House: New York, 2003.
- HERKEN, Gregg - *The winning weapon; the atomic bomb in the Cold War*, Vintage Books: New York, 1982.
- HERRING, George C. - *Aid to Russia*, Columbia University Press: New York, 1973.
- HERSHBERG, James G. - *James B. Conant*, Alfred A. Knopf: New York, 1993.
- HOLLAND, Max - *The Kennedy assassination tapes*, Knopf: New York, 2004.
- IRVING, David - *Rommel: the trial of the fox*, Chatham: Wordsworth Editions, Kent, 1999.
- JENKINS, Roy - *Churchill*, Pan Books, London, 2002.
- KENNAN, George F. - *Memoirs*, New York: Pantheon Books, 1983.
- KIMBALL SMITH, Alice - *A peril and a hope: The scientists movement in America 1945-1947*, University of Chicago Press:

Chicago, 1965.

KISSINGER, Henry - *A world restored; Metternich, Castlereagh and the problems of peace 1812-1922*, Weidenfeld & Nicholson, London, 1999.

KISSINGER, Henry - *Diplomacia*, Laert: Tiranë, 1999.

KISSINGER, Henry - *Does America need a foreign policy? Toward a diplomacy for the twenty first century*, Free Press: London, 2002.

KISSINGER, Henry - *Nuclear weapons and foreign policy*, Oxford University: Press London, 1957.

KISSINGER, Henry - *On China*, Allen Lane: London, 2011.

KISSINGER, Henry - *World Order; reflections on the character of nations and the course of history*, Allen Lane: London, 2014.

LAKËR, Uollter - *Evropa në kohën tonë 1945-1992*, Dituria: Tiranë, 1996.

LENIN, V.I. - Selected Works, International Publishers: New York, 1952.

LOTH, Wilfried - *Stalin's ungeliebtes Kind*, Rohwolt: Berlin, 1994.

LOTH, Wilfried - *The Korean war and the reorganization of the European Security System*, Oxford University Press: London.

MACMILLAN, Harold - *Pointing the way 1959-1961*, Macmillan: London, 1972.

MADDOCK, Shane J. - *Nuclear Apartheid: the quest for American atomic supremacy from World War II to the present*, University of North Carolina Press: Chapel Hill, 2010.

MASTNY, Vojtech - *Il dittatore insicuro; Stalin e la Guerra Fredda*, Tea storica: Milano, 1998.

MAY, Ernest - *American Cold War strategy; Interpreting NSC 68*, Bedford Books of St. Martin Press: Boston, 1993.

MCADAMS, James - *East Germany and Détente*, Cambridge University Press: Cambridge, 1984.

MCCULLOUGH, David - *Truman*, DoubleDay: New York, 1950.

MCGEEHAN, Robert - *The German rearment question*, University of Illinois Press: Urbana, 1971.

MCGHEE, George - *On the frontline in the Cold War*, Praeger: Westport, CT, 1997.

META, Beqir - *Tensioni greko-shqiptar 1939-1949*, GEER: Tiranë, 2002.

MEYER, Frank - *Kennedy and Adenauer*, St. Martin's Press: New York, 1995.

MURPHY, Robert - *Diplomat among warriors*, Doubleday: New York, 1964.

- NAIMARK, Norman M. - *Russians in Germany; a history of the Soviet zone of occupation 1945-1949*, The Belknap press of Harvard University Press: Cambridge, 1995.
- PERSICO, Joseph E. - *Roosevelt's secret war*, Random House: New York, 2001.
- PULZER, Peter - *German politics 1945-1995*, Oxford University Press: Oxford, 1995.
- REEVES, Richard - *President Kennedy*, Simon & Schuster: New York, 1992.
- RUSK, Dean - *As I saw it*, Norton: New York, 1990.
- SCHWARTZ, Thomas - *America's Germany*, Harvard University Press: Cambridge, MA, 1991.
- SLUSSER, Robert M. - *The Berlin Crises of 1961*, John Hopkins University Press: Baltimore, 1973.
- SMITH, Jean Eduard - *Lucius D. Clay*, Henry Holt and Company: New York, 1990.
- SMYSER, W.R. - *From Yalta to Berlin; the Cold War struggle over Germany*, Macmillan Press: London, 1999.
- SNOWDEN, J.K. - *The German question*, St. Martin Press: New York, 1975.
- SODARO, Michael - *Moscow, Germany and the West from Khrushchev to Gorbachev*, Cornell University Press: Ithaca, NY, 1990.
- STONE, Oliver & KUZNICK, Peter - *The untold history of the United States*, Ebury Press: London, 2012.
- THOMAS, Gordon - *Gideon's spies; the secret history of the Mossad*, Thomas Dunne Books: New York, 2009.
- THURSTON, Robert W. - *Life and terror in Stalin's Russia*, Yale University Press: New Haven, 2006.
- TRIVERS, Howard - *Three crises in American Foreign Affairs and a continuing revolution*, Carbondale: Southern Illinois University Press, 1970.
- TRUMAN, Harry S. - *Memoirs*, vol. II, Doubleday: Garden City, NY, 1955.
- TSE TUNG , Mao - *Selected works*, vol. I, International Publishers: New York, 1955.
- VON SIEGLER, Heinrich - *The reunification and security of Germany*, Siegler: Munich, 1957.
- WEINER, Tim - *Legacy of the Ashes; the history of the CIA*, DoubleDay: New York, 2007.

WHEELER-BENNETT and NICHOLLS - *The Semblance of Peace: The Political Settlement after the Second World War*, Norton: New York, 1974.

WINDSOR, Philip - *Germany and the management of peace*, Praeger: New York, 1971.

ZHIHUA, Shen - *Mao, Stalin and the Corean War: Trilateral communist relations in the 1950s*, Routledge: London, 2012.

ZUBOK, Vladislav & PLESHAKOV, Constantine - *Inside the Kremlin's Cold War*, Harvard University Press: Cambridge, 1996.

## Dokumente të botuara

Dean Acheson, "Crises in Asia - an examination of U.S. policy", Department of State Bulletin, January 23, 1950.

Federal Republic of Germany, "Democracy in Germany", Bonn: Press and Great Britain, Ministry of Defense, Statement on Defense, London: 1955.

Hope M. Harrison, "Ulbricht and the concrete "Rose"; New archival evidence on the dynamics of Soviet-East German relations and the Berlin crises 1958-1961", Washington: Woodrow Wilson International Center for Scholars, 1993.

Information Office, 1985.

Vladislav Zubok, "Khrushchev and the Berlin Crises 1958-1962", Washington, Cold War International Project, 1993.

William Burr, "Avoiding the slippery slope; the Eisenhower administration and the Berlin crises", November 1958-January 1959, *Diplomatic History*, 18, no. 2, Spring, 1994.

## Konferenca

Alexei Filitov, "Soviet policy and the early years of two German states 1949-1961", CWIHP, Woodrow Wilson International Center for Scholars, 1994.

Kathryn Weathersby, "Soviet aims in Korea and the origin of the Korean war 1945-1950", Working paper on Russian archives, Woodrow Wilson International Center for Scholars, Washington D.C.

Mikhail Narinsky, "Soviet policy and the Berlin blockade 1948", paper presented at the conference "The Soviet Union, Germany and the Cold War 1949-1952: New evidences from eastern archives", Essen and Potsdam, June 28-July 3 1994.

## **Gazeta & Revista**

- André Philip "Lettre ouverte", Le Monde, 8 juillet 1954.
- Der Spiegel, v. 9, 30 marz 1955.
- E.J. Debeau, "Les armes atomiques et la défense nationale", Revue de Défense Nationale, Paris, Juillet 1955.
- Frankfurter Allgemeine Zeitung, 23 Juni 1955.
- Henry Kissinger, "The unsolved problems of European Defense", Foreign Affairs, July 1962.
- J. Robert Oppenheimer "Atomic weapons and American Policy", Foreign Affairs, vol. 31, July 1953.
- John Lewis Gaddis, "On moral equivalency and Cold War history", Ethics International Affairs, vol.10, 1996.
- Joseph R. Starobin, "Origins of the Cold War; the communist dimension", Foreign Affairs, July 1969.
- M. Rubinstein, "The foreign press on the atomic bomb", Moscow, Trud Newspaper no. 7(17), September 1, 1945. Teng Chao "The military weakness of American imperialism", Peking: 1950.
- Marcel Roubault, "Socialisme et énergie nucléaire", Revue Socialiste, Paris: Mai 1955.
- O.V. Trakhtenberg, "The sociology of the atom bomb", në Filosofii, Moscow: 1948, no. 3.
- Ole R. Holsti "The 1914 case", American Political Science Review 54, no. 2, June 1965.
- Paul Gérardot, "Pour des armements atomiques", Le Monde, 2 Février 1955.
- Richard S. Leghorn, "No need to bomb cities to win wars", U.S. News and World Report, vol. 38, January, 1955.
- sir Anthony W. Buzzard, "Graduated Deterrence", në World Politics, vol. 8, January, 1956.
- Sir John Slessor, "The H-Bomb: Massive Retaliation or Graduated Deterrence", në International Affairs, vol. 32, April 1956.
- Sueddeutsche Zeitung, Munich, 22 October 1955.
- Theo Sommer, "Bonn changes course", në: Foreign Affairs, 1967, f. 480.

## **Burime arkivore**

Arkivi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Viti 1955, dosja 101, 105, 227.

Arkivi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Viti 1961, dosja 97.

## **Burime nga interneti**

<https://www.marxists.org/subject/greek-civil-war>

<http://www.mfa.gov.il/mfa/foreignpolicy/peace/guide/pages/declaration%20of%20establishment%20of%20state%20of%20israel.aspx>.

[www.marxist.org/reference/archieve/hoxha/works/nov1960](http://www.marxist.org/reference/archieve/hoxha/works/nov1960)